



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 5, 6, 9, 12, 19 DHE 23 KORRIK 2018**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 5, 6, 9, 12, 19. I 23. JULA 2018. GODINE**

**KORRIK - JUL
2018**

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme,
4. Interpelanca e kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, sipas kërkesës së GP-të Lëvizjes Vetëvendosje dhe GP të LDK-së, në lidhje me vendimin e Qeverisë nr.01/50, datë 5. 6. 2018 për pagesën e 53 milionë eurove shtesë për kompaninë Bechtel & Enka në Kontratën për ndërtimin e Autostradës R6, “Arbën Xhaferri”, Prishtinë - Hani i Elezit,
5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-080 për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian për pjesëmarrjen e Kosovës në Programin e Unionit “Konkurrenca e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme COSME) 2014-2020”,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 06/L-079 për efikasitet të energjisë,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 06/L-082 për mbrojtjen e të dhënave personale,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 06/L-065 për shqyrtimin dhe vërtetimin e pasurisë së pajustificueshme,
9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 06/L-064 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-132 për automjete,
10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shërbime postare,
11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për masat mbrojtëse në importe,
12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-024 për trajtimin e ndërtimeve pa leje,
13. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës,
14. Propozimi i kandidatëve për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës,
15. Shqyrtimi i raportit vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për vitin 2017,
16. Shqyrtimi i raportit vjetor të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2017,
17. Shqyrtimi i kërkesave të Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me shpenzimet për lobim nga Presidenca dhe Qeveria e Republikës së Kosovës për miratimin e buxhetit, si dhe për zgjatjen e mandatit (afatit) të këtij komisioni,
18. Zgjedhja e një (1) anëtari të Komisionit të Pavarur për Medie,
19. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës,
20. Propozimi i Grupit Parlamentar të AAK-së për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare.

Dnevni red

1. Vreme za deklarisanje van dnevnog reda,
2. Vreme za parlamentarna pitanja,
3. Usvajanje zapisnike sa prethodnih sednica,
4. Interpelacija premijera Republike Kosova, g. Ramush Haradinaj, na zahtev PG pokret Samoopredeljenje i PG - LDK u vezi odluke Vlade br. .01/50 od 05.06.2018 za isplatu dodatnih 53 miliona evra za kompaniju Bechtel-Enka za Ugovor o izgradnji Autoputa R6, "Arbën Xhaferi" Priština-Elez Han,
5. Razmatranje Nacrta zakona br. 06/L-080 o ratifikaciji Sporazuma između Kosova i Evropske unije o učešću Kosova u Program unije "Konkurencija malih i srednjih preduzeća" COSME) 2014-2020",
6. Prvo razmatranje Nacrta zakona br.. 06/L-079 o efikasnosti energije,
7. Prvo razmatranje Nacrta zakona br. 06/L-082 o zaštiti ličnih podataka,
8. Prvo razmatranje Nacrta zakona br. 06/L-065 o preispitivanju i proveru nezakonite imovine,
9. Prvo razmatranje Nacrta zakona br. 06/L-064 o izmeni i dopuni Zakona br. 05/L-132 o vozilima,
10. Drugo razmatranje Nacrta zakona o poštanskim uslugama,
11. Drugo razmatranje Nacrta zakona o zaštitnim merama na uvoz,
12. Drugo razmatranje Nacrta zakona br. 06/L-024 o tretiranju bespravne gradnje,
13. Drugo razmatranje Nacrta zakona br. 06/L-048 o Nezavisnom nadzornom odboru civilne službe Kosova,
14. Predlog kandidata za sudije Ustavnog suda Republike Kosova,
15. Razmatranje Godišnjeg izveštaja nezavisnog nadzornog odbora civilne službe Kosova za 2017,
16. Razmatranje Godišnjeg izveštaja Nezavisne komisije za rudnike i minerale za 2017,
17. Razmatranje zahteva Parlamentarne istražen Komisije u vez i troškova za lobiranje od strane Kancelarije predsednika i Vlade Republike Kosova za usvajanje budžeta, kao i produžetak mandata (roka) ove komisije,
18. Izbor jednog (1) člana Nezavisne Komisije za medije,
19. Formiranje komisije ad hoc za izbor kandidata za članove Odbora Radiotelevizije Kosova,
20. Predlog Parlamentarne grupe AAK za zamenu članova pri parlamentarnim komisijama.

Mbledhjen e drejtoi nënkryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 22 qershor 2018.

Fillojmë me pikat e rendit të ditës, si në vijim:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Koha për deklarime jashtë rendit të ditës është e kufizuar deri në 30 minuta, diskutimi në emër të grupit parlamentar zgjat deri në pesë minuta, ndërsa diskutimi i deputetit zgjat deri në tre minuta. Deputetët e paraqitur për diskutim duhet të deklarohen se në çfarë cilësie e kërkojnë fjalën.

Mimoza Kusari-Lila e ka fjalën.

MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Sot jam para jush në deklarimet jashtë rendit të ditës për një çështje tepër me peshë që e tregon standardizimin e skandaleve në Qeverinë Haradinaj.

Përderisa ne jemi duke diskutuar për dialogun Kosovë-Serbi, shfaqen brenga për Liqenin e Gazivodës.

Në territorin e Republikës së Kosovës është një liqen tjetër, i cili po rrezikohet dhe ky është liqeni i Radoniqit.

Nëse e mbani në mend, kemi qenë këtu dy ministra të Qeverisë Haradinaj, ju kam bërë pyetje parlamentare për një ndërtim që po ndodh atje, kinse objekt administrativ, me leje të tërhequr nga komuna, gjegjësisht objekt pa leje, që të dytë kanë refuzuar se nuk është i tillë, se objekti është krejtësisht për qëllim administrativ, me deklarinimin e ministres së Mjedisit se ky objekt do të ndalet apo do t'i dërgonin inspektorët që të shohin se cili është statusi i këtij objekti.

Po ju prezantoj, kjo ka qenë gjendja e objektit, që të gjithë ta shohin, shtëpi e rojave, P+1 apo 1 kat objekt për rojën që të arrijnë të shikojnë liqenin, pejzash i mbrojtur, gjegjësisht liqeni me interes të veçantë.

Kur është nisur diskutimi në kohën sa unë isha kryetare e Komunës dhe kam ngrehur çështjen me Ministrinë e Zhvillimit dhe me Ministrinë e Mjedisit, edhe aso kohe, që të dy palët kanë thënë se ky objekt do të ndalet.

Ndërsa drejtori i kompanisë rajonale aso kohe ka deklaruar, më ka dërguar edhe një shkresë, fakti dy, që ky objekt është objekt administrativ dhe nuk ka destinacione të tjera, nuk prodhon asgjë për ndotje të mjedisit dhe nuk rrezikon kualitetin e ujit.

Fakti tre, kur dërgohen inspektorët e ndërtimit të Komunës së Gjakovës në mandatin e kaluar, ata nuk lejohen as të hyjnë brenda, është raporti, procesverbali zyrtar i inspektorëve të ndërtimit që roja deklaron se pa lejen e kryeshefit nuk mund të hyjnë brenda, po flasim për pasuri nacionale.

Fakti i katërt, vendimi për zonat e mbrojtura: ky objekt bën pjesë në zonën e dytë të mbrojtur, është 110 metra larg nga liqeni akumulues i Radoniqit. Në të cilin inspektorët e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor janë tërësisht kompetentë që ta mbikëqyrin, ndërsa gjithashtu sa i përket kësaj pjese në kuadër të zonës nuk guxon të ndërtohet, nuk guxon të mbillet, e aq më pak të ofrohen shërbime çfarëdo, ose hoteliere ose turistike, e ndaluar me ligj.

Fakti i pestë, çfarë ndodh në ndërkohë, vjen ftesa për inaugurimin e Hotel Dukagjinit.

Skandali në këtë Qeveri ka mbërritur deri në atë pikë sa me pronën publike është ndërtuar hoteli në zonën e mbrojtur, me paratë publike është keqpërdorur drejtpërdrejt një proces që është quajtur administrativ dhe pastaj ka dalë tërësisht privat. Ndërsa sot në vend të një shtëpie të rojës e kemi këtë hotel, i cili është në duar të privatit.

Çka do të ndodhë tjetër në Qeverinë Haradinaj? A duhet sot ndërtesa e Telekomit që është në qendër të Prishtinës të bëhet Sheraton, ndoshta? Ashtu-kështu s'po ka fitim asgjë, se janë duke operuar me humbje.

Për mua, nëse Prokuroria nuk i merr këto informata dhe këtë çështje ta hetojë, s'ka çudi që nesër edhe në zyrat e Prokurorisë shkojmë e bëjmë hotel ose motel, për arsye se të keqpërdoret deri në këtë pikë paraja publike, ku në pronën publike, në zonën e mbrojtur, në të gjitha shkeljet e mundshme procedurale, me shkeljen e Ligjit për menaxhimin e financave publike, me shkeljen e Ligjit për mbrojtjen e mjedisit, me keqpërdorimin e pozitës zyrtare dhe sot promovohet, inaugurohet dhe është ndërtuar një hotel, i cili absolutisht nuk e ka vendin në atë pikë, 110 metra nga liqeni akumulues.

Për informatën tuaj, Liqeni i Radoniqit furnizon me ujë komunën e Gjakovës, komunën e Rahovecit dhe një pjesë të komunës së Malishevës.

Nesër, kur do ta kemi një epidemi, për arsye se shkarkimi i ujërave të zeza nga objektet hoteliere bahet në liqenin e Radoniqit ose kudo afër, që mund ta kontaminojë, për ndryshe nuk do të ishte e ndaluar me ligj, atëherë është tepër vonë që dikush të zgjohet prej gjumit dhe të reagojë për këtë.

Qëndroj plotësisht e hapur ndaj kujtdo që ka informata ose dëshiron të marrë informata të mëtutjeshme, po për një krim të kësaj natyre, i cili ndodh bashkë me, të mos harroj, objekti i cili sot e kësaj dite është pa leje, me inaugurim ku merr pjesë edhe kryetari i komunës dhe e pre shiritin e një objekti pa leje, unë nuk di çka tjetër mund t'i thuhet këtij vendi. Faleminderit!

KRYETARI: Faton Topalli e ka fjalën.

FATON TOPALLI: Të nderuar deputetë,

Të nderuara deputete,

Nuk po flas, ky nuk është deklarim jashtë rendit të ditës, po një çështje e shtruar me urgjencë.

Në muajin korrik dhe në muajin gusht, siç e dini edhe ju, vijnë dhjetëra-mijëra mërgimtarë nga vendet e ndryshme të Bashkimit Evropian, nga Zvicra e kështu me radhë. Ata përveç që i sjellin gjallëri fizike dhe ekonomike vendit tonë, ballafaqohen me pritje të gjata disaorëshe këtu në vendin tonë, pritje të cilat janë krejtësisht të panevojshme.

Ajo që ne mund të bëjmë për ta, për çfarë nuk duhet asgjë më shumë se sa vullnet i mirë politik, është që këto pritje në kufij t'i zvogëlojmë në minimum.

Ajo që mund të dalë si pyetje nga rezoluta që do të shtroj tani për diskutim është nëse me këtë çështje rrezikohet siguri në Kosovës.

Ajo që duhet thënë është që këta mërgimtarë vijnë nga shtetet e vendeve të Bashkimit Evropian, pra kanë qëndrim të përhershëm në ato vende dhe të rregullt. Ata kalojnë disa mekanizma të sigurisë, filluar prej Bashkimit Evropian e deri në kufijtë ku përfundon Bashkimi Evropian, si në Serbi, Mal të Zi e Maqedoni.

Pra, në qoftë se do të ishin qytetarë që do të kërkoheshin nga Interpoli apo kushdo qoftë tjetër, do të ndaloheshin para se të vinin në Republikën e Kosovës.

Ajo që do të duhet të bënte policia gjatë kësaj kohe është thjesht të sigurohet që secili prej tyre, pra secili automjet të ketë policën kufitare, në mënyrë që në rast fatkeqësie të jenë të siguar.

Unë po e lexoj shpejt dhe shkurtimisht tekstin e përgatitur për këtë çështje:

Të hiqen procedurat e përditshme të kontrollit të kalimit kufitar për bashkatdhetarët tanë në të gjitha pikat kufitare të Republikës së Kosovës, përfshirë këtu edhe aeroportin e Prishtinës.

Hyrja e veturave të bashkatdhetarëve nëpër këto pika kufitare në Republikën e Kosovës të bëhet pa iu nënshtruar kontrollit të domosdoshëm, ndërsa kontrolli i tyre të bëhet me metodën e rastit.

Gjatë hyrjes në kufij të kontrollohet vetëm posedimi i policës kufitare për makina, për të siguruar dëmet e mundshme në makina.

Heqja e procedurave të rregullta aplikohet për periudhën 6 korrik 2018 deri më 31 gusht 2018.

Ministria e Punëve të Brendshme është përgjegjëse për zbatimin e kësaj rezolute.

Kjo rezolutë hyn në fuqi në ditën e miratimit në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Duke pasur parasysh qëndrimin e mirë të të gjitha grupeve parlamentare sa u përket mërgimtarëve nga Kosova, unë ju ftoj të gjithëve që ta votoni këtë mocion, për arsye se nuk shkakton tollovi, përkundrazi është një lehtësim edhe për organet e sigurisë, sepse në vend që të kontrollojnë çdo pasaportë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit!

Koha për deklarime jashtë rendit të ditës vazhdon edhe pesë minuta, do të thotë deri në 11:05.

Unë e bëra këtë përjashtim për vetë faktin se deputeti u konsulta edhe me mua, ka të bëjë me diasporën, shumica janë njerëz kontribuues. Kisha pasur dëshirë që të mos e politizojmë këtë pjesë më shumë. Fatoni së bashku me përfaqësuesit e çdo grupi parlamentar të ulen, bashkërisht mund të kemi mocion përmbajtjesor, e votojmë, po në të njëjtën kohë do të kemi një konsultim të shpejtë me Ministrinë e Brendshme për veprime që mund të ndërmerren, në mënyrën që të lehtësohet sa më shumë lëvizja e lirë. Fatmirësisht e kemi edhe ministrin e Brendshëm këtu.

Ndërkohë çdo grup parlamentar ta kishte dërguar vetëm nga një përfaqësues që të mos e ndalim rrjedhën e seancës, po të dalim me një qëndrim. Në qoftë se ministri i Brendshëm e konsideron se mund ta bëjmë, ministër, përkrahjen e të gjithë deputetëve e ke. Atëherë, s'kemi nevojë të votojmë fare, po administrativisht procedojmë, edhe kryeministri qenka aktualisht këtu, në mënyrë që të lehtësohet qarkullimi dhe familjarët të mos presin në pika kufitare.

Ndërkohë, unë pres një konsultim, Faton, në qoftë se ka mundësi personalisht me çdo grup parlamentar nga një, edhe me ministrin, e pastaj e bëni një konsultim derisa ta përfundojmë kohën për deklarime jashtë rendit të ditës.

Nga Lëvizja Vetëvendosje, Glauk Konjufca, në emër të Grupit Parlamentar.

GLAUK KONJUFCA: Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,
E pamë që javën e kaluar presidenti Thaçi doli në një konferencë për shtyp dhe i hoqi vijat e kuqe në dialogun me Serbinë.

Edhe pse prej fillimit ky dialog ishte një proces me plot të meta, Kosova u vendos e pabarabartë dhe përfaqësuesit tanë bënë dhe pranuan kompromise të dëmshme të njëpasnjëshme, prapëseprapë gjithmonë kanë qenë të nënkuptueshme tri vija të kuqe për vendin tonë.

E para, ka qenë statusi i mbyllur i Kosovës.

E dyta, ka qenë kompaktësia e Kosovës, pra integriteti territorial i Kosovës, e kjo i bie që Kosova nuk ndahet.

Dhe, e treta, ka qenë funksionaliteti i brendshëm i Republikës së Kosovës. Funksionaliteti i brendshëm, pra, e përjashton autonominë politike të serbëve në Kosovë, sepse një autonomi e kontrolluar nga Serbia gjithmonë kemi thënë që është një bosnjëzim i Kosovës.

Këto rreziqe Lëvizja Vetëvendosje i ka shpjeguar gjithmonë prej shpalljes së pavarësisë së Kosovës përmes planit të Ahtisarit. Dhe, pikërisht tash po na vijnë këto rreziqe, për të cilat ka folur gjithmonë Lëvizja Vetëvendosje.

Problemi më i madh është që ne e kemi një president, i cili shkon dhe flet me Aleksandër Vuçiqin pa kurrfarë platforme dhe e nxjerr Kosovën në tavolinën e bisedimeve.

Prandaj, përpos këtyre tri vijave të kuqe që unë i shpjegova, vija e katërt e kuqe në të vërtetë duhet të jetë për vetë presidentin Thaçi, sepse ne mendojmë që ai është një person i paqëndrueshëm për t'i mbrojtur interesat shtetërore dhe kombëtare të Kosovës.

Thënë të drejtën, ekziston edhe një arsye tjetër esenciale pse Hashim Thaçi nuk bën të jetë në krye të dialogut me Serbinë.

Ai jashtë mase është duke u frikësuar nga Gjykata Speciale. Frika e tij e madhe për vetveten mund ta dëmtojë Kosovën në këtë proces.

Edhe ne jemi kundër Gjykatës Speciale, ama Gjykata Speciale nuk luftohet duke i trajtuar interesat e Kosovës si monedhë e kusurit në raport me Serbinë dhe presidenti Thaçi natyrisht nuk mund të bëjë bash çka i thotë mendja atij.

Ai prej fillimit e nisi keq, në një mëngjes e shpalli vetveten të mandatar për t'i udhëhequr negociatat me Serbinë, kjo nuk është në rregull në një shtet demokratik, siç po pretendon të jetë Kosova.

Pra, pa kurrfarë procesi demokratik, pa e mandatar askush, pa folur me asnjë subjekt politik, thotë mjafton që mua më ka ardhur ftesa prej Federika Mogerinit dhe për presidentin tonë më e rëndësishme është t'i shtrëngojë duart edhe ta bëjë një fotografi me Vuçiqin se sa platforma çka ka duhet mbrojtur atje, për çka po shkon atje, çka të flasë me Vuçiqin atje. Më e rëndësishme është të shkojë atje dhe ta realizojë atë vizitë sesa të merremi vesh këtu në Parlament dhe të krijojmë një dokument bazik, i cili nuk e lë të eksperimentojë me interesat shtetërore të Kosovës.

Kështu që, më shumë se kurrë sot është e nevojshme që një diskutim i njëmendtë të ndodhë në këtë institucion, ku është zëri i popullit, dhe të vendosim një platformë të interesave të Kosovës, të cilat janë përnjëmend vija të kuqe për shtetin e Serbisë, vija të kuqe të cilat nuk guxon t'i lëvizë askush dhe nuk guxon askush të bëjë eksperiment me interesat e Kosovës.

Kush bën eksperimente me interesat e Kosovës, më mirë është të mos kthehet fare në shtetin tonë.

KRYETARI: Teuta Haxhiu, në emër të grupit parlamentar, e ka fjalën.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolege dhe kolegë deputetë,

Unë sot kam dalë këtu për një rast shumë të ndjeshëm, për vonimin e punimeve në Kompleksin Memorial Meja dhe procesin se deri ku kanë shkuar.

Ne më 21 qershor, në Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Persona të Pagjetur, Barazi Gjinore dhe Peticione i kishim përfaqësuesit e Shoqatës 27 prilli në komision, me insistimin tim dhe kërkesën qysh prej datës 27 prill dhe pakënaqësive të tyre që ata i shprehën pikërisht në atë datë, i kemi thirrur në takim dhe i ftuar ka qenë edhe drejtori i Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë, zoti Idriz Blakaj, i cili më 20, një ditë përpara, në orët e pasdites njofton që nuk do të marrë pjesë. Pse po e përmend këtë?

Për të treguar një shqetësim shumë të rëndë, pasi jam deputete e asaj ane, që e thanë përfaqësuesit e Shoqatës 27 Prilli, konkretisht kryetari i shoqatës.

Pos punimeve që nuk janë duke vazhduar me cilësinë e duhur, ajo që mua më ka shqetësuar më së shumtë është ajo që ata e treguan për kërkesën e shkëputjes së kontratës kompania e cila kishte filluar ndërtimin kohë më parë nga ish-kryetarja, zonja Kusari-Lila, e cila jo vetëm se e humbi Gjakovën, por nuk ka shans kurrë të kthehet atje, me insistimin e ish-kryetares është bërë shkëputja, po them, është në procesverbal kërkesa e kryetares, ish-kryetares zonja Kusari-Lila që i ka thirrur përfaqësuesit, kryetarin e Shoqatës 27 Prilli që duhet t'ia shkëpusë kontratën ish-kompanisë që e kishte filluar ndërtimin.

Ajo që është më shqetësuese, kompania e padit komunën dhe komuna obligohet të paguajë penallti, ashtu siç është thënë, mbi apo rreth 100 mijë euro dëme që ish-kryetarja ia ka shkaktuar buxhetit të varfër të Komunës së Gjakovës. Kjo për mua është një shqetësim shumë i madh, edhe një euro e vetme keqpërdorimi në Meje është më shumë se masakër, është më shumë se dhimbje që po përsëritet te familjarët, që ende kanë persona të pagjetur.

Nëse me vetëdije të plotë kjo vërtet duhet të hetohet, ka qenë ish-kryetarja kur i ka ftuar përfaqësuesit dhe u ka treguar që duhet të shkëputet kontrata dhe lidhja e kontratës, sipas tyre, nga drejtori apo ish-drejtori, zoti Blakaj, e një kompanie, siç është thënë, nuk e kam të vërtetuar, dhënë një familjari apo rrethit të ngushtë një kompanie tjetër për të vazhduar punimet, dëmi që po i shkaktohet buxhetit të komunës, kjo është shqetësim dhe, them edhe një herë, është dhimbje e dyfishtë për familjarët. Ata jo vetëm se janë të shqetësuar, por edhe një herë e ngrenë zërin për të treguar që jo vetëm që duhet hetuar, por duhet dhënë llogari edhe për një cent të vetëm keqpërdorimit nga kushdo qoftë.

Unë e them sinqerisht, nuk mund të gjej shprehje dhe fjalë në qoftë se diçka e tillë do të ndodhte nga kushdo qoftë i grupit tim parlamentar, do t'i kisha thënë të njëjtat fjalë. Zonja Kusari-Lila, më vjen shumë keq për atë kohë që keni qenë kryetare dhe jo vetëm se e keni humbur, po jam shumë e sigurt që asnjëherë nuk do të ktheheni atje. Por dikush duhet të japë llogari për çka do qoftë që humbjet edhe të një euro të vetme, e aq më tepër në ndërtimin e këtij kompleksi.

Prandaj, edhe një herë jo vetëm që bëj thirrje, por thirrje të shpejtë për të hetuar çdo gjë që është bërë me qëllim apo po qëllim nga kushdo qoftë në këtë kompleks. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zonja deputete, ke qenë edhe në Qeveri, deklarimi jashtë rendit të ditës, nuk ka. E shfrytëzon t'i më vonë në debate kur të kemi.

Nuk kam të drejtë, e kisha bërë, po nuk kam të drejtë, pyeti edhe kolegët e grupit, nuk kam të drejtë. Zafir Berisha e ka fjalën në emër të grupit.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit!

Unë po vazhdoj aty ku kam mbetur edhe në seancat e kaluara për disa çështje preokupuese. Në njëri nga seancat e kaluara unë kam pasur edhe një pyetje parlamentare për ministrin e Bujqësisë, të cilin nuk është rëndë të dihet se ku gjendet. Kryeministri e ka dhënë një premtim se do të ketë përgjigje në pyetjen time, por megjithatë kaluan disa muaj dhe nuk kam marrë përgjigje, është fjala rreth Ligjit për pyjet.

Ligj, i cili dy legjislatura është duke u pluhurosur nëpër sirtarët e ministrisë dhe Qeverisë dhe nuk vjen në Parlament. Si rezultat i kësaj ngecjeje të rishikimit të ligjit, ne kemi një kaos në nivel Kosovë, kur kemi parasysh se 46% përafërsisht të territorit të Kosovës menaxhohet nga Agjencia e Pyjeve dhe, në fakt, mosrishikimi i ligjit ka nxjerrë shumë probleme në menaxhimin e pronave publike, ku shumë keqbërës, privatë, por edhe të biznesit i përdorin dhe i keqpërdorin pronat publike të Kosovës dhe nuk i japin llogari askujt. Mungesa e ligjit prodhon dhe kaos urbanistik dhe shpeshherë, edhe institucionet si lokale, si qendrore, janë në pozita të këqija kur kanë parasysh se investimet e domosdoshme që duhet të bëhen në prona publike që menaxhohen nga Agjencia e Pyjeve dhe, në këtë rast thjesht detyrohen edhe të bëjnë shkelje.

Mendoj se kjo çështje duhet të përshpejtohet për të mundur të vihet rend në këtë fushë dhe një çështje tjetër, e cila nga legjislatura e tretë përmendet disa herë nëpër të gjitha legjislaturat, por në fakt, nuk ka pasur as guxim të merrej me çështjen e Ligjit të lustracionit. Pse po them Ligjin e lustracionit, sepse ne kemi nëpër institucione shumë figura publike me hipotekë, të cilët po shantazhohen nga krimi i organizuar dhe si rezultat i shantazhit pastaj po marrin vendime dhe veprime jo të hijshme që nuk i shërbejnë as demokracisë, as perspektivës së shtetit tonë. Në këtë kontest, unë kisha kërkuar nga Qeveria që ta mendojë çështjen për Ligjin e lustracionit para se të marrë iniciativë si grup i deputetëve, sepse edhe kartat evropiane e parashohin për vendet e dala nga ish-blloku komunist që të kenë një ligj për pastërtinë e figurave, sepse pastërtia e figurave thjesht në Kosovë ka bërë që ne të kemi një gjendje jo të mirë, veçanërisht në drejtësi dhe shpeshherë, në emër të drejtësisë u është bërë qytetarëve padrejtësi për shkak të asaj që e thashë edhe më herët se, thjesht individë të caktuar, me të kaluar të dyshimtë po shantazhohen nga “nëntoka”.

Mendoj se Kosova duhet të mendojë edhe për ventingun, sepse institucionet e stërmbushura me njerëz jokredibilë e nxjerr nevojën urgjente që Kosova, institucionet e Kosovës të mendojnë edhe në këtë drejtim, sepse ventingu disa nga çështjet të cilat po diskutohen në publik, herë me vend e herë pa vend, mund të sqarohen për individë dhe institucione të caktuara. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Besa Baftiu, në emër të grupit parlamentar, Islam Pacolli, në emër të të pavarurve. Besa Baftiu, një herë, Islam, mos u ngut!

BESA BAFTIU: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Unë sot dola para jush të ngre një shqetësim të qytetarëve të Republikës që është shqetësim edhe yni, sa i përket gjendjes së rëndë në sektorin e shëndetësisë.

Të deklaroj se gjendja në sektorin e shëndetësisë është e rëndë, unë e di që nuk është risi, sepse këtë e kemi thënë dhe dëgjuar për 19 vjet. Në çdo legjislaturë të sallës në këtë Kuvend nga deputetët është diskutuar për gjendjen në këtë sektor dhe është kërkuar që sektori i shëndetësisë, si njëri ndër sektorët me rëndësi vitale, të ketë trajtimin e duhur nga ana e Qeverisë dhe të jetë po ashtu prioritet. Mirëpo, një gjë e kemi të qartë të gjithë: qeveritë deri më tani nuk kanë treguar vullnet politik për të mbështetur dhe për të rregulluar sistemin shëndetësor. Ministria e Shëndetësisë nuk ka arritur që t'i përmbushë objektivat dhe detyrat që i përkasin si ministri, si pasojë ne sot po gjendemi përballë një realiteti të hidhur në këtë sektor, apo gjendemi përballë kolapsit, ku në spitalet tona publike shpeshherë nuk gjenden as barnat vitale, barna, të cilat janë të domosdoshme për të shpëtuar jetën e pacientëve.

Të nderuar deputetë,

Kjo mungesë e barnave esenciale, materialit shpenzues, përveç të tjerave, po ndodh sepse ka pasur keqmenaxhim dhe keqpërdorim të buxhetit në prokurimin e barnave të listës esenciale. Unë po besoj se e keni parë apo edhe e keni dëgjuar një hulumtim që është bërë nga Instituti Columbus, e që po besoj po ashtu, gjithsecili që e keni parë jeni tmerruar në atë që ka ndodhur në prokurimin e barnave gjatë viteve 2016-2017. Efektet e këtyre keqpërdorimeve po i bartin pacientët tanë, të cilët janë të detyruar t'i blejnë nga shiringat e deri te penjtë kirurgjikë. Unë këtu me vete e kam një foto, ku e kam marrë në njërin nga repartet, ku shkruan se mungon alkooli, ampula kavitan, gjilpërat, pambuku. Në këtë hulumtim është gjetur se çmimi i barnave është rritur nga 100 deri në 2 000 %, e ku janë mbi 200 produkte farmaceutike që kanë pësuar një rritje të tillë, çmime këto që kanë qenë shumëfish më të shtrenjta se çmimet në barnatoret private. Miliona euro janë keqpërdorur nga disa kompani farmaceutike, ku me të njëjtën shumë të hollave janë blerë më pak barna se sa një vit më parë.

Po e paraqes vetëm një shembull nga shumë sosh, se si është rritur çmimi i barnave pa ndonjë arsye. Për shembull: ampula noradrenalinë apo edhe adrenalinë për atë që janë në këtë sektor, e dinë se çfarë peshe ka kjo ampulë, pa të cilën mjeku nuk guxon as të fillojë të punojë. Prandaj, shumë herë kjo ampulë edhe mungon në spitalet tona. Për këtë ampulë, për një njësi është paguar 2 euro e 78 centë në vitin 2016, për të njëjtin produkt Ministria e Shëndetësisë në vitin 2017 ka paguar 22 euro, që i bie që Ministria e Shëndetësisë ka kontraktuar një produkt 800% më të shtrenjtë, e ku janë produktet e tjera, si stostatikët, edhe ashtu janë me vlerë të njëjtë, apo me vlerë shumë herë më të shtrenjtë. Prandaj, një gjë e tillë ka ndikuar që sot në spitalet tona

mbulueshmëria me barna nga lista esenciale, po ashtu edhe mbulueshmëria me citostatikë të jetë e ulët. Sot e kemi një mbulueshmëri me citostatikë diku 40%, e që 60% duhet t'i mbulojnë vetë pacientët.

Por, jo vetëm stostatikët, edhe barna të tjera të listës esenciale mbulueshmëria kurrë nuk ka qenë më keq, pothuaj në çdo spital nuk kalon 50%, e në anën tjetër, asnjëherë më parë buxheti për shëndetësi, gjegjësisht për barnat nga lista esenciale nuk ka qenë më i lartë se sa këtë vit. Prandaj, këto mungesa të barnave në spitale mund të arsyetohen vetëm me dështim të Ministrisë së Shëndetësisë, që të menaxhojë furnizimin me barna. Këtu i kam disa të dhëna, të cilat janë nxjerrë sa i përket furnizimit me barna të listës esenciale dhe materialit shpenzues në disa nga spitalet e përgjithshme, regjionale të Republikës së Kosovës. Në muajin maj, Qendra Klinike Universitare ka qenë e furnizuar me 57% me barna nga lista esenciale, me 41% me material shpenzues, Prizreni me 44% me barna, me 18% me material shpenzues, Gjakova 58% me 26%, Gjilani 41% me 24%, Ferizaj 47% me 27%, Peja 44% me 20%...

(Ndërprerje nga regjia)

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetarja e Kuvendit, znj. Aida Dërguti.)

KRYESUESJA: Fjalën e ka Islam Pacolli.

ISLAM PACOLLI: Përshëndetje, kryesuese!

Përshëndetje kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Kolegë të nderuar,

Media,

Kor diplomatik.

Unë kam dy, si të them, kërkesa nga ministri i Transportit, pyetje, në fakt: rruga e Pejës deri më sot e dini që ana e Pejës nuk është investuar gati thuajse fare, është një rrugë që ka filluar kaheër, tani me qeverisjen e tanishme do të thotë ka mbetur edhe një pjesë pa përfunduar. Besoj që, apo kërkoj nga ministri nëse ka mundësi që ta përfundojnë këtë rrugë, pasi që këtë rrugë e frekuentojnë shumë edhe atdhetarët, edhe qytetarët e komunës së Podujevës. Kjo rrugë, do të thotë, ka qenë më herët, pastaj e ka zënë edhe Qeverinë e tanishme. Dua të përgëzoj Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe ministrin Pal Lekaj për përkrahjen e Komunës së Pejës për rrugën për Majën e Zezë - Peklan, 13 km, shpresoj që të keni kurajë dhe të gjendet prapë mundësia e financimit, edhe pse ka vështirësi për financim, unë e kuptoj drejt, po zoti ministër, ju e keni bërë një punë të madhe për këtë çështje deri më tani, besoj që tutje do ta shqyrtoni mundësinë e vazhdimit të kësaj pjese, pasi që hapet një pjesë e mirë turistike. Peja nuk e ka vetëm Rugovën, por i ka edhe këto pjesët e tjera dhe sigurisht do të ishte e rëndësishme për atë zonë. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Koha për deklarime jashtë rendit të ditës ka përfunduar. Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Koha për pyetje parlamentare

Për këtë seancë janë parashtruar 55 pyetje parlamentare dhe po ju thërras sipas renditjes. Deputeti Haxhi Avdyli ka pyetje për kryeministrin Ramush Haradinaj.

HAXHI AVDYLI: E nderuar kryesuese!

I nderuar kryeministër,

Pyetja ime ka të bëjë për agjencitë apo komitetet për reforma shtetërore, ku e keni emëruar një koordinator nacional për reforma shtetërore. Një organizim ende i paqartë dhe i pakuptueshëm në kompetenca dhe përgjegjësitë, për mua. Pyetja ka të bëjë jo vetëm për këtë koordinator, por edhe për shumë koordinatorë të tjerë, të cilët janë krijuar: cila është veprimtaria e këtyre organizimeve paralele, konkretisht për reforma? Kur dihet që reformat sektoriale bëhen në secilën ministri dhe pse po i duhet Qeverisë të krijojë poste të tjera për zyrtarët, apo ndoshta po e shihni këtë si mënyrë për të punësuar dhe rehatuar zyrtarët tuaj të pasistemuar në poste ministore dhe zëvendësministra?

Mendoj që në këtë drejtim duhet të na jepni sqarim, cilat janë kompetencat e tyre dhe në cilat fusha bie ndesh me fushën e ministrive adekuate, të cilat i mbulojnë këto fusha? Faleminderit!

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: E nderuar kryesuese e Kuvendit, zonja Dërguti!

Të nderuar deputetë,

Kolegë të Kabinetit qeveritar,

I nderuar deputet, zoti Avdyli, përgjigjja në pyetjen tuaj është si vijon: emërimi i Besnik Tahirit si koordinator nënkupton që reformat shtetërore kanë hyrë në një intensitet më të madh dhe janë marrë me përkushtim. Kjo pozitë, si e tillë, pra e koordinorit, nuk është paralele, nuk është as agjencia dhe nuk ndërhyt në mandatin dhe përgjegjësitë e ministrive përkatëse. Zoti Tahiri ka përgjegjësinë në ngritjen e koordinimit në nivel qendror dhe në mes të nivelit qendror dhe komunal, dhe ngritjen e efikasitetit në funksion të reformës që dalin nga Agjenda Evropiane e Reformave, ERA, ofrimin e rekomandimeve dhe informatave për Qeverinë, institucionet vartëse dhe partnerët në lidhje me dinamikën e reformave. Mbështetja e procesit të reformave të Administratës Publike, me fokus te pakvoja e tri ligjeve dhe Ligjit për Qeverinë, komisionin e të cilët e udhëheq zoti Tahiri. Ajo që e bën më të mirë këtë proces, pra emërimin e zotit Tahiri është mirëpritur nga ana e partnerëve ndërkombëtarë, në veçanti nga ana e Komisionit Evropian, të cilët janë shprehur më 26 prill 2018 në deklaratën zyrtare, që është në ueb faqen e BE-së, palët kanë pranuar se emërimi i koordinorit nacional për reforma shtetërore në Zyrën e Kryeministrit është i mirëpritur, pasi forcon koordinimin në nivel qendror të Qeverisë dhe lehtëson procesin e reformës.

Përveç kësaj, zoti Tahiri ka arritur të përfshijë drejtpërdrejt në këtë proces aktorë kyçë të institucioneve të ndryshme të shtetit dhe të shoqërisë civile. Përgjigjja është përgatitur në kohën kur është menduar se pyetja dedikohet vetëm për këtë koordinator, në një rrethanë tjetër, mund t'ju jap shpjegime shtesë për rolin e koordinatorëve të tjerë. Faleminderit!

KRYESUESJA: Deputet, keni pyetje shtesë?

HAXHI AVDYLI: A do të thotë kjo, kryeministër, që ministri i Administratës ka dështuar në reforma, kanë dështuar ministrat e tjerë dhe duhet që përmes një koordinatori t'i koordinoni reformat përmes tij, apo ku është problemi? Sepse ne e dimë që bartësi i reformave në administratë është ministria gjegjëse, bartës i reformës në shëndetësi është Ministria e Shëndetësisë, bartës i reformës në Administratë Lokale janë ministrinë gjegjëse dhe pse po duhet që tash dikush t'i koordinojë këto? Kjo nuk m'i përmbush ato sqarimet e mia, por sidoqoftë faleminderit për sqarimin tuaj.

KRYESUESJA: Kryeministër, e keni fjalën!

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: I nderuar deputet Avdyli,

Do të thotë, secila ministri është përgjegjëse për fushën e vet të veprimt, mirëpo koordinimi mes ministrive, mes institucioneve të nivelit qendror e komunal, mes aktorëve të tjerë, por edhe partnerëve në raste të caktuara përdoren formula të ndryshme, si komisione ndërministrorë, si trupa të caktuar, veçanërisht kur bëhet fjalë për një temë, e cila ndërlidh aktorë të ndryshëm, të niveleve të ndryshme, por përfshirë edhe partnerët, në këtë rast BE-në.

Pra, vërtet kjo nuk është mohim i punës së ndonjëres nga ministrinë, por është vetëm bashkërenditje e punëve, ta zëmë, të kryera nëpër këto mekanizma. Ju siguroj se rasti në fjalë, i koordinatorit në fjalë, ishte domosdoshmëri për gjendjen e tashme në reformat e nevojshme për ERA-në, Agjendën Evropiane që kemi para vetes.

KRYESUESJA: Deputeti Driton Çausi ka pyetje për kryeministrin Ramush Haradinaj.

DRITON ÇAUSHI: Faleminderit!

Është hera e dytë që kjo pyetje po shtrohet, për shkak se mendoj që çështja është shumë më emergjente se sa është duke u trajtuar nga ju, zoti kryeministër. Megjithatë, unë nuk po gjej mekanizëm tjetër përveçse të përsëris pyetjen, pra janë tanimë gati 4 muaj qysh në Kosovë qytetarët përballen me një situatë alarmante të shëndetit publik, e cila u shpërfaq me rastin e transportit ose importit të mishit me afat të skaduar, e cila pasoi me konfiskime të shumta të tonelatave të tëra në qytete të ndryshme të Republikës së Kosovës, të ushqimit, kryesisht mishit, por edhe forma të tjera tepër të rrezikshme për shëndetin publik.

Kuvendi i Kosovës ka mbajtur një debat më 18 prill dhe ka votuar rekomandime më 26 prill në lidhje me këtë çështje. Përsëris që situata aktuale e sigurisë ushqimore është kërcënim serioz për shëndetin publik, pavarësisht se qytetarët përballen me probleme të shumta dhe kjo çështje ka humbur nga vëmendja edhe e mediave, edhe e opinionit publik në përgjithësi. Unë dua të insistoј dhe të pyes se cilët janë hapat që ju keni ndërmarrë në përmbushjen e rekomandimeve të dala nga ky Kuvend, ku parashihet edhe marrja e masave adekuate ndaj Bordit dhe menaxhmentit të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinës. Nuk ka institucion tjetër që mund të bartë përgjegjësinë më të madhe dhe pasojat nga mungesa e kësaj përgjegjësie janë tepër të dukshme, zoti kryeministër...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: E nderuar kryesuese!

Të nderuar deputetë,

Kolegë të Kabinetit qeveritar,

I nderuar deputet Çaushi,

E vërtetë se lajmi ka qenë shqetësues, ka pasur edhe në të kaluarën lajme për produkte të tjera, ose për zhvillime të tjera që rrezikojnë shëndetin e qytetarit tonë. Lidhur me këtë, pra Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, sipas detyrës zyrtare dhe në kohë reale më 14 mars 2018 ka njoftuar organet kompetente, Policinë e Kosovës, respektivisht njësitin përkatës për hetime dhe Prokurorinë e Shtetit për ndërmarrjen e veprimeve përkatëse ndaj operatorëve të biznesit me ushqim, të cilët dyshohen se kanë bërë shkelje të dispozitave ligjore. Pra, menjëherë nga marrja e informatës, ndërsa në datat 20 dhe 21 mars 2018 ka realizuar edhe kontrollin zyrtar në bashkëpunim me institucionet e lartpërmendura, pra ka vizituar dhe ka bërë kontrollet e nevojshme.

Pra, kësaj Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, lëndët në të cilat ka konstatuar shkelje ligjore i ka proceduar pranë gjykatës kompetente për ndërmarrjen e veprimeve ligjore sipas legjislacionit në fuqi. Po ashtu, ju njoftojmë se pas kontrollit zyrtar dhe të gjeturave faktike, është urdhëruar pezullimi i ushtrimit të aktivitetit për një periudhë ndaj operatorëve të biznesit, urdhër i cili është zbatuar plotësisht nga ana e tyre. Aktiviteti i kontrollit zyrtar të agjencisë është kryer në bashkëpunim të plotë dhe profesional brenda institucioneve të përfshira, gjithnjë i konsultuar me Prokurorinë themelore, pra në Prizren.

Po ashtu, në muajin mars 2018 agjencia e ka paraqitur kërkesën për mbështetjen buxhetore në Ministrinë e Financave me dokumentin përkatës 2019-2021, në kuadër të së cilit përfshihet furnizimi me pajisje laboratorike, pajisjen e inspektorëve me pajisje pune, po ashtu kërkesa buxhetore për transferimin e inspektorëve nga niveli komunal në agjenci, me qëllim ngritjen e kapaciteteve inspektuese dhe ngritjen e një zinxhiri unik të inspektimit në gjithë territorin e vendit. Me mbështetje të Projektit për siguri ushqimore 2017-2019, i cili financohet nga

Komisioni Evropian, është duke zhvilluar programin softuerik lidhur me kontrollet zyrtare dhe aktivitetet e tjera të agjencisë, program, i cili nga data 1 korrik 2018 hyn në zbatim. Agjencia e Ushqimit krahas ushtrimit të mandatit të saj të udhëhequr nga parimet që po caktohen me Ligjin për ushqimin, për çdo aktivitet në realizimin e kontrolleve zyrtare po ashtu ka treguar transparencë të plotë dhe besueshmëri ndaj opinionit publik.

Përmes këtij programi do të prezantohen në ueb faqen e agjencisë të gjitha aktivitetet që kanë të bëjnë me kontrollet zyrtare, inspektimet, ku njëkohësisht ueb faqja aktuale është aktive dhe përditësohet vazhdimisht për të gjitha të rejtat që kanë të bëjnë me regjistrimin dhe aprovimin e operatorëve të biznesit për ushqim. Në mbështetje të kontrollit kufitar të ushqimit agjencia është duke përgatitur procedurën standarde...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESJA: Deputet, keni pyetje shtesë?

DRITON ÇAUSHI: Kryeministër, e kuptoj ngarkesën tuaj, megjithatë edhe çështja mund të jetë jo ajo të cilën ju e trajtoni në punën tuaj të përditshme. Ju kujtoj që rastet e helmimeve janë gati të zakonshme në Republikën e Kosovës. Në Gjilan kishim të paktën 30 persona që ishin shtruar në spital për shkak të helmimit. Ju keni një detyrim, ta quajmë nga rekomandimet e këtij Kuvendi, pra saktësisht të merren masa adekuate ndaj Bordit dhe menaxhmentit të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinës.

Pra, ata që e kuptojnë çështjen, rrezikun që vjen, pasojat nga ky neglizhim, nga kjo mospërgjegjësi e këtij institucioni janë kriminale, nuk janë të dukshme aty për aty, janë afatgjate. Mirëpo, ne nuk mund të qëndrojmë të vetëdijshëm se çka po ndodh, çfarë rreziku përballen qytetarët dhe të heshtim përballë edhe rekomandimeve që i keni nga një rezolutë e Kuvendit të Kosovës.

KRYESUESJA: Mund të përgjigjeni, zoti kryeministër!

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Para se të ndërmarr veprime, do të thotë ndaj agjencisë së caktuar, ne kemi kërkuar raport për veprimet që ka ndërmarrë kjo agjenci për të trajtuar temën. Tani vlerësimi se këto veprime a mjaftojnë, a janë marrë në kohë dhe a janë adekuate, është një vlerësim që po ashtu na obligon më tutje, përfshirë edhe rezolutën e Kuvendit, por ju siguroj që kjo agjenci dhe mekanizmat e tjerë që, në disa raste janë edhe inspektime sanitare e tjera, që duhet marrë përsipër përgjegjësinë e tyre. Besoj edhe nga kjo foltore dhe nga pyetja juaj dhe nga bisedat që bëjmë e kuptojnë ndjeshmërinë e temës dhe është mirë të ketë një vigjilencë të duhur në të gjitha nivelet. E pranojmë edhe kritikën e Parlamentit,

pra për gjendjen në fjalë, por po ashtu edhe e pranojmë që obligohemi nga kjo rezolutë që të trajtohet seriozisht përgjegjësia, shkalla e përgjegjësisë.

Mirëpo, sot megjithatë ju sollëm veprimet e ndërmarra nga agjencia për temën, ndërsa po ashtu me siguri se askush s'do të mund t'u ikë përgjegjësive. Faleminderit!

KRYESUESJA: Deputetja Valentina Bunjaku-Rexhepi, pyetje për ministrin Kujtim Gashi.

VALENTINA BUNJAKU-REXHEPI: E nderuar kryesuese,

Të nderuar kolegë deputetë,

Kabinet qeveritar,

Pyetja parlamentare është Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore në raportin e fundit ka konstatuar, se Ministria për Kulturë, Rini dhe Sport ka shkelur Ligjin për trashëgimi kulturore. Po ashtu, këshilli ka kërkuar nga Kuvendi i Kosovës që të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të detyruar MKRS-në që të respektojë Ligjin për trashëgimi kulturore.

Pyetja është: Pse nuk jepni përgjegjësi për shkeljet e Ligjit për trashëgimi kulturore dhe për këto dëme që MKRS i shkakton trashëgimisë kulturore?

Edhe pse, pyetja është bërë më herët, besoj që ka ndryshuar situata, por lus që ta marr përgjigjen.

KRYESUESJA: Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI KUJTIM GASHI: Faleminderit, e nderuar kryetare e Kuvendit!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Të nderuar kolegë ministra,

Lidhur me zbatimin e Ligjit për trashëgimi kulturore kemi diskutuar në takimin e ftuar nga Komisioni Parlamentar për Arsim, Shkencë, Kulturë, Teknologji, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi, më datën 16 maj 2018, që në takim sa më kujtohet, zonja deputete, nuk keni qenë të pranishëm, me ç'rast unë si ministër kam raportuar për anëtarët e komisionit për të gjitha të arriturat, por edhe për sfidat që MKRS-ja dhe institucionet vartëse të saj i kanë në zbatimin e Ligjit për trashëgiminë kulturore.

Kurse, po jua rikujtoj edhe një herë se MKRS nëpërmjet Departamentit për Trashëgimi Kulturore për vitin 2017 ka zbatuar aktivitete të paracaktuara në dokumentin e politikave programore, si vijon:

- Përveç mbrojtjes ligjore, MKRS-ja e ka zbatuar në vazhdimësi procesin e inventarizimit dhe programin e masave preventive, intervenimet emergjente për kategorinë e trashëgimisë arkitekturore dhe gërmimet arkeologjike me karakter shpëtimi për trashëgiminë arkeologjike.

- MKRS-ja ka zbatuar në tërësi Rregulloren nr. 2006/2017 për caktimin e institucioneve të trashëgimisë kulturore, vartëse të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në cilësinë e institucionit kompetent.

- Të gjitha lëndët, kërkesat, për ndërhyrje konservuese restauruese për asetet e mbrojtjes dhe hapësirat përreth shqyrtohen dhe vlerësohen nga Komisioni Profesional në IKMM, ku anëtar i këtij komisioni ka qenë edhe një përfaqësues i Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore.

E nderuara deputete,

Të nderuar deputetë,

Në përpjekjet tona për të përmbushur obligimet ligjore që derivojnë nga Ligji për trashëgimi kulturore ne e kemi themeluar edhe inspektoratin për trashëgimi kulturore, i paraparë me këtë ligj. Inspektorati i trashëgimisë kulturore, përveç koordinimit me institucionet vartëse të trashëgimisë kulturore, vizitave në terren, ka bërë edhe tre kallëzime penale, kurse ka ndaluar punimet në disa prej punimeve të paautorizuara në qytetin e Prishtinës dhe qytete tjera të Republikës së Kosovës. Inspektorati gjatë kësaj periudhe ka bërë edhe gjashtë vizita inspektuese në Gjakovë, dy vizita inspektuese në Mitrovicë dhe një vizitë inspektuese në Pejë, kurse vetëm në Prizren nga themelimi i inspektoratit janë realizuar 17 vizita inspektuese.

Pra, në vazhdimësi po përpiqemi të bashkëpunojmë me të gjitha palët, në mënyrë që në përpikëri dhe në plotni ta zbatojmë Ligjin për trashëgiminë kulturore.

Unë mbetem i hapur për të diskutuar për të gjitha shqetësime eventuale, që mund të vijnë nga ju dhe të tjerët në raport me angazhimet tona në përmbushjen e detyrimeve ligjore. Faleminderit!

KRYESUESJA: Deputete, keni pyetje shtesë? Po!

VALENTINA BUNJAKU-REXHEPI: Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore në bazë të Ligjit për trashëgimi kulturore neni 5.2 e ka në mandat vlerësimin e të gjitha projekteve të trashëgimisë kulturore, ndërsa ministria është përgjegjëse për aprovimin dhe implementimin e të gjitha projekteve. MKRS asnjëherë nuk e ka dorëzuar pranë këshillit asnjë projekt për vlerësim, ashtu siç është përcaktuar me Ligjin për trashëgimi kulturore. Faleminderit!

KRYESUESJA: Zoti ministër, urdhëroni!

MINISTRI KUJTIM GASHI: Faleminderit, deputete!

Ashtu siç e dini, edhe këshilli ka pasur disa probleme në funksionim të saj, por që nga ardhja në krye të ministrisë ne jemi përpjekur që të bashkëpunojmë ngushtë, në mënyrë që edhe këto shqetësime të cilat i apostrofove bashkërisht t'i tejkalojmë.

Jemi në rrugë të duhur dhe besoj se në takimin që e kemi pasur me komisionin, ku kanë qenë të pranishëm edhe anëtarët dhe dhjetëshi i këtij këshilli, jemi dakorduar që të kemi hapa konkretë dhe të përbashkët në vazhdimësi. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Deputeti Armend Zemaj, pyetje për ministrin Bejtush Gashi.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryesuese!

Zoti ministër, pyetjen e kam bërë në muajin e pestë.

Çështja ka të bëjë me përdorimin e drogave në ambientet e shkollave, që është një problem tejet shqetësues.

Kjo dukuri negative e përdorimit të narkotikëve nga ana e të rinjve ka shënuar rritje dramatike të abuzimit me substancat narkotike në shkollat dhe afër tyre. Të rinjtë dihet se janë grupmosha që rrezikojnë dhe bien në grackat e dilerëve të drogave, e sidomos në qytetet që janë të mbipopulluara, siç është edhe rasti i Prishtinës.

Pyetja ime ka të bëjë: Çka po bëjnë autoritetet kompetente që bien në fushëveprimtarinë e Ministrisë së Punëve të Brendshme në evidentimin e faktorëve të rrezikut, që rrezikojnë nxënësit, fëmijët, të rinjtë, si dhe masat që e parandalojnë dhe luftojnë këtë dukuri negative?

MINISTRI BEJTUSH GASHI: E nderuar kryesuese e Kuvendit,

I nderuari kryeministër,

Të nderuar deputetë,

Kolegë ministra,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

I nderuari deputet Zemaj, ju falënderoj për pyetjen e shtruar dhe në të njëjtën kohë më lejoni të ju informoj se përdorimi i substancave narkotike, psikotrike dhe analoge është dukuri shqetësuese kurdo dhe kudo që shfaqet ajo. Mirëpo, shfaqja e këtij fenomeni negativ në ambientet edukativo-arsimore, posaçërisht në përfshirjen e personave fëmijë apo të mitur përbën një alarm, se ky shqetësim duhet trajtuar në mënyrë urgjente dhe me prioritet.

Duke iu referuar pyetjes suaj për masat që kanë ndërmarrë autoritetet kompetente në evidentimin e faktorëve të rrezikshëm, ju informoj se në këtë aktivitet kompleks është i domosdoshëm bashkëpunimi edhe i institucioneve tjera, të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, komunave, shoqërisë civile, këshillave të prindërve, këshillave të nxënësve dhe aktorëve tjerë.

Sidoqoftë, sa i përket ministrisë që unë drejtoj, ju njoftoj se Ministria e Punëve të Brendshme ka hartuar strategjinë shtetërore kundër narkotikëve dhe Planin e Veprimit 2018-2022. Këto dy dokumente janë paraparë përmes aktiviteteve koncize, që të parandalojnë dhe të luftojnë këto fenomene dhe këto dy dokumente së shpejti do të aprovohen në Qeveri. Tutje, Policia e Republikës së Kosovës ka nxjerrë një plan operativ i quajtur “Stop drogave në shkolla”, i cili ka filluar të realizohet nga 2. 10. 2017 dhe aktualisht është duke u realizuar në tërë territorin e republikës së Kosovës.

Konsideroj se bashkëpunimi dhe angazhimi i njësive kompetente në terren ka treguar rezultate, si në fushën e parandalimit, ashtu edhe në luftimin e drogave në shkolla dhe rreth tyre.

Në fushën e parandalimit janë bërë vizita dhe kontakte me personelin e shkollës, patrullime rreth shkollave, janë mbajtur ligjëratat me nxënës dhe takime me prindër, si dhe janë shpërndarë fletushka dhe broshura. Ndërsa, në fushën e luftimit janë kontrolluar persona të cilët kanë frekuentuar zonat e sigurisë 350 metra në perimetrin e shkollës, si dhe janë marrë të gjitha masat dhe aktivitetet e parapara me Kodin Penal.

Për realizimin e aktiviteteve janë angazhuar zyrtarë nga drejtoritë rajonale të Policisë, Drejtoria e Policisë në bashkësi dhe preventivë, Drejtoria për Inteligjencë dhe Analizë dhe Drejtoria për Hetimin e Trafikut dhe Narkotikëve. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Deputet, keni pyetje shtesë? Po!

ARMEND ZEMAJ: Zoti ministër,

Unë i kuptoj të gjitha këto që ju i thatë dhe sigurisht se janë statistika që dalin nga puna e përditshmërisë së Ministrisë së Punëve të Brendshme. Unë po flas dhe atë që po e kërkoj është mungesa e kontrolleve efektive dhe një plani operativ shtetëror desha ta quaj edhe në praninë e gjithë Kabinetit qeveritar, sepse kjo është një dukuri negative e cila jo vetëm që rrezikon të ardhmen tonë, por çdo ditë është duke u bërë gangrenë e keqe, sidomos në shkolla dhe në afërsi të shkollave, duke prekur grupmoshat edhe nga ajo që është e paimagjinueshme se kush dhe si përdoren.

Në një aksion që ju e përmendët të Policisë, i cili ka zgjatur vetëm gjashtë ditë, është konfiskuar 1 kg e më shumë drogë vetëm për atë periudhë në shkolla dhe në afërsi të tyre. Dhe, paramendoni tash në statistika sa është qarkullimi tjetër i cili nuk kontrollohet dhe mund të jetë në duart e fëmijëve tanë, tuajve dhe të gjithë fëmijëve.

KRYESUESJA: Zoti ministër, urdhëro!

MINISTRI BEJTUSH GASHI: I nderuari deputet,

Ju falënderoj për shqetësimin!

Të jem më i qartë dhe konciz.

Plani është aktualisht në zbatim në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Disa statistika gjatë periudhës raportuese 2. 10. 2017 - 31. 5. 2018 janë realizuar 30 742 patrullime rreth shkollave, 17 280 vizita dhe kontakte me personelin e shkollave, 33 512 persona të kontaktuar, 15 718 vetura të kontrolluara, 498 lokale të kontrolluara, 299 ligjërata nëpër shkolla, 18 586 pjesëmarrës nxënës në këto ligjërata, 474 pjesëmarrës prind në këto ligjërata dhe 1 265 fletushka të shpërndara.

Gjithashtu, janë arrestuar 744 persona, ndërsa janë iniciuar procedura për 592 persona. Gjithsej janë konfiskuar 63 kg marihuanë brenda objekteve, 97 kg marihuanë në oborr të shkollës, 4 500 kg marihuanë në afërsi të shkollave. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Deputeti Faton Topalli, pyetje për ministrin Pal Lekaj.

FATON TOPALLI: I nderuar ministër,

Kosova është njëri prej vendeve me një numër të madh të qytetarëve që jetojnë jashtë vendit. Ky numër i qytetarëve, një pjesë e tyre, udhëtojnë përmes Aeroportit të Prishtinës, diku rreth 2 milionë në vit, me tendencë të ngritjes permanente. Megjithatë, qytetarët e Kosovës paguajnë çmimet më të larta në rajon për fluturime, më të larta se në shtetet fqinje, si në Shkup, Tiranë, Cetinjë apo në Beograd e ndonjëherë këto çmime janë edhe më të larta se për të fluturuar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

E kuptoj që tregu është i lirë dhe Qeveria nuk ka ndikim direkt, sa u përket çështjeve të çmimeve të biletave të aeroplanit, megjithatë këto çmime të larta paguhen për faktin se nuk shfrytëzohet korridori nga Shqipëria dhe me sa di unë, edhe nga Mali i Zi, gjë që i bën fluturimet për 20 minuta më të gjata, për shkak se këto korridore nuk shfrytëzohen.

Tjetra është, që në këto vende këta aeroplanë rreth Kosovës janë detyruar të fluturojnë më ulët, gjë që e ngre çmimet e biletave. Ajo që mua më intereson të di, çfarë ka bërë Qeveria në rregullimin, në përmirësimin e kushteve që biletat e aeroplanëve për bashkatdhetarët tanë të jenë më të lira, duke i plotësuar këto kushte për të cilat fola.

KRYESUESJA: Zoti ministër, urdhëroni!

MINISTRI PAL LEKAJ: E nderuara kryesuese,

Kryeministër,

Ministra,

Deputetë të nderuara,

I nderuar deputet Topalli, miku im,

Bazuar në analizat statistikore të të dhënave lidhur me çmimet e avio-biletave konstatojmë se Kosova nuk ka çmimet më të shtrenjta në rajon. Sipas analizave statistikore të çmimeve të avio-biletave ju prezantojmë këto të dhëna:

Janar - dhjetor 2017, krahasuar me vitin 2016, Kosovë - Shqipëri, krahasuar me Shqipërinë 31% më të lira janë biletat. Kosovë - Maqedoni është 29% më shtrenjtë.

Janar - mars 2018, krahasuar me vitin 2017, Kosovë - Shqipëri, 11% më të lira. Kosovë - Maqedoni është 7% më të shtrenjta krahasuar me këto vende.

Cila është arsyeja e çmimeve kaq të larta, e përmendët edhe vet, faktorët që kanë ndikuar në çmimin e avio-biletave janë mosnormalizimi i hapësirave ajrore, si dhe hapja e korridoreve ajrore të reja, të cilat do të bëjnë shkurtimin e distancës së fluturimeve dhe krijimin e alternativave për zgjidhje të korridoreve ajrore më të përshtatshme, shkurt, në distancë fluturimi për destinacionin e caktuar. Pamundësia e lëvizjes së lirë, liberalizimi i vizave të qytetarëve të Kosovës me krijimin e mundësive të lëvizjes së lirë, qytetarëve të Kosovës në bazë të praktikave të shteteve të rajonit, çmimi i avio-biletave do të ulet rreth 30% nga se me rritjen e kërkesave numri i udhëtarëve ulet dhe çmimi i avio-biletave.

Prandaj, ju kuptoj dhe e thatë me të drejtë, që tregu është i lirë dhe në këtë rast nëse duam ta ulim çmimin e biletave duhet të reagojë Qeveria e Kosovës, mirëpo ne nuk kemi ndonjë avio-kompani shtetërore, që ndoshta do të mund të kishim ndikuar në çmimin e tyre apo subvencionimin për uljen e avio-biletave. Prandaj, në këtë drejtim e kemi të pamundur, por ajo që është në kompetencat tona do ta bëjmë më të mirën të mundshme. Faleminderit!

KRYESUESJA: Deputet, keni pyetje shtesë?

FATON TOPALLI: Po! Zoti ministër,

Çështja e çmimeve varësisht nga periudha kohore, natyrisht që dallon, ju e përmendët vet që 30% do të mund të ishin çmimet më të lira në rast se do të plotësoheshin kushtet që i përmenda edhe unë. Por, thelbi i pyetjes sime është: Çfarë ka bërë Qeveria në rregullimin e këtyre kushteve për të pasur çmime më të lira për aeroplanë? Pra, a ka diskutuar me NATO-n, a ka diskutuar me shtetet fqinja...?

Ajo që po pyes unë është, cila është puna që ka bërë apo do ta bëjë Qeveria për ta rregulluar këtë çështje?

KRYESUESJA: Ministër, urdhëroni!

MINISTRI PAL LEKAJ: Me të drejtë e shtroni këtë pyetje, sepse dihet se përgjegjësitë për hapësirën ajrore të lartë e ka NATO dhe atë hapësirë e kontrollon Hungaria. Tani në shtator i skadon afati dhe ne kemi kontaktuar, kemi bërë shkresa të vazhdueshme, që të bisedojmë me përgjegjësit e NATO-s dhe në këtë drejtim ne të marrim përgjegjësitë dhe t'i zhvillojmë kapacitetet tona, se mund të them lirisht që ne ende nuk i kemi kapacitetet e plota për ta marrë një përgjegjësi të plotë.

Por, sa i përket hapësirës së ulët ajrore, dihet se është çështje politike dhe dihet se kundërshtimin e Beogradit, dhe e kemi të pamundur ne si Kosovë të veprojmë, përpos atëherë kur kemi ndonjë marrëveshje shtetërore. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Deputetja Shqipe Pantina, pyetje për kryeministrin Ramush Haradinaj. Si duket, kryeministri nuk është këtu. Deputete, a doni ta lexoni pyetjen apo ta shtyni?

SHQIPE PANTINA: Po, sepse një pyetjeje të tillë do të mund t'i përgjigjej ndoshta edhe zoti Lekaj, ndonëse pyetja i është drejtuar kryeministrit.

Hapësira e lartë ajrore e Kosovës tash e katër vjet menaxhohet nga kompania hungareze e navigimit ajror "Hungaro-Kontrolli", të cilës i skadon kontrata në qershor të vitit të ardhshëm. Në atë kohë vendimin për ta kaluar në menaxhim hapësirën e lartë ajrore të Kosovës kësaj kompanie ishte marrë nga KFOR-i.

Pyetja ime për Qeverinë, kryeministrin, në këtë rast nuk e di nëse i ka informatat zoti Lekaj apo ndonjë nga ministrat tjerë, është se çfarë është duke bërë Qeveria që nga qershori i vitit të ardhshëm menaxhimin e hapësirës ajrore ta bëjnë autoritetet tona, gjegjësisht autoriteti i aviacionit civil. A kanë filluar negociatat e nevojshme me autoritetet e NATO-s dhe a janë tejkaluar pengesat tjera, disa prej të cilave kanë qenë pengesa teknike në kuptimin ngritjen e kapaciteteve të stafit e të tjera, që hapësira ajrore t'i kalojë nën mbikëqyrje autoriteteve tona, të Kosovës, pra. Faleminderit!

KRYESUESJA: Zoti kryeministër, e keni fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: E nderuar kryesuese,

Të nderuar deputetë,

Kolegë të Kabinetit qeveritar,

Përgjigja në pyetjen e zonjës deputete Pantina, hapësira e lartë ajrore e Republikës së Kosovës është e hapur për fluturime civile në prill të vitit 2014. Kjo përfshinë hapësirën ajrore mbi 6 500 metra, e cila përdoret për mbikalime transit të aeroplanëve civilë e që udhëhiqet nga Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror të Kosovës nën mbikëqyrjen rregullatore të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës.

Ofrimi i shërbimeve në hapësirën tonë të lartë ajrore i është deleguar përkohësisht Hungarisë me vendim unanim të Këshillit të NATO-s. NATO pati vendosur disa kritere që duhet t'i përmbushë shteti që do t'i ofrojë këto shërbime, ndër të cilat ai shtet duhet të jetë anëtar i NATO-s dhe nuk duhet të jetë shtet fqinj i Kosovës.

Sipas vendimit të Këshillit të NATO-s dhe marrëveshjes implementuese të nënshkruar nga komandanti i KFOR-it dhe shteti i Hungarisë në vitin 2014 "Hungaro-Control" do t'i vazhdojë pra mandati automatikisht, nëse asnjëra palë nuk tërhiqet prej detyrimeve të marra me këtë marrëveshje.

Në programin tonë qeverisës e kemi prioritet edhe anëtarësimin e Republikës së Kosovës në Organizatën Ndërkombëtare të Aviacionit civil, e cila është agjenci e specializuar e OKB-së. Jemi duke punuar në këtë drejtim, mirëpo anëtarësimi në organizata të nivelit ndërkombëtar e OKB është një proces për të cilin nuk kishim dhënë shumë detaje në këtë etapë. Faleminderit!

KRYESUESJA: Deputete, pyetje shtesë?

SHQIPE PANTINA: Po, faleminderit!

Kryeministër, konstatimet që ju i thatë, që ndërrojnë do të thotë, por çështja është se disa prej arsyeve se nuk i ka kaluar nën menaxhim autoritetit tonë civil, gjegjësisht organeve përgjegjëse në Kosovë, janë edhe disa prej çështjeve teknike përfshirë këtu edhe investimin në ngritjen e kapaciteteve të stafit tonë, një detyrë të cilën institucionet tona mund ta bëjnë, sepse Kosova afërsisht humb rreth 20 milionë në vit nga që nuk arrin ta mbledhë atë tarifën që do të duhej ta paguanin aeroplanët që kalojnë transit nëpër hapësirën tonë ajrore.

Pyetja ime kishte të bënte me këtë, do të thotë a jemi ne duke i kryer përgjegjësitë tona, a janë ngritur kapacitetet, a janë plotësuar kushtet teknike, në mënyrë që nesër kur të shkohet për t'u negociuar edhe me NATO-n, por edhe me autoritetet hungareze, të paktën nga ne të jenë përgjegjësitë të përmbushura. Faleminderit!

KRYESUESJA: Zoti kryeministër, e keni fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: E nderuar deputete,

Gjendja nuk është e mirë në shumë aspekte të menaxhimit, pra të autoritetit tonë dhe të përgjegjëseve që kemi. Në Aeroport kemi pasur edhe sfida të tjera, edhe të sigurisë dhe të tjera. Janë bërë disa ndërhyrje të menjëhershme dhe mendoj që na pret më shumë punë në të ardhmen. Pra, nuk është një gjendje që aktualisht konfirmon atë që ju po e kërkon, se a i ka kryer Kosova përgjegjësitë e veta, punët e veta, që të mund të kualifikohet, ta quaj ashtu, për marrjen e përgjegjëseve në fjalë. Jo. Ka ende punë që duhet bërë Kosova.

Kemi pasur, kemi vështirësi pastaj të karakterit tjetër, pos këtyre punëve të shtëpisë që duhet t'i bëjmë në lidhur me temën konkrete, ato janë pastaj në planin ndërkombëtar, pra si i prezantojmë, si i menaxhojmë dhe si... Po, edhe brenda kemi punë për të bërë. Nuk është në rregull, nuk ka qenë realisht gjendja në rregull, ka pasur shqetësime edhe të sigurisë, janë bërë disa teste, janë bërë disa... jo teste, por janë zhvilluar disa operacione, që është matur gjendja dhe janë ndërmarrë disa veprime, për të cilat opinioni tash mund vetëm ta konfirmojmë te opinioni, se janë evituar disa të meta që kanë ekzistuar në të kaluarën. Faleminderit!

KRYESUESJA: Deputetja Blerta Deliu-Kodra, pyetje për zëvendëskryeministrin Behgjet Pacolli. Zonja deputete, meqë zëvendëskryeministri nuk është këtu, dëshironi ta tërhiqni apo ta lexoni pyetjen?

BLERTA DELIU-KODRA: Atëherë, unë e kam bërë pyetjen një herë edhe atëherë nuk ka qenë zëvendëskryeministri këtu, e bëj herën tjetër. Nëse jo, do të jetë me shkrim pyetja e dedikuar.

KRYESUESJA: Faleminderit! Deputeti Lutfi Zharku, pyetje për ministrin Pal Lekaj.

LUTFI ZHARKU: Faleminderit!

Ministër, herën e kaluar e kam bërë pyetjen, megjithatë po e përsëris pasi që është ministri këtu.

Ministri ka deklaruar, nëse nuk gaboj në fillim të majit, në një intervistë në KTV, kur janë pezulluar projekte në komunën e Lipjanit, se projekte që kam nënshkruar unë kanë qenë vetëm në letër, pa kode buxhetore. Dhe, unë kam kërkuar, ministër, që ta tregoni vetëm një projekt që nuk ka kod buxhetor, se unë i kam nënshkruar 22 memorandume të mirëkuptimit me komunat e Kosovës, që janë 170 projekte, kështu që nëse e gjeni vetëm një projekt që nuk ka kod buxhetor, së paku kështu ka qenë lajmi i KTV-së. Faleminderit!

KRYESUESJA: Zoti ministër.

MINISTRI PAL LEKAJ: E nderuar kryesuese,

Kryeministër,

Ministra,

Deputetë,

I nderuar deputet Zharku,

Sa i përket deklaramit tim, është e vërtetë që kam deklaruar që sa u përket marrëveshjeve apo memorandumeve të mirëkuptimit mungon mbështetja financiare me kode, po jam i vetëdijshëm që nuk ka marrëveshje pa kod, ajo nuk ka as si të implementohet. Ndoshta e kanë keqinterpretuar, por jam i vetëdijshëm çka kam thënë dhe prapë po e përsëris, të gjitha memorandumet e nënshkruara kanë pasur pjesë të vogël, përqindje të vogël të vijave buxhetore që nuk e ka përmbushur tërë projektin, kështu kam thënë dhe prapë qëndroj, se diku të gjitha

memorandumet e mirëkuptimeve që janë nënshkruar me komuna nuk e kanë kaluar diku 10-15%-shin. Kaq!

KRYESUESJA: Deputet, keni pyetje shtesë? Po!

LUTFI ZHARKU: Zoti ministër,

Të gjitha memorandumet e mirëkuptimit që i kam nënshkruar unë kanë të bëjnë me vitin aktual 2017 dhe me projeksionet për vitin 2018 dhe 2019. Nuk ka asnjë teori që të nënshkruhet një memorandum pa e pasur bazën buxhetore për tre vjet, jo vetëm për atë vit, po për tre vjet. Çdo projekt, çdo memorandum, çdo projeksion buxhetor ka qenë në përputhje me projektet që janë paraparë nga komunat.

KRYESUESI: Zoti ministër, urdhëro!

MINISTRI PAL LEKAJ: I nderuar deputet,

E kuptoj gjendjen tuaj dhe e di që ndoshta pa dashje keni nënshkruar memorandume të mirëkuptimit për projekte elektorale dhe po e them saktë, është një vendim i ish-kryeministrit Mustafa, kur janë pezulluar të gjitha aktivitetet apo të gjitha projektet dhe janë tërhequr të hollat në Qeverinë e Kosovës, është një pezullim, është vendimi dhe nëse pritni pak, unë mund t'jua sjell. Faleminderit!

KRYESUESJA: Deputetja Blerta Deliu-Kodra, pyetje për ministrin Nenad Rikalo.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, zonja Dërguti,

Është e vërtetë që këtë pyetje e kam bërë edhe në njërin prej seancave të fundit dhe natyrisht sot kam dashur ta parashtroj edhe si shqetësim, meqë kryeministri është këtu, që ministri Rikalo nuk po u përgjigjet kërkesave të deputetëve. Ka pasur së fundi edhe telashe me vërshime dhe me të reshurat në komunën e Rahavecit. Pyetja ime është lidhur me dëmet që u janë shkaktuar bujqve në komunat e Istogut, Skenderaj dhe të Drenasit dhe kam kërkuar sqarim nga ministri. Meqë kryeministri është këtu, unë ndoshta si vartës do të duhej të deklarohej se çfarë do të ndodhë, a do të vijë ai që t'u përgjigjet pyetjeve dhe shqetësimeve që i kanë qytetarët e që duhen të adresohen, sepse janë vërtet shqetësime të mëdha. Faleminderit!

KRYESUESJA: Zoti kryeministër, urdhëro!

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: E nderuar kryesuese,

Të nderuar deputetë,

E nderuar deputete Kodra Deliu,

Me rëndësi është se tani jemi ballafaquar një kohë me dëme të reshjeve atmosferike, pati breshër, erë, po edhe të vërshime. Këto dëme e kanë përfshirë Kosovën gati në tërësi, ka pasur dëme të

tilla edhe në Ferizaj, në Istog, Drenas, pastaj në Rahovec, fatkeqësisht Kosova nuk ka instrument të paraparë e që i sanon këto dëme. Pra, ne nuk kemi ndërtuar një instrument paraprak. Jam interesuar për mënyrën se si duhet ta menaxhojmë këtë në vazhdimësi, jo vetëm një ndihmë të njëhershme dhe ishin disa mënyra.

Ishte riaktivizimi i sistemit mbrojtës raketor që ka ekzistuar dikur për mbrojtjen nga breshri. Ky sistem ka mundur të kthehet në funksionim, nuk është kostoja e lartë, duhet një marrëveshje me KFOR-in pikërisht për atë hapësirën ajrore e disa aspekte të tjera, por e kemi në interes të rikthehet dhe veprim i cili nuk do ta mbronte në tërësi, po do të ishte diku një ndihmesë e madhe, ndoshta 70% të rreziqeve do t'i evitonim në të ardhmen. Pastaj, është sigurimi i parcelave, i kulturave, ky sigurim në Kosovë nuk po i mbulon dëmet natyrore, dëmet e fatkeqësive natyrore, fatkeqësisht kishte sigurime të tjera edhe për kultura, por dëmi nga fatkeqësitë natyrore nuk po u mbuluaka në Kosovë, për shkak se nuk kishte ndonjë kompani të sigurimit që pranon të marrë këtë kosto, sepse dëmi ishte i madh, nëse ndodh dhe këtu kishte mundur që buxheti, pra Qeveria të propozojë një masë, pra një fond, një garanci financiare në rast të këtyre dëmeve. Është edhe një opsion që duhet ta shqyrtojmë bashkë, është një fond për fatkeqësitë natyrore, për dëmet atmosferike të këtyre kulturave.

Të gjitha këto opsione do t'i shqyrtojmë me urgjencë, cilat janë, por ajo që do ta bëjmë në ndërkohë, edhe pse ministri nuk është këtu, jam interesuar në ministri, pra ministria është funksionale, ministri nuk është i pranishëm fizikisht, edhe për këtë u kërkoj falje deputetëve dhe të gjithë qytetarëve.

Mirëpo ministria është funksionale, janë zëvendësministrat, janë kolegët e tjerë që po punojnë. Ajo që duhet të bëjmë është të paktën këtyre kategorive të fermerëve që u ka ndodhur dëmi t'i favorizojmë në kohë për subvencione e dakorduara, pra janë dakorduar subvencionet për ta, mirëpo në bazë të afateve kohore, ato u shkojnë më vonë. Do të ishte shumë me rëndësi që ato subvencione t'i marrin tani që të paktën ta mbijetojnë, ta quaj ashtu, periudhën kohore...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESJA: Deputete, keni pyetje shtesë?

BLERTA DELIU-KODRA: Jo, faleminderit kryeministrit!

Unë shpresoj shumë që do ta trajtojmë me seriozitet, nëse ka një mundësi që Qeveria të marrë masa, për shkak se sistematikisht po kemi raste të tilla të dëmeve që po shkaktohen. Natyrisht unë kuptoj që linjat buxhetore nuk arrijnë të kenë mbështetje për të gjitha kategoritë, por të paktën që të ketë lehtësi për ata që kanë pasur dëme të mëdha gjatë kësaj kohe në të gjitha komunat e Kosovës. Faleminderit, kryeministër!

KRYESUESJA: Ministri i Shëndetësisë, zoti Uran Ismajli, na ka dërguar njoftimin se gjendet në takim me kryetarët e komunave dhe e ka të pamundur të vijë të përgjigjet në pyetjet tuaja parlamentare.

Meqë deputeti Naser Rugova, pyetje për ministrin e Shëndetësisë. Dëshironi ta lexoni pyetje, apo ta shtyni për seancën e radhës?

NASER RUGOVA: Faleminderit!

Pasi ministri nuk është këtu, propozoj që të shtyhet për seancën e radhës.

KRYESUESJA: Faleminderit! Deputetja Hykmete Bajrami, pyetje për ministrin Pal Lekaj. Deputetja nuk qenka këtu!

Deputetja Besa Baftiu, pyetje për ministrin Uran Ismajli. Doni ta lexoni pyetjen?

BESA BAFTIU: Pyetjen e kam parashtruar edhe në seancën e kaluar, është e bartur, meqenëse ministri prapë qenka arsyetuar, edhe në seancën tjetër është arsyetuar se e ka një delegacion. Unë nuk di a është më e rëndësishme të ketë takime me delegacione, apo të vijë e të na përgjigjet neve këtu si deputetë, sepse pyetjet tona janë shqetësime të qytetarëve të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Deputeti Armend Zemaj, pyetje për ministren Albena Reshitaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryesuese!

Kolegë deputetë,

Çështja ka të bëjë se në muajin prill ishte paralajmëruar nga ministri një debat publik për ndërtimin e një hidrocentrali në rrjedhën e lumit në Grykën e Lloqanit. Duke marrë parasysh pasojat të cilat janë krijuar nga ndërtimi i hidrocentralit në grykën e Deçanit, ku pas shkeljeve tash të njohura ligjore, në të cilën është bërë krim mjedisor, qytetarët e asaj pjese kanë frikë se e njëjta gjë do të ndodhë edhe në Grykën e Lloqanit, apo edhe në atë të Jasiqit.

Pyetja ime konsiston: cili është involvimi i ministrisë suaj si ministre, a jeni në dijeni për këto zhvillime dhe si po e trajtoni këtë çështje?

KRYESUESJA: Zonja ministre, urdhëroni!

MINISTRJA ALBENA RESHITAJ: E nderuar kryesuese, Dërguti,

I nderuar kryetar i Kuvendit, Veseli,

Të nderuar deputetë,

I nderuar kryeministër,

Të nderuar kolegë ministra,

Fillimisht më lejoni të falënderoj deputetin Zemaj për pyetjen dhe interesimin.

Kompania 'Lloçan Energy' për ndërtimin e hidrocentralit Lloçani në lumin Lumëbardhë të Lloçanit në Deçan ka aplikuar për pëlqim mjedisor në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor më 8. 12. 2017.

Kompania 'Lloçan Energy' është njoftuar për planin e debatit publik dhe ka filluar procedurat e shqyrtimit. Kompania në fjalë ka propozuar planin për dëgjim publik dhe është dakorduar me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Në të njëjtën kohë, Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ujërave, duke marrë parasysh lokacionin, ka kërkuar nga Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës mendim profesional për të marrë informacion se lokacioni i planifikuar për ndërtimin e hidrocentralit a gjendet brenda territorit të zonës së mbrojtur, bazuar në regjimin e mbrojtjes Zona e parë, Zona e dytë dhe Zona e tretë.

Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës ka informuar se lokacioni i planifikimit për ndërtimin e hidrocentralit Lloçani në lumin Lumëbardhë të Lloçanit në Deçan ndodhet brenda parkut kombëtar Bjeshkët e Nemuna, përkatësisht në Zonën e dytë të mbrojtjes.

Sipas Ligjit për parkun kombëtar Bjeshkët e Nemuna, me numër 04/L-86, neni 3, pika 1.2, Zona e dytë, menaxhimi aktiv përfshin pjesët të territorit të parkut kombëtar Bjeshkët e Nemuna që karakterizohet me ekosisteme vlera peizazhore dhe vlera të tjera të natyrës, ku mund të ushtrohen ekoturizmi, bujqësia tradicionale dhe veprimtaritë, të cilat nuk janë në kundërshtim me qëllimet e mbrojtjes.

Duke i marrë parasysh argumentet e lartcekura, lënda është proceduar për shqyrtim përfundimtar në komisione për shqyrtimin e raporteve të VNM-së dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, komisioni ka propozuar të refuzohet kërkesa për pëlqim mjedisor më 18.2.2018, kurse Vendimi për refuzim është nxjerrë më 19.4.2018.

Pas kompletimit të informatave se lokacioni gjendet në Zonën e dytë të parkut nacional Bjeshkët e Nemuna më 17.4.2018 palët janë njoftuar për anulimin e debatit publik të paraparë më 24.4.2018, për arsye se nuk ka pasur nevojë të mbahet debat publik bazuar në argumentet e lartcekura.

Sa i përket hidrocentralit Jasiq në lumin Erenik, komuna e Junikut, lokacioni i planifikuar nga kompania 'Securiti tim Kabashi' ndodhet brenda parkut kombëtar Bjeshkët e Nemuna, gjegjësisht në Zonën e dytë të mbrojtur, andaj i është refuzuar pëlqimi mjedisor më 5.5.2018. Faleminderit!

KRYESUESJA: Deputet, keni pyetje shitesë? Po!

ARMEND ZEMAJ: Ministre,

Vitin e kaluar faktikisht ishte fillimi i mandatit kur e kam ngritur një çështje që atje ka ndodhur një degradim mjedisor, keni reaguar shumë shpejt. Kjo ishte një shpresë për qytetarët që ju do ta përcillni këtë reagim, ajo nuk po ndodh. Nëse sot shkoni në Deçan, është e njëjta gjendje, nëse shkoni në dy pjesët ku po flisni, është tentimi për të njëjtën gjendje dhe qytetarët e Deçanit sot në fillimin e verës ballafaqohen me mungesë të ujit të pijshëm. Shumica e fshatrave nuk kanë ujë të pijshëm. Ato fotografi janë publike, shihen çdo ditë.

Këto kompani që ju i përmendët, janë kompani fiktive, zonja ministre, janë të themeluara, nëse shikoni në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve, nga njerëz që janë të lidhur me pushtetin, së pari dhe janë themeluar pasi është ardhur në pushtet kjo Qeveri dhe ju është dashur që t'i keni parasysh dhe të intervenoni e t'i bëni publike. Qytetarët kanë dërguar lëndë në Prokurori, por s'po funksionon asnjë linjë.

Ju kisha lutur, të jeni të vëmendshëm...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESJA: Zonja ministre, urdhëroni!

MINISTRJA ALBENA RESHITAJ: I nderuar deputet Zemaj,

Konsideroj që Qeveria e Republikës së Kosovës kësaj here, për herë të parë është përkushtuar jashtëzakonisht në mbrojtje të mjedisit dhe degradimet mjedisore, për të cilat edhe ju po shqetësoheni, është e vërtetë që nuk mund të zgjidhen problematikat brenda një dite a një muaji. Mirëpo keni veprime konkrete të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për mbrojtje të natyrës, për mbrojtje të lumenjve.

Siç e dini, ne tashmë jemi duke marrë masa konkrete dhe besoj që edhe për punën e hidrocentraleve, edhe për punën e lumenjve ne do të vendosim në bazë të kapaciteteve ujore që ka vendi ynë, por edhe gjithmonë duke respektuar kornizën ligjore.

Tashmë mendoj që unë vetëm ju dhashë dy vendime që ka marrë Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për refuzimin e pëlqimeve mjedisore, për shkak se kompanitë, pa marrë parasysh cilat janë ato, kanë shkelur ligjin, gjegjësisht kanë dashur të vendosin që ato të ndërtohen brenda zonës së mbrojtur, e cila normalisht respektohet dhe mbrohet edhe me Kushtetutë të vendit.

Mendoj që për herë të parë në Republikën e Kosovës, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor është duke punuar me përkushtim për mbrojtje të mjedisit dhe normalisht gjithmonë duke e respektuar kornizën ligjore.

Ka shumë veprime konkrete, të cilat janë marrë dhe janë duke u marrë brenda Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, të cilat çojnë drejt mbrojtjes biodiversitetit, mbrojtjes nga degradimi i natyrës, normalisht edhe nga keqpërdorimet që bëhen në lumenjtë tanë. Faleminderit!

KRYESUESJA: Deputeti Haxhi Avdyli, pyetje për ministrin Uran Ismajli, a doni ta lexoni pyetjen? Atëherë e shtyni për seancën e radhës.

HAXHI AVDYLI: Për Uran Ismajlin po e shtyj, nëse ka mundësi e kam edhe pyetjen të njëjtës datë për ministrin e Çështjeve Sociale.

KRYESUESJA: Më vjen keq, nuk është në rend dite, sepse pyetjet duhet të procedohen në bazë të mënyrës se si i keni dorëzuar, pra kronologjikisht.

Deputetja Time Kadrijaj, pyetje për ministrin Uran Ismajli.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit!

Në fakt, i kam dy pyetje për ministrin, por meqenëse ka kërkuar leje, po i shtyj për seancën e radhës.

KRYESUESJA: Faleminderit! Deputeti Imet Rrahmani, pyetje për ministrin Uran Ismajli. Regjia, ju lutem, jepjani fjalën deputetit Imet Rrahmani.

IMET RRAHMANI: Faleminderit, kryesuese!

Pyetjen nuk do ta bëj, sepse nuk jam i interesuar të flas me veten dhe nuk e kam veç të dal në televizor, por pyetja që kam pasur ta shtroj është e interesit të madh publik për qytetarët dhe pacientët.

KRYESUESJA: Faleminderit! Deputeti Imet Rrahmani, pyetje për ministrin Bejtush Gashi.

IMET RRAHMANI: Këtë pyetje, kërkoj ndjesë, mund ta përsëris, por e kam bërë në seancën e kaluar. Ministër, nëse je i gatshëm të përgjigjesh, mund ta bëj?

Pyetja ka qenë se si kompensohen punëtorët, në fakt, pjesëtarët e Policisë së Kosovës në rast se angazhohen për punë shtesë dhe punën shtesë gjatë vikendeve, a kompensohen korrekt dhe sipas ligjit? Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Zoti ministër!

MINISTRI BEJTUSH GASHI: E nderuar kryesuese,

I nderuar kryeministër,

Të nderuar deputetë,

Kolegë ministra,

I nderuar deputet Rrahmani,

Ju falënderoj për pyetjen referuar çështjes që keni ngritur,

Më lejoni t'ju informoj se çështja e kompensimit të pjesëtarëve të Policisë për punën shtesë gjatë ditëve të festave është e rregulluar me Udhëzimin administrativ 04/2017 mbi marrëdhënien e punës në Policinë e Kosovës, konkretisht neni 64, kundër të tjera përcaktohet se për ditët e punuara gjatë festës së pushimeve, punës jashtë orarit, paraqitjes në gjyq, stërvitjeve të obligueshme dhe për kryerjen e detyrimeve speciale përtej orarit të zakonshëm të punës bëhet kompensimi në ditët e lira apo me pagë.

Të punësuarit i takon kompensimi në ditë të lira apo paga shtesë në përqindje të mëditjes si më poshtë:

20% në orë për kujdestari,

30% në orë për punë gjatë natës,

30% në orë për punë jashtë orarit,

50% në orë për punë gjatë ditëve të festave dhe

50% në orë për punë gjatë fundjavës.

Për informimin tuaj, në fund të vitit kalendarik, me vendim të kryeministrit të Republikës së Kosovës janë ndarë mjete të konsiderueshme me këtë rast për të kompensuar orët shtesë të pakompensuara.

Mirëpo, nëse kompensimi do të bëhet me mjete materiale apo me ditë pushimi, varet ekskluzivisht nga mjetet materiale që i kemi në dispozicion, përkatësisht fondet.

Pra, varësisht nga ky fakt si dhe në përputhje me Udhëzimin Administrativ të sipërpërmendur bëhet kompensimi material ose në mungesë të tyre kompensimi me ditë pushimi. Faleminderit!

KRYESUESJA: Deputet, keni pyetje shtesë? Po!

IMET RRAHMANI: Zoti ministër,

Sipas përfaqësuesve të Sindikatës së Policisë, kompensimi material që e çekët ju, që qenka i rregulluar me Udhëzim Administrativ, është bërë në një periudhë të shkurtër dhe është ndërprerë.

Nëse kjo parashihet në Udhëzim Administrativ, atëherë nuk duhet të varet nëse ka apo nuk ka mjete, por kompensimi i paraparë duhet të bëhet dhe të jetë në vazhdimësi, të mos ketë ndërprerje. Faleminderit!

KRYESUESJA: Zoti ministër!

MINISTRI BEJTUSH GASHI: Faleminderit për komentet që dhatë, megjithatë kur nuk ka mjete atëherë duhet gjetur edhe mënyrë alternative për ta realizuar një obligim ligjor. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme

Pyes nëse keni vërejtje në procesverbalet e seancave plenare, të mbajtura më 16, 17, 18, 20, 26 prill, 17, 30 e 31 maj, 1, 4, 5, 8 dhe 28 qershor 2018?

A ka vërejtje? Të pranishëm janë 69 deputetë, domethënë kemi kuorum dhe me këtë rast konstatoj se Kuvendi i miratoi procesverbalet e seancave të lartpërmendura.

(Drejtimin e mbledhjes plenare e merr kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.)

KRYETARI: Faleminderit!

4. Interpelanca e kryeministrit të Republikës së Kosovës, zotit Ramush Haradinaj, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje dhe Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës në lidhje me vendimin e Qeverisë Nr.01/50, datë 5. 6. 2018 për pagesën e 53 milionë eurove shtesë për kompaninë Bechtel & Enka në Kontratën për ndërtimin e Autostradës R6, “Arbën Xhaferi”, Prishtinë - Hani i Elezit

Ju njoftoj se në bazë të Rregullores së Kuvendit, interpelanca mund të zgjasë deri në tri orë. Propozuesi i interpelancës mban të drejtën e fillimit të debatit në kohëzgjatje deri në 30 minuta dhe në fund të debatit deri në 5 minuta, nën 44.7 i Rregullores së Kuvendit. Në bazë të nenit 44.8 të Rregullores së Kuvendit, kryeministri Ramush Haradinaj e paraqet dhe e arsyeton raportin, qëndrimin e Qeverisë së Kosovës për çështjet e ngrehura në interpelancë në kohëzgjatje prej 15 minutave. Koha për diskutimet e grupeve parlamentare dhe për deputetët pa grup parlamentar është e ndarë sipas nenit 44.9 Rregullores së Kuvendit.

S’kam nevojë që t’jua lexoj krejt se i dimë të gjithë dhe në emër të propozuesit kush është? Liburn Aliu, në emër të propozuesit të interpelancës, le ta merr fjalën. Koha është 10 minuta,

urdhëroni! A në emër të dy propozuesve, a ndaras? Sqaro, Liburn! Faleminderit! Vetëm të Vetëvendosjes, a? Vazhdo!

LIBURN ALIU: Të nderuar deputetë!

Çështja e autostradave është çështje e cila Republikën e Kosovës po e ndjek tash e sa vite, pothuajse u bënë 7 vjet që po merremi me çështje dhe diskutime të ndryshme që lidhen me Bechtel&Enka dhe autostradat. Ka filluar me kontratën për autostradën Morinë-Merdar të vitit 2011, në kohën kur edhe asokohe kemi pasur debate të shumta në lidhje me këtë kontratë dhe e mbaj mend që po qe se kundërshtoj apo i jepje vërejtje tua në lidhje me këtë kontratë asokohe, ne konsideroheshim që jemi kundër autostradës në përgjithësi, kundër lidhjes me Shqipërinë, e kështu me radhë.

Ka qenë propagandë e madhe asokohe, ne e kishim të qartë që kostoja e asaj autostrade do të jetë tepër e madhe dhe sot na ka kushtuar rreth 1 miliard euro. Por, ajo çka kisha kërkuar nga deputetët dhe po ashtu nga qytetarët, shkoni bjerini pak asaj autostrade, dhe ato 1 miliard euro që i kemi dhënë, shikoni pak se për çfarë i keni dhënë. Janë përmbi 30 vende të ndryshme ku kjo autostradë i ka shembjet në anë të rrugës, dhe të cilat shembje pastaj me improvizimet teje të shëmtuara janë meremetuar deri diku dhe ato barriera të shëmtuara me gurë e me rrjeta teli janë përmbytur prapë nga vërshimet dhe mund ta shihni se në çfarë gjendje është sot autostrada, kontrata për të cilën është nënshkruar në vitin 2011. Po ashtu, nëpër rrugë, në mbi 15 vende të ndryshme është intervenuar në asfalt dhe janë kilometra të tërë në të dyja anët e rrugës, sidomos shiriti i djathtë, ku deformimet janë tepër të mëdha dhe çarjet janë tepër të mëdha. Kjo është autostrada të cilën ne e kemi pagur për 1 miliard euro.

Dua të përkujtoj që me fillimin e kësaj autostrade asokohe kanë patën kaluar kilometra të tërë të ndërtimit dhe nuk ka pasur fare mbikëqyrje profesionale, edhe pse me kontratë ishte dashur të kishte diçka të tillë. Atë çka e ceka në fillim, pra janë 7-8 vjet që ne po merremi me këto autostrada në kohën e qeverisjes Thaçi, kemi qenë kritikë, kemi pritur që në qeverisjen tjetër të Isa Mustafës do të ketë eventualisht ndonjë ndalim apo pengim të kësaj të keqeje. E kemi konsideruar, më kujtohet atëherë opozita si të dobët qeverisjen e Isa Mustafës që nuk po arrin t'i pengojë proceset e këqija, e ndër to kemi qenë kritikë edhe për çështjen e kontratave së autostradës, kemi shpresuar dhe unë personalisht kam shpresuar jashtëzakonisht shumë, edhe pse kam votuar kundër, në mos kjo qeverisje me kryeministër Ramush Haradinaj do t'i pengojë, por fatkeqësisht jo që nuk i ka penguar, por shumëfish më thellë dhe më keq ka shkuar sa i përket çështjes, shumë çështjeve tjera, e sidomos po flas për çështjen e autostradës.

Autostrada Prishtinë - Hani i Elezit është nënshkruar më 2 korrik 2014, pas rezultatit të zgjedhjeve të vitit 2014. Pra, Qeveria asokohe e ka nënshkruar në largim dhe e ka bërë një kontratë, e pak ditë më vonë ka filluar puna dhe ka qenë kontratë që duke pas parasysh që është bërë marrëveshje për paushall, pagesë prej 600 milionë eurove, e cila pastaj është rrit në 608

milionë për shkak se është shtuar TVSH-ja nga 16% në 18%, dhe duke e pasur parasysh se nuk ka pasur fare projekt dhe kontraktorit i bie përsipër që ta hartojë projektin, unë mund të konkludoj që kjo kontratë që e dimë të gjithë që është sipas tipit, sipas kontratave të FIDIC-ut, që është Federata Ndërkombëtare për Inxhinierët Konsulentë dhe kontratist mendoj dhe supozoj që kontrata është “Libri i Argjendte” - “Silver Book”, e cila i jep kontraktuesit jashtëzakonisht tepër shumë autoritet, në ndërkohë që punëdhënësi në këtë rast Qeveri është shumë pak e përfshirë, që i bie që komplet risku, rreziku i punëve në autostradë bie mbi kontraktorin.

Kjo është një anë e favorshme për Qeverinë, por, në anën tjetër, kontraktori e ka autoritetin e plotë për dizajn dhe për korridor që ta përcaktojë korridorin dhe kjo pastaj e detyron Qeverinë t’i shkelë ligjet e veta. Dhe në këtë rast, është shkelur konkretisht Ligji për vlerësimin strategjik mjedisor, sepse nuk mund të bëhet vlerësimi strategjik mjedisor duke u bërë projekte të cilat mund t’i bëjë ku të dojë kontraktori dhe, e dyta, dëmet tjera kanë qenë për shkak të testeve të ndryshme që i ka bërë Kompania Bechtel&Enka, e sot kemi dëmtime të shumta në faqen e malit, faqen e majtë të malit në rrugën Kaçanik - Hani i Elezit, janë kilometra të tërë të gërryer të tokës ku janë bërë testimet, për të cilat në atë faqe ne e dimë të gjithë që është vend ku ka rrëshqitje të mëdha të dheut dhe kjo rrezikon edhe më tepër rrëshqitje në të ardhmen.

E, tash, çka ndodhi më tutje? Kur u nënshkrua kjo kontratë me 600 milionë euro, buxhet të paraparë nuk ishin 600 milionë euro, por vetëm për vitet 2014 - 2016 ishin 285 milionë euro. Qeveria ka qenë e papërgjegjshme atë kohë kur e ka nënshkruar këtë kontratë, sepse ka ndarë jashtëzakonisht pak buxhet për diçka që nuk mund të mbulohet deri në përfundim të kësaj kontrate. Autostrada është paraparë që të përfundojë më 20 janar 2018. Edhe një herë dua ta cek që është kontratë e tipit FIDIC, dhe sipas kësaj kontrate definohen palët shumë qartë, është Qeveria në njërin anë, e cila sipas kontratës quhet punëdhënësi. E kemi kontraktorin, në këtë rast si palë që është Bechtel&Enka dhe ajo çka është më e rëndësishme për ta thënë është pala e tretë mbikëqyrëse, pra mbikëqyrëse profesionale, që sipas kontratës quhet inxhinieri, e në këtë rast është kompania “Hill International”. Kjo kompani e ka rolin jashtëzakonisht të rëndësishëm në të gjitha punët inxhinierike e jashtëzakonisht shumë të rëndësishme në këtë, konkretisht në projektin të cilin Qeveria po e realizon sot.

Cili është në këtë rast roli i kompanisë “Hill”? Nëse i kemi dy palët, Qeverinë, e cila i jep fonde, donacione dhe kontraktorin, që i kryen punët, kompania “Hill”, në këtë rast inxhinieri do ta kryejë të themi mbikëqyrjen profesionale dhe njëlloj ndërmjetësimi. Nuk mund të bëhet pagesa pa e dhënë pëlqim kompania “Hill International”. Mund të kërkojë Bechtel&Enka miliona të tërë, mund të ketë pretendime e pretendime, Qeveria nuk është e thirrur për t’i vlerësuar ato, ama është kompania, në këtë rast “Hill International” – Inxhinieri, që duhet ta vlerësojë secilën punë, të cilin e kryen kontraktori dhe pastaj për ta paguar Qeveria në afatet e caktuara, të cilat parashihen me kontratë. Nëse do të kishte vonesa, nuk pritet që penalltitë të ndodhin në fund, penalltitë kërcasin menjëherë. Pra, nuk mund thjesht të kërkohet një punë, të kërkohet një

pagesë. Atë çka e realizon Bechtel&Enka e vlerëson kompania “Hill International” dhe e paguan Qeveria e Kosovës. Kjo është marrëdhënia në trekëndësh, në këtë trekëndësh ndërmjet këtyre tri palëve, të cilat janë të qartësuara besoj me kontratë, edhe pse ajo nuk është publike, por prapë po e them e dimë që është sipas FIDIC-ut, dhe supozojmë qartë që është Libri i Argjenditë. Ajo çka do të doja ta përmend është që neve, mua personalisht, më ka qartësuar më së tepërmi është raporti të cilin e ka dorëzuar ministri i Infrastrukturës, zoti Pal Lekaj, në Komisionin për Zhvillim Ekonomik, në të cilin raport besoj që keni rast, mundësi ta keni ju të gjithë, dhe e kam edhe unë.

Ajo çka do të doja të cek këtu është, për mua këto janë pyetje dilemat më të mëdha që dua t’i shtroj, thotë kështu në pjesën e parë, në kapitullin e parë: “Pas vonesës së pagesave nga Qeveria e Kosovës për punët e kryera nga kontraktori dhe rrjedhimisht ngecjes në përparimin e ndërtimit sipas planit dinamik, Qeveria e Kosovës është detyruar për të kërkuar zgjatjen e kontratës”. I bie që komplet përgjegjësia për kërkesën për zgjatjen e kontratës është te vonesat e pagesave. Kjo punë është e definuar besoj me kontratë shumë qartë, përderisa kemi kompaninë “Hill International”, kjo punë qartësohet aty. Nuk mund të bëhet ndonjë pagesë pa e vlerësuar kjo kompani. Këtu në po të njëjtin raport, në pjesën e tretë thotë që në vitin 2014 është dashur të paguhen 70 milionë euro, ndërsa janë paguar 55 468,...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Minutat e Vetëvendosjes, vazhdoja! Regjia, të lutem vazhdoja fjalën, kalon në konsumin e minutave të Vetëvendosjes!

LIBURN ALIU: Pra, nga 70 milionë që është dashur të paguhen, janë paguar 55 milionë. Këtu shtrohet pyetja, a s’ka pas Qeveria pare që i ka paguar vetëm 55, apo kaq është puna, të cilën e ka bërë Bechtel&Enka? Ta kemi të qartë, këtu kemi prapë të bëjmë me kompaninë ndërmjetësuese, palën e tretë, mbikëqyrjen profesionale kompaninë “Hill International”, ata e bëjnë vlerësimin e punëve. Nëse ata e kanë vlerësuar punën 55 468 milionë, kaq duhet të paguajë Qeveria, jo më tepër. Ndoshta janë paraparë 70 milionë, kanë mundur në buxhet të ndahen 85 milionë qysh janë ndarë, ama pagesa bëhet 55 milionë, aq sa ka punuar kompania.

Njëjtë në vitin 2015, 112 milionë dhe thotë është dashur të paguhen 220 milionë. Sa është vlerësimi i Bechtel&Enka? Sa e ka bërë vlerësimin e punës së Bechtel&Enka kompania “Hill International”, a është 112 milionë? Nëse është 112 milionë, Qeveria është krejt në rregull, i ka paguar 112 milionë. Dhe, 155 milionë nga 205 për vitin 2016. Kjo punë duhet të sqarohet nëse vërtet ka pasur vlerësim nga kompania “Hill International”, sepse nuk bëhet ndonjë pagesë shtesë, mund të kërkojë “Bechtel&Enka” sa të dojë, por mund të paguhet vetëm aq sa ka punuar. Kjo punë qartësohet shumë qartë me kontratë besoj. Ajo që pastaj është jashtëzakonisht me rëndësi është që flitet për kërkesën për shtyrje të kontratës, e cila është bërë me kërkesën e ish-

ministrit Lutfi Zharku, e cila kërkesë bazohet që për faktin që buxheti ka qenë i vogël dhe nuk ka mundur ta përmbushë, ka mbetur përgjegjësi te Qeveria e Kosovës. Ky problem duhet të diskutohet në të ardhmen edhe me ministrin Zharku, madje edhe sot mbase. Pse konsiderohet që është faji te Qeveria nëse ne i kemi paguar aq sa ka thënë “Hill”? Pse po konsiderohemi ne fajtorë për shtyrjen? Nëse ata që po supozojnë që paskan punuar vetëm aq sa ne kemi ndarë buxhet, ata kanë mundur të punojnë edhe më tepër, siç ka ndodhur kjo në vitin 2017. Në vitin 2017 është paraparë buxhet 105 milionë, e sa është paguar - 170 milionë. Pra, edhe pse është paraparë 105 milionë, janë paguar 170 milionë. E njëjta ka mundur të ndodhë edhe në vitet tjera. Nuk do të thotë pse parasheh, paguhesh më shumë ose më pak, paguhesh sa ke punuar, dhe pastaj në një marrëveshje ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe “Bechtel&Enka” ka dalë kërkesa për shtyrje të afatit për 11 muaj e 13 ditë, e cila është vlerësuar 14 778 654 euro, për 11 muaj vonesë, duke e llogaritur 1 milion euro vonesën për muaj, kjo ka qenë marrëveshja dhe kjo duhet të diskutohet, pse? Kah erdhi ky 1-milionësh?

Dhe, tjetra? Është llogaritë premiumi i sigurimit për këtë periudhë kohore dhe duke ia shtuar TVSH-në ka arritur deri te kjo vlerë. Dhe, meqenëse kjo marrëveshje nuk qenka realizuar për shkak se komisioni ndërministror e ka arsyetuar që nuk duhet ta paragjykojmë fundin, njëri prej arsytimitëve ka qenë që nuk duhet ta paragjykojmë ne që do të ketë shtyrje, vjen pastaj shtatori i vitit 2017, kur kontraktori edhe sipas këtij raporti vjen me propozimin, duke pretenduar kërkesën prej 63 milionë euro. Dhe, atë kërkesë prej 63 milionë eurove në këtë raport thotë që e arsyeton për zgjatje të projektit, për pajisjet dhe për ndërprerjet, kur për zgjatje të projektit ka kërkuar 16,6, për pajisje 30,8 dhe 10 milionë euro për ndërprerje, që në total është 63 milionë euro.

Një veprim i drejtë, për mendimin tim, i ministrit Pal Lekaj, ka shkuar te kompania “Hill International” dhe ka kërkuar nëse kjo kërkesë është e drejtë, dhe përgjigjja nga “Hill International” që është palë me kontratë, palë e tretë, dhe autoritet në çështjet e inxhinierisë, ka qenë “jo”. Pika e parë, po, çështja e shtyrjes, ndërsa çështjet e pajisjeve dhe çështjet e ndërprerjeve është problem i kontraktuesit. Pse? Kemi kontratën “Libri i argjendte”, krejt rreziqet bien mbi kontraktuesin. A e bën kontraktuesi me pajisje a me shati, është punë e tij. Nuk mund të kërkojë kontraktuesi në këtë rast absolutisht pagesë shtesë për pajisjet.

Prandaj, në këtë rast, pse është anashkaluar mendimi, opinionimi, i kompanisë “Hill-International”? Ata kanë thënë: Jo 63 milionë euro, mund të flitet vetëm për shtyrjen e kontratës, për atë që ka pasur edhe marrëveshje në fakt më herët. Pse është dashur me i dhënë edhe milionat tjerë pa e konsultuar fare? Pse ministria shkon me “Bechtel&Enka” lidh marrëveshje dhe nënshkruhet marrëveshja pa e thirrur autoritetin, që me kontratë është kompetent për ta vlerësuar punën? Pra, këtu e kemi problemin.

53 milionë euro kanë dalë si rezultat i një marrëveshjeje, e cila nuk e ka bazën te puna konkrete e kryer dhe për këtë punë unë mendoj se këtu duhet të kërkohet llogari. Ky 53 milionë eurosh

duhet të sqarohet në hollësi. Pse jepen para për pajisjet, kur ajo nuk është... është përgjegjësi e kontraktuesit për ndërprerjet, ku prapë është çështje e kontraktuesit.

Dhe një çështje tjetër, gjendjen që po e shohim ne sot po e shohim që nuk do të kryhet kontrata deri më 31 dhjetor 2018. A do ta penalizojmë ne pastaj Behtel&Enkën? Dhe, ajo që dua të them është, ky 53 milion eurosh që përmendet në raporte kudo, quhet si penalizim i Qeverisë së Kosovës. Urdhëroni, na i sillni dokumentet ku u penalizua, qysh u penalizua. Për mua ky nuk është penalizim. Nuk është penalizuar në këtë rast Republika e Kosovës për punën në pagesë, por konkretisht është dhënë në mënyrë të parregullt ky 53 milion eurosh. Faleminderit!

Më falni, për çështjen e rezolutës do të kemi mundësi të diskutojmë dhe ta bëjmë një rezolutë të përbashkët. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në ndërkohë edhe LDK-ja po e kërkon fjalën, por kjo paraqitja është kjo është një materie. Me Rregullore, i nderuar Avdullah, nuk kam të drejtë, me Rregullore ta them edhe publikisht, unë mund ta bëj një përjashtim në minuta të LDK-së del ta shfrytëzojë kohën para se të fillojë kryeministri të ju përgjigjet raportuesit të interpelancës. A e bëjmë kështu? Atëherë, në minuta të LDK-së kaloni njëri, cili të doni. Kush, Aga Lutë, Lutfi Zharku, më fal, e ka fjalën.

LUTFI ZHARKU: I nderuar kryetar,
Kryeministër,
Ministra të nderuar,
Kolegë deputetë,

Ashtu siç është cekur edhe në kërkesën për interpelancë, Lidhja Demokratike e Kosovës e konsideron se ndarja e mjeteve shtesë në shumë prej 53,1 milionë eurosh për zgjatjen e afatit të përfundimit të punimeve në Autostradën Prishtinë - Hani i Elezit, në bazë të vendimit të Qeverisë 01/50 të datës 5 qershor 2018 nuk ka bazë ligjore dhe as kontraktuale.

Në mënyrë që të argumentoj këtë do ta sqaroj llojin e kontratës, strukturën institucionale dhe organizative të vendosur për realizimin e projektit, vendimin e Komitetit Drejtues Ndërministror të kaluar mbi aprovimin e kostos shtesë në shumë prej 14.78 milionë euro, si dhe qëndrimet tona në lidhje me vendimin e Qeverisë për miratimin e kostos shtesë në shumë prej 53,1 milionë euro dhe disa nga arsyet e paraqitura nga ta.

Kontrata për ndërtimin e Autostradës Prishtinë - Hani i Elezit, e nënshkruar nga Ministria e Infrastrukturës në emër të Qeverisë së Kosovës me Konsorciumin Bechtel&Enka është lloji i kontratës FIDIC, të cilat janë forma standarde të kontratave për projekte ndërtimore, të hartuara nga Federata Ndërkombëtare e Inxhinierëve konsulentë e që përdoren në tërë botën.

Format FIDIC paraqesin pikënisje në përgatitjen e kontratave ndërtimore të cilat plotësohen, në mënyrë që të reflektojnë karakteristikat e veçanta të çdo projekti, si dhe kërkesat e palëve. Edhe në rastin tonë, kësaj i janë shtuar kushtet e veçanta dhe klauzola shtesë, të cilat rregullojnë në mënyrë specifike çështje të caktuara në interes të të dyja palëve, siç janë afati i përfundimit të punimeve, ndarja e rrugës në seksione, komunikimi i palëve, përcaktimi që kontrata qeverisëse sipas ligjeve në Kosovë, gjuha e komunikimit, konfidencialiteti, sigurimi i performancës, dëmet për vonesa, nënkontraktimi, mjedisi, e tjera.

Tek ne është aplikuar “Libri i Argjendte”, si formë e kontratës FIDIC, që përdoren në projekte që përfshijnë dizajnin, prokurimin dhe ndërtimin, të njohura si projekte EPC. Sipas këtyre projekteve kontraktuesi obligohet që t’i dorëzojë investitorit objektin e kompletuar dhe të jetë i gatshëm për të operuar sipas parimit të njohur “me çelës në dorë”.

Prandaj këto kontrata vendosin tërë përgjegjësinë e projektimit dhe ndërtimit të projektit në kontraktuesin. “Libri i Argjendte” përdoret aty ku janë të rëndësishme pasiguria e çmimit dhe data e përfundimit, duke i mundësuar investitorit që të ketë mundësi më të madhe se në format tjera të kontratave. Kështu, përderisa Qeveria e Kosovës ka zgjedhur formën e duhur të kontratës për zhvillimin e këtij projekti, këtë nuk e ka bërë edhe sa u përket kushteve të kontraktuara. Qeveria ka përzgjedhur anën e mirë të kësaj kontrate sa i përket kufizimit të çmimit që paguhet për autostradë, duke kontraktuar shumë fikse për tërë projektin në shumë prej 600 milionë euro, me mundësi të shpenzimeve të paparapara në lartësi prej 10% në përputhje me Ligjin për prokurimin publik. Mirëpo, ajo nuk e ka bërë këtë edhe sa i përket afatit të përfundimit të punimeve, duke përcaktuar afatin prej 42 muajsh jo në përputhje me mundësitë e alokimeve vjetore buxhetore për këtë kontratë.

Të nderuar deputetë,

Siç kam sqaruar shumë herë në Kuvend dhe në medie, kontrata për ndërtimin e autostradës është nënshkruar më 2 korrik 2014, që do të thotë më shumë se 5 muaj para se të emërohet Qeveria e kryeministrit Mustafa. Dy vite më parë, Qeveria përmes vendimit 06/78, datë 12 qershor 2012 ka themeluar Komitetin Drejtues Ndërmintor për Zhvillimin e Projektit në përbërje nga ministri i Infrastrukturës si kryesues dhe nga ministri i Financave, i Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Industrisë dhe i Ambientit e Planifikimit Hapësinor si anëtar. Për marrjen e vendimeve të Komitetit Drejtues Ndërmintor kërkohet vota afirmative e shumicës së anëtarëve të komitetit, përfshirë votën afirmative të ministrit të Infrastrukturës dhe atij të Financave.

Për zbatim me sukses të projektit Komiteti Drejtues Ndërmintor më 15 shtator 2014 ka themeluar njësinë për zbatimin e projektit nga shërbyes civilë të Ministrisë së Infrastrukturës, ekspertë nga fusha profesionale, të cilët kanë qenë të angazhuar edhe në Autostradën Ibrahim Rugova, e cila edhe e ka rolin e sekretariatit teknik dhe administrativ për nevojat të Komitetit Drejtues Ndërmintor. Rregullat dhe udhëzuesi operativ për prokurimin publik këtë njësi e

ngarkon edhe me përgjegjësi të mbikëqyrësit të menaxherit të kontratës. Pas kësaj, Qeveria përkatësisht Ministria e Infrastrukturës, bazuar në Ligjin për prokurimin publik ka kontraktuar kompaninë konsulente amerikane me renome ndërkombëtare “Hill International” për menaxhimin e kontratës në aspektin teknik financiar dhe ligjore, si dhe mbikëqyrjen e punimeve, si në aspektin cilësor dhe atë sasior.

Duke marrë parasysh rëndësinë e këtij kontraktimi më duhet të sqaroj angazhimin e menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të punimeve “Hill International” nga Qeveria. Po përmend vetëm dy arse bazë për angazhimin e menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të punimeve apo siç njihet inxhinierit të pavarur nga jashtë Qeverisë. Në aspektin e standardeve ndërkombëtare, të trupëzuara edhe në legjislacionin tonë, çdo ndërtim që kryhet për shfrytëzim nga palët e treta duhet ta kryejë, duhet të mbikëqyret nga kompani apo inxhinierë të pavarur profesionalë, të cilët do të kryejnë punën e tyre me paanshmëri dhe do të vlerësojnë kontestet eventuale në mes të investitorëve dhe punëkryesit. Ky standard është i përfshirë si mundësi edhe në Ligjin për prokurimin publik i specifikuar me rregullat dhe udhëzuesin operativ të prokurimit publik numër 61.18.

Në anën tjetër kushtet standarde te kontrata FIDIC përcaktojnë inxhinierët e pavarur si menaxherë të kontratave dhe mbikëqyrës të punimeve. Kjo vjen nga fakti se investitor në parim mund të jetë individ, kompani apo institucione që investojnë në objekte të ndryshme të mëdha, pa pasur nevojë të kenë ekspertizën apo përvojën e duhur dhe interesat e tyre në përgjithësi janë në kundërshtim me njëra-tjetrën.

Në këtë mënyrë angazhimi i inxhinierit të pavarur të jashtëm profesional vepron si përfaqësues i investitorit për menaxhimin e kontratës dhe mbikëqyrjen e punimeve si në aspektin cilësor dhe sasior. Për këtë arsye menaxhimi i kontratave dhe mbikëqyrja e punimeve të tilla u besohet kompanive që kanë ekspertizë dhe përvojë profesionale të nivelit të njëjtë me atë të punëkryesit, gjegjësisht kontraktuesit.

Në rastin tonë realizimi i Autostradës Prishtinë - Hani i Elezit i është besuar Konsorciumit Bechtel&Enka, i cili në aspektin e ekspertizës dhe përvojës në këtë fushë është shumë më superior se investitori, gjegjësisht Qeveria e Kosovës, prandaj Qeveria fatmirësisht ka përzgjedhur për menaxhimin e kontratës dhe mbikëqyrjen e punimeve si përfaqësues të saj kompaninë amerikane “Hill International”, e cila është lidere botërore në menaxhimin e riskut në ndërtimtari. Si rezultat i kësaj, që nga momenti i nënshkrimit të kontratës me “Hill International”, Qeveria e Kosovës e ka bartur menaxhimin e kontratës dhe mbikëqyrjen e punimeve në aspektin ligjor te kjo kompani, e cila në përputhje me rregullin 61.19 të rregullave për prokurimin publik menaxhon obligimet dhe detyrat e autoritetit kontraktues të specifikuar në kontratë dhe siguron se operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termet dhe kushtet e specifikuar në kontratë.

Prandaj, që nga momenti i nënshkrimit të kësaj kontrate, as Qeveria e Kosovës, as Komiteti Drejtues Ndërministror, as ministri i Infrastrukturës nuk kanë pasur të drejtë ligjore dhe as kontraktuale që të përfshihen në menaxhimin e kontratës. Në përputhje me rregullat dhe udhëzuesin operativ për prokurim publik, që nga momenti i nënshkrimit të kësaj kontrate, asnjë faturë apo ndonjë shpenzim apo çfarëdo kostoje tjetër nuk mund të pranohet pa aprovimin nga menaxheri i kontratës, si dhe asnjë pagesë nuk mund të bëhet pa aprovimin e tij. Asnjë punë shtesë apo ndryshim nuk mund të bëhet pa aprovimin e menaxherit të kontratës. Rrjedhimisht, investitori dhe punëkryesi në rastin tonë Qeveria dhe “Bechtel&Enka” për shkak të interesave të kundërta me njëra tjetrën nuk kanë të drejtë të përcaktojnë direkt kurrfarë çështjeje pa pëlqimin e menaxherit të kontratës.

Prandaj, cilado marrëveshje direkte duke anashkaluar menaxherin e kontratës paraqet shkelje të rregullave bazë të menaxhimit të kontratave, gjegjësisht shkelje të rregullave 61.19 dhe 61.20 të rregullave dhe udhëzuesit operativ për prokurim publik dhe çfarëdo marrëveshje e tillë, në cilëndo gjykatë apo arbitrazh vendore apo ndërkombëtare konsiderohet e pavlefshme.

Të nderuar deputetë,

Tash kthehemi te situata financiare e Qeverisë me rastin e nënshkrimit të kontratës për autostradë. Së pari, duhet theksuar se të dyja palët, edhe Qeveria, edhe Bechtel&Enka kanë hyrë në marrëveshje, të cilën paraprakisht e kanë ditur se mund të kenë vështirësi ta përmbyllin anën financiare të saj në përputhje me afatin e kontraktuar prej tri vjet e gjysmë. Në ditën e nënshkrimit të kontratës në përputhje me Ligjin e Buxhetit të vitit 2014 për periudhën 2014 - 2016 kanë qenë të buxhetuara vetëm 285 milionë euro dhe atë 85 milionë euro për 214-ën, 100 milionë për 2015 dhe 100 milionë për 2016, kurse kontrata është nënshkruar në shumë prej 600 milionë eurosh, e cila prapë në përputhje me Ligjin për prokurimin publik mund të rritet edhe 10% në rast të punimeve shtesë të paparapara.

Pra, Qeveria e Kosovës ka hyrë me vetëdije në një kontratë, se do ta ketë pothuajse të pamundur sigurimin e fondeve sipas afatit të kontraktuar për përfundimin e punimeve. Po ashtu, edhe Bechtel&Enka ka hyrë në një kontratë duke qenë e vetëdijshme se Qeveria do të ketë vështirësi në respektimin e afatit të punimeve për shkak të mungesës së fondeve. Megjithatë, Qeveria Mustafa e ka trashëguar kontratën e nënshkruar dhe para saj kanë qenë vetëm dy opsione: zbatimi me përpikëri i kontratës, duke ndërprerë shumë...

(Ndërprerje nga regjia)

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Kujtim Shala.)

KRYESUESI: Lus regjinë që të vazhdojë nga minutat e Lidhjes Demokratike të Kosovës.

LUTFI ZHARKU: ...zbatimi me përpikëri i kontratës, duke ndërprerë shumicën e projekteve kapitale tanimë të kontraktuara, jo vetëm në rrugë por edhe në projekte tjera, ose të vazhdohet me ritëm të ngadalësuar të punimeve. Natyrisht, Qeveria Mustafa gjatë gjithë kohës ka qenë e përgjegjshme, duke shterur të gjitha opsionet e mundshme për realizimin e kontratës me përpikëri, por pa dëmtuar projektet tjera kapitale më se të nevojshme për vendin tonë.

Buxheti i ndarë për ndërtimin e Autostradës është publik dhe i bazuar në Ligjin e Buxhetit për vitin përkatës, i cili përfshin edhe parashikimet për dy vitet e ardhshme, duke dëshmuar transparencë me punëkryesin dhe duke mos dhënë premtime të pabaza. Kjo i ka mundësuar Bechtel&Enkas përshtatjen e programit të punimeve me buxhetin e ndarë dhe duke kontribuar në minimizimin e kostove eventuale të parapara të të dyja palëve.

Kështu pas takimeve të shumta në mes të gjitha subjekteve të përfshira në këtë proces, menaxheri i kontratës “Hill International” ka rekomanduar shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve për 11 muaj e 13 ditë, që nga data e përfundimit të punimeve, që data e përfundimit të shtyhet nga 18 janar në 31 dhjetor 2018, me kosto shtesë prej 14 778 654 euro e 87 centë, e cila shumë përbëhej vetëm nga dy pozicione bazë dhe TVSH. Kostoja indirekte prej 1 milion euro në muaj në përputhje me ofertën financiare të kontraktit, që është pjesë e kontratës që në bazë të përlllogaritjeve për 11 muaj e 13 ditë është 11 419 354 euro e 84 centë. Kostoja e sigurimit të performancës së kontratës për periudhën e shtyrë është bazuar në koston aktuale të paguar nga kontraktori, sipas përlllogaritjeve detaje nga Hill International dhe arrin shumën prej 1 104 928 euro e 95 centë. Të dyja këto pozicione së bashku arrijnë shumën prej 12 524 283 euro e 79 centë dhe i shtohet TVSH-ja në shkallë prej 18% në shumë prej 2 254 379 euro e 8 centë dhe arrin te kostoja totale prej 14,78 milionë.

Komiteti drejtues ndërministror në mbledhjen e mbajtur më 30 shtator 2016 pas shqyrtimit të rekomandimit të menaxherit të kontratës “Hill Internacional”, në mënyrë unanime ka aprovuar aneks-kontratën me Bechtel&Enka për zgjatjen e afatit të përfundimit të punimeve deri më 31 dhjetor 2018, si dhe koston shtesë bazuar në ligj dhe kontratë në shumë prej 14,78 milionë euro dhe i ka rekomanduar Qeverisë ta miratojë këtë vendim. Janë së paku tri arsye pse Komiteti Drejtues Ndërministror e ka kërkuar miratimin e Qeverisë për këtë çështje.

E para, rekomandimet për nënshkrimin e kontratës bazë i ka përkrahur Qeveria sipas vendimit 01/193, datë 30 qershor 2014, që nënkupton se edhe çdo aneks i saj duhet paraprakisht të përkrahet nga Qeveria.

E dyta, shtyrja e afatit të përfundimit të punimeve ka rezultuar me kosto financiare dhe jo punë të kryer shtesë e të paparaparë, që do të mund të shqyrtohej si lëndë e kontratës, dhe e treta është se kostoja financiare për shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve nuk përfshihet në kuadër të

shumës 10% të lejuar për punë shtesë të paparaparë dhe të jashtëzakonshme në përputhje me kontratën dhe Ligjin për prokurimin publik.

Mirëpo, Qeveria nuk e ka shqyrtuar asnjëherë në ndonjë nga mbledhjet e saj rekomandimin e Komitetit Drejtues Ndërministror për miratimin e kostos shtesë për zgjatjen e afatit të përfundimit të punimeve. Duke u nisur nga esenca e aneks-kontratës, e cila ka të bëjë me koston për shtyrje të afatit të përfundimit të punimeve nga 18 janari në 31 dhjetor 2018 dhe se pagesa do të duhej të bëhej çdo muaj në mënyrë proporcionale që nga momenti i hyrjes në fuqi të shtyrjes së afatit, gjegjësisht nga 19 janari 2018 nënshkrimi i saj është konsideruar i hershëm nga Qeveria. Me aprovimin e aneks-kontratës Komiteti Drejtues Ndërministror ka vendosur limitin e epërm të kostos shtesë. Qeveria ka shtyrë miratimin dhe nënshkrimin e aneks-kontratës për shkak se ka pasur plane të qarta, të cilat do të rezultonin me rritje të buxhetit dhe rritje të alokimit të mjeteve për autostradë, e për të cilat janë njohur palët.

Siç tanimë dihet, buxheti i vitit 2017 është rritur në shumë prej 2 miliardë eurosh, kurse alokimet për autostradë arritën në 200 milionë euro. Qeveria me rishikimin e Buxhetit do të rriste edhe më tutje alokimet për autostradë, por zhvillimet politike të cilat pasuan me votim të mosbesimit të Qeverisë më 10 maj 2017 dhe zgjedhjet e parakohshme të qershorit i ndërprejnë të gjitha masat në këtë fushë.

Të nderuar deputetë,

Pajtueshmëria e plotë e punëkryesit dhe përcaktimi i kostos nga “Hill International” bazuar në kontratë dhe ligj ka qenë garanci e pakontestueshme për kufizimin e shpenzimeve, që është arritur edhe bazuar në bashkëpunimin e singertë dhe afatgjatë të të dyja palëve. Fatkeqësisht, me kërkesën e fundit për kosto shtesë, Bechtel&Enka e përkrahur nga Qeveria e ka keqpërdorur mirëbesimin, pasi që me vetëdije ka hyrë në një kontratë që vështirë do të përmbushej pa dështimin e palës tjetër. Por, hyrja në një kontratë duke e ditur paraprakisht se pala tjetër do të dështojë dhe në atë rast ju mund të përfitoni, konsiderohet hazard moral dhe njihet si keqpërdorim i së drejtës.

Për më tepër, duke marrë parasysh që kemi të bëjmë me fonde publike hyrja në një kontratë, në të cilën punëkryesi mund të përfitojë nga dështimet e pritura të Qeverisë, konsiderohet kontratë e korruptuar. Ky keqpërdorim i së drejtës konfirmohet me faktin, se përfitimi nga kostoja prej 53,1 milionë eurosh edhe është përtej masës së dëmit eventual të shkaktuar nga Qeveria dhe ky përfitim është në kundërshtim me Ligjin në fuqi në Kosovë.

Kështu duket se qëllimi i vetëm i përfitimit është dëmtimi i paarsyeshëm i Qeverisë. Prandaj, edhe për këtë arsye kërkesa e “Bechtel&Enka” për koston shtesë prej 53,1 milionë euro konsiderohet si e pabazë. Natyrisht, ata e dinë se përmes keqpërdorimit të së drejtës nuk do të

mund të fitonin në asnjë arbitrazh, prandaj kanë bërë marrëveshje direkte me Qeverinë dhe ministrin Lekaj, duke anashkaluar menaxherin e kontratës “Hill International”.

Të nderuar deputetë,

Pavarësisht asaj se aneks-kontrata nuk është miratuar, Qeveria aktuale e ka trashëguar atë dhe e ka pasur obligim që të njëjtën ta respektojë duke marrë të gjitha masat për implementimin e saj, apo eventualisht të mundohet ta zvogëlojë koston, e jo ta katërfishojë.

Deri më tash, Qeveria nuk ka publikuar asnjë dokument me të cilën dëshmon përpjekjet e saj në këtë drejtim. Përkundrazi, ajo hoqi dorë nga aneks kontrata që ishte në fuqi, edhe më keq, ministri Lekaj shkeli rregullat e prokurimit publik dhe uzurpoi të drejtat e Departamentit të Prokurimit dhe të menaxherit të kontratës dhe në mënyrë kundërligjore, vetëm 2 javë pas marrjes së detyrës, më 20 shtator 2017 nënshkroi marrëveshje për zgjatjen e afatit të përfundimit të punimeve.

Me nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje, ai në mënyrë kundërligjore apriori ka përcaktuar dhe ka pranuar pa kurrfarë fakti se fajtori i vetëm për shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve është Qeveria dhe i ka hapur rrugë punëkryesit “Bechtel-Enka”-s që të parashtrijë çfarëdo kërkesë financiare.

Nuk besoj se ka ndonjë rast në realizimin e ndonjë projekti, qoftë publik apo privat, ku zgjatet afati i përfundimit të punimeve pa u përcaktuar kostoja e saj.

Deputetë të nderuar,

Se ministri Lekaj e ka shkelur me vetëdije dhe qëllimisht ligjin dhe kontratën, e pranon ai vetë me shkresë zyrtare. Kështu në raportin e ministrit Lekaj numër KM-MI 075/18, datë 19 janar 2018, për pretendimet penale të “Bechtel-Enka”-s ndaj Qeverisë të dorëzuar Komisionit Parlamentar për Zhvillim Ekonomik, shkruan:

“Ministria e Infrastrukturës më 13 dhjetor 2017 ka kërkuar nga mbikëqyrësi ‘Hill International’ të hartojë një opinion lidhur me arsyeshmërinë e kërkesës së kontraktorit”.

Mbikëqyrësi i kontratës e ka dorëzuar opinionin, me të cilën është mbështetur kërkesa e kontraktorit për pagesë shtesë, sipas planit fillestar si më lart, por është refuzuar kërkesa për pagesën nën pikat b dhe c.

Për dijeninë tuaj, kërkesa e “Bechtel-Enka”-s në shumë prej 63 milionë euro, sipas shkresës së ministrit Lekaj përbëhet nga:

a) zgjatja e projektit, mbajtja e personelit menaxhues në shumën prej 16,6 milionë eurosh,

b) pajisjet të cilat duhet të përdoren gjatë kësaj periudhe me kosto prej 30.8 milionë eurosh, dhe

c) ndërprerjet e shkaktuara gjatë periudhës 2014-2017, në kosto prej 10 milionë eurosh.

Nuk ka nevojë për dëshmi më të madhe se kjo për shkelje të ligjit. Mbikëqyrësi i kontratës e miraton pagesën shtesë vetëm sipas pikës a) në shumë prej 16,6 milionë euro, kurse Qeveria ai aprovon 53,1 milionë euro.

Kjo vërtetohet se ministri Lekaj nuk i përfill procedurat e parapara me kontratë dhe ligj për zgjidhjen e kontestit, të cilat përcaktojnë inxhinierin e pavarur "Hill International" si të vetmin subjekt ligjërish kompetent për këtë çështje.

Prandaj, ministri Lekaj dhe Komiteti drejtues ndërministror duhet të sqarojnë cila është arseja e shkeljes së ligjit dhe kontratës, duke përcaktuar drejtpërdrejt me punëkryesin koston e shtyrjes së afatit të përfundimit të punimeve në shumë prej 53,1 milionë eurosh dhe mospranimit të vlerësimit prej 16,6 milionë eurosh nga ata që Qeveria i paguan për këtë punë.

Sipas rregullave të prokurimit publik, ata janë të angazhuar nga Qeveria e Kosovës të veprojnë si përfaqësues tonë në projektin e ndërtimit të autostradës dhe vetëm ata janë kompetentë për vlerësimin e çfarëdo kërkesë të punëkryesit.

Përndryshe, janë rreth 1 600 shkresa të korrespondencës së tyre, të cilat e dëshmojnë tërë ecurinë e projektit që nga fillimi e deri më sot.

Për më tepër, siç duket, ministri Lekaj nuk e ka konsultuar as Njësinë për implementimin e projektit në përcaktimin e koston shtesë për shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve.

Deri sot ai nuk publikoi asnjë vlerësim nga kjo njësi, kurse drejtori i saj, zoti Qupeva, në të cilin u thirr ministri si person që e ka bërë vlerësimin e koston shtesë, nuk ishte në krah të tij në konferencën për media që të mbështesë koston e tillë.

Natyrisht ai nuk ishte aty, sepse e di që gjatë këtyre tre vjetëve nuk ka pasur vonesa në pagesa të asnjë fature dhe nuk ka asnjë pajisje, kamionë, ekskavatorë apo çfarëdo qoftë, nuk ka asnjë të punësuar, inxhinierë, makinistë apo punëtorë të tjerë që nuk janë angazhuar për shkak se Qeveria e Kosovës nuk i siguroi buxhet të mjaftueshëm për realizimin e projektit.

Zoti Qupeva e di se sa i përket realizimit teknik operacional punëkryesi "Bechtel-Enka" nuk ka humbur asnjë minutë në punishte dhe kurrë nuk ka kërkuar dhe as që mund të kërkojë ndonjë cent nga Qeveria e Kosovës. Përndryshe, edhe ai do të ishte përgjegjës për mosreagim të tillë, ky

është edhe një fakt tjetër i pamohueshëm që rrëzon të gjitha pretendimet e ministrit Lekaj dhe “Bechtel-Enka”-s për koston shtesë për 53,1 milionë euro.

Deputetë të nderuar,

Më duhet shkurt të sqaroj edhe çështjen e të ashtuquajtur kërkesa të ndryshme për fonde nga “Bechtel-Enka”, të cilat në fakt paraqesin vlerësime vjetore për financim të projektit, të cilat Qeveria i konsideron fatura të papaguara si arsye për koston e miratuar.

Së pari, çdo kërkesë apo vlerësimi të tillë i është përgjigjur menaxheri i kontratës “Hill International” në përputhje me obligimin e tij kontraktual dhe ligjor dhe të gjitha i ka hedhur poshtë si të pabaza, duke u nisur, ndër të tjera, edhe nga faktet që “Bechtel-Enka” kur nuk e ka dorëzuar projektin e plotë të autostradës, në bazë të cilit do të përcaktohej programi i punës, që është dokumenti bazë për përcaktimin e dinamikës së punimeve dhe sasive në bazë, të cilat do të kërkoheshin fonde të tilla.

Së dyti, kurrë dhe asnjëherë “Bechtel-Enka” nuk ka kryer punë në bazë të kërkesave që ka parashtruar për fonde, por në bazë të buxhetit të ndarë me ligjin e aprovuar nga Kuvendi i Kosovës.

Vëllimi i punëve të kryera vërtetohet lehtë nëpërmjet raporteve mujore të punës, të cilat janë dorëzuar në Njësinë për zbatimin e projektit në Ministrinë e Infrastrukturës nga vetë “Bechtel-Enka” dhe të aprovuara nga “Hill International”.

Po të kishte kryer punë “Bechtel-Enka” sipas kërkesave për buxhet, që i paraqet ministri Lekaj, atëherë nuk do të kishte nevojë për shtyrje të afatit të përfundimit të punimeve, sepse autostrada do të ishte përfunduar më 18 janar 2018 dhe sot ne do ta shqyrtonim vetëm pagesën e borxheve, e jo shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve. Të gjithë qytetarët e Kosovës janë dëshmitarë që autostrada ende nuk është kryer.

Më tutje, se punët janë kryer vetëm në bazë të buxhetit të alokuar me ligj e vërteton edhe fakti se nuk ekziston asnjë faturë për punët që janë kryer dhe që nuk janë paguar në përputhje me afatet e përcaktuara me kontratë.

Komiteti Ndërminstrosor kurrë nuk ka pranuar ndonjë njoftim as nga “Bechtel-Enka”, as nga “Hill Interenational” dhe as nga Njësia për implementimin e projektit që ekziston ndonjë faturë e papaguar për mungesë buxheti.

Prandaj, asnjë pretendim i ministrit Lekaj, i cili fatkeqësisht po i lexon letrat e “Bechtel-Enka”-s për obligimet e papaguara, nuk është i vërtetë. Po të kishim borxh shumë, të cilat i përmendi ministri Lekaj, atëherë në përputhje me kontratën “Bechtel-Enka” do t’i kishte ndërprerë punët

për mospagesë të faturave, e që kurrë nuk ka ndodhur. Kjo është edhe arseja e thjeshtë që “Bechtel-Enka” ka hequr dorë nga kërkesa e tyre për kompensim në shumë prej 10 milionë eurosh, që u cek më lart.

Përndryshe, kjo çështje lehtë vërtetohet nga raportet financiare vjetore të Qeverisë së Kosovës, ku përshkruhen obligimet e çdo institucioni që financohet nga buxheti, e të cilat janë në ueb-faqen e Ministrisë së Financave dhe në disponim të çdo qytetari.

Për konfirmim të kësaj, po përmend vetëm obligimet e Ministrisë së Infrastrukturës sipas viteve, ku janë të përfshira edhe obligimet e “Bechtel-Enka”-s, po qe se ka pasur për t’u paguar ndonjë faturë brenda afatit kontraktual.

Kështu, të gjitha obligimet e Ministrisë së Infrastrukturës në vitin 2014 kanë qenë një milion e 30 mijë euro, faqe 72, aneksi 9 i raportit financiar të vitit 2014.

Kurse “Bechtel-Enka” dhe ministri Leka pretendojnë se nuk janë paguar afro 15 milionë. Në vitin 2015, të gjitha obligimet e ministrisë kanë qenë 22 milionë e 383 mijë, kurse “Bechtel-Enka” dhe ministri Lekaj pretendojnë se nuk janë paguar mbi 100 milionë euro. Në vitin 2016, të gjitha obligimet kanë qenë 15 milionë e 500 mijë, kurse “Bechtel-Enka” dhe ministri Lekaj pretendojnë se nuk janë paguar mbi 50 milionë euro.

Në vitin 2017, të gjitha obligimet janë 22 milionë e 500 mijë, kurse përsëri “Bechtel-Enka” dhe ministri Lekaj pretendojnë se nuk janë paguar me dhjetëra miliona euro.

Se këto pretendime janë të pabaza, vërtetohet edhe nëse e analizojmë vitin 2014. Kështu, Ligji i buxhetit 2014 e përcakton shumën prej 85 milionë eurosh për autostradën, “Bechtel-Enka” i ka kërkuar 70, kurse janë paguar 55, që do të thotë se “Bechtel-Enka” nuk ka mundur ta absorbojë as shumën që ka qenë e ndarë në buxhet.

Po ashtu, për vitin 2017 “Bechtel-Enka”, sipas shkresës në të cilën thirret ministri Lekaj, i ka kërkuar 105 milionë, kurse janë paguar 170 milionë, që do të thotë 65 milionë euro më shumë.

Nga ministri Lekaj dhe anëtarët e Qeverisë dëgjuam, ndër të tjera, edhe evitimin e Arbitrazhit si arsye të miratimit të një kostoje kundërligjore dhe jokontraktuale. Por, kërcënimi me Arbitrazh është filluskë, e cila shpërthehet lehtë nga çdo qytetar, e lëre më zyrtar publik.

Para së gjithash, Qeveria ka pasur obligim ta marrë opinionin e menaxherit të kontratës “Hill International” për këtë çështje, pasi ata do të duhej ta mbronin rastin në Arbitrazhin eventual, përsëri u anashkaluan ata, por Qeveria nuk e kërkoi një opinion, sado të thjeshtë, mbi rezultatet e Arbitrazhit eventual nga cilado firmë konsulente ligjore, qoftë vendore apo ndërkombëtare, pasi

e shkeli ligjin dhe kontratën me “Hill Internacional”, duke mos e kërkuar opinionin nga ata. Edhe më keq, Qeveria nuk e siguroi një opinion të thjeshtë ligjor së paku nga zyrtarë të shumtë juridikë të saj.

Si është e mundur që për dy javë, pa kurrfarë analize, të nënshkruhet marrëveshja për vazhdimin e afatit të punimeve pa e përcaktuar koston, kurse për 9 muaj nuk ishin në gjendje të angazhojnë ekspert për vlerësimin e koston, pasi menaxheri i kontratës ishte i pavlefshëm për Qeverinë.

Si nuk qe e mundur që Qeveria ta ndajë një shumë simbolike për vlerësimin e kësaj çështjeje para se të vendoste për miratimin e koston prej 53,1 milionë eurosh.

Se ministri Lekaj e ka përcaktuar në mënyrë kundërligjore koston shtesë për shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve, e vërteton edhe mospjesëmarrja e anëtarëve të caktuar të Qeverisë në këtë proces.

Kështu, ministri i Financave, pa votën afirmative të cilit, sipas vendimit të Qeverisë mbi themelimin e Komitetit Drejtues Ndërministror, nuk mund të merret asnjë vendim për projektin e autostradës, nuk ka marrë pjesë në asnjë mbledhje të Komitetit Drejtues Ndërministror.

Si rezultat, cilido vendim i Komitetit Drejtues Ndërministror mund të konsiderohet i pavlefshëm nga cilado gjykatë, për shkak se sipas vendimit të Qeverisë, Komitetin Drejtues e përbëjnë ministrat, e jo zëvendësministrat dhe në asnjë pikë të vendimit Qeveria nuk e ka lënë të hapur mundësinë e delegimit të kësaj përgjegjësie.

Përpos kësaj, ai nuk mori pjesë as në mbledhjen e Qeverisë, ku u miratua kostoja shtesë për shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve. Në atë mbledhje nuk morën pjesë as shumica e anëtarëve të Kabinetit qeveritar nga partia më e madhe e koalicionit, kurse këta të gjithë ishin në Kosovë.

Deputetë të nderuar,

Që nga ardhja në pushtet e Qeverisë, duke i paraprirë dhe për ta arsyetuar dëmin e madh financiar që do t’ia shkaktonin vendit, ministri Lekaj dhe anëtarë të ndryshëm të saj kanë trumbetuar për keqmenaxhim të kontratës nga Qeveria e kaluar, Komiteti Ndërministror dhe unë si ish-ministër i Infrastrukturës.

Nga sqarimi i mësipërm i strukturës organizative dhe institucionale të realizimit të projektit konfirmohet se asnjëri nga ne nuk ka pasur dhe as Qeveria aktuale nuk ka të drejtë ligjore e as kontraktuale të përfshihet në menaxhimin e një kontrate publike.

Prandaj, sa herë që cilido anëtar i Qeverisë përmend akuza për keqmenaxhim, i konfirmojmë dy çështje.

Çështja e parë është për keqardhje, për shkak se me akuza për keqmenaxhim Qeveria dhe cilido anëtar i saj që e përmend keqmenaxhimin e konfirmon mungesën e njohurive bazë për menaxhimin e kontratave publike në përgjithësi, e lëre më të llojit FIDIC dhe në veçanti infrastrukturën ligjore dhe strukturën institucionale të vendosur për realizimin e këtij projekti. Nëse nuk është padituri, atëherë kjo është shkelje me qëllim dhe me vetëdije të plotë e Ligjit për prokurimin publik dhe kontratën.

Ministri Lekaj, duke mos e zbatuar vendimin e Komitetit Drejtues Ndërministror të kaluar që përcakton koston për zgjatjen e afatit të përfundimit të punimeve në shumën prej 14,78 milionë eurosh dhe përsëri, duke mos respektuar opinionin e marrë nga menaxheri i kontratës “Hill International” për vlerësimin e ri prej 16,6 milionë euro, me qëllim shkeli ligjin dhe kontratën, duke i mundësuar përfitime të paligjshme “Bechtel-Enka”-s dhe dëmtuar buxhetin e Kosovës përmes përcaktimit të drejtpërdrejtë të koston në shumë prej 53 milionë eurosh.

Kështu ai vuri në lajthitje anëtarët aktualë të Komitetit drejtues ndërministror dhe anëtarët e tjerë të Qeverisë, të cilët e miratuan një kosto pa bazë kontraktuale dhe ligjore.

Çështja e dytë është se nëse Qeveria vërtet konsideron dhe ka dëshmi se kontrata është keqmenaxhuar dhe për pasojë duhet të paguajë kosto shtesë, atëherë është publikimi i saj ligjor dhe kontraktual që të kërkojë përgjegjësi nga menaxheri i kontratës “Hill International” dhe të fillojë procedurat kontraktuale për rimbursimin e koston, të cilën Qeveria e ka aprovuar për punëkryesin “Bechtel-Enka”.

Natyrisht Qeveria këtë nuk mund ta bëjë për shkak se duke e përcaktuar koston direkt me “Bechtel-Enka”-n, e ka shkelur kontratën me “Hill International” dhe rregullat e prokurimit publik.

Kështu me veprimet e saj Qeveria i ka shkelur të dy kontratat, në këtë linjë të kërkimit të përgjegjësive, Qeveria në mënyrë automatike duhet t’i ndërmarrë të gjitha masat ligjore edhe ndaj njësisë për implementimin e projektit që vepron në kuadër të Ministrisë së Infrastrukturës, në përputhje me përgjegjësitë e tyre.

Nëse nuk i ndërmerr Qeveria këto masa, atëherë ajo e pranon publikisht se e ka aprovuar koston shtesë për punëkryesin në mënyrë kundërligjore dhe në kundërshtim me kontratën dhe rekomandimin e menaxherit të kontratës “Hill International”, e deri atëherë asnjë anëtar i Kabinetit qeveritar nuk guxon ta përmendë keqmenaxhimin si arsye të miratimit të koston shtesë.

I nderuar zoti kryeministër,

Pas të gjitha këtyre fakteve, besoj se edhe ju jeni bindur dhe nuk ka fije dyshimi se miratimi i koston shtesë në shumën prej 53 milionë eurosh është jologjor dhe jo në përputhje me kontratën.

Prandaj, e vetmja zgjidhje ju mbetet që ta shkarkoni ministrin Lekaj dhe gjithë kabinetin e tij për shkelje të ligjit, të anuloni vendimin e Qeverisë për miratimin e koston shtesë prej 53,1 milionë eurosh dhe zbatoni aneks-kontratën, tanimë të rekomanduar nga menaxheri i kontratës “Hill International” në shumë prej 14,78 milionë eurosh.

Përndryshe, jam i bindur se edhe nëse filloni një proces të ri të përcaktimit të koston shtesë, duke zbatuar me përpikëri rregullat e prokurimit publik dhe kontratës siç kam vepruar unë, apo edhe nëse shkojmë në arbitrazh, kurrë nuk do të kalohet shuma e aprovuar nga Komiteti drejtues ndërministror i kaluar apo ndoshta mund të jetë edhe më e ulët. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Kryeministri i Republikës së Kosovës, zoti Ramush Haradinaj, e ka fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: I nderuar kryetar zoti Veseli,

Të nderuar deputetë,

Kolegë të Kabinetit qeveritar,

Qytetarë të Kosovës,

E para, dëshiroj t’i shpreh mirënjohje kompanisë “Bechtel-Enka” për një partneritet shumë serioz që nga nisja e punëve me Kosovën.

Deklarimet se “Bechtel” qëllimshëm është futur në angazhime korruptive me qeveritë e Kosovës nuk vlejné, se po flitet për Qeverinë në të cilën ka qenë kolegu që i përfaqësoi ato është gabim ai pretendim, besoj ose u ka vjedhur ose është ndonjë tejkalim.

Është një kompani serioze, një operator serioz, operon në krejt botën, jo vetëm te ne, nuk bëjnë përjashtim, është marrëdhënie kontraktuale edhe me ne.

Pra konsorciumi “Bechtel-Enka” është një partner serioz, me të cilin Kosova e ka një marrëdhënie kontraktuale qe disa vjet. Pra, ju lutem, mos e harroni, i shpreh falënderim dhe respekt që është një kompani shumë serioze.

Tjetra, e falënderoj ministrin Leka që i ka dhënë fund një gjendjeje që ka mundur të jetë edhe më e keqe për Kosovën në etapat që vijnë. I shpreh falënderim profesional, u shpreh falënderim të gjithë ministrave dhe të gjithëve që kanë marrë pjesë në përmbylljen e kësaj gjendjeje.

Tani do të shkoj me radhë t'u përgjigjem, se ju shoh dy grupe të ndryshme. Habitem si Albin Kurti dhe Liburni janë palë për këtë temë me ish-ministrin e Infrastrukturës, thënë të drejtën, bukur e çuditshme pamja, ndoshta është kthyer në normalitet, po për mua është një farë çudie kjo, besoj edhe për qytetarët e vendit.

Pyetja për Vetëvendosjen dhe për Liburnin është: Liburn, a e di kush e ka krijuar këtë konflikt, këtë borxh, qoftë atë të parin prej 14.7, a mos e ka krijuar ky që ti edhe ky po e paraqitni temën para deputetëve, para Qeverisë, para popullit. Nëse është ashtu, thuaje një fjalë bile për këtë, dikush është shkaktar që e ka krijuar një borxh, sado qoftë ai, e kush është ai shkaktari, është ky partneri yt i interpelancës së sotme. Qe ku keni mbërritur, të dashur deputetë, që e keni nderin e moralin ta mbroni paranë e popullit. Megjithatë, kam respekt për disa prej tyre që janë këtu, se mendoj që u dhemb paraja e popullit, më dhemb edhe mua, jo 53 milionë, po 5 euro të këtij vendi më dhembin.

Por, po ju tregoj, për disa që donë të marrin vesh pse s'e kemi lënë të shkojmë në arbitrazh? Pse, veç pse, thjesht, pse s'e kemi lënë këtë gjendje të vazhdojë të përkeqësohet deri në arbitrazh.

Me kërkesën për zgjatje të kontratës është pranuar fajti, kush i ka fajet, kush i paguan dëmet nëse dalim fajtor nga ministri Zharku. Kosova ka kërkuar, se nuk ka qenë palë korrekte, ka kërkuar të zgjatet kontrata.

Është pranuar mundësia që "Bechtel-Enka" të mos heqë dorë nga kërkesat komerciale shtesë që e kanë tejkuluar atë 14,7-in, po kjo duhet ditur, duhet pasur parasysh. Edhe pse është vlerësuar 14,7, është lënë mundësia që pala tjetër të mos heqë dorë prej kërkesave të tjera. Pra, nuk ka qenë dakordim i të gjitha palëve, por është lënë çel kjo, ka qenë vetëm një shumë, 14,7 është një shumë, po është lënë çel që "Bechtel-Enka" t'i kërkojë të drejtat e tjera të veta.

Është shtyrë implementimi i pagesës për zgjatje të kontratës, edhe pse është propozuar një shumë, nuk është nënshkruar, atij ministri që po i beson ti të dalë e të paraqesë temën sot, Qeveria e vet nuk e ka marrë përsipër t'ia pranojë këtë borxh, 14.7, ai ia ka propozuar Qeverisë së vet, i ka thënë nënshkruaje vetë, se ne nuk ta nënshkruajmë, pra është lënë çel atëherë.

Edhe kompania Hill, pra e njëjta që po e përmend pse s'e ka dhënë ajo vlerësimin, ajo e ka dhënë këtë 14,7, po nuk e ka mbyllur, nuk ka thënë që s'ka kosto të tjera.

Njëkohësisht, ju lutem, ju lutem, atëherë pse s'e ke mbyllur, i nderuar, pse nuk e ke nënshkruar, keni mundur...

(Ndërhyrje nga salla)

A s'po ju durohet, a? 25 minuta, 30 minuta ua dëgjova ato pallavra, dëgjoni edhe ju pak, kolegë të nderuar, nëse keni durim, nëse s'keni po e lëmë, unë ju dëgjova.

Shikoni, pastaj çka është tepër me rëndësi sidomos për ty, Liburn, çdo vonesë është specifikuar në kontratë se kushton 40 mijë euro për ditë. A e dini çka do të thotë kjo, nuk qëndron vlerësimi se a i kryen punët me shati a me bager, mos flisni kështu, me shati e dimë çka kemi bërë ne, kur i kemi marrë do punë, me karrocë e me shati. Bageri më i vogël në Kosovë sot e ka orën deri 40 euro, e pra nuk qëndron... Çka ka bërë kjo Qeveri, se do të kthehem te këto që dua t'i diskutoj. Çka ka bërë kjo Qeveri, i nderuar deputet, cilido qoftë prej juve dhe të nderuar qytetarë. E kemi gjetur në tavolinë një marrëdhënie të borxhit fillestar të pranuar prej 14.7 para dy vjetësh, e kemi gjetur degradimin e këtij borxhi se s'kanë pasur guxim, tash tregoj pse ka ndodhur borxhi, do t'u tregoj votuesve të LDK-së, pse i paguajmë sot këto para do t'u tregoj votuesve të LDK-së.

Por e kemi gjetur një borxh që është rritur në vazhdimësi, nuk kemi guxuar të shkojmë në arbitrazh se e kemi pasur të humbur, sepse i kanë pranuar krejt elementet kyçe.

Kjo Qeveri, pra operatorit së pari është dashur t'i afrohet një mundësi qysh të mbesim ne në marrëdhënie kontraktuale me këtë, të mos na nxjerrin në gjyq, të mos ndalet puna, të mos kryhet rruga. Kemi qenë të detyruar, përndryshe, atë që thoshte ministri, pse s'e ka ndalur punën. Një ditë e kishte ndalur, po jam detyruar a ta lë rrugën që shkon për Han të Elezit në shtylla, në shtylla të mëdha, të gjata, e kush e di kur të rimerret, çfarë dëmsh ish in bërë të ndalen për pak muaj punët, apo të ripranohet një marrëdhënie, nuk është punë qejfi që e ka bërë kjo Qeveri, as Haradinaj, as Pal Lekaj, as kurrkush për qejfi, ishim marrë me tema të tjera, është njëra prej atyre bombave që m' i kanë lënë në tavolinë, me cilën është dashur të përballej kjo Qeveri, ose të lihet Kosova të kalojë në një marrëdhënie tjetër me këtë operator, të ndalen punimet, të mbetet në shtylla ajo ura që e keni parë, që po na rrëshqet rruga edhe në anën tjetër, s'e kemi as atë në rregull dhe, kur ta fitonte gjykimin ai e të kishin kaluar mbi 100 milionë dëm, atëherë... Çka ka bërë kjo Qeveri, e ka negociuar në mirëbesim, me këtë operator, po në bazë të vlerësimeve që i kanë pranuar njësitë për zbatim, njësitë për punë.

Tash a ka pasur zgjidhje, cila ka qenë zgjidhja për ne? Ne e kemi pasur zgjidhjen, njëjtë të thuhet në kësi procedurash sikur ky zotëria që ka bërë. Po ju tregoj pse i ka bërë ky, ta dini, nuk i ka bërë të ruajë paranë e popullit, tash do t' ju tregoj pse i ka bërë.

Ne s'kemi guxuar ta lëmë Kosovën të shkojë në pakufi. Shikoni, është e njëjta situatë me borxhin për pasaportat, për të mos i paguar ato para, e kanë dërguar në Gjykatën Themelore këtu, shuma ka shkuar duke u rritur dhe na i kanë bllokuar 15 milionë. Nuk kam guxuar ta lë Kosovën të mbërrijë në asi shtate të bankrotimit total prej një pretenduesi një shumë të caktuar në një gjykatë ndërkombëtare, për të cilën ai është shumë më i zoti se ne, e që ka pasur elemente të mjaftueshme të na dëmtojë, si vend, si buxhet, si popull.

Për këtë arsye, pra, e kemi kryer këtë, nuk ka qenë shumë lehtë të kryhet, nuk ka qenë e padhembshme, mos harroni, nuk ka qenë e padhembshme, është e dhimbshme që na ka ardhur ajo ditë që është dashur të veprojmë ashtu. Po kjo bën pjesë në ato minat që i kam gjetur në tavolinë.

Pse ka ndodhur krijimi i këtij borxhi? Dëgjo, kush do të marrë vesh, sidomos votuesit e LDK-së.

Në vitin 2015 i kanë shtuar, kur e kanë marrë pushtetin, 30 projekte të paplanifikuara që s'kanë qenë pjesë e planifikimeve buxhetore prej 9 milionësh për komunat që i ka udhëhequr LDK-ja. Është pak normal, kur ta këqyrësh, se kanë thënë PDK-ja s'na i ka përkrahur komunat, kanë dashur të investojnë në komuna të veta, e kanë bërë, dhe po ju tregoj edhe kush janë përfituesit e këtyre komunave, nëse ju intereson: Sali Asllanaj, Lutfi Haziri, ka edhe të tjerë. Kanë qenë 9 milionë para që është dashur të lihen për këtë projektin e madh, i kanë shpërndarë nëpër komuna krejt arsyeshëm, se ne kemi thënë PDK-ja po investon diku, AAK-ja diku, edhe LDK-ja ka investuar.

Në vitin 2016, 111 projekte të reja, të paplanifikuara, ky ministri që po na shet moral sot, ky i ka shtirë të paplanifikuara, nuk kanë qenë pjesë e buxhetit fare. I ka shtirë dhe a e dini ku kanë shkuar? Me leje, shikoni: Gazmend Muhaxheri, Agim Veliu, Agim Veliu, 370 mijë euro për Kaçanikun, se është komuna e tij, Lutfiu, i janë dashur atje, është në rregull, dhe shikoni, Podujeva prapë, kështu kanë qenë. E keni materialin, i gjeni edhe në buxhet, e shikoni a është ashtu, a po spekuloj a po e them të vërtetën.

Është edhe Avdullah Hoti, mund të na tregojë ai a është kështu, se ai është dashur t'ia mbulojë atëherë këto, është dashur të hiqen paratë që kanë qenë të parapara për autorrugën, është dashur të barten që të shpëtojnë fytyrën LDK-ja, se kanë hyrë në pushtet e duhet bërë diçka për komunat që kanë pritur, kanë pasur pritje prej elektoratit. Shikoni, në vitin 2017, mbajeni mend, 123 projekte të paparapara janë shkuar, zotëri, ka qenë temë në këtë Parlament qysh LDK-ja ka planifikuar, ka lënë para rezervë për komunat e LDK-së. 123 projekte, pra, janë shkuar, prej të cilave prapë është Lutfi Haziri Gjilan, Kaçanik, Rahovec, ku Avdullah Hoti vjen prej atje, ia ka bartur disa edhe vetes andej. Prapë, janë Muharrem Sfarça e Gazmend Muhaxheri. Pra, arsyeja pse nuk janë paguar paratë që është dashur të paguhen me rregull, me kohë e të mos krijohej borxhi është se LDK-ja ka vendosur diçka që unë nuk e akuzoj, por dëmin ia ka bërë buxhetit, ka dashur t'i dërgojë disa projekte në komuna të veta.

Edhe unë jam AAK. Ka komuna që qeverisen prej AAK-së, kam qejf t'i dërgoj disa projekte, po s'guxoj t'i marr paratë e një borxhi e të thellohet ai borxh, e sot të mbërrijmë ku kemi mbërritur. Kjo është e vërteta, të nderuar kolegë, këtë e di krejt LDK-ja, mirë kanë bërë në atë kohë, por nuk po i kuptoj sot çka kanë, pse e kanë lënë të bëhej ky borxh, pse s'e ka nënshkruar zotëria i nderuar atë 14.7 milionë e ta mbyllte, të mos ma linte mua në tavolinë dhe pse ka lejuar të

degradojë gjendja në këtë formë. Duke qenë kështu, ne i kemi krejt materialet, të cilat tregojnë çka ka ndodhur. Kam një radhitje të materialeve, pastaj më duhen nja 30 minuta, si ju, se po duket më mirë të flasësh më shumë, do t'i marr prej jush minutat.

Së pari, kontrata për ta dizajnuar dhe ndërtuar Autostradën 6 Prishtinë - Hani i Elezit është nënshkruar më 1 korrik 2014. Pastaj po thotë vlera e kësaj kontrate ka qenë 599 milionë euro, për shkak të ndryshimeve në TVSH vlera është rritur në 608. Pastaj thotë ka pasuar amendament për zgjatje të afatit, pra janë materialet që ekzistojnë, më 27 shtator 2017, që kjo ka ndodhur mes palëve që sot i përfaqësoj unë këtu. Edhe kështu me rend, por në të gjitha këto materiale, të nderuar kolegë, duhet pasur parasysh edhe një herë atë që ju thashë më herët dhe që besoj se do ta kemi rastin ta shpjegojmë edhe më tutje, krejt borxhi është ndërtuar prej Qeverisë së mëparshme, prej ministrit që sot e prezantoi interpelancën, por ai ka qenë i përkrahur edhe prej ministrit të Financave, nuk ka mundur vetë.

Pra, sikur të mos kishte qenë Avdullah Hoti, ai s'kishte mundur t'i bënte këto devijime buxhetore. Mua më vjen keq, pse? Vetëvendosje, për shembull, në rastin konkret, nuk e ka shtruar një pyetje pse ka ardhur deri te kjo situatë dhe sa është shkaktare partneri që po përfaqësoni bashkë sot për t'u krijuar ky borxh, sa ka ndikuar? A ka ndikuar? Pyetja e radhës për të gjithë ju është: pse nuk është nënshkruar borxhi fillestar 14.7 milionë? Pse u prit edhe dy vjet të tjera? Nëse paska qenë i tillë, i pranuar prej "Hillit", prej tjetrit, në rrethanat që i kemi para nesh, pra po e përsëris edhe një herë, besoj do ta kemi rastin t'i shpjegojmë. Në përgjithësi të gjitha të dhënat që u folën nga ministri ju siguroj që janë manipulime, ministri Zharku është shkaktari i këtij borxhi, nëse ka një njeri në këtë Kosovë që e ka shkaktuar këtë borxh është partneri juaj i interpelancës, të dashur deputetë dhe ministri i tij i Financave, nuk ka mundur ndryshe të burojë borxhi, e shihni. Nëse ka dikush në këtë sallë, ju lutem, vetëm prej LDK-së, të gjithë juve po ju pyes, votuesve tuaj: a mendoni ju që Qeveria Haradinaj e ka shkaktuar borxhin cilindo qoftë, a është një euro, a 14...

KRYETARI: Kryeministër, për hir të opinionit, afroju afër mikrofonit, se nuk je duke u dëgjuar.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Nëse ka dikush në këtë sallë që mund të thotë kush e ka shkaktuar borxhin. Ju lus, po ashtu e kam një pyetje, të dashur deputetë të LDK-së, a mund të më thoni në kohën e cilit ministër, cilit kryeministër, cilës qeveri është nisur borxhi? Veç, ju lutem, më tregoni këtë, sa ka qenë ai borxh, sipas jush, nëse është nisur dhe pyetja e radhës, ju lutem, pse LDK-ja nuk e ka përmbyllur atë borxh? Pse s'e ka dhënë një nënshkrim e ta paguajë? 14.7, nëse paska qenë, për koston shtesë, megjithatë ishim përballur sot. Pse në atë kohë pra, borxhin që e ka krijuar, ta kini parasysh, të nderuar deputetë, jo vetëm të LDK-së, por qytetarë të Kosovës, këtë borxh të Kosovës, këtë minë të pashpërthyer në tavolinë të Qeverisë Haradinaj e ka krijuar Qeveria e LDK-së, kryeministri Mustafa, ministri Zharku, ministri Hoti.

Sikur këta ta kishin hequr këtë temë prej rendit të ditës, nuk e kisha gjetur në tavolinë, këta njerëz për një arsye ose për një tjetër, ju tregova pse, kanë dashur t'i përkrahin komunat e veta, kanë dërguar projekte nëpër komuna, ka qenë temë e diskutimit në këtë Parlament që kanë qenë vija buxhetore disi dhe të padefinuara, veç janë ndarë për komuna shuma të caktuar. Për fat të keq, tash po e marrim vesh pasojën, por janë hequr paratë prej projektit të madh të autorrugës. Pse s'ndodhi borxhi për "Ibrahim Rugovën"? Pse s'kemi pasur këso rrethanash me autostradën "Ibrahim Rugova"? E mirë, e keqe, është më e mira në rajon realisht, se unë kam qenë nëpër autorrugë të tjera, kam parë, nuk di dikush në rajon që e ka më të mirë se na, a është çmimi i lirë a i shtrenjtë, për ato të gjithë kemi menduar në atë kohë se është shtrenjtë, por nuk di që ka më të mirë, por pse nuk ndodhi borxhi? E vetmja herë që Qeveria i ka krijuar vetes situatë të borxhit është pikërisht ky vendim i këtyre njerëzve që kanë menduar që është më mirë t'u dërgojnë projekte komunave të veta. Rezultat i kësaj, ka ardhur borxhi. Tash ti mund të thuash pse është 63, pse është 53, pse s'ka qenë 14.7? Shikoni, edhe kur e ka dhënë "Hilli" 14.7, nuk ka qenë e dakorduar prej të gjitha palëve, prapë ka qenë e kontestueshme dhe ajo prapë në gjykatë kishte marrë një epilog. Pastaj, nuk ka qenë shuma totale, por janë lënë mundësi të kostos shtesë dhe atë shumë 14.7 nuk e ka nënshkruar ministri, s'e ka përmyllur, s'e ka paguar. Ka mbetur ajo dy vjet më vonë... ti ke qenë drejtor i Urbanizmit, secili e dini një borxh i mbetur në penalltitë çka ndodh me të.

Kur jam ardhur unë 63, i kam pasur dy zgjidhje, qytetarit po i flas, se e di që këtu jemi të interesuar pas votave shumica nesh, por qytetarit po i them, kur kam ardhur e kam pasur mundësinë ose të shkojmë në gjykatë, në arbitrazh, diku një vend jashtë Kosovës, e të mbërrijë shuma kushedi sa, dhe të mbetet rruga përgjysmë, se ishim prishur me të nëse do të shkonim në arbitrazh, nëse s'bënim marrëveshje, nëse s'bëjmë dakordim, nëse s'e paguajmë këtë pjesë të borxhit, do të na mbetej në shtylla autorruga që shkon për Han të Elezit, ashtu si e shohim kur shkojmë në Shqipëri në raste të caktuara, disa shtylla të urave, ose të negociojmë me ta, të arrijmë një marrëdhënie të kompromisit që na shpëton prej gjendjes që është krijuar. Tani, nuk e kuptoj konstatimin e disa prej juve këtu që po ia drejtoni gishtin Qeverisë Haradinaj. Çka ju bëri, more Qeveria Haradinaj? Qysh mund t'i thuash kësaj Qeverie, "kjo edhe më keq se tjerat"? Jo, kjo Qeveri është duke e larë atë që e kanë bërë të tjerat, është duke e larë bukur me mund, bukur me zor, se nuk është lehtë të bëhen këto punë, po duhet t'i kryejmë e të mos e lëmë të na shkojë më lart dëmi.

Për këtë arsye jam detyruar ta bëj, për këtë arsye jam detyruar të shpëtoj diçka nga ajo që mund të shpëtohet pa shkuar më tutje, kam mundur edhe unë t'ua lë, e të shkohet në arbitrazh. Kam mundur të fshihem, siç janë fshehur disa, t'i merrja këto para edhe të këtij viti, t'i dërgoja edhe unë nëpër komuna, t'i fshihja, t'i dërgoja në arbitrazh, kur të vijë dëmi të thuhet "s'kam faj unë". Na bënë të padrejtë, kisha mundur ndoshta të them na ka bërë padrejtësi Gjykata e arbitrazhit. Këtë e kanë bërë në atë kohë, këta e kanë lënë kështu, i kanë marrë paratë, i kanë investuar. Po ju siguroj që në këtë negociim me këta nuk ka para të vjedhura prej Kosove, është tepër gabim

supozimi i ministrit që ata e kanë ditur se Qeveria s'paska kapacitet t'i paguajë paratë e kanë hyrë në marrëdhënie korruptive, nuk është ashtu. Mbajeni në mend çka po ju them, ata kanë hyrë në marrëdhënie me qeveritë e Kosovës, mirë e keq, në çmim, po ata kanë krijuar bindjen që qeveritë e Kosovës janë serioze, i paguajnë paratë se deri në kohën e këtij ministri janë paguar paratë. S'ka dështuar asnjë kësht, janë paguar paratë në kohë, në afat, s'ka pasur penallti, hera e parë që u krijua marrëdhënia e penaltive, e dëmit, është me këtë ministër, me këtë qeveri që sot po do të vajtojë se po i dhimben ato para. Jo, po t'u ishin dhimbsur ato para, këta e kanë ditur që janë duke krijuar dëm, këta ishin shkuar menjëherë i kishin mbyllur 14.7-shin me firmë, i kishin marrë obligimet që është dashur të merren, më mirë aq se më shumë edhe sot, ne ishim duke folur për tema të tjera.

Unë do ta ruaj të drejtën të kyçem në vazhdimësi, do t'i mbledh këto materialet që t'jua tregoj disa shkresa a letra që i keni bërë, por e vërteta, le ta di qytetari i Kosovës, e para, kjo Qeveri Haradinaj nuk e ka krijuar këtë borxh, ky borxh ka lindur në kohën e Qeverisë së LDK-së, Isa Mustafa, kryeministër, ministër i Infrastrukturës Lutfi Zharku dhe ministër i Financave Avdullah Hoti. Në këtë kohë janë shtuar, ashtu qysh i ceka, projekte të paplanifikuara, janë shkuar në komuna të LDK-së që është në rregull, se nuk e akuzoj, edhe ato janë të Kosovës, na kemi thënë PDK-ja po i dërgon në Drenicë a diku, dikush në Dukagjin, dikush atje, dallimi është, po i ka hequr paratë prej këtij projekti, e ka krijuar borxhin. Kur është konstatuar defekti, ka mundur vetëm, i është dhënë mundësia me gjashtë muaj vonesë dhe 14.7, por s'e ka nënshkruar, s'e ka pranuar atë 14. 7, që po thoni ju, pse ka qenë aq. Nuk e ka bërë, është lënë hapur ajo për dy vjet, jemi ridetyruar, pra, po përsëris edhe një herë, shikoni çka po ju flas, unë jam ridetyruar, kjo Qeveri është ridetyruar ta thërrasë "Bechtel-Enka"-n të kërkonim të merremi vesh ta kryejmë projektin. Por, ka një dallim, ne e kryejmë projektin në këtë vit, a paratë i paguajmë deri në mes të vitit tjetër, deri në qershor kemi kërkuar kohë, kemi thënë a mund të na pritni, ju lutem, kryeni punën, që foli dikush a i bëhen penallti "Bechtel-Enka"-s, hajgare po bën, a!

Ata po na presin gjashtë muaj pasi të kryhet puna. Domethënë na kanë dhënë edhe 6 muaj, që të mos prishen këto marrëdhënie kontraktuale që janë krijuar diku, të mos priset kjo përvojë dhjetëvjeçare me ta, e ky thotë duhet bërë penallti! Nëse ka për penallti, kolegë, në këtë Parlament, në këtë Kosovë, lidhur me këtë rast, bash sponzorizuesi juaj është, ajo është për penallti, pse ia ka lënë vendit të vet, Kosovës, një situatë pa vendimmarrje me një borxh në rritje, i vetëdijshëm që ai borxh do të degradojë, unë habitem pse nuk e shtron kurrkush këtë pyetje, nëse e keni ndonjë problem, tregomëni, s'ka dert. Tjetra, unë jam betuar kur kam ardhur në qeveri, nuk do të hyj në punë të kësi letrash, e kam bërë me qëllim, e di pse.

Shikoni, na ka shkuar jeta duke u ankuar në të tjerët e duke mos punuar vetë. Unë me këtë nuk kam bërë amnisti, prapë po ju them që nuk shkoj në letra të kurrkuajt, e vetmja gjë që jam duke i bërë kësaj Kosove që besoj se herë do kur do të më thonë "faleminderit", jam duke ia hequr këto tema të kontaminuara prej tavoline këtij vendi, edhe goxha me dhimbje, goxha me mund, goxha

me vuajtje, se nuk është lehtë të kalohet nëpër këto që po kalojmë tash. E kam pasur rastin e pasaportave, është dashur të mbyllej, ndryshe do të dështonim. Ndryshe do të humbim edhe reputacionin e një vendi shumë serioz, shumë mik, Austrisë. E kemi rastin me këtë, shkonim në degradim total të marrëdhënieve me plot palë nëse do të dilte lajmi qysh ne me një operator s'po jemi seriozë, do të humbshim në klimën investive dhe në plot tema të tjera, pos dëmeve reale të kontratës tonë. Duke qenë kështu, unë nuk pres që do të më falënderoni, se të gjithë garojmë kundër njëri-tjetrit në zgjedhje, përfshirë edhe ne që jemi të koalicionit, garojmë kundër njëri-tjetrit, se edhe ne kemi qejf secili për veti, u përmendën disa ministra jo kanë qenë, jo s'kanë qenë. Ani mirë, bre Lutfi, po ta bëj një pyetje ty: a mendon që këta ministrat e PDK-së e ruajnë paranë e Kosovës më shumë se unë, a? E që s'kanë qenë ata aty qenka ndonjë tregues që s'ka qenë marrëveshja e mirë, a?

Prej kur u bërë kaq besimtar, ti? Unë e di që i ke pasur kolegë, keni bashkëqeverisur, po edhe aty s'po ta kuptoj 'foren'. Shiko, u hidhërua një ministër për një arsye tjetër, besoni, e ka krejt ku ta dish çka dhe atë ditë s'ka ardhur, ose ka ndonjë hall tjetër që s'ia kemi përkrahur një projekt, ose s'ia kemi votuar një temë në Qeveri, kjo është 'forja', nuk është ndonjë tregues kjo. Ruajuni se nganjëherë po ju shoh deri ku po shkoni, unë ju tregoj edhe një herë, pra, po e përsëris, shpresoj që kontraktuesi ynë, në këtë rast operatori "Bechtel-Enka" duke e parë këtë shtet tonin, do të thotë do ta lëmë me kaq këtë muhabet Kosovë-"Bechtel-Enka" dhe do të përmbillet si është më së miri projekti, nuk do të mbetet në shtylla rruga jonë, do ta përmbylim këtë vit në kohë. Njëkohësisht Qeveria e vendit duhet të jetë serioze të mos i heqë paratë e parapara për t'u kryer kjo deri në qershor, ju siguroj që i Kosovës, as Pal Lekaj, as Ramush Haradinaj, as ndonjë në këtë sallë, as në ndonjë sallë tjetër s'kanë mundur ta marrin një cent, as ndonjë favor çfarëdo qoftë, po kemi humbur ndoshta vota, se ne e dimë që nuk është popullore, ne e dimë që është popullore t'i shtohen buxhetit edhe 35 milionë, të dërgohen diku nëpër shkolla. Nuk ka qenë e lehtë për ne, por dikush duhet t'i hajë të sharat e këtij vendi, por të mos i lihen këtij vendi temat që i rrinë në tavolinë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Pothuajse, përfundoi gati edhe pak. Nënkryetari Kujtim Shala e ka fjalën në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës, jemi duke shkuar te grupet parlamentare, kini parasysh ora të cilën e kaloni u merret grupeve parlamentare. edhe kryeministri i ka marrë pozitës, por ta keni parasysh. Nuk ia ndali fjalën askujt, deri t'i harxhojnë minutat e partisë, le të merret vesh partia mes vete. Faleminderit!

KUJTIM SHALA: Faleminderit, zoti kryetar!

Zoti kryeministër,

Të nderuar ministra,

Kolegë,

Unë jam përjekur të kuptoj nga debati publik deri më sot për këtë çështje aq sa kam pasur mundësi dhe me aq sa kam formim, normalisht unë nuk jam ekspertë i kësaj fushe, por e kam një

përvojë pune në institucione, jo drejtpërdrejtë me vendime të kësaj natyre, por normalisht drejtpërdrejtë me vendimmarrje.

Më duhet të them që përfaqësuesit e qeverisë, kryesisht kanë qenë të paqartë lidhur me këtë proces e që është i rëndësishëm, sepse ka edhe kosto tepër të lartë financiare. Unë mendoj që me fjalën e sotme kryeministri me ose pa qëllim e ka bërë edhe më të paqartë. Po përpiqem të jap 3-4 argumente të lidhura me shifra, pa asnjë ngjyrim as privat, as politik.

Për shumën e parë, 14.7 milionë diçka më tepër, të cilin ministri po e quan “borxh”, dëshiroj të sqaroj se ky nuk është borxh. Pra, kemi të bëjmë me një kategori, të cilën kolegët e mi që janë ekspertë ma shpjeguan që është fjala për një kosto, e që është diçka tjetër. Mbikëqyrësi, që është edhe një tip ndërmjetësi, “Hill”-i, thotë që punëkryerësi nuk ka të drejtë, nuk jep të drejtë e çka do të thotë kjo, ai vlerëson që punëdhënësi, në këtë rast Qeveria e Kosovës nuk ka asnjë detyrim financiar dhe detyrimet financiare janë borxhe. Domethënë, Qeveria e Kosovës nuk ka asnjë faturë të papaguar për konzorciumin “Bechtel-Enka” për punë të kryera. Po patjetër, ...

KRYETARI: Nënkryetar, vazhdo, pastaj kryeministër e merr fjalën.

KUJTIM SHALA: Po më pyet kryeministri drejtpërdrejt, kështu që në rregull jemi. Tani dallimi është i madh, domethënë 14.7 milionë dhe 53 milionë, edhe ato 14,7 milionë janë shumë, por 53 milionë janë shumë më shumë. Pse nuk u bë atëherë? Me sa më kujtohet, vendimi i tillë ka qenë një herë edhe në rendin e ditës të Qeverisë dhe është tërhequr, sepse do të ishte një tip i vendimit të marrë me paragjykim. E kemi fjalën për një kosto 14,7 milionë euro që ka parasysh vitin 2018, sepse parasheh shtyrjen e punëve. Domethënë, s’kemi të bëjmë me borxhe. Tani, vendimi për 53 milionë euro është arbitrar dhe kur them “arbitrar”, i bie që ky është një vendim tipik për këtë Qeveri, të gjitha vendimet themelore të saj janë të kësaj natyre dhe vendimet arbitrare, në esencë, në origjinë janë të kundërligjshme. Unë do t’u lë radhën kolegëve, të cilët e njohin shumë më mirë këtë lëndë, po e jap edhe një element tjetër, tani edhe politik, sepse kryeministri foli për projekte të reja. Projekte të reja të paplanifikuara s’mund të jetë ashtu, sepse projektet e reja reflektohen në Ligjin për buxhetin, do të thotë janë të planifikuara dhe të planifikuara e të shoqëruara me kosto financiare.

E dyta, nëse projektet hiqeshin, do të thotë financat hiqeshin nga ky projekt i rëndësishëm dhe shkoni në komuna që drejtonin njerëz të LDK-së, por në komunat e AAK-së, për shembull, në Deçan ose në Obiliq, unë kam pasur numrin më të madh të projekteve të reja në këto dy komuna kur kam qenë ministër. Do të thotë, merreni dhe shihni me kujdes, nga ajo, si rrumbullakim, nga ajo që thoni ju, zoti kryeministër, unë vërej pasaktësi jashtëzakonisht të mëdha që janë të rrezikshme, por edhe më e rrezikshme është që po tentoni që këtë çështje ta bëni edhe më të paqartë se sa që është, ndërkaq ne këtu jemi të kuptojmë, normalisht, ato s’janë as paratë e mia, s’janë as para tuaja. Por, kësaj radhe ju e keni për detyrë që të kujdeseni, që të menaxhoni, që t’i

ruani dhe që të punoni me to për ne të gjithë. Kjo është kërkesa themelore e kësaj interpelance dhe ky është synimi themelor, përtej kësaj, së paku grupi im parlamentar nuk shkon. Qëllimi është që ne, nëse mund të mbrohet diçka, të mbrohet.

Dhe, e fundit arbitrazhi. Si mund të shkohet në një arbitrazh nëse mbikëqyrësi punëkryerësit nuk i jep të drejtë. Ju rezultatin e dini.

Dhe, e fundit prapë, që lidhet me mbikëqyrësin, marrëveshja prej 14,7 milionë euro nuk ka qenë e hapur, meqë mbikëqyrësi e ka lënë në mirëbesim të palëve dhe palët janë marrë vesh. Si situatë është plotësisht e qartë. E kemi 14.7 milionë euro të provuara me dokumente dhe, nëse mundeni kontestoni dokumentet dhe 53 milionë euro, për të cilat ju s'po na jepni asnjë dokument. Unë jam shumë i interesuar që të shoh dhe dokumentet tuaja. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Kryeministër, fjala është për ju! LDK-ja i ka edhe 3 minuta e 13 sekonda, ta keni parasysh.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Më fal, Kujtim, t'i bëj disa pyetje çka është e paqartë sot që vërtet edhe mua ti tash më bëre konfuz. A është e vërtetë, a është e qartë që borxhi ka filluar, është nisur në kohë të qeverisjes suaj, me ministrin Lutfi Zharku, Avdullah Hotin dhe kryeministrin Isa Mustafën, më falni.

A mund të pyes diçka: ky kontest i tillë a është zgjidhur në kohën e qeverisjes suaj apo i është lënë kësaj qeverie? Ai 14.7? A është e qartë a e paqartë diku? Pastaj, ti po thua që ke pasur projekte në Deçan, o burrë, a ke qenë ministër i Infrastrukturës a i Kulturës? Po, projektet e tij, të ministrisë, po ti ke qenë i Kulturës, me sa e di unë, ne jemi duke folur vetëm për rrugë, të lutem. Shiko, shumë e qartë është, me shifra, me shuma, 48 milionë projekte të paplanifikuara janë shtuar gjatë kësaj periudhe të qeverisjes qysh e ceka, janë shkuar në komuna të LDK-së, nuk është marre, shlyqyr që i keni dërguar, veç pse s'i keni siguruar edhe paratë ta kryenit këtë, tjetra, Kujtim, po të pyes, më fal, zotëria tha "Bechtel-Enka" ka hyrë qëllimisht në marrëdhënie kontraktuale, se e ka ditur që Qeveria s'i paguan paratë korruptive, e ku po di unë. Më fal, po kush i ka detyruar të nënshkrueshin letrat? Dy vetë kanë nënshkruar letër aty!

Ky zotëria po e quan pak më të korruptuar "Bechtelin" se neve, për besë, nuk është duke na bërë korrupsionin as "Bechteli", as dikush nga jashtë, po krejt ne e kemi bërë. Po, për Zotin krejt vetë i kemi bërë këto! Nuk di unë që është ndonjë engjëll, qe Liburni le të më tregojë a ka qenë ndonjë engjëll i menaxhimit të parasë publike zoti Zharku, bashkëkryesuesi i kësaj interpelance, le të më tregojë, nëse ke qenë një engjëll. Edhe shikoni çka është e qartë, më se e qartë, ne e kemi gjetur një situatë që është dashur, ju po thoni "Qeveria arbitrarë". Po ju pyes diçka, pse e keni zgjedhur këtë Qeveri, kush e ka zgjedhur, a e ka zgjedhur të lihen punët të ndalen, për shembull, kjo Qeveri ka qenë para situatës ose ta rinegociojë me "Bechtel-Enka"-n, ta kryejë

këtë rrugë ose të ndodhë ajo që thoshte ai, pse s'ka ndodhur më herët, të përfundojmë në arbitrazh, të na mbetet rruga përgjysmë, në shtylla, qysh është atje, të na mbetet marrja hapur dhe e kishim fituar në arbitrazh, se e dimë qysh i fitojmë në kur duam t'i fitojmë, e kishim fituar fort!

Nuk është ashtu, shikoni, më të qartë e më kristal nuk ka, keni bërë, keni hyrë në këtë temë që keni menduar që fitoni vota, por nganjëherë vërvani mendjen deri ku po hyni. Është njëfarë shprehje e anglezëve: "Be afraid of your wish", (mos po të ndodhë ajo që po e lyp). Shikoni, nëse ka një subjekt politik që i ka bërë dëm Kosovës në këtë borxh është LDK-ja, është qeveria juaj, që s'keni pasur ato çka duhet t'i ketë një qeveri ta mbyllë një borxh që ka qenë duke u rritur. Dhe e keni sjellë një qeveri tjetër në problemet që i keni sjellë, qysh s'keni pasur guxim as për energji, i keni lënë ekskavatorët dy vjet të mos punojnë, edhe tema të tjera. Jam duke e pastruar atë që e keni lënë, jam duke i hequr nga tavolinat ato që i keni lënë, llom. Qysh s'keni pasur guxim as Ligjin për Prishtinën ta bëni, sa keni qenë vetë e kërkonit, por kur kenë këta tjerët s'ua lejonit. Gjë e thjeshtë kishte qenë. A është arbitrar Ligji për Prishtinën? Po, arbitrar, shumë se kjo Qeveri merr vendime arbitrare, është arbitrare edhe një zonë për Prizrenin, po është arbitrare. Këto vendime arbitrare që po i themi ne, janë vendime ta nisim këtë vend, të mos e lëmë këtë vend peng, edhe një herë e përsëris, kjo Qeveri e ka marrë një vendim të vështirë, të zorshëm, të dhimbshëm, por sikur të mos e mernim ne, çka do të kishte ndodhur, pra do të hynim në konflikt me operatorin, do të kishim ndërprerje të punës të autorrugës që është arteria jonë ekonomike, e caktuar, veç një herë na u ka ndërprerë rruga disa ditë atje, kanë dalë në protestë, rruga tjetër, për të cilën e kemi lënë ashtu që 100 vjet, duhet edhe atë ta trajtojmë dhe të përfundonim në Gjykatë të arbitrazhit e pastaj unë isha mburrur se e kam mbrojtur interesin e Kosovës se s'i kam paguar paratë.

Nëse këtë jeni duke ma sugjeruar, bëfshi hair, nuk jam ashtu. E shihni ku e keni sjellë punën duke qenë ashtu.

KRYETARI: Nënkryetari Kujtim Shala e ka fjalën. S'po e quaj as replikë, për arsye se ata janë minuta të cilët janë. Vazhdo, të lutem, po, po, vazhdo, të lutem!

KUJTIM SHALA: Faleminderit, zoti kryetar!

Meqë kryeministri e pati një adresim të drejtpërdrejtë, unë besoj që kryeministri e tha një gjë që e di, por përmbys. Unë s'interoshem për vota në debate me kryeministrin dhe me të tjerët, as në fushatë, e lëre më në këtë rast. Pastaj, unë jam shumë i sigurt që debatet me kryeministrin nuk më favorizojnë në atë kuptim, sepse në këtë tip komunikimi është vështirë të sqarohen dhe unë synoj që të sqaroj sa më shumë që të jetë e mundur.

Cili është keqkuptimi themelor i kryeministrit, ose që dëshiron që ta errësojë me qëllim? Flet për borxhe, e përsëris, mbikëqyrësi thotë që Qeveria e Kosovës s'e ka asnjë cent borxh. Kjo kategori

për të cilën po flasim, 14,7 milionë euro, nuk është kategori e borxheve, pra s'ka të bëjë me borxhet. E qartë! Quhet kosto shtesë, e cila do të duhej të paguhej në vitin 2018, sepse s'mund të jepet paraprakisht. E dyta, nëse ke në lojë 14,7 milionë dhe e zgjidh me 53 milionë, kush s'e pranon këtë zgjidhje, patjetër që e pranon. Patjetër!

Dhe, tani çështja e arbitraritetit, zoti kryeministër, se ju po e përsëritni vazhdimisht, sidomos pas nesh, po s'e kuptoni në esencë. Arbitraritet nuk do të thotë zgjidhje e punëve, po zgjidhje e punëve pa bazë ligjore të dëshmuar, të provuar, dhe gjithçka që të jem më esencial dhe të mos marr kohë, gjithë ajo që po kërkoj unë, nëse ish-ministri po sjell dokumente dhe ju po kontestoni, më jepni mua së paku një dokument që ta kontestoj, sepse s'e kam asnjë. Asgjë tjetër!

KRYETARI: Kryeministri e ka prapë fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: I nderuar nënkryetar Shala, Vërtetë është... edhe një herë, bile harrova të të them faleminderit për Obiliqin. Je sjellë korrekt në kohën tënde, kryetari i Aleancës të ka falënderuar. Besoj edhe në Deçan në kulturë, nuk po them që nuk është ashtu.

Tjetra? Nëse po flasim për qartësim, plot këto qartësime që do të të duheshin, besoj që i ke afër aty, se nëse e marrim edhe në kohëzgjatje që më pak jam unë duke u marrë me këtë temë, sesa që është marrë subjekti, ose Qeveria jote, fatkeqësisht. Domethënë, unë jam i fundit, e kam gjetur "bukë e ardhur", s'kam pasur kah ta çoj më.

Ju po e quani "kosto", dikush po thotë "borxh". Shikoni, veç ta keni parasysh, të kishte qenë që krejt kjo shifër është... s'paska vlerë kjo, pse ia ka propozuar ministri juaj Qeverisë suaj atëherë, po edhe pse Qeveria i ka thënë, "A din çka, bëje vetë!", s'ia ka aprovuar, a s'ia ka nënshkruar, a s'e ka votuar, eh, jo, jo, prit, prit, prit njëherë. Prit njëherë, se jemi kah flasim për dy afate kohore. Pyete ministrin, pasi s'je i lëmit, të tregon ministri, dy herë është shtyrë ky projekt. Ky 14,7 është pikënisja, nuk është ajo që po flet ti.

Shikoni! Unë s'kam asnjë arsye, besoni, sot ta mashtroj askënd në këtë sallë, as të shtrembëroj fakte, as ta them ndonjë send. Jam i hapur për çdo lloj hetimi vendor e ndërkombëtar, për çfarëdo shkeljeje në këtë temë, prej kur ekziston kjo Qeveri është e hapur. Ajo që jam duke ia shpjeguar secilit në këtë sallë, është bukur e thjeshtë, zotëri i nderuar. E keni lënë me vetëdije një kosto, po e quaj tash me fjalë tënden "kosto", që ka qenë pra e diskutueshme, me një operator me të cilin keni mundur ta mbyllni këtë kosto, por s'keni pasur arbitraritet, burra, arbitraritet s'keni pasur, se u ka munguar arbitrariteti, ajo baza ligjore e njohur, e dëshmuar, e përvojat. Nuk keni pasur arbitraritet të atillë, çfarë dikur ka ardhur dhe ajo ka mbërri mbi 63 milionë. Shihni pra, mungesa e arbitraritetit tuaj çfarë i ka bërë këtij vendi!

Mungesa e arbitraritetit tim sot do ta çonte këtë pak më lart. Po, sigurt, zotëri i nderuar, me këtë jam dëshmitari asaj që po. Sepse, nëse ka ardhur prej asaj të juaj deri këtu e di ku do të mbërrinte, plus ndërprerja e punimeve. Tash, ju lutem, nëse këtë s'e keni të qartë, atëherë konfuzioni sa të duam, po kunfozojmë bashkë, po shpërndajmë mjegull sa të duam. Unë e kam dëgjuar këtë temë, unë e kam dëgjuar kur ka dalë kjo temë. Unë e kuptoj që është atraktive e zgjedhore, të preket në varrë, në plagë, qytetarin tonë, fukaranë tonë, njeriun që është pa punë, njeriun që është pa para, edhe janë 53 milionë, edhe unë e di çka domethënë, se jam politikan. Por, unë s'kam mundur të tutem prej këtij fakti e të vazhdoj t'ia rris borxhin vendit tim, e në vend të 53-ve, ose 63, që i ka propozuar ai se në 45 + TVSH, të shkohet në shumë tjetër edhe të mbërrijë në gjykata e të mbetet rruga pa u kryer.

Këtë e ka bërë kjo qeveri e në rrethana tjera dikush do t'i thoshte "Faleminderit, që e more ti fajin dhe problemin edhe e zgjidhe", sikurse disa probleme tjera që i kemi zgjidhur. Edhe ju siguroj, deri në shtator të këtij viti nuk mendoj, e vetmja temë e vjetër që ka me mbet në Kosovë deri në këtë shtator, pra në tavolinë të Qeverisë së këtij vendi, të vetmit që kanë me pasur tema të vjetra është Gjyqësori, por në qeverisje s'kanë me mbet më tema të vjetra.

E kam marrë..., shiko veç një send, ajo mungesa e arbitraritetit që po thoni arbitrar edhe po doni ta siguron qytetarin, që ky kryeministër i merr vendimet paushall, nuk e konsulton ligjin, nuk i konsulton procedurat, i mëshon, e shkel ligjin, i shpërndan paratë... ky është qëllimi t'i thuhet qytetarit të vendit.

Faleminderit! Qe qytetari po ju dëgjon, ndoshta edhe do të ju besojë!

Komuna e Gjilanit në mënyrë arbitrare ka votuar një herë, e ka kërkuar do tokë për varreza. Mungesa e arbitraritetit në nivel nacional e ka lënë atë komunë qe sa vjet pa tokë për varreza. Komuna e Skenderajt e ka lypë një park, njëfarë aerodromi a çka ka qenë, qe sa vjet e lypë. Kryetari i Ferizajt e ka lypë një plan urbanistik për qytetin e vet, i ka humbur zgjedhjet, i LDK-së, po ka munguar arbitrariteti diku, nuk ia keni dhënë në kohë, ka fituar Agim Aliu, që e respektoj shumë, për shkak të mungesës së arbitraritetit. Po!

Shikoni, dallojmë, burra! Nëse kujtoni që jemi njësoj, nuk jemi njësoj. Jo, shyqyr janë do të ndryshëm, do kanë me i ra trup, bam-bam-bam, me i krye këto punë në këtë vend.

KRYETARI: Nënkryetar, edhe një minutë e dhjetë sekonda janë, edhe një minutë prej meje mund ta jap të PDK-së.

KUJTIM SHALA: Rri, rri këtu!

KRYETARI: Vazhdo, vazhdo, se kryeministri dëgjon edhe kur të dalë jashtë.

KUJTIM SHALA: E pëlqej ndonjëherë edhe këtë lojë me terme, po jo me kryeministrin. Janë njerëz tjerë ata me të cilët unë bisedoj për diskutet. Edhe një herë po e përsëris, se këto rrëfimet ekstensive të kryeministrit janë të padobishme, së paku këto.

E para, a mund të na japë Qeveria sot, së paku një faturë të papaguar, së paku një faturë. E dyta, pse kur mbikëqyrësi “Hilli” thotë që s’duhet të jepen 53 milionë, ju i jepni 53 milionë? E treta, marrëveshja, se ne kishim një marrëveshje, 14,7 milionë euro, marrëveshjet bëhen mbi bazë motivimi, po kur kthehet marrëveshja bëhet arbitrare.

Arbitrariteti si e shpjegon kryeministri, nuk ka lidhje. Ato janë vendime pa bazë ligjore. Sikur e thotë vet në trajtën më autentike, “Pse po e bën kështu?”, “Sepse kështu po ma merr mendja.” Në institucione të cilat funksionojnë mbi bazën e ligjeve nuk ka “po ma merr mendja”. Ka, “këtë e thonë ligjet, ky është përfitimi dhe kjo është kostoja”. Të gjitha të tjerat, të gjitha ato që po i thotë kryeministri, përpos funksionit të parë, që çështja të mbetet e paqartë, ose të bëhet edhe e më e paqartë, asnjë funksion tjetër nuk e kanë.

KRYETARI: Faleminderit! Partia Demokratike e Kosovës, Memli Krasniqi. Po vazhdojmë me partitë politike. Nënkryetarin, Kujtimin, në qoftë se ka mundësi...

MEMLI KRASNIQI: I nderuar kryetar,

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Me thënë të drejtën, isha në dy mendje a të mbaj fjalim apo jo, sepse fjala ime nuk mund të jetë as afërsisht interesant dhe informuese, sa fjala padyshim e kryeministrit, po edhe e Lutfi Zharkut si deputet, po mbi të gjitha dua të them që shpjegimin që ka dhënë kryeministri, pavarësisht që dikujt mund t’i duket në gjuhën popullore, unë mendoj që ne të gjithë e kemi marrë vesh dhe besoj se kanë qenë shpjegime goxha të sakta për mënyrën sesi ka ardhur deri te ky problem dhe për formën sesi është bërë zgjidhja e këtij problemi.

Por, sidoqoftë, edhe unë do ta jap njëfarë retrospektive, pak a shumë, të rrjedhës së kësaj çështjeje si një prej projekteve më të mëdha infrastrukturore, që janë duke u realizuar në Republikën e Kosovës. Qysh në gjenezë dua të them, që me marrjen e drejtimit të Qeverisë nga ana e Partisë Demokratike të Kosovës është iniciuar ndërtimi i Autostradës, fillimisht nga Morina në Prishtinë, Rrugës së Kombit, dhe është arritur që para afatit të kontratës të përfundohen nëntë segmente të autostradës në gjatësi prej 78 kilometrash, dike lidhur kryeqytetin e Kosovës me Shqipërinë.

Ndërtimi i segmenteve nga Vërmica në Prishtinë dhe duke vazhduar në Besi, ka hapur perspektivë për herë të parë të lidhjes së rajonit dhe vazhdimin e Autostradës prej Basisë në Mërdar dhe më tutje, pra në korridorin 10, duke integruar plotësisht Rrugën e Kombit në

korridoret Pan-evropiane dhe duk kthyer Kosovën nga një vend i mbyllur në aspektin e rrjetit rrugor, në një transit për gjithë Evropën Juglindore.

Projektet e drejtimeve rrugore, rrugëve 6 dhe 7, pra autostradat Vrëmicë - Merdar dhe Prishtinë - Hani i Elezit, Kuvendi i Republikës së Kosovës me 2 qershor të vitit 2008 i ka shpallur projekte me interes të veçantë publikë. Qeveria e Republikës së Kosovës është ngarkuar për marrjen e veprimeve ekzekutive për implementimin e këtyre projekteve. Qeveria, po ashtu ka emëruar komitetet drejtuese ndërministrore për zhvillimin e këtyre projekteve, në rastin konkret të Autostradës Prishtinë - Hani i Elezit, me qëllim të përgatitjes së projektit dhe përcjelljes së realizimit të tij në të gjitha fazat e zbatimit.

Në vitin 2014, konkretisht më 2 korrik, është nënshkruar kontrata që po e diskutojmë ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Konsorciumit fitues “Bechtel&Enka” dhe vlera e kësaj kontrate ka qenë afërsisht 600 milionë euro. Afati i përfundimit të kontratës ka qenë 42 muaj. Si rezultat i ndarjeve jo të mjaftueshme buxhetore, s’mund t’i mohon askush, se e kemi Ligjin e buxhetit të secilit vit edhe rishikimet, për zbatimin e këtij projekti, por mbi të gjitha për shkak të ngecjeve në alokimin e mjeteve në përputhe me dinamikën e punimeve, Komiteti Drejtues Ndërministror vet ka kërkuar nga konsorciumi implementues, që ta shqyrtojë mundësinë e shtyrjes së afatit të punëve dhe kërkesa e Qeverisë, unë kam qenë pjesë e asaj Qeverie, e mbaj mend mirë, ka qenë që të shtyhet për afërsisht për një vit, prej 20 janar 2018 deri më 31 janar 2018.

Të ju them të drejtën, për mua ka qenë kërkesë e panevojshme në atë kohë, kryesisht ministri i Financave ka menduar që është kërkesë e nevojshme për t’i drejtuar fondet në projektet tjera, që kanë qenë ndoshta pjesë e programit të asaj Qeverie.

Si pjesë e propozimit për vazhdim të afateve të kontratës nga konsorciumi dhe rekomandimeve nga kompania tashmë të famshme gjatë kësaj dite mbikëqyrëse “Hill International”, përfaqësues i punëdhënësit është “Hilli”, kështu që realisht është pak a shumë si njëfarë ndërmjetësi, asaj Qeverie i është përgatitur një aneks i kontratës dhe i ka përmbajtur disa dokumente, në mes të së cilave aneksin për shtyrjen e kohës së përfundimit të punimeve, kërkesat teknike dhe komerciale të punëdhënësit, skemën e pagesave, ose orarin e pagesave dhe datat e përfundimit të kyçjeve, të cilat janë pjesë e projektit.

Pas vlerësimit të dokumenteve të prezantuara edhe rekomandimi nga ana e kompanisë mbikëqyrëse, Komiteti Drejtues Ndërministror për projektin Rruga-6, në takimin e datës 30 shtator 2016 ka marrë vendim dhe i ka rekomanduar Qeverisë me e zgjatë afatin e përfundimit me koston shtesë, siç e quajtet ju saktësisht, 14,778 milionë euro, rreth 15 milionë euro, ku kanë qenë të përfshira dokumentet e lartcekura. Pra, po flasim për para dy vjetësh. Kanë kaluar dy vjet. Nuk është e saktë të thuhet se ka qenë për vitin 2018, kanë kaluar dy vjet. Ne nuk e kemi nënshkruar, ajo Qeveria e kaluar, nuk e kemi nënshkruar, sepse nga ana e Qeverisë nja dy muaj

më vonë, konkretisht më 6 dhjetor 2016 është dërguar një shkresë ku njoftohet Ministria e Infrastrukturës, që Komiteti Drejtues Ndërmintoror është kompetent lidhur me projektin e Autostradës. Rrjedhimisht, Ministria e Infrastrukturës nuk e ka ndërmarrë asnjë veprim dhe nuk mund t'i fajësojmë, sepse Qeveria ua ka imponuar këtë çështje. Aneksi nuk është nënshkruar asnjëherë dhe normalisht që nuk ka hyrë në fuq.

Ne kemi ardhur në një situatë tjetër. Me ardhjen Qeverisë Haradinaj në pushtet ka qenë çështje urgjente, ka qenë çështje urgjente, sepse është afruar fundi i vitit, është afruar përfundimi i kontratës dhe ti s'ke pasur qartësim, sepse ato dokumente që ne po i shohim janë të nënshkruara në njërin anë, nuk janë të nënshkruara prej anës së punëdhënësit, veç punëkryesi i ka nënshkruar dokumentet, të cilave po u referohemi për këtë koston shtesë, se borxhin prej pak më pak se 15 milionë euro. Dhe, pas nënshkrimit të zgjatjes së afatit të kontratës në shkresat e dorëzuara nga ana e konsorciumit është kërkuar fillimisht ajo që e tha kryeministri, kostoja prej 63 milionë eurove, dhe pas bisedimeve ndërmjet palëve është reduktuar shuma në 53 milionë euro, duke përfshirë tatimin e vlerës së shtuar dhe Qeveria e ka aprovuar këtë shumë.

Ajo që ne sot unë mendoj se kemi hapësirë për ta diskutuar dhe është e drejtë ta diskutojmë, është që ky vendim i Qeverisë është marrë pa vlerësimin final të kompanisë mbikëqyrëse, pa raportin final nga ana e kompanisë Hill International, që në një formë edhe përfaqëson Qeverinë. Andaj, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së po shpreh qëndrimin që ne presim që inputet e kompanisë mbikëqyrëse, të raportit që do të vihet në javët në vazhdim të merren parasysh në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Si përfundim, dy rekomandime ndoshta që mund t'i nxjerrim, ose që n ofrojmë, për interpelancën e sotme janë:

E para, që me të vërtetë, përkundër dallimeve politike, përkundër ndryshimit të pozitive që i kemi disa prej nesh sot, përkundër, kushtimisht ta quaj, lojës politike që mund të jetë edhe legjitime, unë mendoj se ne duhet ruajtur partneritetin me kompanitë e respektuara ndërkombëtare, mbi të gjitha duke pasur kujdes në zbatimin e saktë të kontratave me kohë dhe pa pasojat kontraktuale për cilëndo palë, por para së gjithash pa pasojat për Qeverinë. Dhe kjo nuk është se ka ndodhur në këtë kontratë, veçanërisht në mandatin e kaluar.

E dyta është që Ministria e Infrastrukturës me përkrahjen e kompanisë mbikëqyrëse të vlerësojë propozimet dhe të akordohet me konsorciumin Bechtel&Enka për koston finale të kontratës, sepse unë besoj që do të jetë e rëndësishme raporti final i kompanisë mbikëqyrëse.

Tani pyetje për këtë çështje mund të bëhen shumë dhe ne mund të vendosim cilin qëndrim duam ta marrim, a jemi pro a jemi kundër edhe me e ndërta qëndrimin, pikërisht ndoshta edhe në mënyrë joparimore, vetëm duke u nisur prej kësaj. Por, përgjigje në një pyetje të thjeshtë duhet

me dhënë, nëse 600 milionë euro ka qenë kontrata për 42 muaj, a po mendon dikush që 600 milionë kanë me qenë edhe për 53-54 muaj? Nuk ka logjikë, sepse janë 11 muaj e disa ditë kosto shtesë. Domethënë, ta kemi të qartë, nuk mund të mbetet në asnjë rast kontrata siç ka qenë në origjinal, sepse kanë qenë pikërisht ish-ministrat e LDK-së që kanë kërkuar me e zgjatë afatin. Zgjatja e afatit për të gjithë ne edhe për këta ka qenë e qartë, se nënkupton rritje të kostos së finalizimit të rrugës.

Tash, ne po kemi pikëpyetje a është dashur të rritet kaq, a kaq? Dhe, qëndrimet janë të ndryshme. Unë mendoj që pajtohemi të gjithë se mirë do të ishte të kryhet kjo punë me ato nën 15 milionë euro, por mandej legjitime është pyetja e kryeministrit, se përse nuk u krye? Është legjitime, duhet bërë pyetjen të gjithë neve. Është e vërtetë, zoti Shala, se e përmende një mbledhje të Qeverisë, ka qenë në rend dite, por e kemi tërhequr. Ka qenë në rend dite dhe e kemi tërhequr me kërkesën e kryeministrit dhe ministrit të Financave, kurrë më s'ka ardhur në rend dite. I kemi çuar shkresë Ministrisë së Infrastrukturës, i kemi thënë është Komiteti Ndërministror, për t'i ikur përgjegjësisë si Qeveri, por qeveritë serioze nuk u ikin përgjegjësi.

Qeveritë serioze marrin përgjegjësi dhe kryejnë punë e vendime, të cilat nuk janë domosdoshmërisht të popullarizuara, qysh s'është aspak popullarizues ky vendim, por të paktën nuk ikin prej përgjegjësi. Ne, zoti Shala, kolegë kemi qenë, i kemi ikur përgjegjësisë.

Kjo është e vërteta. Ne i kemi ikur përgjegjësisë si Qeveri dhe kur po them ne, mua nuk më ka pyetur kush, se ti ke qenë i Kulturës, unë i Bujqësisë, po trioja kryeministër - ministër i Financave - ministër i Infrastrukturës, bile-bile, se po flasim sot goxha... i kemi çelë letrat, bile-bile mendoj se më së rëndi e ka pasur ministri i Infrastrukturës, që unë mendoj se e ka pasur vullnetin absolut për ta kryer këtë punë dhe të mos ia lë trashëgimi kësaj Qeverie këtë problem. Unë e kuptoj që sot duhet të dalë e të japë arsyen e vet dhe ka të drejtë 100%, se ka qenë 100% i angazhuar, unë të paktën e kam pasur këtë bindje dhe e kam sot e kësaj dite, që ka pasur absolutisht vullnetin dhe angazhimin për ta kryer këtë punë. Pse nuk është kryer kjo punë, përgjigjet janë po ashtu në mesin e grupit tënd parlamentar.

E keqja është që sot është dashur të paguhen shumë më shumë mjete se sa kemi mundur të paguajmë në të kaluarën. Eh, tash është lehtë të thuash "ta shohim çfarë po thotë Hilli". Edhe unë mendoj që duhet dëgjuar Hillin domosdoshmërisht, se na obligon kontrata edhe na obligon edhe ligji, po me qenë mbarë e mirë e kishim kryer në të Qeveri e këta sot nuk do të kishin pasur nevojë të merreshin me këtë çështje. Po, qëndrimet kundërshtuese brenda Qeverisë, qëndrimet kundërshtuese brenda ministrave të Lidhjes Demokratike të Kosovës e kanë sjellë këtë situatë, të cilën sot ne mund të vendosim çfarë qëndrimi do të marrim, pro ose kundër, dhe të kemi edhe insinuata që mendoj se janë përtej çdo nacionaliteti e me çua kah mendimet që ky është proces korruptiv edhe me i ofendua edhe partnerët tanë, besa edhe ato shtete që i kanë mbështetur këta partnerë tanë gjatë gjithë këtyre viteve për të cilat punojmë.

Përndryshe, ne e kemi edhe sistemin gjyqësor në Kosovë, Prokuroria është, gjykatat janë, kushdo që ka pyetje të pasqaruara për tërë këtë proces mund të iniciojë çështje të tilla. Po, mandej nuk e di, unë nuk kam ndonjë dyshim që mund të ketë diçka të keqe, përveç që të gjithëve po na dhemb, sepse është kostoja e madhe. Të bëhemi fer dhe ta shohim fotografinë e plotë, jo veç këtë përfundimin. Dhe, fotografia e plotë mendoj se nuk është bardhezi, siç po mundohet të portretizohet sot, qoftë prej anës së LDK-së, ose në anën tjetër prej Qeverisë. Ky, tek e fundit, nuk është projekt i vetëm një qeverie, një kryeministri a ministri, bile është projekti kryesor i vazhdimësisë. Këtë projekt e ka pas nisur kryeministri Hashim Thaçi, ka qenë në pushtet kur është kryer. Në kohën e Isa Mustafës ka vazhduar me këto probleme që po i flasim dhe në kohën e Ramush Haradinajt do të përfundojë. Është mirë mandej me u dhënë rrugë edhe projekteve tjera të rëndësishme.

Sidoqoftë, besoj se diskutimet, ose unë kam pritur që diskutimet të jenë më shumë në frymën e qartësimeve për opinionin publik, sepse opinionin publik e kemi mjegulluar, i madh e i vogël, duke folur jo për të dhënë sqarime, por duke u munduar të fitohen poenë politikë, duke u munduar të garohet kush po e ruan më shumë paranë e Kosovës dhe jo duke u munduar të marrë secili përgjegjësinë që i takon. E përgjegjësia për këtë projekt tash nuk i takon, as një njeriu, as një ministri, as një kryeministri, por përgjegjësia është e krejt atyre që kemi qenë të involvuar, së paku qe pesë vjetët e fundit që kur ka filluar ky projekt. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani unë do të bëj dy-tri komente, për shkak se mungon kryetari dhe s'ka kush të më zëvendësojë do të flas prej këtu dhe ju kërkoj falje, sepse nuk është plotësisht në përputhje me Rregulloren.

Besoj që ky fjalimi i fundit i kolegut Krasniqi është pak a shumë si fjalimi i kryeministrit, si vrojtimit e tij, por pjesërisht i shkruar dhe njerëzit që na kanë ndjekur me kujdes, edhe pse juve ju duket paradoksale, nëse shihni në tri pika themelore, që janë fakte themelore, kolegu Krasniqi më jep të drejtë plotësisht.

E para, që kjo është një kosto. E dyta, që shtyrja është për rreth 11 muaj, domethënë 12 muaj e jo më shumë. Nëse e merr dhe llogaritë koston, është rreth 1,3 milion euro për një muaj dhe kur të gjitha këto i bën bashkë është 14,7 milionë euro dhe diçka më shumë. Kjo është kështu, e para.

E dyta, që shtyrja është për periudhën 1 janar 2018 - 31 dhjetor 2018, 20 janar, domethënë rreth 11 muaj e dhjetë ditë. Tani tjetra, që e tha dy herë dhe e përsëriti, që është vendosur që të bëhet kjo pagesë në shumë prej 53 milionë euro pa një raport të mbikëqyrësit. Dhe, ju e dini që kjo s'është e ligjshme. Në rastet e investimeve kapitale nëse vendoset pa raportin e mbikëqyrësit, kjo është dhe vepër penale.

Kam edhe çështje tjera, por s'po dëshiroj të flas prej këtu.

Memli, a dëshiron? Po! Memli Krasniqi. Jo, i ke minutat e grupit, sado që të kesh nevojë.

MEMLI KRASNIQI: Zoti kryesues, faleminderit!

Përndryshe, unë s'pres prej teje ta keqpërdorësh pozitën e kryesuesit, se minutat e LDK-së janë harxhuar, nuk e di a t'i ka dhënë dikush! Nëse m'i lyp mua, një ta jap. Po, ato minuta nuk e di të kujt ishin, meqenëse e mora vesh më herët që i keni harxhuar.

E dyta, ju interpretuat fjalimin tim. Unë nuk ju dhashë, as juve të drejtë, as kryeministrit, as Lutfi Zharkut, as asnjërit tjetër, unë e shpjegova një rrugëtim të këtij projekti deri këtu edhe ashtu qysh unë e shoh këtë problem, duke qenë pjesë edhe e asaj qeverie edhe pjesë e këtij koalicioni dhe duke e theksuar faktin, që Qeveria e kaluar është dashur ta kryejë këtë punë, e jo kjo Qeveri. Ikje e përgjegjësishë e Qeverisë kur kemi qenë unë e ti anëtarë është ky problem, të cilin ia kemi bërë kësaj Qeverie.

Tani mund të flasim për pjesën tjetër, po nëse ti thua këto janë të vërteta, e vërtetë është edhe kjo, që Qeveria e kaluar s'e ka kryer punën e vet, që Qeveria e kaluar ku kemi qenë unë e ti anëtarë të saj i ka ikur përgjegjësishë. S'ka të bëjë ajo më 2018, kanë mundur të paguhen mjetet në vitit 2018, po aneks-kontrata, vazhdimi i punimeve, zgjatja e afatit, orari i pagesave, afati i përfundimit të kyçjeve, krejt ato dokumente, se nuk është një letër, është dashur të nënshkruhen në atë kohë.

Edhe unë e di që ka pasur vullnet të nënshkruhen prej ministrit Zharku, i cili e ka pasur përgjegjësi dhe e ka ditur punën, po ka pasur ministra të tjerë, të cilët nuk kanë dashur ta kryejnë këtë punë, qysh besa i kanë zvarritur edhe punët e tjera që e dimë ne.

Sidoqoftë, unë e përmenda kompaninë mbikëqyrëse për një arsye të thjeshtë, sepse kuptimin edhe të interpretimit të kontratës, edhe të legjislacionit në fuqi, është e nevojshme ta kemi raportin e tyre final, e përmenda po ashtu që të mos interpretohet se jemi pajtuar, se nuk besoj që jemi pajtuar krejtësisht, ose që e kemi thënë të njëjtën send, po e presim raportin final, sepse nga ajo që unë jam informuar edhe prej Ministrisë së Infrastrukturës, raporti i kompanisë mbikëqyrëse besoj që gjatë javëve të ardhshme do të vijë, pastaj ma merr mendja do të kemi njëfarë qartësimi edhe njëfarë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Unë për ndërhyrjen që pata ju kërkova falje edhe vetë e thashë që s'është në përputhje me Rregulloren, për pjesën tjetër, është e domosdoshme të komentohen nga fillimi, por unë s'do ta bëj, për shkak se jam këtu, po e them vetëm një gjë të vetme që janë plotësisht të pasakta, sepse nëse ka një dokument dhe një vendim, ai është i Qeverisë Mustafa.

Sipas radhës, fjalën e ka përfaqësuesi i Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, kush e dëshiron fjalën, deputeti Liburn Aliu.

LIBURN ALIU: E para, nuk është këtu kryeministri e ministri Pal Lekaj dhe, rrjedhimisht ne i kemi thirrur ata në interpelancë, ata do të duhej të ishin këtu tash.

E përmendi qysh u befasua që Liburni apo Vetëvendosja është e pozicionuar me LDK-në, nuk jemi të pozicionuar, absolutisht nuk jemi të pozicionuar as me LDK-në, as kundër dikujt.

Dëshira ime më e madhe do të ishte që në këtë interpelancë të mos kem mundësi ku të kapem për një çështje, mirëpo unë nuk mund të hesht. Respektin që e kam për zotin Ramush Haradinaj dhe shpresën e madhe që e kam pasur për qeverisjen që do të mund ta bënte, unë totalisht e kam për toke tash, prandaj nuk mund të hesht, nuk mund të hesht kur e shoh që 53 milionë euro të buxhetit thjesht janë nënshkruar dhe janë dhënë pa asnjë lloj procedure të rregullt.

E tash, po thuhet 14.7-milionëshi, i cili qenka kosto apo borxh, qysh po përpiqet ta interpretojë kryeministri prej Qeverisë së kaluar. Ky 14,7 paska rrezikun e rritjes në të ardhmen, prandaj ky 53-milionëshi qenka një lloj rritje i këtij 14,7-milionëshi, gjë që nuk është e vërtetë. Ku po e bazoj këtë? Në raportin e Pal Lekajt, raporti i Pal Lekajt thotë që kur e ka sjellë, në fakt, kur e ka sjellë kontraktuesi në nëntor 2017 kërkesën prej 63 milionë, ka thënë që për shtyrje të projektit, për zgjatje të projektit janë 16,6.

Pra, “Bechtel-Enka” këtë 14,7 në nëntorin e vitit 2017 e ka rritur në 16.6. Kosto të tjera, pajisje, ndërprerje, nuk kanë të bëjnë me kontratën, janë tejkalim i kontratës. Prandaj, eventualisht ky 14,7 paska mundur të bëhej 16,6, po absolutisht jo 53 milionë euro.

U tha qysh LDK-ja i paska marrë paratë e buxhetit të “Bechtel-Enka”-s e i ka bartur këndeja, e krejt dhe e mirëkupton. Unë nuk e mirëkuptoj LDK-në, nëse ka bërë diçka të tillë, unë nuk e mirëkuptoj as sot Aleancën, as kryeministrin nëse paratë e buxhetit i merr e i alokon vetëm për komunat, ku zgjedhjet lokale i ka fituar AAK-ja, kjo nuk është në rregull. Nuk mund të thuash unë i kuptoj këta, në një farë mënyre ta arsyetosh veten që tash të veprosh në këtë mënyrë, sepse kanë vepruar krejt, me Vetëvendosjen kjo nuk ndodh.

Po flitet për penallti, nuk ka penallti, le të thuhet konkretisht cilat janë penalltit, kush e ka marrë atë vendim për penallti, cilat janë ato penallti, cili është ai? Thjesht, konkret, le të dalë vendimi konkretisht, kush e ka bërë penalltinë?

Po thuhet kështu, kontrata ka qenë për 42 muaj, është shtuar për një vit, edhe për 11 muaj të tjerë, qysh mund të jetë kostoja, po pikërisht ajo kostoja kalkulohet.

E para, në vlerësimin e parë 14,7 dhe në vlerësimin e dytë prej vetë “Bechtel-Enka”-s 16,6. Pse duhet 53 milionë euro, kur dihet shumë qartë që nuk ka të bëjë me pajisjet.

Tjetra, çështja e “Hill”-it, kompanisë “Hill” është jashtëzakonisht i rëndësishëm vendimi dhe vlerësimi i tyre, sepse thuhet në këtë raport, në raportin e vetë Pal Lekajt.

Kompania “Hill” e ka refuzuar kërkesën, e ka konsideruar jo të rregullt kërkesën e “Bechtel-Enka”-s në pikat b dhe c që ka të bëjë me pajisjet dhe me ndërprerjet.

Prandaj, nuk po e zgjas më tepër, vazhdojmë.

KRYESUESI: Faleminderit! Përfaqësuesi i Grupit Parlamentar të Partisë Social Demokratike, kush e dëshiron fjalën. Deputeti Dardan Sejdiu. Urdhëro, Dardan!

DARDAN SEJDIU: I nderuar kryesues,

Të nderur deputetë,

Faleminderit shumë që e keni ftuar këtë seancë, këtë interpelancë, do të ishte mirë nëse së paku ministri përkatës të ishte këtu, një ministër që e di këtë temë apo ish-ministër që e di këtë temë së paku e kemi këtu, kështu që nëse gaboju diko, më korrigjoni.

Në Komisionin për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri e kemi pasur në raportim ministrin e Infrastrukturës, zotin Pal Lekaj dhe prej atij raportimi ka derivuar edhe ky dokument, të cilit sot po i referoheni.

Dhe, atje është bërë e qartë që tema e kostos apo e borxhit, varet kë e pyet, është temë që duhet trajtuar, meqë ekziston një paqartësi rreth mënyrës se si një zarf, ashtu i thoshte ministri në komision, një zarf i cili kishte vlerën prej 14,7 milionëve duhet rinegociuar në një zarf tjetër, i cili arrin vlerën prej 53 milionëve.

Aty na është prezantuar edhe një raport “Hill International”, raport i cili, në fakt, ishte çuditërisht më pozitiv në aspektin e ruajtjes së parasë publike, se sa raportimi që bëhej në komision nga ministria.

Por, para se t’i trajtojmë këta 53 milionë euro, ndonëse janë vlerë jashtëzakonisht e madhe dhe është tepër me rëndësi të trajtohen në detaje, e që besa edhe të hetohen si duhet, është me rëndësi gjithashtu të shpërfaqet një diçka, e cila sot disi u anashkalua.

Si mund të vlerësohet një marrëveshje e tillë pa e lexuar kontratën? Si mund të vlerësojmë një marrëveshje mes dy palëve, nëse nuk e kemi të qartë kontratën që e kanë nënshkruar këto dy palë?

Sot e kësaj dite ne nuk e kemi parë kontratën, pra kemi asimetri të informatave, kemi ministra këtu që debatojnë me njëri-tjetrin, kemi deputetë që bazohen në fjalë të ministrave, një raport të “Hill International”, po nuk kemi kontrata.

Kontratën për autoudhën Shkup-Han të Elezit unë nuk e kam parë si deputet. E kam kërkuar në komision, i kam thënë ministrit krejt kjo çka po na thoni ju do të kishte kuptim nëse unë do ta lexoja kontratën, e pra kontrata e lexuar, së bashku me raportin e “Hill International” dhe vlerësimin tuaj do të na pasqyronte qartazi se ky 53-milionësh çfarë kuptimi ka.

Përndryshe sot këtu i kemi dy ministra duke treguar cili e ka mirë e cili e ka keq dhe ne 120 deputetë, në fakt, shumë më pak, po debatojmë, po diskutojmë se kujt t’i besojmë? Ky është debati sot që e keni këtu.

Por një gjë është e qartë. Ka ekzistuar një zarf, një marrëveshje për 14,7 milionë euro. Ky zarf dhe kjo marrëveshje nuk është finalizuar dhe për periudhën kohore të kaluar tashmë kemi përfunduar në 14,7, duke na u bërë herë katër, apo here tre e gjysmë, të bëhem më i saktë, duke u bërë 53 milionë euro dhe këtë diferencë po e diskutojmë duke u bazua në raportin e “Hill International” dhe në fjalët e dy ministrave.

Ekziston një vendim i gjykatës, i cili e obligon, vendim të cilin e ka iniciuar një organizatë e shoqërisë civile për të pasur qasje në kontratë, e cila e obligon ministrin, cilido që është ai, qoftë Pal Lekaj, qoftë Lutfi Zharku, që t’ia japë asaj organizate të shoqërisë civile kontratën në dukje, pra ta shohë kontratën.

Përderisa ne si Komision për Zhvillim Ekonomik, në bazë të këtij aktvendimi të gjykatës kemi kërkuar gjithashtu që edhe neve në komision të na sillen kontrata, sot e kësaj dite kjo kontratë nuk na është sjellë në komision, ekziston vendimi i gjykatës.

Pra kontratat me kompaninë “Bechtel-Enka” dhe këtu më duhet pa tjetër të potencoj, “Bechtel-Enka” mund të jetë kompania më e mirë në botë, po është kompani që punon për fitim, për profit, nuk i bart ajo bagerët pse është e Amerikës apo e Turqisë, por për euro apo dollarë fitim.

Në vitin kur u nënshkrua kjo autostrada e parë Prishtinë-Morinë me kosto prej gati apo më shumë se një miliard euro, kemi kërkuar ta shohim kontratën. Sot, më 5 korrik të vitit 2018, janë shpenzuar afër dy miliardë euro, përfshirë këtu edhe këtë 53-milionëshin, i cili nuk është paguar ende dhe ne ende nuk i kemi parë kontratat!

Çdo diskutim, të nderuar kolegë, çdo diskutim prej çfarë derivon ky 53-milionësh, prej kah vjen ky 53 milionë euro, pa i parë kontratat, pa i diskutuar kontratat, besoj unë është edhe jokorrekt, e që besa nuk i bën as mirë diskutimit.

Pra, hapi i parë, i nderuar ministër, faleminderit që erdhe, i nderuar ministër, është publikimi i kontratës. Publikoje kontratën! Publikoje kontratën, ministër, sepse ajo kontratë shpenzon para të qytetarëve të Republikës së Kosovës, publikoje atë kontratë, e ke një vendim të gjykatës për një organizatë joqeveritare që duhet t'ia japësh në dukje, publikoje atë kontratë. Nuk ka kuptim ti edhe zoti Lutfi Zharku këtu të debatoni kush ka faj. Publikoje kontratën, po e shohim “Hill International”, punët që janë bërë, dënimet për mospagesa e të kuptojmë qysh e trajton kontrata këtë punë.

Qysh mund të diskutoj për 53 milionë euro pa e parë nenin, në të cilën thirret “Bechtel-Enka”, qysh? Në bazë të fjalëve që i thuni ju, po i keni shpenzuar dy miliardë euro për 100 kilometra auto-udhë, dy miliardë euro për 100 kilometra auto-udhë janë shpenzuar, tash edhe 53 milionë euro të tjera, thotë kontrata nuk bën të shihet. Dy miliardë euro, 150 milionë në mesatare në vit shpenzohen për këtë kontratë prej vitit 2008, pra kemi nevojë për ta bërë këtë debat të mirëfilltë ta shohim kontratën.

Kur ta shohim kontratën, e shohim raportin e “Hill International”, kur të shohim raportin e “Hill International”, ta shohim pse Qeveria Mustafa nuk e ka nënshkruar zarfën e parë prej 14,7 milionë euro, e si kemi mbërritur në 53 milionë euro?

Këta janë hapa të domosdoshëm për të pasur transparencë të plotë mbi shpenzimin e parasë publike. Pa këta hapa ky diskutim ka kuptim vetëm popullist e elektoral, asgjë më shumë, asgjë më shumë.

Ju lutem, dy miliardë euro, kontratat, e shohim raportin e “Hill International”, e shohim çka ka bërë Lutfi Zharku, si ministër, Memli po thotë që ka qenë insistues, po del që ministri i Financave, ish-kryeministri nuk kanë qenë insistues, po këto janë llafe. Ky Kuvend duhet të veprojë në dokumente.

Në fund, tjetra, që është tepër me rëndësi, besoj unë. Raporti i cili, ministër, është prezantuar në komision, të cilin ju e keni prezantuar pas kërkesës së Komisionit për Zhvillim Ekonomik, është raport në të cilin pak a shumë shpërfaqet një dallim në pozicion mes mbikëqyrësit të punës dhe kontratës dhe Qeverisë, në këtë rast juve, si ministër.

A ka mundësi, ministër, sot të na shpjegoni pse është ky dallim? Pse mbikëqyrësi i kontratës e kursen më shumë paranë publike? A po thotë që nuk duhet pranuar kjo kosto, pse ne e pranojmë këtë kosto, këtë duhet ta qartësojmë, përsëri pa e parë kontratën.

Dhe, po e përmbyll duke thënë që nuk ka kuptim, e lexova para sa dite edhe një deklaram të një zyrtari të Ministrisë së Infrastrukturës, i cili thotë që tek në vitin 2023 do ta kemi të qartë koston e saktë të këtyre dy autostradave, po kjo s'ka kuptim.

Pra, ju kisha lutur, në bazë të një qasjeje normale në shpenzimin e parasë publike, për hir të debatimit korrekt në Kuvend, na e publikoni kontratën, na e publikoni marrëveshjen, na e publikoni raportin e “Hill International” dhe atëherë askush nuk ka hapësirë të thotë ‘ky më tha e ai më tha’.

Pra, kjo është rruga e vetme përpara, është e dhimbshme që 14,7 milionëshi të shndërrohet në 53 milionë, po edhe më e dhimbshme është të shpenzohen dy miliardë euro pa e ditur asnjëri prej nesh çka po shpenzohet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kryeministri e ka kërkuar fjalën. Urdhëroni, zoti kryeministër! Një minutë, zoti kryeministër, lus regjinë që të marrë nga Grupi Parlamentar i AAK-së

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Nuk e di sa jua ke thënë në fillim, nja gjysmë ore atyre paraqitësve.

KRYESUESI: Jo, janë të LDK-së, LDK-ja nuk ka më minuta.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Rregullorja vlen.

Shikoni, mos i ikni të vërtetës askush për cilindo arsye, i cilit do grup parlamentar. “Hill” që po e përmendni shpesh këtu, s’e mbron paranë e Kosovës më shumë se na që jem të këtij vendi, s’po duam të bazohemi në të, e që po kem qejf të jetë ndërmjetësuesi.

Shikoni, çka jeni duke folur? A po besoni që ashtu është a? Se dikush tjetër na mbron ne më shumë se ne veten. Ok-ej.

Tjetra është, a po e merrni vesh që “Hill” kur e ka dhënë atë shumë, e ka lënë çel mundësinë e kostove të tjera, nuk e ka mbyllur dhe ai që ka mundur ta mbyllë, të na shpëtojë prej këtij borxhi, nuk e ka mbyllur ministri as Qeveria. A po e merrni vesh qysh kemi ardhur këtu, ku kemi ardhur. Çka bën sot ti? Shko ti pyte “Hill” prapë, edhe “Hill”, më fal Dardan, po thoshte nuk bën ta pranoni këtë kosto. A po e aprovoni ju një rezolutë këtu, po e anulojmë ne vendimin e po shkojmë në arbitrazh, merrni përgjegjësinë, pra, se po doni t’i shpëtoni paratë. Merrni ju përgjegjësinë, po shkojmë në arbitrazh. Duhet ta kuptoni për çka jemi duke folur, ju lutem. Shiko, nëse dikush kujton që kjo Qeveri, edhe unë, nuk po më dhimben paratë e këtij vendi dhe nuk më ka dhimbsur kjo gjendje, për besë, po analizojmë edhe pak atëherë, pse kemi ardhur deri te ky konstatim, se kështu qenka puna.

Unë e kam përcjellë këtë gjendje prej ditës së parë në Qeveri, nuk kam kalkuluar bukur fort kah t’i biem kësaj pune. Unë kom mundur të fshehur, mundem edhe sot të fshihem, merrni ju një vendim, aprovoni një rezolutë, që LDK-ja në shumicë jeni, po shkojmë në arbitrazh, dhe më shpëtoni edhe mua, s’kam nevojë të marr vendime. Po atëherë kur të vijë vendimi i arbitrazhit, ju

lus, fitoni pra, mos e leni të humbim dhe shkoni bazohuni në “Hill”-in, etj., nuk është ashtu, ju lutem, se po të kishte pasur situatë që do të kishim shpëtuar prej këtij borxhi, nuk kisha pasur nevojë të vij e të më thotë gjithkush mua këtu ‘merre atë, merre këta’. S’kemi pasur kah ia mbajmë! E kemi krijuar vetë, i kem hequr paratë për çështje zgjedhore, i kemi destinuar në komuna të caktuara, e kemi lënë pa e paguar borxhin, sot e ke në tavolinë.

Nëse ky Parlament, ju lutem, pasi po u dhimbset shumë Kosova, disa që po i dëgjoj këtu, bravo ju qoftë, urdhëroni, aprovoni rezolutë, e anulojmë këtë borxh dhe po shkojmë në arbitrazh, merrni përgjegjësinë veç, e kur të vijë arbitrazhi, atëherë flasim kush ka pasur të drejtë, a kam pas unë sot, a dikush tjetër.

Në këto situata dikush duhet të marrë vendime në emër të këtij vendi. Ndryshe, nëse i lëmë në afatgjatë, shkojmë duke e rritur borxhin, i bëjmë dëme këtij vendi.

Edhe ju siguroj që nuk ka qenë moment i lehtë të marr një vendim të këtillë, po e kemi marrë që ta shpëtojmë tutje këtë vend.

Edhe një herë ju them, unë nuk dua të them kush është më i mirë, kush është më i keq ,se të gjithë për diçka vlejme, edhe Zharku vlen për diçka, edhe unë për diçka dhe secili për diçka. Veç jam habitur me këtë duetin Liburn Aliu - Lutfi Zharku. Përnjëmend jam habitur. S’po mund ta marrë vesh, më është mbështjellë krejt filmi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Dardan Sejdiu, pastaj Liburn Aliu për replikë.

DARDAN SEJDIU: Është tepër me rëndësi, kryeministër, veç një minutë e kam unë shumë me rëndësi. E para, kryeministër, unë besoj jashtëzakonisht shumë në secilin deputet në këtë seancë, e në secilin ministër që nuk do t’i shpenzojë paratë publike për dikë keq besoj, si parim jetësor e kam t’i mirëbesoj dikujt, por gjithashtu jam i votuar këtu për t’u siguruar që këtë mirëbesim e kam të bazuar në dokument dhe ky dokument që unë po e kërkoj është fare i thjeshtë dhe i lehtë, dhe është kontrata. Kontratën pa e lexuar, i vetmi element që i mbetet një deputeti këtu është një raport, i cili është publik. Ai raport i cili është publik është raport, të cilin ne e paguajmë për ta mbikëqyrur një kontratë që e ka nënshkruar Qeveria në vitin 2014. Të gjitha të tjerat janë fjalë ndërmjet zotit Lutfi Zharku dhe zotit Pal Lekaj.

Pra, pa e pasur një kontratë para nesh si deputetë nuk mund ta vlerësojmë në saktësinë e saj, e rrjedhimisht pra nuk mund ta marrim edhe përgjegjësinë. Ajo çka po kërkojmë është që informatën që e keni ju si kryeministër ta ketë secili deputet në këtë sallë. Kur ka asimetri të informatave, ka edhe vendime që dallojnë, sepse ti kryeministër e ke informatën e plotë, së bashku me 4-5 këtu që kanë qenë ministra e janë deputetë sot, e disa që sot janë edhe ministrat. Pra, po shpresoj që zoti Zharku nuk hidhërohet që po e përmendi, është zoti Zharku që ka qenë

ministër, zoti Avdullah Hoti s'paska ardhur sot, është zoti Pal Lekaj këtu. Memli e përmendi veten që ka qenë ministër, ju krejt keni informacion dhe e keni të plotë informacionin. Derisa unë detyrën e deputetit jam duke e ushtruar pa informacion të plotë dhe përsëri unë jam ai që po mirëbesoj, dhe po them edhe dhjetë vjet vonesë, na e jepni kontratën, në rregull jemi.

KRYESUESI: Faleminderit! Kryeministri, prapë e ka kërkuar fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Edhe Liburnin e dëgjoj, edhe Dardanin, nuk po iku prej sallës, këtu jam diku edhe kur s'jam në ulëse për shumë arsye, qofshin edhe njerëzore, por dëgjoni. Nëse duam ta shikojmër a ka ndonjë faj kjo Qeveri dhe çka kjo Qeveri s'e ka bërë në rregull për shkak të arbitraritetit se i atribuohet arbitrariteti i vendimeve, ok po shpurdhim, po këqyrim. Kurrë ne s'jemi kundër kësaj. Nuk është ministri Lekaj, unë jam që e kam bërë këtë punë, Ramush Haradinaj e ka bërë këtë punë, ministri është ministër i Qeverisë Haradinaj. Jam përballë me këtë temë, do të përballem edhe me tjerat, cilado qofshin, tema të çfarëdo natyre, nuk do t'u ikim temave, nuk mund ta lë vendin as pezull, as peng, veç po ju tregoj një gjë, Dardan edhe Liburn, edhe një herë. Nëse ka shkelje a krim në këtë punë, e ka bërë ky krah, ky krah është duke e shfrytëzuar këtë interpelancë për ta fshehur atë krim dhe duke e keqpërdorur këtë krahun këtu. Kjo është e vërteta e kësaj dite, vëllai jem.

Mua po më vjen marre pse jemi kështu. Edhe e kam gjetur në tavolinë aty, të akumuluar, dhe jam detyruar në emër të krejt neve që duhet t'i biem dikah në emër të këtij vendi për ta zgjidhur këtë problem, dhe nuk është pa letra, pa vlerësime, nuk është pa kurrigjë. Shiko, vlerësimet që i ka bërë ai operatori, janë bukur lart ata, nuk janë kesi operatori cikërrimë. T'i kanë shkruar, t'i kanë vënë në letër, t'i kanë vënë në tavolinë, janë 63, dhe nëse s'e mbyll të ka paralajmëruar po ashtu deri kur shkojnë deri në datën e caktuar kurdo që shkon në Arbitrazh. Dhe ju siguroj edhe një herë, çdo politikan normal, çdo deputet normal, e di që është zor për të shkruar asaj rruge, nuk është zgjedhore është problem, është e ndjeshme, është e dhimbshme të futet i ashtu paraja e këtij vendi, në fund të fundit.

Duhet zgjedh a do ta kryesh, a do ta lësh të shkojë deri atje. Në fund të fundit, keni mundur edhe ju ta merrni atë vendim, por nuk do të ishte një vendim i lehtë që do ta kishit marrë kurrë, se nëse e lejoni të shkojë në Arbitrazh, merrni përgjegjësi. Dhe, në çfarë baze do ta merrni, me çfarë të dhënash? Kjo është e vërteta e kësaj ngjarjeje. Unë ju kam thënë edhe më herët që vërtet nuk do të shpurdhi, por ju siguroj që nëse edhe jam i hapur, jo unë pse e kërkoj, kurrë s'kam për ta kërkuar, s'kam për të bërë dosje për askënd, por jam i hapur që çdo prokurori të vendit, a të huaj, le ta arsyetojë këtë temë prej nisjes deri sot. Kjo qeveri është e pastër si loti, kjo qeveri e ka veç një faj që e ka guximin të mos lejojë të bëhet më keq për këtë vend. Edhe nuk ka përfitim të çfarëdo natyre kjo qeveri, por e ka vetëm dëmin publik që e ka marrë mbi vete se është dashur ta kryejë këtë punë, të mos e lërë të bëhet më e keqe, dhe janë letrat, dhe janë të dhënat, materialet

janë krejt. Dikush e ka bërë dëmin, fshihet në këtë dëm me këtë interpelancë dhe e shfrytëzon dikë tjetër... Kështu siç po shihet.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Liburn Aliu e ka fjalën për replikë.

LIBURN ALIU: Kryeministër, të kisha lutur të qëndrosh. Ju thatë se po ju habit dueti ndërmjet meje dhe LDK-së, e qysh po pritni kryeministër të hesht unë, a qysh? A të hesht unë? Unë jam i bindur që këta 53 milionë euro janë dhënë pa procedurë të rregullt dhe ka shkelje. Nuk mund të heshtim për këtë punë. Është çështje shumë e thjeshtë, pavarësisht respektit të madh që mund të kemi për ju në të kaluarën, por sa i përket kësaj qeverisjes dhe Qeverisë tash, unë mendoj që për mua personalisht një zhgënjim, dikush tjetër mbase s'ka besuar shumë, unë ndoshta kam qenë naiv, kam besuar.

Po na trajtoni pak si naivë. Besoni që ne s'e kemi fajin, e ka dikush tjetër. Ne i kemi letrat përpara, ne jemi duke i lexuar letrat para vetes. Ne e kemi këtu një raport edhe të "Hillit" për ata 14,7 milionë dhe detajet e tij, por po ashtu e kemi edhe raportin e ministrit Pal Lekaj. Është shumë e qartë çështja e këtyre 53 milionëve, për 2 pikat tjera nuk ka bazë me kontratë. Për pikën e parë "shtyrje të kontratës", 14,7-shi eventualisht mund të rritet në 16,6. Pse 53 milionë?

"Kjo Qeveri është e pastër si loti" thoni. Kjo është frazë, fjala "kjo Qeveri është e pastër loti" është frazë. Letrat përpara, po dakord jam me kërkesën ta futin edhe në rezolutë, le të publikohet kontrata, ta kemi kontratën e publikuar, mirëpo 53 milionëshi duhet të arsyetohet. Nuk janë pare as të miat, as të tuajat, janë para të cilat na dhimbsen të gjithëve, as ty më shumë, as mua më shumë, as këtij tjetrit. Të gjithëve ju dhimbsen këta 53 milionë dhe detyrë e jona si deputetë është të kërkojmë llogari për to. Nëse pse kërkoj llogari i bie që qenkam me dikë apo kundër, jo unë po e bëj detyrën time si aktivist i Lëvizjes Vetëvendosje dhe si deputet i Republikës së Kosovës. Unë e kam për detyrë, pavarësisht respektit ndaj kujtdo qoftë, edhe brenda nesh, ta ngre një çështje kur mendoj se ka shkelje.

KRYESUESI: Faleminderit! Kryeministri prapë e dëshiron fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Vërtet nuk pres ndonjëherë për çfarëdo respekti që askush obligohet për të mos e mbrojtur të drejtën, të vërtetën dhe interesin e këtij vendi, edhe unë s'e bëj. Për cilindo respekt që kam ndaj dikujt kur është interesi i një vendi, mundohem ta mbroj. Pyetja ime është më e thjeshtë Liburn: A e kupton që këtë borxh nuk e ka shkaktuar kjo Qeveri, as nuk e ka lidhur atë kontratë që po e kërkon. Ka mundur ta kërkojë VV-ja këtë kontratë edhe para dy vjetëve. A e kupton që ai borxh dhe kjo gjendje, edhe krejt ky dëm, ka lindur prej bashkë sponsorizuesit të interpelancës të sotme, dhe cili është qëndrimi yt për këtë fakt? A nuk vlen për ty, apo nuk është me rëndësi ajo? Nëse s'është e lëmë, e tani nuk po pranon, më fal, që kjo Qeveri është e pastër si loti, janë krejt temat e qeverisjes, e nuk e di a është a s'është, por nëse po

flasim për një temë konkrete, unë jam duke thënë para teje se nuk ka as marrëdhënie korruptive, nuk ka as para të vjedhura prej ndokujt, nuk dimë që ka, por ka një situatë të zorit për të mos e lënë një gjendje, në çka po e bazon që u bë prej 14 në 16, Liburn? Duhet të të vijë pak marre çka je kah flet. Më fal, a po flet dëshira, ti a po di që kanë kaluar dy vjet prej atij raporti?

Nuk jeni në rregull. Shikoni, sa më përket mua, çdo kontratë që e nënshkruan Kosova do ta kem guximin ta publikoj, bash çdo kontratë. Nëse ky vend ka marrë obligimet për kontratat që janë të papublikuara, s'e kam atë të drejtë, se dënohet ky vend, e s'kam arsye personale të mos i publikoj. Ama edhe një herë po ju siguroj, shikoni vetëm duhet ta kuptoni, bashkë jemi sot, shumë në rregull është, po ta kishit bërë ju një interpelancë, unë t'i kisha trajtuar shqetësimet tua. Ju më keni ardhur ju dy, kush? Ti Liburn, me Albinin, Albulenën, me këtë tjetrin, me atë, me Lutfi Zharkun, ish-ministrin e Transportit, me Avdullah Hotin, dhe po më kërkoni llogari mua! Çka po doni, bre? S'po ju vjen marre! Kërkoni prej atij llogari që e ka sjellë gjendjen deri këtu!

KRYESUESI: Faleminderit! Po, Liburn, para se të vazhdojmë dua t'i kërkoj kryeministrin që në Kuvend të flasë ashtu siç flasim ne, sepse ne e kemi një Rregullore, duhet ta përdorë gjuhën parlamentare. Në rast se kryeministri sillet kështu, unë do ta ndërpres seancën. Fjalën e ka deputeti Liburn Aliu.

LIBURN ALIU: E para, çështja e interpelancave - janë dy interpelanca: ne si Grup Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje kemi kërkuar interpelancë, në të njëjtën kohë ka kërkuar interpelancë edhe Grupi Parlamentar i LDK-së. Vendimi i Kryesisë është që i ka fuzionuar bashkë, është vendim i Kryesisë. Por, sa i përket edhe një herë, ku e keni marrë këtë 16,6 milionëshin, në raportin e ministrit Pal Lekaj, thuhet "në fund të muajit nëntor të vitit 2017", në kohën kur ka qenë Pal Lekaj ministër, dhe kryeministër Ramush Haradinaj, e ka sjellë kërkesën, pretendimin prej 63 milionë euro "Bechtel Enka" ku pika e parë zgjatja e projektit që lidhet njëjtë sikur ai 14,7 milionëshi është 16,6.

Kërkesa shtesë është pajisjet 30,8 milionë, dhe ndërprerjet 10 milionë. Të dyja këto janë hedhur poshtë prej kompanisë "Hill", që është jashtëzakonisht vlerësim i rëndësishëm vlerësimi i kompanisë "Hill", sepse është autoriteti sipas kontratës, dhe prandaj unë këtë 16,6 e lidh...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Tani radhën e ka përfaqësuesi i Grupit Parlamentar të AAK-së, kush e dëshiron fjalën? Shkumbin? Po, urdhëro! Shkumbin, i keni 2 minuta e 6 sekonda, sepse i ka marrë minutat kryeministri. Lus regjinë që t'i reflektojë në ekran të madh minutat e grupeve parlamentare.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Faleminderit, kryesues!

Je duke e keqpërdorur pak pozicionin ku je, gjuha parlamentare ishte gjatë gjithë kohës. Konsideroj se me Ramush Haradinaj dhe Pal Lekaj s'mund të shtyhet kurrkush, ne e dimë që kemi pjesëmarrje të vogël në Qeveri, atë s'po e them për t'u shtyrë në atë që ju e transmetoni forcën fizike, por forcën e mendjes, dhe puna që bëhet në këtë qeveri.

S'ka nevojë Ramush Haradinaj për respektin e askurrkujt për të kaluarën se atë e ka bërë me dëshirë për vendin e vet dhe në atë aspektin tjetër që sot Ramush Haradinaj është kryeministër dhe ju pritshmërinë e juaja i keni pritur, por nuk ndodhi ashtu, për atë s'ju vlerësojmë dhe s'kemi nevojë për pritjen e pritshmërive tuaja në opozitë. Këtë kishim mundur, po të kishit dashur edhe pritur për Ramushin, kishit mundur të thoni "ta kemi dhënë votën si kryeministër, dhe je kryeministër si opozitë, puno", por kur e ke kundërshtuar dhe atëherë kur e ke ditur që Ramushi është duke u bërë kryeministër, s'ke të drejtë që të flasësh për vlerat e Ramush Haradinajt.

Tjetra, e them edhe në element tjetër. Sot jemi para një akti tjetër, "Bechtel&Enka", deputetë të nderuar, qytetarë të këtij vendi, nuk është organizatë humanitare. Kjo qeveri e kaluar e zotit Mustafa, që kurrë nuk na thanë këta deputetë as për gjendjen e tij shëndetësore, i cili kurrë nuk ka qenë i sëmurë, përpos ka mundur të ketë diçka, ka shkuar në Gjermani me aeroplan privat, ka paguar 50 mijë euro, është tërhequr me krejt familjen për shkak të kontratave të këqija që i ka bërë ky ministër këtu. Komisioni në ministrinë e tij ka nënshkruar kontrata në orën 23:00. Kur e kanë marrë vesh se kjo qeveri ndodhi, para takimit të seancës së OSHP-së, më 18 janar, më 14 janar është sëmurë Isa Mustafa. Më i miri deklaram deri më tani ka qenë i zotit Besnik Berisha që ka thënë prej gripit, se Isa Mustafa është i vjetër mund t'i bjerë gripi, por prej depresionit dhe prej presionit të keqmenaxhimit...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Ju s'keni më kohë. Grupi Parlamentar i AAK-së nuk ka më kohë. Pra, unë të ju njoftoj që unë po e drejtoj seancën, interpelancën në përputhje me Rregulloren. Gjuha parlamentare kërkohet nga kryesuesi, nga deputetët dhe nga pjesëtarët e Qeverisë. Në rast se kryeministri ose ndonjë nga pjesëtarët e Qeverisë vazhdon me të njëjtën gjuhë, unë do ta ndërpres seancën. Fjalën e ka përfaqësuesi i Grupit Parlamentar të Listës serbe. S'është! Nisma? Shefi i Grupit Parlamentar, Bilall Sherifi. Urdhëro, Bilall!

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ka gati tri orë që po debatojmë për një çështje për të cilën është debatuar në publik shumë më gjatë para se të debatohet këtu në seancë dhe kjo interpelancë është e mirëseardhur së paku për t'u dhënë një mundësi të gjithë atyre, të cilët qoftë kanë qenë të përfshirë në këtë proces në fazën

e kaluar, qoftë këta që janë tash dhe deputetët, qoftë nëpërmjet pikëpamjeve të grupeve të tyre parlamentare apo të deputetëve që veç e veç ta thonë mendimin e tyre.

Unë në cilësinë e kryetarit të grupit, nga ajo çka dëgjova, erdha në një përfundim se ky keqmenaxhim ka filluar shumë më herët dhe duke e pasur parasysh mënyrën qysh funksionojnë kompanitë e mëdha të jashtme, që nuk të falin bash kurrëgjë, ama bash hiç kurrëgjë nuk të falin, na del se një obligim, që u quajt kështu “kosto shtesë” që ka filluar para dy vjetësh, ka shkuar dhe ka degraduar në këto përmasa, të cilat sot i kemi këtu para vetes. Në një mënyrë më erdh mirë që faji apo u lehtësova se mirë nuk më erdh që faji nuk qenka te pjesa profesionale e ministrisë, është një lehtësim se zakonisht keqmenaxhimet bëhen te pjesa profesionale, te mbikëqyrja e hapave të zhvillimit, apo të kryerjes së punimeve.

Kësaj radhe po shihet qartë që me konfirmimin e vet nga disa ministra, të cilët kanë qenë pjesë e Kabinetit, u konfirmua se ka pas zvarritje në Qeverinë e kaluar. Pra, këtu askush nuk po e konteston faktin që embrionin e ka në Qeverinë e kaluar. Kontestet vijnë kur vjen çështja e mënyrës si u trajtua kjo nga ajo qeveri dhe si erdhëm te shuma. Unë këtu shoh konteste dhe ajo që u tha edhe nga disa kolegë, ne shumica e deputetëve jemi të privuar nga mundësia për ta pasur një mendim tonin. Ne duhet të nxjerrim e të ndërtojmë një mendim nga mendimet, nga pikëpamjet, të cilat u thanë nga deputetët, qoftë në cilësinë e ministrave të dikurshëm, qoftë në cilësinë e deputetëve të sotëm. Tash unë do të kisha thënë që kjo nuk është një kontratë ta quaj ashtu “mbi vepër”, deri në 9 900 euro që i jep Qeveria dhe shpeshherë çështjet mund të bëhen edhe pa mbulesë. Unë nuk e di pse ky siklet kaq i madh. Kemi të bëjmë me një kontratë 600 milionë eurosh, aty janë letrat. Dhe, më lehtë se për të ardhur në përfundime të sakta se pse, si filloi, si u zhvillua, si degradoi se në këtë kontratë nuk mund të ketë, për faktin se një auditim krejt i lehtë, profesional, do ta nxirrte në sipërfaqe shkakun, pasojën. Kush ishte shkaktori? Dhe, kush po e merr përsipër pasojën? Le të bëhemi bashkë të gjithë dhe t’i hapim rrugë një auditimi.

Le t’i lëmë “prokuroria, gjykata, hetuesi”. Nuk ka nevojë. Fakti, nëse auditimi dhe ta marrim një kompani më të mirë, qoftë vendore, qoftë të jashtme, që e njeh këtë lëmi, dhe auditorët duhet të kenë ekspertë të këtij lëmi, kemi të bëjmë me një kontratë mijëra faqesh që mendjet e ekspertëve tonë shpeshherë edhe nuk i kuptojnë e lëre më t’i interpretojnë dhe t’i zbatojnë. Pra, le të bëhemi bashkë rreth kësaj ideje që kushdo që mban përgjegjësi për këtë le ta marrë përgjegjësinë nëse nuk është i gatshëm ta marrë vullnetarisht, do ta marrë nga momenti kur auditori, e unë propozoj një auditor të jashtëm në emër të Nismës që të japë zgjidhje, le të na informojë neve deputetëve nesër se pse u shkakua dhe si u shkakua krejt kjo. Nuk mund tash, unë jam i prirë t’i besoj Qeverisë, mazhorancës në të cilën unë bëj pjesë. Ka këtu mënyrë, argumente të cilat u hodhën edhe nga eksponentë të Qeverisë së kaluar, ku shpeshherë u tha “ne po japim fakte në letra, ju s’po jepni asgjë”.

Le ta bëjmë një letër të përbashkët të Auditorit dhe askush, ama bash askush, nuk do të mund pastaj të nxirret duke thënë “unë nuk pata faj po i pati fajet tjetri”. Nëse e kemi përnjëmend, vërtet përnjëmend, që po na dhimbsen këto para, le t’i japim rrugë auditimit. Kur auditimi të vijë me një përfundim, se këtu qëndron, këta janë fajtorët, kjo është e vërteta, ne do të vijmë prapë në Kuvend, do të debatojmë për çështjen në fjalë dhe do të shihet se kush është përgjegjësi për këtë. Le të përfundojë, për mendimin tim, kjo interpelancë me atë lojën “macja - miu”, sepse herë po del në pozicionin e “maces” herë në të “miut” dikush, njëri tjetrin duke e ndjekur dhe le të shkojmë drejt dhënies së një zgjidhjeje. Kaq! Nuk ka më lehtë se kjo.

Pra, kemi të bëjmë me një kontratë 600 milionësh, letrat janë aty, nuk ka mundur para në xhep t’i jepen kurrkujt, të nxirret kesh e t’i jepen e të themi tash “ku i çove, s’po të besoj”. Aty janë letrat, s’ka shans në projekte të tilla të fshihen paratë. Gjurmët janë në 3-4 vende, me sa di unë. Derisa të shkojnë paratë në “Bechtel&Enka” në 4-5 vende duhet të kalojnë ato para dhe kështu e heqim mjegullën edhe brenda neve deputetëve, e heqim mjegullën edhe në raport me opinionin publik, i cili me të drejtë është i shqetësuar, sepse kemi të bëjmë me një shumë që është përafërsisht 10% e kontratës totale. Pra, nuk kemi të bëjmë me 1% e 2%, po me 10%, përafërsisht 10% të kontratës totale.

Le të ecim përpara, të mos e mbajmë peng, të mos e mbajmë të ndarë në ndasi politike edhe publikun, por le t’i japim rrugë profesionalizmit, as Palit, as Lutës, asnjërit, por thjeshtë Auditimit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar 6+, s’është paraqitur askush. Nisma për Kosovën, deputeti Milaim Zeka. Atëherë, kur të të vijë radha Milaim, se tani kalojmë te deputetët sipas kërkesës individuale. Grupi Parlamentar i LDK-së nuk ka minuta, për deputetin Lumir Abdixhiku Lëvizja Vetëvendosje ka dhënë një minutë. Urdhëro, Lumir!

LUMIR ABDIXHIKU: Faleminderit, kryesues!

E falënderoj Lëvizjen Vetëvendosje për këtë minutë!

Besoj se mjafton për të hedhur poshtë të gjitha pretendimet e Qeverisë.

Fillimisht, kërkoj prej Grupit Parlamentar të AAK-së të distancohet prej deklaratave të një kolegut të tyre, i cili në nivelin më të ulët njerëzor hodhi akuza për shëndetin e zotit Isa Mustafa.

E para, në këtë debat parlamentar këtu po mundohet t’i jepet njëfarë figure e frikshme dhe pa shpjeguar fare mirë, se si 14 milionët u bënë 53 milionë dhe në mes 14 milionëve dhe 53 milionëve është diferencë prej 40 milionëve, jo 40 eurove, por 40 milionëve. Frika që po na thuhet këtu është, se kanë mundur të humben edhe 100 milionë euro. Kush po e thotë këtë?

Këtu kam raportin e Palë Lekajt, i cili e citon kompaninë “Hill International” që thotë saktë, se borxhet e Kosovës janë vetëm 16 milionë. Pra, asnjë cent tjetër nuk guxojmë ta japim, jo pse e kemi me qejf, po se kështu e kemi obligimin.

KRYESUESI: Faleminderit, Lumir! Grupi Parlamentar i PDK-së ka një sekondë, me sa po shoh. Kalojmë te deputetët sipas radhës. Fjalën e ka deputeti Sami Kurteshi.

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryesues! Unë e dëgjova krejt diskutimin, natyrisht me shumë kujdes. Nga kjo interpelancë mua po më dalin më shumë pyetje se sa përgjigje.

A janë paguar apo s’janë paguar 53 milionë? Nëse po, atëherë ku janë këto mospërputhje që po dalin këtu? Ne nuk jemi të informuar. Një pyetje është, a është dëmtuar Buxheti i Kosovës apo nuk është dëmtuar? Nëse është dëmtuar Buxheti i Kosovës dhe ka fakte, le të kyçet Prokuroria, edhe kryeministri kërkoi. Shumë e drejtë, meqenëse përgjegjësia politike po mungon, atëherë është e domosdoshme që të caktohet përgjegjësia penale, sepse ky nuk është rasti i parë. Ne po i ikim arbitrazhit, nuk u besojmë institucioneve, as Auditorit. Ne kemi rastin e pasaportave, ne kemi rastin e Telekomit me Z-Mobile edhe dëmtime të tjera që janë bërë me Buxhetin e Kosovës.

Këtu dikush është fajtor edhe është duke fshehur diçka. Ajo që është kryesore, edhe kjo Qeveri, edhe qeveritë e kaluara, kurrë nuk i kanë bërë publike këto kontratat e mëdha që janë me qindra milionë, me miliarda, e ne flasim kot këtu. Prandaj, për mua, disa kontrata, të gjitha kontratat me Bechtel&Enkën duhet të bëhen publike dhe të kyçet prokurori e të caktojë përgjegjësinë penale. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Shqipe Pantina.

SHQIPE PANTINA: Faleminderit, kryesues!

Në fakt, ishte interesante interpelanca e sotme, ndonëse nuk hoqi shumë mjegull mbi atë se kush është përgjegjës, ndoshta edhe fajtor, për këto 53 milionë euro që si po duket do të ikin nga Buxheti i Kosovës panevojshëm.

Përderisa Qeveria aktuale po e akuzon Qeverinë e mëparshme, ajo e mëparshme prapë po e hedh fajin te Qeveria aktuale. Ne na mbetet, ose të vendosim të mos i besojmë asnjëherë, ose të vendosim të jemi të anshëm dhe t’i besojmë atyre që duam t’ua mbajmë anën. Por, për të dalë në shesh e vërteta, kryeministër, duhet të publikohet kontrata. Ne duhet ta shohim kontratën për të gjykuar vet, sepse unë mendoj se në këtë sallë ka edhe deputetë që i lexojnë ato. Dhe, pastaj e nxjerrim vet të vërtetën, pa pasur nevojë të hamendemi se kujt t’i besojmë.

Elementi i parë i një qeverisjeje të mirë është transparencja. Pra, na tregoni pse dhe si erdhi, jo me fjalë deri tash, por na e publikoni kontratën dhe pastaj ne vet e nxjerrim të vërtetën, edhe nëse ajo e vërtetë është ndryshe prej asaj çfarë pretendojnë më herët. E njëjta kërkesë vlen edhe për ish-ministrin Zharku.

Zoti Zharku, ju duhet ta keni një kopje të kësaj kontrate, është e paimagjinueshme që ju të mos e keni, të mos e ruani një kopje. Nëse Qeveria e tanishme nuk e paska vullnetin për ta bërë publike, atëherë bëjeni publike ju dhe hiqeni pra edhe ju fajin prej vetes. Nëse vazhdohet kështu, atëherë ne kemi edhe shembuj të mëhershëm, kryeministër, se çfarë ka ndodhur kur vendimet janë marrë para se të pyetet Kuvendi dhe pastaj janë sjellë ato si vendime të Qeverisë në Kuvend. Veprimet tona janë të mirënjohura, disa prej tyre i kemi bërë edhe bashkë, kështu që është mirë që një shembull i tillë të mos përsëritet, që vendimet para se të merren, ose të paktën para se të ekzekutohen, le të vijnë një herë të diskutohen në Kuvend.

Mendoj se nuk është dashur të pritet, që një interpelancë të thirret nga opozita, Qeveria vet në momentin kur e ka gjetur këtë borxh, siç po pretendohet, në tavolinë, të vinte dhe t'ua bënte të njohur deputetëve dhe pastaj çdo vendim i tyre do të ishte më lehtë i arsyetueshëm, sepse do na thoshit se ua kemi bërë me dije. Sot, ne ende nuk e dimë se në fakt çfarë po ndodh! Pse po i humbim, nëse vërtet po i humbim këta 53 milionë euro dhe kush duhet të japë përgjegjësi? Sepse, në këtë vend dikush duhet të japë ndonjëherë përgjegjësi. Deri tash ajo nuk ka ndodhur, pothuajse fare, por mendoj se çdo gjë fillon diku dhe gjithçka bëhet për herë të parë. Ndoshta, le të bjerë sepse kjo kontratë, që dikush të japë përgjegjësi.

Vërtet, nuk janë 53 euro, as 5 milionë, janë 53 milionë euro. Janë barabar me buxhetin vjetor të Forcës së Sigurisë së Kosovës. Po të mos ia jepnim “Bechtel&Enkës” ato para, ka x-vende tjera tejet të nevojshme, ku do të mund t'i çonim ato para, do të ndërtonim më shumë çerdhe, ndoshta do t'i rregullonim spitalet që i kemi për faqe të zezë.

Të paktën, na e bëni publike kontratën dhe pastaj vendosim ne se ku në të vërtetë qëndron e vërteta. Faleminderit!

KRYESUESI: Urdhëroni, zoti kryeministër, keni 2 minuta e gjysmë.

KRYEMINISTRI: Kohën e Veton Berishës.

KRYESUESI: Po!

KRYEMINISTRI RANUSH HARADINAJ: Shikoni, po çerdhe, po spitale, po për këtë folëm gjithë ditën. Po, për këtë jemi duke treguar se ka qenë e dhembshme, e vështirë dhe jo e lehtë dhe çfarëdo dimensionit tjetër po i japim.

Ju po flisni për kontratë. Më falni, ju që jeni në politikë e dini që nuk e kam nënshkruar unë këtë kontratë. Po, a merr vesh që s'e kam nënshkruar unë, a kuptoni në këtë Parlament? Nuk është kontratë e lidhur prej kësaj Qeverie... prit, prit, prit, një sekondë prit. Ky Parlament ka mundur ta lypë një kontratë të publikuar në atë kohë kur është nënshkruar, para se të nënshkruhet. Kjo Qeveri nuk guxon ta publikojë një kontratë, se shkojmë prapë atje, nën atë arbitrazhin. Jo, a? Ju jeni juriste, ju e Samiu, më tregoni a është ashtu. Më tregoni nëse është ashtu, por nuk guxojmë. Po, se kur është nënshkruar në atë kohë... Urdhëro? Me leje! Më falni veç një sekondë!

Shikoni, ne jse unë po ju siguroj një send, se koha po ec, unë nuk kam ndonjë arsye që mos ta publikoj një kontratë, përkundrazi do ta bëja me vullnetin më të madh, një kontratë me "Bechtel&Enkën" dhe mendoj që një kontratë e tillë është kredibile, është serioze, është nënshkruar prej palëve serioze dhe ekziston qe sa kohë. Pra, të më thuash mua "S'je kah e publikon kontratën e ka diçka behane..." po më habisni pak, ose po e bëni me qëllim për të konfuzuar. Prapë po doni të gjithë të shisni mjegull në këtë vend. Pse s'po e publikuakam unë kontratën, një kontratë që ekziston qe sa vjet? Çfarë zorit paska kjo Qeveri që të mos e publikojë? Një kontratë e kemi lidhur, të mirë a të keqe, për një investim. E kemi bërë publike nen për nen. Nuk është kjo Qeveri që s'po publikon. Po kritikohet për vendimet e veta, se janë transparente, krejt po i keni në dorë.

Asnjë vendim të kësaj Qeverie nuk është që s'e dini, që s'është marrë, që s'e keni (kontratë, shkresë, çdo gjë). Ju kisha siguruar edhe një herë, shikoni, unë e kuptoj shqetësimin e gjithkujt dhe ju tregova nëpër çka kemi rënë edhe nuk e kam pasur qëllimin as të çfarëdo natyre, bile ju siguroj që unë ruaj edhe respekt, edhe për oponentë politikë, edhe ata që... ish-kryeministri Mustafa e të tjerë (thuj oponentë, kundërshtarë...), ruaj respektin, edhe për ata që s'jam me ta, edhe për ata që jam me ta, edhe kundërshtitë. Por ka diçka, ju lutem, është bukur e padrejtë të kujtosh...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit, zoti kryeministër! Blerim tani... minutat e kujt? Sa minuta? Tre minuta Blerim Kuçi të Grupit Parlamentar 6+.

BLERIM KUÇI: Faleminderit, kryesues! Më në fund!

Shiko, unë e shoh tri probleme në këtë çështje që sot jemi duke e debatuar dhe është thirr interpelanca.

E para, pikërisht keqmenaxhimi i ministrisë, ose i Qeverisë ka sjellë një humbje Qeveria e kaluar Kosovës, Buxhetit të Kosovës me dhjetëra milionë eurosh.

E dyta, prolongimi i këtij problemi i ka shtuar edhe disa dhjetëra milionë eurosh. Po ky prolongim është tashmë krim ekonomik, sepse është bërë me vetëdije. Me vetëdije Qeveria e kaluar e ka prolonguar këtë problem, e ka ditur që do të vijë, do të ketë probleme, do të rritet ky borxh edhe e ka prolonguar. A për vota, a për çka, unë nuk e di, por e di që me vetëdije e ka bërë.

Ajo që më çudit, fakti që më çudit shumë, është thirrja e interpelancës prej LDK-së! Duke ditur se është një tendencë me të bë një mbulesë për ta mbuluar krimin. Pra, kjo Qeveria e kaluar në krye me më përgjegjës që ka qenë Lutfi Zharku, ka bërë një krim ekonomik dhe tash nëpërmjet një interpelance po mundohen dhe janë munduar një orë të flasë Lutfi Zharku këtu edhe ta mbulojë krimin. Pra, këtu ka një tendencë përmes interpelancave të mbulohet krimi.

Problemi i tretë është nënshkrimi i një marrëveshje, ose jo nënshkrimi i marrëveshjes, vendim i Qeverisë aktuale me i pagua ato borxhe që janë grumbulluar. Nuk është e vërtetë, që vetëm një element i kësaj kontrate ka kosto buxhetore, vetëm shtyrja e afatit në asnjë rregull të FIDIC-ut nuk shkruan kështu. Ato janë për të hedhur hi syve, sepse nuk qëndrojnë. Çdo shtyrje e kontratës ka efekte anësore, ka kosto shtesë. Pra, zoti Lutfi Zharku nuk ka të drejtë, assesi.

Po ky vendim i kësaj Qeverie aktuale në krye me zotin Haradinaj e ka marrë një vendim dhe është përgatitur ta bëjë pagesën. E bëri një pyetje se a është bërë pagesa. Nuk është bërë. Ne mund sot të marrim një vendim, Kuvendi ka të drejtë të marrë një vendim, që të mos paguhet ato obligime, që të mos paguhet "Bechtel&Enka". Me 61 vota ne mund ta obligojmë Qeverinë që të mos paguajë. Mirëpo, a e kemi atë të drejtë, atë guxim, që të krijojmë pasoja tjera?

KRYESUESI: Faleminderit! Milaim Zeka. Milaim, minutat e kujt i ke? Sa minuta ia keni dhënë? Tre minuta Milaim Zeka në pjesën e Grupit Parlamentar 6+.

MILAIM ZEKA: Faleminderit, kryetar!

Veç s' deshta kështu Dardan Sejdiu më intrigoj kështu të dal. Qe ku e kam kontratën, kjo është kontrata sekrete, që nuk e ka publikuar Qeveria edhe kjo është kontrata e lidhur në mes Bechtel&Enkës dhe Qeverive të kaluara. Sot jam bindur 100% atë që e kam thënë, nuk ka qare pa shkuar në burg, ose Lutfi Zharku, ose Palë Lekaj, sepse me akuzua Ramush Haradinajn për këtë punë, është sikur me i thënë papës së Romës, pse s'po do të bëhesh mysliman? Gjë lidhje nuk ka Ramush Haradinaj me këto 53 milionë.

Për procedura mund të diskutojmë me javë e me muaj, po dola në foltore që t'i bëj thirrje prokurorit të shtetit, krejt çka ka folur Lutfi Zharku sot është për ta çuar 20 vjet në burg Palë Lekajn. Çka ka folur pastaj kryeministri me e çua në burg Lutfi Zharkun. Çka kemi folur ne sot nga ana e kryeministrit dhe e Lidhjes Demokratike të Kosovës është për prokurorin e shtetit, i cili po u hap aktakuza policëve të shkretë e fukarenjve të shkretë për fara të kungujve e për dhjetë euro e nuk merret me këto gjëra.

Ajo që vërtet më vjen gjynah, që ka hyrë në sandwich kësaj radhe, ka rënë në penallti, Lëvizja Vetëvendosje. Në momentin që e keni parë që Lidhja Demokratike bashkë me juve e kanë thirrur këtë interpelancë. Liburn, po të isha në vend tuaj do të isha tërhequr, sepse ju e dini fort mirë që në matematikë dhe në fajin e kriminalistikës nuk ka rëndësi a i vjedh 14,7 milionë apo i vjedh 300 milionë, nuk ka rëndësi a i vret dy vetë të pafajshëm, a i vret 20. Ajo që tha kryeministri, krejt kjo punë është nisur me 14,7 milionë. Sebepe i krejt 53 milionëve është Lidhja Demokratike e Kosovës.

I kam krejt letrat këtu, që i kanë këmbyer e këto letra CC u janë bërë edhe PDK-së, edhe zotit Avdullah Hoti, edhe Blerand Stavilecit. Çdo letërkëmbim që e ka bërë edhe vendimin kur kryeministri nuk ka lejuar vendimin e zotit Zharku, i cili ka lypë me marrë vendim edhe Qeveria. Qeveria ka thënë nuk kemi ne nevojë të përzihemi në kompetencat e Këshillit Ndërmintor. Kaq desha të them. Prandaj, ishalla kemi ndonjë prokurori në këtë vend. Nuk ma ha mendja që do të hapë hetime, kështu do të vazhdojmë të flasim, kur shoferi... jetojmë në një vend, ku shoferi e ka rrogën më të madhe, se mjeku specialist. Faleminderit!

KRYESEUSI: Faleminderit! Liburn Aliu, replikë.

LIBURN ALIU: Deputeti po kërkon që ne të jemi taktikë. Pra, po shohim që paska ardhur disi LDK-ja dhe ne jemi në njëfarë situatë, prandaj ne duhet të jemi taktikë dhe të tërhiqemi. Ne s'jemi fort taktikë, unë nuk jam shumë taktik, nëse e kemi parë shkeljen, s'ka më aty taktikë, aty duhet të thuhet troç gjërat, duhet të flitet dhe këtu është vendi ku duhet të flitet.

Sa i përket publikimit të kontratës, është jashtëzakonisht i nevojshëm publikimi i kontratës, është mirë të bëhet.

Për këtë interpelancë nuk ka qenë domosdoshmërisht për të filluar interpelancë që ta kemi kontratën e publikuar, sepse s'po dimë çka po thuamë, ne e dimë çka po themi. Përpyekja për të thënë pasi që nuk e kemi kontratën e publikuar, diqysh si të relativizohet fajti, kjo nuk qëndron.

Ne i kemi shumë të qarta raportet që janë dhënë dhe i kemi të qarta edhe opinionet prej kompanisë që ne e paguajmë si Qeveri, si shtet, e paguajmë kompaninë, e cila e bënë vlerësimin e punëve të "Bechtel-Enka"...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Lus regjinë që t'i japë minutat e grupeve parlamentare në ekranin kryesor.

Fjalën e ka deputetja Shqipe Pantina.

SHQIPE PANTINA: Tash Milaimi po na sjell para hundëve një dokument që po thotë është kontrata, më vonë mund të dalë edhe dikush tjetër po ashtu ta tundë përpara një dokument tjetër e të thotë se është kontrata. Por ne nuk po e dimë cila është kontrata e vërtetë.

Ne mund të thirremi edhe në këto raporte të “Hill International”, edhe të ministrisë, por këto raporte janë bazuar në një kontratë. Tash, ne nuk po i besojmë as Qeverisë, të cilën e kemi zgjedhur, e cila paguhet prej taksave tona. Pse duhet t’i besohet apriori verbërisht një raporti, pa e ditur se ku po bazohet, pa e parë unë dokumentin bazë, mbi të cilën po bazohet.

Tash kryeministri tha se e ka nënshkruar dikush tjetër atë kontratë dhe ai nuk mund ta publikojë. Nuk është e vërtetë, sepse kryeministri trashëgon edhe përgjegjësitë, po edhe të drejtat dhe tash ka edhe mënyra, nëse paska pjesë të asaj kontrate që qenka konfidenciale, ato mund të hijezohen, por pjesa tjetër mund të bëhet publike.

Dhe, për më tepër, ne mund të mbajmë një seancë të mbyllur për publikun, ku i diskutojmë haptazi, me dokumente përpara, me kontratë dhe mundohemi ta gjejmë përgjegjësinë e vërtetë.

A ka këtu dikush që është përgjegjës, unë nuk besoj më që ka dilema. Çështja është mes Qeverisë së kaluar dhe kësaj Qeverie, kush është përgjegjësi i vërtetë.

Dhe po ashtu sa i përket publikimit të kontratës, ne tashmë e kemi një vendim gjyqësor, i cili i ka dhënë të drejtë kërkuesit të kontratës për të pasur qasje, është fjala për kontratën me të njëjtën kompani, po natyrisht për një projekt tjetër. Kështu që, të paktën, nuk mund të kemi frikë se gjyqësori nesër mund të na fajësojë për bërje publike të një dokumenti.

Dhe, në fund, nuk ka logjikë që një dokument, një kontratë që paguhet para publike në bazë të saj, të mos bëhet publike për atë që e paguan, sepse ne jemi duke paguar “Bechtelin”, ne mund të vejmë kushte, e jo “Bechteli” neve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i LDK-së nuk ka më kohë, po ashtu Grupi Parlamentar i PDK-së, Lëvizja Vetëvendosje i ka 11 minuta e tre sekonda, PSD-ja ka tre sekonda, AAK-ja nuk ka asnjë minutë. Nisma ka 53 sekonda, 6+ tre minuta e 33 sekonda, pa grup pesë minuta e 48 sekonda.

Milaim, i keni 53 sekonda. Urdhëro!

MILAIM ZEKA: Kryetar, desha t’i them Shqipe Pantinës që unë besoj, sepse unë nuk jam paranoik, po Shqipe Pantina është moti në këtë Parlament dhe kurrë s’ka kërkuar të bëhen publike as kontratat e Ferronikelit, as kontratat e rrymës, as kontrata e “Bechtel-Enka”-s prej Morinës e deri këtu.

Dhe krejt sot ky debat po zhvillohet vetëm për vota, për asgjë tjetër. Kjo është punë e Prokurorisë, nuk është punë debati, po hajt s'po kemi çka të bëjmë, se i kanë një milion telashe të tjera qytetarët, e të bëjmë llaf këtu.

Përndryshe, edhe një herë i bëj ftesë prokurorit të shtetit, a Shqipes, si kolege ia jap faqen e parë të kontratës ta fotografojë, Pali, e di se kjo kontratë është, prej Lutfi Zharkut e kam marrë.

KRYESUESI: Faleminderit! Tani ia jap fjalën deputetit Arbër Rexhaj.

ARBËR REXHAJ: Faleminderit, kryesues!

Këtu u tha që ose Lekaj ose Zharku, njëri prej këtyre dyve ose të dytë së bashku do të shkojnë në burg, por pyetja themelore, e në fakt, diskursin do ta ndërroj, do të flas në temë, por megjithatë do të flas për punëtorët, të cilët e kanë humbur jetën në vendin e punës. Pra, kush do të shkojë në burg për këta punëtorë, të cilët pothuajse janë të pambrojtur në çdo kuptim të fjalës dhe po e humbin jetën në punë.

“Bechtel-Enka” merr miliona euro nga ne, ndërsa punëtorët tonë, disa prej tyre humbin jetën gjatë punës, sepse nuk janë të mbrojtur.

Tre punëtorët e vdekur, Valoni, Tafili edhe Afet Pravalia, pra janë tre punëtorë të vdekur gjatë punëve të “Bechtel-Enka”-s dhe deri më tash askush nuk ka dhënë përgjegjësi.

E tash do të flas për një çështje që moralisht edhe si Lëvizje Vetëvendosje, në kuadër të kësaj teme, dëshirojmë që ta sforcojmë edhe si diskurs, edhe si temë.

Para disa ditësh nga një fshat i Prizrenit, Lubizhda, fshati i parë nga rajoni i Kabashit, humbi jetën fatalisht një djalosh 17-vjeçar.

Më lejoni t'ua shpjegoj pak.

Seldin Alija punonte në një moshë të njomë për ta financuar shkollimin e vet, madje shpeshherë ka zëvendësuar edhe të atin e tij kur ka qenë i sëmurë.

Djali i vetëm i familjes Alija vdiq tragjikisht, duke u përpirë nga makina përzierëse e stiroporit.

Po t'i shihnit pamjet e kësaj tragjedie, siç i kam parë unë, një trup i njomë i copëtuar, nuk do të bënit qetësi as si qytetarë të kësaj Republike derisa drejtësia të vihej në vend. Askush në këtë sallë nuk do të donte një fat për djalin e tij si të Seldinit.

Po shumë lehtë djemtë e kësaj Republike mund të bëhen Seldina, e shumë prej tyre në forma të ndryshme veç se janë bërë Seldina.

U pushoftë shpirti në paqe, e ne nuk do të bëjmë paqe, derisa të bëjmë drejtësi për ta.

Respekt pa mbarim për dëshmorët e punës, të cilët kanë qenë të shtypur e të keqtrajtuar edhe në “Bechtel-Enka”, me orarin e punës paguhen pak, tash po flas në përgjithësi, paguhen me vonesa, nuk paguhen fare, në javë punojnë me 60 e 70 orë në vend të 40 orëve, pa pushim javor e mujor, pa pushim vjetor, pa kushte të punës, pa siguri, pa sigurime shëndetësore, pa ambient e strukturë pune të sigurt, shumë prej tyre vdesin, shumë prej tyre lënë gjymtyrët e gjakun në vendin e punës.

Në këtë krizë ekonomike, ku qytetarët tanë po përballen me varfërinë më të madhe në rajon, ku kemi nivel të lartë të papunësisë, ku punëtorët shtypen sistematikisht, edhe ata të sektorin publik, e në veçanti ata privat. Kemi raste si Seldini së fundmi para tij juristi, i cili humbi jetën tragjikisht, sepse punonte në ndërtimtari. Raste të tilla, të cilat i përmenda kemi edhe në “Bechtel-Enka”, kemi edhe në Prizren, në Prishtinë, Pejë, Gjakovë, kudo në Kosovë.

E këso rastesh do të kemi në vazhdimësi derisa punëtori të respektohet si i tillë, të mos përfitohet gjaku, gjymtyrët dhe djersa e tij dhe derisa ndokush këtu të marrë përgjegjësi për këta punëtorë, të cilët na vdesin për çdo ditë.

Po vazhdoj edhe pak. Seldin Alija është fytyra e Kosovës, është pafytyrësia e sistemit, është ndërgjegjja e shitur dhe e vrarë.

Ky shtet duhet të krijojë mekanizmat për mbrojtjen e dinjitetit të punëtorëve, edhe atyre punëtorëve në “Bechtel-Enka” dhe Inspektorati i Punës nuk duhet të korruptohet, ai duhet të jetë në anën e punëtorëve dhe jo në anën e korporatave.

Ky sistem i shtetit të kapur duhet shkullur nga rrënjët, ndryshe do të na i shkulin qytetarët prej vendit, prej vetëdijes.

Ne nuk kemi rrugë tjetër pos ta kthejmë vendin nga njerëzorja, nga e drejta e punëtorëve.

Prandaj, në kushte normale do të bëja thirrje për Qeverinë që të marrë masa urgjente, po ne nuk jemi në kushte normale, ne nuk jemi në kushtin as normal, ne jemi në kushte çnjerëzore. Kryeministri 3 000 euro në muaj, “Bechtel-Enka” 53 milionë, përfshirë bakshishin e rastit, e punëtori pa mbrojtje me 130 euro në muaj.

Prandaj, për Seldinin, për juristin, për punëtorët e vdekur në Prizren, Prishtinë, Pejë dhe gjithë andej në Kosovë, pra ata janë dëshmorët e ndërgjegjes sonë dhe sigurisht që çdo qytetar, çdo njeri me mend në kokë nuk do të ndalej derisa të vihej drejtësia në vend.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Enver Hoti ka tre minuta të Grupit Parlamentar 6+.

ENVER HOTI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kabinet qeveritar,

Është folur shumë në opinion lidhur me këtë çështje dhe me ecurinë se si ka ardhur deri këtu, është mirë që kemi këtë interpelancë këtu dhe mendoj që së paku një pikë sot u konstatua.

U konstatua se pikënisja e këtij problemi është ai 14-milionshi, i cili edhe nga shtruesit, kërkuesit e kësaj interpelance u vërtetua dhe u pranua se është një borxh, i cili ndoshta me fajin e Qeverisë së kaluar është ardhur te ai 16-milionshi, ku e pranon ish-qeveria apo aktorët e ish-Qeverisë. Unë kam pyetjen: pse sot nuk u zbërthe çështja si erdhi deri te kjo çështje? 14-milionshi si ka filluar? Pse ka filluar dhe kush është fajtori? Ta zgjidhim një herë këtë pjesë, mandej shkojmë në pjesën tjetër. U ngritën edhe dilema të tjera që nuk e kemi kontratën. Unë mendoj që kontrata është e kotë t'i kërkohet Qeverisë që të publikohet, sepse mendoj se secili deputet e di rrugën, e ka mundësinë për të shkuar dhe për ta shikuar kontratën dhe për të nxjerrë të gjitha elementet që atyre ose neve na duhen për të trajtuar çështjen, për të ardhur deri te e vërteta. Prandaj, edhe raportet, të cilat disa deputetë i patën përpara, siç është raporti i ministrit të Infrastrukturës, raporti i kompanisë mbikëqyrëse, elementet e tjera, sikurse që u thanë se janë të pavlera derisa nuk e kemi kontratën, por ejani t'i qasemi punës, ta shikojmë kontratën, të marrim këto elemente dhe deri te një mundësi tjetër, e cila do të trajtonte çështjen në themel.

Kryetari i grupit tonë, zoti Sherifi, e dha një propozim që t'i bëhet një auditim ekstra kësaj kontrate, pse jo, mund të bëhet edhe kjo, por Parlamenti nuk po është në gjendje përpos kësaj zhurme, do të thosha, një angazhimi zhurmues këtu, sidomos i pjesës opozitare, nuk po është në gjendje të propozojë një vendim që a duhet të vazhdohet apo duhet që Qeveria ta ndërpresë këtë mundësi të mos paguhet, të mos bëhet pagesa e 53 milionëve dhe cila është rruga, çka i pret institucionet e vendit? Prandaj, janë dy pyetje, mendoj janë kritike që është dashur t'u jepet përgjigjja. Pse ndodhi ai obligim 14 milionë? Qeveria duhet të vazhdojë me pagesën për 53 milionë apo jo? Le t'i marrë këto dy vendime Kuvendit. Një herë le të na sqarohet çështja si erdhi deri te ky 14-milionesh dhe ne t'i ofrojmë Qeverisë një propozim konkret a duhet të vazhdohet apo si duhet të veprohet më tutje me këtë obligim, të cilin tani për tani e bart pjesa e kësaj kontrate. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani ia jap fjalën deputetit Salih Zyba, është i fundit i paraqitur për interpelancë.

SALI ZYBA: Faleminderit, kryesues!

Të dashur qytetarë,

Të nderuar të pranishëm,

Duke dëgjuar përgjegjësit e kësaj gjendjeje, më me dëshirë sot do të isha në një seancë gjyqësore, në cilësinë e dëshmitarit a të dëmtuarit për dëmet që kanë shkaktuar për buxhetin e Kosovës këto kontrata. Më shumë është pyetja dhe vazhdon të jetë pse nuk është publike kontrata? Kush e ndaloi atë?

Ndërsa, marrëveshja për 53 milionë ka qenë pazar me “Bechtel-Enka”-n, duhet të thuhet gjithmonë, ka qenë pazar. Shkaktar i kësaj gjendjeje nëse nuk është Qeveria Haradinaj, pashmangshëm është përgjegjëse sot. Në këtë marrëveshje, në këtë Pazar, u tha se është negociuar dhe ka qenë negociim në mirëbesim, për kryeministrin konkretisht është pyetja: a ka qenë pleqëri, a ka qenë drejtësi? Ndërsa, për gjendjen teknike të autostradës, po dua ta kaloj për shkak të kohës, në shprehjen dhe në dokumente gjithmonë në autostradën Morinë-Prishtinë ua bëj me dije të gjithëve, sepse nuk është autostradë Morinë-Prishtinë, është Morinë-Malishevë, për të vazhduar më pas Fushë-Kosovë, Prishtinë. Janë, sipas “Bechtel-Enka”-s 102 kilometra, prej aty ku ka përfunduar në Malishevë, dy kahet po të llogariten nuk bëjnë 102 kilometra, prandaj gjithmonë kontrata është ruajtur si e fshehur dhe e rëndësishme për ata që kanë vjedhur.

Kemi pasur tri raste me fatalitet, i përmendi kolegu, s’po ndalem te to, po kini parasysht “Bechtel-Enka”, e cila na ka dënuar me penallti 53 milionë për tri jetë njerëzish tanë, qytetarëve tanë, njëra ka qenë 2 mijë euro, njëra 7 mijë e 500 euro si dëmtim për palët. Ka qenë në kushtet e sigurisë, mospunës, prandaj edhe këto përgjegjësi i kemi si Qeveri e si vend. Në 5-kilometërshin e kursyer për tunel “Bechtel-Enka” thotë i kemi kursyer qindra miliona euro Qeverisë. Po e rikujtoj edhe atë kohë, dhe e formuloj një fjali kështu, sepse ministrat Limaj, s’e përjashtoj ministrin Zharku dhe ministrin Lekaj, do të mbahen në mend në histori si ministra të skandaleve në autostrada. Gryka e Kaçanikut, urat, traseja gjarpërore më e gjatë se rruga e vjetër nënkuptojnë se këtu ka qenë qëllim vetëm profiti për kompaninë. 53-milionshi për Qeverinë duhet të ishte ose edhe është në fakt përgjegjësi për dy vjetët e ardhshme, për skemën sociale të 105 mijë të qytetarëve të Republikës së Kosovës. Prandaj, ai negociim, ai mirëbesim për Qeverinë nuk është mirëbesim, por është keqpërdorim i parasë publike. Prandaj, po e lë fjalën edhe për kolegë të tjerë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani është paraqitur deputeti Ismajl Kurteshi. Ismajl, keni tre minuta kohë.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit! Do ta shfrytëzoj vetëm një minutë, sot këtu për tri orë kemi dëgjuar një debat, i cili i ka përngjarë një lojë të ashpër të ping-pongut, duke e hedhur fajin herë në njërin anë, herë në anën tjetër. Por, nëse shumëçka është e paqartë, ajo që është e rëndësishme, është e qartë: buxheti i Kosovës është dëmtuar për 53 milionë dhe faji i takon njëres nga tri qeveritë: Qeverisë që e ka nënshkruar marrëveshjen dhe nuk i ka pasur mjetet e nevojshme për marrëveshje, Qeverisë e cila nuk i ka kryer obligimet gjatë mandatit të saj, domethënë Qeverisë së kaluar, ose kjo Qeveri, e cila po thuhet që nuk i ka respektuar procedurat.

Ajo që duhet të ndodhë është kjo, nuk duhet gjërat të përfundojnë me këtë debat dhe pastaj të heshtet kjo çështje, por duhet të gjendet mënyra që të zbulohen fajtorët e vërtetë dhe fajtorët e vërtetë të dalin para përgjegjesisë dhe të japin përgjegjësi për dëmtimin e buxhetit të Kosovës për 53 milionë euro. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Liburn, kohën e mbetur dëshironi ta shfrytëzoni? Liburn Aliu e ka fjalën!

LIBURN ALIU: Nga gjithë debati, të cilin e patëm sot, unë mendoj që kemi pasur situata interesante, edhe pse shpeshherë është ikur prej fakteve konkrete, faktet konkrete i kemi të gjithë në tavolinë, janë raportet. Është shumë me rëndësi raportin, të cilin e jep kompania mbikëqyrëse, të cilën ne e paguajmë si shtet dhe publikimi i kontratës dhe publikimi i të gjitha të dhënave të tjera janë jashtëzakonisht të nevojshme për të ardhmen. Përndryshe, për këtë debat dokumentacionin që e kemi pasur në tavolinë ka qenë i mjaftueshëm.

Dua po ashtu të përkujtoj që nuk duhet të heq përgjegjësi nga asnjëra qeveri, as nga Qeveria e mëparshme, as nga kjo e tashmja, e as ajo e hershme që e ka bërë kontratën, si kontratë e cila është bërë shpejt e shpejt dhe tipi i kontratës, ku kontraktorit i është dhënë kompetencë e madhe në projektim, duke e pasur mundësinë e përzgjedhjes së korridorit, e ka sjellë sot situatën në të cilën jemi, ku Gryka e Kaçanikut, e cila ka qenë një grykë me vlera natyrore, sot është e dëmtuar tej mase, për shkak se komplet autostrada kalon mes përmes të Grykës së Kaçanikut dhe kjo ka ndodhur për shkak se tipi i kontratës e ka pamundësuar që të zbatohet Ligji i vlerësimit strategjik mjedisor. Pra, asokohe kur është bërë kontrata, është dashur të kihet parasysh që ne kemi ligje, kemi plan hapësinor, ku edhe Ligji i VSM-së, edhe Plani hapësinor i Kosovës janë shkelur, po ashtu dua të përkujtoj që është shkelur edhe Plani rregullativ i lagjes...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit, Liburn! Tani jemi në fund të interpelancës, koha është shpenzuar, ka të drejtë dhe propozuesi për fjalën përfundimtare, ka pesë minuta, meqë janë dy grupe parlamentare bashkë, a dëshiron të flasë vetëm njëri apo të ndani nga 2 minuta e gjysmë?

Liburn, a e doni kohën e plotë apo gjysmën? Dy minuta e gjysmë!

LIBURN ALIU: Atëherë, i tërë debati i sotëm ka sjellë të dhëna të reja. Kur e kemi filluar idenë për këtë interpelancë nuk e kam pasur idenë e përfundimit se te kush do të mbetet, as idenë se kush është më fajtor, është kjo qeverisje apo ajo qeverisje. Po, falë hulumtimeve, për mua sot është mjaft e qartë se deri ku ka arritur puna. Është jashtëzakonisht e nevojshme të konfirmohet një gjë e tillë, që të publikohen dokumentet, pajtohem me një pjesë të deklarimeve që i kemi

pasur sot në lidhje me publikimin e dokumenteve që janë të rëndësishme në lidhje me këtë kontratë dhe kjo është po ashtu edhe pjesë e rezolutës, të cilën e kemi propozuar.

Natyrisht, unë po i lexoj këto pikat e rezolutës, por për këto pikat e rezolutës jam shumë i gatshëm, jemi shumë të gatshëm si Grup Parlamentar që t'i diskutojmë të gjitha me të gjithë, në mënyrë që të rezultojmë tamam me produktivitet.

Pika e parë është që brenda pesë ditëve Qeveria, respektivisht Ministria e Infrastrukturës të sjellë në Kuvend dosjen e plotë, studimin e fizibilitetit për ndërtimin e Autostradës RE6, kontratën me "Bechtel-Enka"-n, pasqyrat e pagesave nga Thesari për çdo këst, letërkëmbimin, kërkesat dhe përgjigjet midis Qeverisë dhe "Bechtel-Enka"-s për borxhin e pretenduar.

Të paraqesë me shkrim menjëherë pas miratimit të kësaj rezolute para Kuvendit të Republikës së Kosovës arsyet e pagesës së 53 milionë eurove shtesë për këtë projekt.

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm të hartojë raport të auditimit për zbatim të kësaj kontrate dhe mbikëqyrjen e saj nga Qeveria e Republikës së Kosovës, Ministria e Infrastrukturës dhe Ministria e Financave.

Qeveria, menjëherë pas miratimit të kësaj rezolute, t'i paraqesë me shkrim Kuvendit të Republikës së Kosovës koston përfundimtare të projektit të autostradës "Ibrahim Rugova".

Qeveria e Republikës së Kosovës të paraqesë në Kuvend raportin e mbikëqyrjes së projektit të autostradës "Ibrahim Rugova".

Qeveria e Republikës së Kosovës të publikojë në faqet zyrtare kontratat dhe dokumentet e plota të këtyre autostradave dhe çdo projekti të tillë, të miratuar nga Qeveria dhe Ministria e Infrastrukturës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i LDK-së, dy minuta e gjysmë, a dëshironi për fjalën përfundimtare? Deputeti Lutfi Zharku!

LUTFI ZHARKU: Faleminderit, nënkryetar!

Deputetë të nderuar,

Do t'i shqyrtojmë rekomandimet së bashku me deputetin Aliu, kurse sa i përket publikimit të kontratës në shkurt apo mars 2017, kjo çështje u rregullua me "Bechtel-Enka"-n, ata kanë dorëzuar draftin, i cili i ka larguar të gjitha dispozitat që i konsiderojnë 'sekret afarist' dhe të njëjtën çdo deputet mund ta ketë, për nevoja të tij, por jo për publikime. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani propozuesi duhet të dorëzojë formalisht tekstin e rezolutës dhe unë pyes shefat e grupeve parlamentare nëse dëshirojnë të bëjnë ekip që të harmonizojnë tekstin apo jo? Avdullah Hoti e ka fjalën!

AVDULLAH HOTI: Një rezolutë u prezantua këtu, nëse ka disponim prej grupeve të tjera parlamentare mund të ulemi bashkë, nëse jo, e nxjerrim atë në votim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i PDK-së, Memli Krasniqi e ka fjalën.

MEMLI KRASNIQI: Unë e dëgjova rezolutën që e lexoi zoti Aliu, edhe duke u nisur prej faktit që kjo interpelancë sot është thirrur për një autostradë që e ka emrin “Arbër Xhaferri”, nuk di çka kërkon në rezolutë autostrada “Ibrahim Rugova”, sepse përndryshe mund ta zgjerojmë rezolutën, i shtimë edhe nja dhjetë tema të tjera. Kështu që mundësia e vetme, besoj, për të pasur njëfarë lloj dakordimi është të takohen përfaqësuesit e grupeve parlamentare dhe të tentojnë të gjejnë harmonizim për pikat që ndërlidhen me subjektin e interpelancës që u diskutua sot. Përndryshe, nuk ma merr mendja që mund të ketë harmonizim nëse tentohet që të futen edhe tema të tjera në një rezolutë që buron prej një interpelance për një temë të caktuar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Po, a do të propozoni dikë ju për...?

MEMLI KRASNIQI: E propozoj Memli Krasniqin.

KRYESUESI: Faleminderit! Glauk Konjufca?

GLAUK KONJUFCA: Po, mesa i dëgjova diskutimet e deritashme, unë jam shumë optimist që ekziston një hapësirë, që grupet parlamentare me përfaqësuesit që i delegojnë të gjejnë një gjuhë të përbashkët deri te formulimi i disa pikave, që do të mund ta merrnin këtu një numër të mjaftueshëm të votave për t’u shndërruar në një rezolutë valide të Kuvendit të Kosovës dhe legjitime, e cila pastaj do të ishte sikur, le të themi, obligative për Qeverinë e Kosovës dhe për ministrin që t’i realizonte ato pika.

Kështu që, unë mendoj se nga Lëvizja Vetëvendosje do të duhej të ishte Liburni, i cili faktikisht në mënyrë profesionale më shumë është marrë me këtë temë. Meqenëse, edhe grupet tjera i dërguan përfaqësuesit e tyre, unë mendoj që fillimisht mund të diskutohet e pastaj të vijmë deri te një tekst përfundimtar i rezolutës, i cili nuk është e thënë që patjetër sot të konkludohet. Me rëndësi është që të ndodhin diskutimet dhe harmonizimet e pastaj votimi nuk është e thënë, që patjetër të ndodh në ditën e sotme.

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i PSD-së, Shqipe Pantina?

SHQIPE PANTINA: Ndonëse ne pajtohemi edhe me tekstin aktual të propozuar të rezolutës, megjithatë nëse ka vullnet për të harmonizuar atëherë propozojmë shefin e grupit parlamentar, Dardan Sejdiu, që të marrë pjesë në këtë grup.

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Muharrem Nitaj.

MUHARREM NITAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Nuk besojmë që pikat e propozuara në këtë projektrezolutë janë bazë për harmonizim. Po duket se debati është përtej këtij 53-milionëshi. Fakti që në pikët e projektrezolutës vendosen edhe pikët që kanë të bëjnë me Autostradën "Ibrahim Rugova", domethënë është komplet jashtë kontekstit. Nëse këto pika do të jenë bazë e harmonizimit, nuk besoj se do të arrihet. Sidoqoftë, ne po e dërgojmë përfaqësuesin tonë, Blerim Kuçin, dhe të shohim. Por, gjasat që të kemi harmonizim më duket që janë shumë të vogla. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar 6+. Tani u paraqit Zafir Berisha, përfaqësuesi i Nismës. Urdhëro, Zafir!

ZAFIR BERISHA: Faleminderit!

Unë mendoj se pikat e prezantuara janë para se të bëhet debati. Debati që u bënë të dhënat, sugjerimet që dolën prej deputetëve, mendoj se komplet e ndryshojnë bërthamën e asaj që zoti Liburn e prezantoi, por sido që të jetë ne shokun Enver e dërgojmë në emër të Nismës.

KRYESUESI: Faleminderit! Albert Kinolli, nga 6+.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuari kryesues!

Ne si Grup Parlamentar 6+ mendojmë se ka nevojë për harmonizim qëndrimesh. E përkrahim këtë iniciativë dhe ne do të marrim pjesë në këtë grup punues për harmonizimin e kësaj rezolute. Ne propozojmë shefin e grupit 6+.

KRYESUESI: Faleminderit, Albert! LDK-ja s'ka propozuar përfaqësues. Avdullah, edhe një herë.

AVDULLAH HOTI: Deputeti Zharku merr pjesë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, propozuesi dhe përfaqësuesit e grupeve parlamentare do të kontaktojnë, që të takohen dhe të përpiqen të harmonizojnë tekstin. Këtu mbyllet kjo pikë e rendit të ditës.

Tani unë më duhet të ju pyes, nëse dëshironi të marrim pauzë, ta ndërpresim krejtësisht seancën apo si? Shefat e grupeve parlamentare, LDK Avdullah Hoti.

AVDULLAH HOTI: Po, ne mund të marrim pauzë së paku 1 orë, ora është 3:30, mendoj deri në 4:30 na duhet një pauzë e pastaj të vazhdojmë prapë.

KRYESUESI: Grupi Parlamentar i PDK-së?

MEMLI KRASNIQI: Ne jemi të gatshëm pas pauzës të vazhdojmë, por mirë është ndoshta të konsultohemi me Sekretarinë dhe me Administratën, se sot na kanë njoftuar që salla e Kuvendit është e prenotuar pas orës 17:00 për diçka tjetër. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, domethënë është pa asnjë funksion që të marrim qëndrime të grupeve parlamentare më tej, se s'mund të vazhdojmë. Unë kam marrë sugjerime nga një numër i kolegëve, që seancën të mos e vazhdojmë nesër për punë të disa angazhimeve që kanë. Unë propozoj që të vazhdojmë të hënën në orën 10:00, nëse pajtoheni ju. LDK-ja.

AVDULLAH HOTI: Ne tanimë kemi marrë njoftim për mbledhje të Kryesisë së Kuvendit për nesër në orën 11:00, kështu që mund ta vendosim aty, që të mos e caktojmë prej sot për të hënën, po qe se dakordohen të tjerët.

KRYESUESI: Në rregull. PDK-ja?

MEMLI KRASNIQI: Unë mendoj që nesër në mbledhjen e Kryesisë do ta caktojmë seancën e javës së ardhshme, sepse ka shumë pika të tjera. Propozimi im do të ishte që mos ta shtyjmë për të hënën, por ta vazhdojmë nesër seancën në ora 11:00. Nuk e di mbledhja e Kryesisë nuk besoj se zgjatë më shumë se gjysmë ore, por pavarësisht deputetët tjerë mund të jenë në sallë për ta filluar seancën.

Propozimi ynë është që të vazhdojmë nesër në ora 11:00 që të mos na mblidhen shumë për javën e ardhshme.

KRYESUESI: Glauk, Lëvizja Vetëvendosje!

GLAUK KONJUFCA: Po, këta tre muaj që i kemi kapërcyer kanë qenë me të vërtetë shumë të vështirë për nga dinamikën e vonuara të punës së Kuvendit dhe kemi pa se çfarë kemi hequr të zitet e ullirit me ato seancat që mbulonin njëra-tjetrën. Kështu që, mezi erdhëm deri te një kohë kur mund ta kapim dinamikën normale të zhvillimit të punëve të Kuvendit. Prandaj, për këtë arsye mendoj që nëse nesër do ta përfundonim këtë seancë do të ishte shumë mirë për ne.

KRYESUESI: Faleminderit! Avdullah, urdhëro, një ndërhyrje, ju kërkoi falje. Po, Frashër, pas Avdullahut.

AVDULLAH HOTI: Kërkoj ndjesë, prandaj unë thash nesër në 11:00, në mbledhje të Kryesisë ta vendosim, sepse nesër Grupi Parlamentar i LDK-së do të jetë në disa aktivitete për përvjetorin e Betejës së Loxhës. Kështu që, pothuajse asnjë deputet i LDK-së nuk do të ketë mundësi fizike të jetë në sallë, prandaj kërkoj mirëkuptim që nesër në Kryesi ta vendosim një datë kur është e përshtatshme për shumicën. Faleminderit!

KRYESUESI: Frashër Krasniqi, PSD.

FRASHËR KRASNIQI: Ne jemi dakord që të mbahet seanca, qoftë nesër, qoftë të hënën, por ajo që e kemi si kërkesë, nëse ka kuorum momentalisht në Kuvend. Nuk e di a është e mundshme proceduralisht apo jo, por do të kishte qenë mirë që të hyjë në votim rezoluta e propozuar prej deputetit Faton Topalli, lidhur me heqjen e kontroleve kufitare për ata që vijnë prej diasporës. Kjo do të ishte mirë të procedohej sa më shpejt. Përndryshe, sa i përket seancës, qoftë të premtën, qoftë të hënën, për ne është në rregull, varësisht si vendosin edhe grupet tjera.

KRYESUESI: Faleminderit, Frashër! Në sallë janë vetëm 48 deputetë, domethënë s'kemi kuorum që të vazhdojmë më tutje.

MUHARREM NITAJ: Zoti kryesues,

Besojmë që për shkak të dinamikave të vonuara, për të cilat po flet kolegu Konjufca, është mirë që ndoshta seanca të vazhdojë nesër në ora 11:00 po qenka problem Lidhja Demokratike e Kosovës, kështu që sido që të jetë ne do ta mbështetim që të ndërpritet seanca sot dhe të vazhdojë në ndonjë ditë tjetër.

KRYESUESI: Faleminderit! Zafir Berisha, Nisma.

ZAFIR BERISHA: Mendoj se seanca duhet të vazhdojë nesër për shumë arsye, por njërin prej tyre po e bëj publike, sepse shpesh po ndodh e veçanërisht nga opozita që po akuzohet pozita për neglizhim të seancave dhe tash nuk është shumë OK, opozita të kërkojë të neglizhojë sepse pastaj po i jep material vetes prapë për të sulmuar, kundërsulm. Mendoj se ne, siç tha edhe Glauku, duhet pak kohën e humbur ta kompensojmë dhe nesër në ora 11:00 mendoj se është ideale të vazhdohet seanca. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Albert Kinolli.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, kryesues!

Duke pasur parasysh që shumica e grupeve parlamentare kanë qëndrim të njëjtë, që nënkupton se janë të pajtimit për të vazhduar seancën nesër, atëherë ne si Grup Parlamentar 6+ mbajmë të njëjtin qëndrim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Unë e hapa këtë, sepse ky është një lloj i mocionit dhe që të vendosim pas deklarimeve duhet të procedojmë me votë, por ne s'kemi kuorum, kështu që të mos ndjek njërin orientim, ose tjetrin, unë mendoj që është më mirë t'ia lëmë Kryesisë nesër që të vendosë për vazhdimin e saj.

MEMLI KRASNIQI: Zoti kryesues,

Qëndrimet e grupeve parlamentare i dëgjuat. Përveç Grupit tuaj Parlamentar që i takoni krejt të tjerët kërkuan të vazhdohet nesër në ora 11:00. Ju po qe se doni, ne ua biem për 5 minuta deputetët, por ju kisha lutur, që për shkak se e keni pozicionin e kryesuesit, mos na impononi qëndrimin e LDK-së në kundërshtim me qëndrimin e krejt grupeve tjera parlamentare.

Këtu përveç Grupi të LDK-së të gjithë kërkuan nesër të vazhdojë seanca nesër në 11:00, jo ta caktojë Kryesia, pozitë dhe opozitë. Ne duam ta vazhdojmë seancën nesër në 11:00, kemi shumë pika të rendit të ditës që na presin, disa prej tyre tepër të rëndësishme. Duam të vijmë nesër në ora 11:00. Nuk mund ta vendosë Kryesia nesër në ora 11:00, sepse në ora 11:00 e ka mbledhjen e vet, por po kërkujmë që ju ta konstatonë që shumica janë për në ora 11:00. Ne nesër si deputetë vijmë pastaj këtu dhe vazhdojmë seancën. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Unë s'po mbështes propozimin e LDK-së, sepse propozimi është për të hënë në origjinë. Unë thash që të jetë pak më neutrale. Atëherë, meqë është mocion lus regjinë dhe deputetët të bëhen gati për votim. Votojmë tash për vazhdimin e seancës nesër në orën 10:00. Votojmë tash!

E përsëris edhe një herë, votojmë mocionin për vazhdimin e seancës nesër në orën 10:00. Lus regjinë dhe deputetët, të votojnë tash, në orën 11:00, më falni, po.

Votojmë tash! Kanë marrë pjesë në votim 2...

A dëshironi të votojmë me dorë? Atëherë, kush është për? Faleminderit! Kush është kundër? Abstenime? Ju lus të presim derisa të marrim rezultatin nga Administrata.

Faleminderit! Kanë marrë pjesë në votim 42 deputetë. Të gjithë janë për. Asnjë kundër, asnjë abstenim, por ky votim është i pavlefshëm për mungesë të kuorumit.

Unë, që të mos jem i anshëm, do të lë që për kohën e vazhdimit të vendosë kryetari i Kuvendit. Faleminderit!

* * *

E premtë, më 6 korrik 2018

Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 5 korrik 2018

Mbledhjen e drejton nënkryetarja e Kuvendit, znj. Myfera Shiniq.

KRYESUESJA: Të nderuar deputetë,

Në sallë janë 77 deputetë, prandaj fillojmë me punimet e seancës.

Pritet harmonizimi i tekstit për interpelancën e kryeministrit të Republikës së Kosovës, zoti Ramush Haradinaj, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar Lëvizja Vetëvendosje dhe Grupit Parlamentar të LDK-së.

Kalojmë në pikën tjetër. Fjalën e ka Memli Krasniqi. Urdhëro!

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, e nderuar kryesuese!

Desha të flas edhe për këtë që sapo e thatë, jemi pajtuar që fillimisht të provojmë ta harmonizojmë tekstin.

Por, unë e mora fjalën për një mocion, duke pasur parasysh që sot është e premtë, një pjesë e deputetëve në konsultë me ta pasdite nuk besoj që do të jenë këtu për shkak të planeve të mëhershme.

Unë e kam një propozim, që pikën e rendit të ditës me numër 14, propozimi i kandidatëve për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës ta vendosim menjëherë në rend të ditës tash, në mënyrë që ky numër më i madh i deputetëve, realisht ta kryejmë këtë pikë të rendit të ditës, sepse pasdite rrezikohet që të mos e kemi kuorumin e mjaftueshëm dhe pastaj kjo pikë, e cila edhe ashtu është vonuar shumë, mund të shtyhet edhe për më tutje.

Kisha shprehur kërkesën që edhe grupet tjera parlamentare ta mbështetin këtë kërkesë timen. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Për këtë propozim duhet një votim formal, ose deklaram i shëfave të grupeve parlamentare.

Grupi Parlamentar i LDK-së, urdhëroni!

LUMIR ABDIXHIKU: Faleminderit, e nderuar kryesuese!

Për shkak të rëndësisë së temës në fjalë dhe për shkak të nevojës për koordinim me deputetët tjerë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, ne nuk e mbështetim këtë propozim. Kërkojmë që pika të mbahet siç është e paraparë në agjendë. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar i Vetëvendosjes, Glauk Konjufca, urdhëro!

GLAUK KONJUFCA: Po shihet këtu, sidomos Lidhja Demokratike e Kosovës, por edhe një pjesë e deputetëve të opozitës nuk janë të pranishëm, kështu që mendojmë që ata do të vijnë gjatë kohës, gjatë seancës, disa prej tyre, dhe pikërisht për këtë arsye unë mendoj se kjo pikë duhet të mbahet ashtu siç është përcaktuar në mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit të Kosovës.

KRYESUESJA: Faleminderit! Prej Grupit PSD, fjalën e ka Dardan Sejdiu. Urdhëro, Dardan!

DARDAN SEJDIU: Në gjuhën turke i bie PDS, vërtet. Faleminderit!

Mendoj që tema e Gjykatës Kushtetuese dhe mbushjes dhe plotësimit të kuorumit të domosdoshëm për punë është një temë e cila duhet trajtuar dhe besoj që sa më shpejt të merremi me temën, aq më mirë do të jemi.

Seanca është paraparë të fillojë në orën 11:00, tani ora është 11:40, kështu që nuk po shoh asnjë arsye, meqë votimi ashtu-kështu merr kohë, kështu që po shoh asnjë arsye të mos fillojmë me këtë temë.

KRYESUESJA: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar AAK, Muharrem Nitaj.

MUHARREM NITAJ: Përtej agjendave dhe interesave individuale, propozimi i shefit të Grupit Parlamentar të PDK-së është shumë me vend. Besoj që është me interes që të shkohet menjëherë në votim, edhe ashtu janë mbi 80 deputetë dhe s'ka asnjë arsye që të shtyhet në një afat kur rrezikojmë ta humbim kuorumin.

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka Sasha Milosavljeviq, nga Grupi SLS.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala predsedavajuća! Mislili ste na SL?

KRYESUESJA: Srpska lista, izvinjavam se!

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Okej, šalim se.

Srpska lista se slaže sa predlogom kolege Krasnićija da prva tačka dnevnog reda današnje sednice bude izbor sudija Ustavnog suda. Hvala!

KRYESUESJA: Hvala vam! Faleminderit!

Nga Grupi Parlamentar Nisma, Bilall Sherifi, urdhëro!

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryesuese!

Po, të gjithë jemi të vetëdijshëm për rëndësinë që ka përmbyllja e kësaj çështjeje, zgjedhja e gjykatësve të Gjykatës Kushtetuese. Ju e dini që këtë çështje kemi marrë edhe qortime publike nga aleatë, miq ndërkombëtarë, prandaj nëse e lëmë për pasdite të jeni të sigurt që shumë deputetë do të ecin nëpër agjendat e tyre private dhe pastaj mund të kemi vështirësi në kuorum dhe të shtyhet për javën tjetër, e me shtyrje pas shtyrjes do të mbetemi ndoshta pa e zgjidhur fare këtë çështje.

Prandaj, meqë deputetët janë këtu dhe procesi i votimit edhe ashtu nuk fillon me minutë e me sekondë, por zhvillohet kah ora 12:00, deri në ora 12:15 të gjithë deputetët që janë afër Kuvendit, madje që mund të jenë edhe në Ferizaj, mund të vijnë se tash autostradë gjithkrah, mund të vijnë në seancë për të marrë pjesë në votim dhe le ta zgjedhim këtë çështje sot, përkatësisht le ta zgjedhim tani. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka shefi i Grupit 6+, zoti Albert Kinolli.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, e nderuar kryesuese!

I nderuar ministër,

Të nderuara kolege dhe kolegë deputetë,

Edhe ne si Grup Parlamentar 6+, duke pasur parasysh peshën dhe rëndësinë e kësaj pike, e cila ka të bëjë me votimin e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, e përkrahim mocionin e propozuar nga shefi i Grupit Parlamentar të PDK-së. Faleminderit!

KRYESUESJA: Të nderuar deputetë,

A shkojmë me votim formal, ose me elektronikë? Me elektronikë.

Së sallë janë 82 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të bëhen gati për votim. Votojmë tash!

Propozimi i zoti Memli Krasniqi.

Kanë votuar 54 deputetë,

Me kartela 54, për 53, kundër një deputet, 58 deputetë kanë votuar. Nuk kalon, vazhdojmë.

Po e përsëritim votimin edhe një herë! Albulena, votoje kundër.

Nuk kalon, vazhdojmë. Shkojmë në pauzë 15 minuta.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,

Po vazhdojmë seancën, regjia ju lutem në qoftë se ka mundësi t'i sinjalizoni kolegët deputetë, ata të cilët janë, të paktën le të vijnë në sallë.

Të nderuar kolegë deputetë, po e vazhdojmë seancën. Paska pasur debat lidhur me mocion procedural. Unë formalisht vetëm po e bëj edhe një herë votimin, pasi e kemi bërë praktikë dhe vazhdojmë në bazë të vendimmarrjes juaj, pastaj vazhdojmë.

Mocioni procedural, Memli Krasniqi ka propozim qenë për ta bartur pikë të parë të rendit të ditës sot në këtë vazhdim të seancës, zgjedhjen e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

Ju lutem, 77 kolegë deputetë janë në sallë. Përgatitemi për votim. Votojmë tash!

2 me dorë, cila është vota juaj? Zoti Simiq, cila është vota juaj? Për! 2 me dorë janë, a? Edhe Sloba, 3 për. Kanë votuar 62 deputetë, 59 në mënyrë elektronike, 3 me dorë. 50 në mënyrë elektronike janë për, edhe 3 me dorë janë, d.m.th. 53 për, 9 abstenime... Futet pikë e parë e rendit të ditës.

Kisha pasur dëshirë, pa vazhduar më tutje, për shkak të sensitivitetit, administrata, a ka mundësi të na e sjellë votimin në mënyrë elektronike dhe të ma verifikojë me dorë? Është punë një a dy minutash. Ndërkohë derisa ta sjellin, le të përgatiten Fatoni, a është këtu? E kemi një pikë, e cila është ngritur si projektrezolutë për ta votuar. Do ta votojmë në ndërkohë.

Faton, a po e lexon edhe një herë? A është harmonizuar tanimë? Po, është harmonizuar, është përkthyer, e lexon zoti Faton Topalli dhe pastaj e votojmë edhe këtë pjesë.

FATON TOPALLI: I nderuar kryesues,

Të nderuara deputete,

Të nderuar deputetë,

Pas propozimit për rezolutë lidhur me kontrollin e mërgimtarëve në kufi, është harmonizuar rezoluta me të gjitha grupet parlamentare, me Lidhjen Demokratike të Kosovës, Partinë Demokratike të Kosovës, Lëvizjen Vetëvendosje, AAK-në, Nismën Socialdemokrate, Listën serbe dhe Grupin Parlamentar 6+.

Unë i falënderoj të gjitha grupet parlamentare për bashkëpunim dhe qasje shumë konstruktive karshi mërgimtarëve.

Tani po e lexoj tekstin e harmonizuar:

REZOLUTË

1. Të reduktohen në minimum procedurat e përditshme të kontrollit të kalimit kufitar për bashkatdhetarët tanë në të gjitha pikat kufitare të Republikës së Kosovës.
2. Hyrja e veturave të bashkatdhetarëve nëpër këto pika kufitare me Republikën e Kosovës të bëhet pa iu nënshtruar kontrollit të domosdoshëm, ndërsa kontrolli i tyre të bëhet me metodën e rastit.
3. Gjatë hyrjes në kufi kontrollohet vetëm posedimi i policave kufitare për makinat, për të siguruar dëmet e mundshme në makina.
4. Heqja e procedurave të rregullta aplikohet për periudhën 15 korrik 2018 - 15 shtator 2018.
5. Të dyfishohen kapacitetet e punës në të gjitha pikat kufitare gjatë periudhës në fjalë.
6. Ministria e Punëve të Brendshme është përgjegjëse për zbatimin e kësaj rezolute.

Kjo rezolutë hyn në fuqi ditën e miratimit në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Kolegë deputetë, përgatitemi për votim. Projektrezoluta është lexuar. Votojmë tash!

70 deputetë janë. Me dorë, a ka dikush? 70 deputetë, 63 për, 7 abstenime. Aprovohet rezoluta.

Ta kini parasysh, ndërkohë situata është kështu në votimin për Gjykatën Kushtetuese. Zoti Slobodan Petroviq, vota juaj në mënyrë elektronike është regjistruar, ta keni parasysh. Do të thotë, është gabim, do të thosha, për arsye se zakonisht deputetët e vërejnë se nuk punon, se nuk ua regjistron. Por, sido që të jetë, janë 61 vota për rezultat, 61 vota janë për, 2 me dorë, 59 në mënyrë elektronike, do të thotë 61 vota. Prapë është valide vendimmarrja.

Zoti Zyba, ky është proces, është vendimmarrja juaj. Vazhdojmë!

Ka të drejtë në fjalë. Urdhëro, zoti Zyba.

SALI ZYBA: Përshëndetje, të gjithëve!

E konsideroj shumë të domosdoshme përsëritjen e votimit, sepse u konsiderua dhe u konstatua se është bërë shkelje.

KRYETARI: Zoti Zyba, të falënderoj shumë, por 61 deputetë kanë votuar. Nuk kam bërë shkelje, në të cilën mund të ngritësh pretendimet, për arsye se iniciativa ime ishte për shkak të sensitivitetit, pikërisht si kryetar Kuvendi ta verifikoj, për aq sa do ta bëj çdoherë, pavarësisht dallimeve partiake që mund t'i kenë grupimet politike.

Zoti Hoti, urdhëroni edhe ju!

AVDULLAH HOTI: Kryetar, faleminderit për fjalën.

Por, para se të vini ju në sallë, ne kishim një proces votimi, në të cilin nuk kaloi.

Nga kryesuesja kërkova që të respektojë vullnetin e deputetëve dhe të procedojë me rendin e ditës. Të kisha lutur, tash e kam fjalën unë, nëse mund të më dëgjosh. Pas saj, presioni i deputetëve të Grupit Parlamentar të PDK-së e detyroi kryesuesen të marrim pauzë për 15 minuta, edhe pse kishte kuorum në sallë për të vazhduar me pikat e tjera.

Ju tash e nxorët në votim. Mënyra se si po procedohet, e kësaj pike në veçanti, pra votimi për Gjykatën Kushtetuese, ta dini të gjithë, ta dinë qytetarët e vendit, është manipulim i shumicës për të çuar përpara kandidatë të caktuar, duke e ditur që nga dita e djeshme, këtu e kam thënë publikisht, që shumica e deputetëve të LDK-së me arsye nuk do të jenë në sallë. Insistimi i kryetarit të Grupit tuaj Parlamentar të PDK-së për të vendosur tash, në këtë moment, këtë pikë, ndërkohë që deputetët e LDK-së janë disa në Pejë dhe disa këtu në Prishtinë, në ceremoni të rëndësishme, për mendimin tim, është manipulim i hapur i shumicës parlamentare këtu për të çuar përpara kandidatë të caktuar.

Unë ju kërktoj që si kryetar i Kuvendit ta keni parasysh ndjeshmërinë e këtij lloj votimi dhe të mos e menaxhoni kështu Kuvendin. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Më lejoni ta sqaroj publikun, por në të njëjtën kohë edhe ju, kolegë deputetë.

Pretendimet e kryetarit të Grupit Parlamentar për votimin është...unë kam vepruar veç në bazë të Rregullores. Për vetë faktin se nuk kanë votuar 61 deputetë, deri në momentin kur nuk votojnë 61 deputetë, votimi pothuajse me aktvendim të Gjykatës Kushtetuese është i paqenë. Kjo është ajo që e ka sjellë vendimmarrjen time, pse të futet edhe këtë herë në votim.

Tash kemi 61 deputetë. Unë edhe po qe se dëshiroj ta ndërroj këtë vendimmarrje me vullnetin politik, nuk mundem. Edhe në qoftë se dëshiroj, të jem shumë i singertë. Edhe po të dua, tash pas këtij votimi, nuk mundem.

Kështu që vazhdojmë.

Në të njëjtën kohë zoti Zyba kërkoi, tash do t'ju sillet në mënyrë elektronike nga administrata, do t'ju vijë në mënyrë të printuar votimi, që ta keni për hir të tejkalimit të çdo mëdyshje në proces. Arsyeja edhe pak, unë isha i pari që kërkova një verifikim të tillë, për arsye se është përgjegjësi institucionale para publikut dhe e bëra me dëshirë, edhe pse nuk isha i obliguar.

Shkojmë më tutje në pikë të rendit. Urdhëroni, zoti Krasniqi, replikë!

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, zoti kryetar!

Mua më vjen keq kualifikimet të cilat zoti Hoti i bëri për mocionin tim, i quajti 'manipulim'. Unë e arsyetove dhe e shpjegova saktësisht arsyen pse kërkova që kjo pikë të vendoset tash, dhe ma marr mendja të gjithë ne këtu, po edhe krejt qytetarët që na përcjellin, e dinë mirë që jo të premtën, po edhe të mërkurën po të jetë, pas pauzës neve na ikin gjysma e deputetëve dhe s'kemi kuorum.

Pika për Gjykatën Kushtetuese, e di secili prej nesh që është tepër e rëndësishme. Ka dështuar procesi herën e kaluar, jemi vonë, është i rrezikuar funksionalizimi i Gjykatës Kushtetuese. Shtyrja për javën tjetër, shtyrja për një javë pas saj neve na rrezikon që kjo punë të shtyhet deri në pambarim. Ne sot e kemi pasur në rend dite kështu-ashtu. Dallimi në kërkesën time për të filluar tash, që është rreth orës 12:00, është dallim prej ndoshta nja katër orësh që kemi mundur ta bëjmë këtë punë në ora 16:00, pasi që do të ishin kryer disa shqyrtime të projektligjeve.

As nuk është e jashtëzakonshme, as nuk është unike kërkesa, është në pajtim me Rregulloren. Shumica e deputetëve janë deklaruar, tashmë është në rend të ditës. Secili prej grupeve parlamentare sot ka mungesa, as grupi i PDK-së nuk është i plotë, asnjë grup sot këtu nuk është i plotë. Nuk ma merr mendja që janë as javën tjetër, kështu që mua më vjen keq nëse kualifikohet si diçka e tillë, por thjesht ishte kërkesa për ta proceduar sa më shpejt me temën më të rëndësishme të kësaj seance. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

14. Propozimi i kandidatëve për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës

Do të lexoj bukur gjatë, mos u mërzitni, po të më kishit lejuar, s'i kisha lexuar, se janë një faqe e gjysmë, po...

Të nderuar deputetë,

Komisioni i posaçëm për shqyrtimin e kandidatëve për emërim në Gjykatën Kushtetuese, në bazë të nenit 6 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese ka zhvilluar të gjitha procedurat e parapara me ligj për përzgjedhjen e kandidatëve për gjyqtarë në Gjykatën Kushtetuese dhe Kuvendit ia ka paraqitur për votim listën e ngushtë me 6 kandidatë, për 3 pozita.

Komisioni në mbledhjen e mbajtur më 22 qershor 2018 në mungesë të procedurave të përcaktuara me Kushtetutë dhe me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese për mënyrën e votimit të kandidatëve, ka propozuar që para fillimit me votim për propozimin e tre kandidatëve për gjyqtarë në Gjykatën Kushtetuese të miratohet procedura e votimit, si në vijim:

- Votimi i kandidatëve për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës bëhet me votim të fshehtë.

- Deputeti i Kuvendit prej 6 kandidatëve për gjyqtarë në Gjykatën Kushtetuese të rekomanduar nga komisioni i posaçëm votohen për tre kandidatë për pozitën e gjyqtarit në Gjykatën Kushtetuese.

- Nëse në votimin e parë asnjëri nga kandidatët nuk e merr numrin e nevojshëm të votave, kandidati që ka marrë më së paku hiqet nga lista dhe votimi përsëritet me pesë kandidatë për tri pozita.

- Nëse në votimin e dytë asnjëri nga kandidatët nuk e merr numrin e nevojshëm të votave, kandidati që ka marrë më së paku vota hiqet nga lista dhe votimi përsëritet me katër kandidatë për tri pozita.

- Nëse në votimin e tretë asnjëri nga kandidatët nuk e merr numrin e nevojshëm të votave, përsëritet konkursi.

Për rastet në vijim komisioni nuk ka propozuar, andaj Kuvendi duhet të deklarohet edhe për rastet në vijim:

- Nëse në votimin e parë vetëm një kandidat e merr numrin e nevojshëm të votave, kandidati që ka marrë më së paku vota hiqet nga lista e votimit dhe votimi përsëritet me katër kandidatë për dy pozita.

- Nëse në votimin e parë vetëm dy kandidatë e marrin numrin e nevojshëm të votave, dy kandidatët që kanë marrë më së paku vota hiqen nga lista dhe votimi përsëritet me dy kandidatë për një pozitë.

- Nëse në votimin vijues asnjëri nga kandidatët nuk e merr numrin e nevojshëm të votave, përsëritet konkursi.

Kërkohet deklarimi i kryetarëve, ose përfaqësuesve të grupeve parlamentare. LDK, Avdullah Hoti.

Avdullah, lexova shumë, s'mund edhe një herë të lexoj. Për procedurë është. Procedura e fundit, është formale.

AVDULLAH HOTI: Për ne ky proces i votimit është i pavlefshëm dhe është bërë tendencioz nga ana e Grupit Parlamentar të PDK-së, kështu që unë nuk kam çka të deklarojmë për këtë, kryetar.

KRYETARI: Partia Demokratike e Kosovës, Elmi Reçica a Memli Krasniqi.

ELMI REÇICA: Faleminderit, kryetar!

Ne e propozojmë deputetin Hajdar Beqa në këtë komision, si zakonisht.

KRYETARI: Një faqe e gjysmë e kam lexuar. Koncentrohuni çka kam lexuar. Janë procedura, të cilat duhet të miratohen në procedura të votimit. Do të thotë, nëse në votimin e parë vetëm një kandidat merr numrin e nevojshëm të votave, kandidati që ka marrë më së paku vota hiqet nga lista dhe votimi përsëritet me katër kandidatë për dy pozita.

Tjetra, nëse në votimin e parë vetëm dy kandidatë e marrin numrin e nevojshëm të votave, dy kandidatë që kanë marrë më së paku vota hiqen nga lista dhe votimi përsëritet me dy kandidatë për një pozitë. Dhe, nëse në votimin vijues asnjëri kandidat nuk e merr numrin e nevojshëm të votave, përsëritet konkursi.

Urdhëro, Elmi Reçica.

ELMI REÇICA: Kërkoj falje, kryetar, juve dhe opinionit, se nuk isha i koncentruar vërtet, këto janë procedura standarde dhe ne i akceptojmë këto si procedura. Faleminderit! Kërkoj falje!

KRYETARI: Lëvizja Vetëvendosje, Albulena Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje e propozon deputetin Arbër Rexhaj.

KRYETARI: Hajdar Beqaj nga PDK-ja futet në protokoll, Arbër Rexhaj, e pranoj edhe këtë, propozoni menjëherë, por në të njëjtën kohë, na duhet veç a i aprovoni këto procedura. Po? Atëherë, po. Zonja Haxhiu, a mundesh vetëm...

ALBULENA HAXHIU: Dakord jemi, sepse i kemi diskutuar edhe në komisionin e posaçëm këto procedura, prandaj edhe jemi dakord.

KRYETARI: Faleminderit! Partia Socialdemokrate, Shqipe Pantina e ka fjalën.

SHQIPE PANTINA: Po, me procedurat pajtohemi, sepse i kemi diskutuar në komision, kurse për komision zgjedhor këtu propozojmë Frashër Krasniqin.

KRYETARI: Faleminderit! Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Daut Haradinaj e ka fjalën.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryetar!

Fillimisht, jemi për procedurat. Ne propozojmë deputetin Shkumbin Demalija, por më lejo veç t'i rikujtoj deputetit në fjalë, ose shefit të grupit Avdullah Hoti, se janë bërë këta LDK-ja si dhelpra: "M'u kall bishti, u kall dynjaja". Domethënë, shumica e ka votuar për, 61 vota, edhe asnjë send nuk ka këtu jashtë Rregullores. Të gjithë deputetët janë këtu të pranishëm.

KRYETARI: Shkojmë te Lista serbe, të lutem!

(Ndërhyrje nga salla)

Jo, ke të drejtë, po s'desha të hyjmë Ke të drejtë, ke të drejtë. Urdhëro, zoti Hoti.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit!

Më lejo të sqaroj edhe një herë për deputetin Haradinaj.

Nuk dua të përdor fjalorin që po përdor ai, sepse po mundohem të rezervohem prej fjalëve të tilla që të mos i sjellim në Kuvend.

Dje e kam kërkuar dhe e kam shpjeguar arsyen pse deputetët tanë nuk janë këtu, edhe prapë e kam respektuar qëndrimin dhe vendimin e kryetarit të Kuvendit që sot seanca të fillojë në orën 11:00. Prapë deputetët kanë ardhur këtu dhe u dakorduar ta vazhdojmë seancën, por insistimi i Grupit Parlamentar të PDK-së që kjo pikë të jetë e para në rend dite, është thjesht manipulim dhe tendencë të çohen përpara kandidatura të caktuara, duke e shfrytëzuar situatën kur deputetët e opozitës nuk janë në sallë. Kjo është e vërteta, zoti Haradinaj.

KRYETARI: Faleminderit. Lista serbe? A, kundër-replikë, zoti Haradinaj.

DAUT HARADINAJ: Meqenëse, zakonisht domethënë opozita po i thotë mazhorancës pakicë, sot i pate të pranishëm numrat edhe i pe, i lexove dhe në demokraci vendos shumica. Kështu që, edhe nesër, edhe një javë po të presim, prapë je pakicë në këtë Kuvend. Faleminderit shumë!

KRYETARI: Faleminderit! Lista serbe, të lutem, zoti Igor Simiq, a më fal, Sasha Milosavljeviq, urdhëro, kërkoj falje.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala predsedniče!

Ja mislim da na početku kolega Memli Krasniqi je lepo objasnio zbog čega je tražio da ova tačka dnevnog reda bude prva na ovoj sednici, da tome ne treba više pridavati pažnju. A mi se slažemo sa procedurom i za člana komisije za izbor sudije Ustavnog Suda ispred Srpske Liste predlažemo Jasminu Živković.

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë, nga Nisma zoti Sherifi, Nisma Socialdemokrate.

BILALL SHERIFI: Faleminderit!

Jemi në rregull me procedurat. Faleminderit!

Albulenën, kolegen deputete, por këtë të Nismës, jo të Vetëvendosjes.

KRYETARI: Faleminderit! 6+, ju lutem, zoti Kinolli!

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Edhe ne si Grup Parlamentar jemi në rregull sa u përket procedurave, ndërsa sa i përket anëtarit për komision, propozohet deputeti Bahrim Shabani.

KRYETARI: Faleminderit. Votojmë në mënyrë formale.

Kush është për? A ka kundër? Abstenim?

Në mënyrë formale janë 71 deputetë, kalon.

Miratohen procedurat e votimit për propozimin e kandidatëve për gjyqtarë në Gjykatën Kushtetuese.

Për zbatimin e procedurës së votimit të fshehtë kërkohet krijimi, po, e kemi krijuar komisionin. Atëherë, komisioni le të zërë vendin, ju lutem! Veç me ngritje dore le të deklarohen për komisionin, vetëm formalisht.

Janë 71 deputetë, ju lutem, atëherë aprovohet, emërohen anëtarët në komisionin votues për propozimin e kandidatëve për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese. Lus komisionin që të fillojë me procedim, ndërsa deputetët do të ftohen të votojnë sipas listës.

A ka mundësi komisioni ta zërë vendin?

...Abdyl Salihu, Adem Hoxha, Adem Mikullovc, Ahmet Isufi, Aida Dërguti, Albin Kurti, Albulena Balaj-Halimaj, Albulena Haxhiu, Ali Lajçi, Allbert Kinolli, Andin Hoti, Anton Quni, Arban Abrashi, Arben Gashi, Arbër Rexhaj, Arbërie Nagavci, Armend Zemaj, Avdullah Hoti,

Bahrim Shabani, Bekë Berisha, Bekim Haxhiu, Besa Baftiu, Besa Gaxherri, Bilall Sherifi, Blerim Kuçi, Blerta Deliu-Kodra, Danush Ademi, Dardan Molliqaj, Dardan Sejdiu, Daut Haradinaj, Donika Kadaj-Bujupi, Doruntinë Maloku-Kastrati, Drita Millaku, Driton Çausi, Driton Selmanaj, Duda Balje, Dukagjin Gorani, Elmi Reçica, Emilija Rexhepi, Enver Hoti, Etem Arifi, Evgjëni Thaçi-Drăgusha, Fadil Beka, Fatmir Xhelili, Fatmire Kollçaku, Faton Topalli, Fidan Rekalio, Fikrim Damka, Fisnik Ismaili, Fitore Pacolli-Dalipi, Flora Brovina, Frashër Krasniqi, Gani Dreshaj, Ganimete Musliu, Glauk Konjufca, Hajdar Beqa, Haxhi Shala, Haxhi Avdyli, Hykmete Bajrami, Igor Simiq, Ilir Deda, Imet Rrahmani, Islam Pacolli, Ismajl Kurteshi, Ismet Beqiri, Jasmina Zhivković, Jelena Bontiq, Kadri Veseli, Korab Sejdiu, Kujtim Shala, Labinot Tahiri, Liburn Aliu, Lirije Kajtazi, Luljeta Veselaj-Gutaj, Lumir Abdixhiku, Lutfi Zharku, Memli Krasniqi, Mërgim Lushtaku, Mexhide Mjaku-Topalli, Milaim Zeka, Miljana Nikoliq, Mimoza Kusari-Lila, Mirjeta Kalludra, Mufera Srbica-Shinik, Muharrem Nitaj, Nait Hasani, Naser Rugova, Naser Osmani, Nezir Çoçaj, Ramiz Kelmendi, Rasim Selmanaj, Rexhep Selimi, Safete Hadërgjonaj, Sala Berisha-Shala, Salih Salihu, Sali Zyba, Sami Kurteshi, Saranda Bogujevci, Sasha Milosavljeviq, Shëmsi Syla, Shkumbin Demaliaj, Shqipe Pantina, Slavko Simiq, Slobodan Petroviq, Sërgjan Mitroviq, Teuta Haxhiu, Teuta Rugova, Time Kadrijaj, Valentina Bunjaku-Rexhepi, Valon Ramadani, Verica Qeraniq, Veton Berisha, Visar Ymeri, Vjosa Osmani-Sadriu, Xhavit Haliti, Xhelal Sveçla, Xhevahire Izmaku, Zafir Berisha, Zenun Pajaziti, Zoran Mojsilović.

Kushdo që nuk është thirrur, që në fakt mendon se nuk është thirrur..., të gjithë i kam thirrur, ose nëse dikush nuk ka votuar, i lus të drejtohen tek kutitë e votimit deri të përfundojë procesi.

Të nderuar kolegë deputetë,

Në mënyrë që të mos shpërndajmë letra çdo kund, Administrata do t'i lërë tash në dy anët e tavolinave për mënyrën e votimit më herët, e kush është i interesuar verifikoni, në dyja anët ta keni parasysh, ku qëndrojnë punonjësit e Administratës.

Ju kisha lutur që për votim të drejtohen të gjithë deputetë, unë do të jem i fundit që do të votojë, pastaj të përmbillet procesi.

A ka deputetë tjetër që është në proces të votimit? A duhet pritur më shumë? A e ka përfunduar komisioni? E përmbylim procesin e votimit, komisioni vazhdon të procedojë. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes plenare e merr kryesuesja, znj. Mufera Shinik.)

KRYESUESJA: Përfaqësuesi i komisioni, urdhëro!

ALBULENA BALAJ-HALIMAJ: Për përzgjedhjen e kandidatëve për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës kanë votuar 97 deputetë, si në vijim:

Safet Hoxha,
Remzie Istrefi-Peci
Shkëmb Manaj
Nexhmi Rexhepi
Safet Hoxha
Remzie Istrefi-Peci
Safet Hoxha
Shkëmb Manaj
Safet Hoxha
Remzie Istrefi-Peci
Shkëmb Manaj
Nexhmi Rexhepi
Safet Hoxha
Remzie Istrefi-Peci
Nexhmi Rexhepi
Remzie Istrefi-Peci
Nexhmi Rexhepi
Safet Hoxha
Remzie Istrefi-Peci
Nexhmi Rexhepi
Remzie Istrefi-Peci
Vigan Qorolli
Safet Hoxha
Remzie Istrefi-Peci
Nexhmi Rexhepi
Safet Hoxha
Emrush Kastrati
Nexhmi Rexhepi
Safet Hoxha
Remzie Istrefi-Peci
Nexhmi Rexhepi
Safet Hoxha
Remzie Istrefi-Peci
Nexhmi Rexhepi
Safet Hoxha
Remzie Istrefi-Peci
Nexhmi Rexhepi
Remzie Istrefi-Peci
Emrush Kastrati
Nexhmi Rexhepi

Safet Hoxha
Remzie Istrefi-Peci
Shkënd Manaj
Remzie Istrefi-Peci
Shkëmb Manaj
Nexhmi Rexhepi
Remzie Istrefi-Peci
Vigan Qorolli
Shkëmb Manaj
Nexhmi Rexhepi
Safet Hoxha
Remzie Istrefi-Peci
Remzie Istrefi-Peci
Shkënd Manaj
Remzie Istrefi-Peci
Emrush Kastrati
Nexhmi Rexhepi
Safet Hoxha
Remzie Istrefi-Peci
Remzie Istrefi-Peci
Shkënd Manaj
Remzie Istrefi-Peci
Remzie Istrefi-Peci
Shkëmb Manaj
Shkëmb Manaj
Nexhmi Rexhepi
Safet Hoxha
Remzie Istrefi-Peci
Nexhmi Rexhepi
Safet Hoxha
Remzie Istrefi-Peci
Nexhmi Rexhepi
Remzie Istrefi-Peci
Vigan Qorolli
Nexhmi Rexhepi
Safet Hoxha
Remzie Istrefi-Peci
Nexhmi Rexhepi
Safet Hoxha
Remzie Istrefi-Peci

Nexhmi Rexhepi
Remzie Istrefi-Peci
Emrush Kastrati
Remzie Istrefi-Peci
Nexhmi Rexhepi
Remzie Istrefi-Peci
Emrush Kastrati
Nexhmi Rexhepi
Remzie Istrefi-Peci
Vigan Qorolli
Remzie Istrefi-Peci
Shkëmb Manaj
Safet Hoxha
Remzie Istrefi-Peci
Emrush Kastrati
Nexhmi Rexhepi
Safet Hoxha
Remzie Istrefi-Peci
Safet Hoxha
Remzie Istrefi-Peci
Vigan Qorolli
Nexhmi Rexhepi
Safet Hoxha
Remzie Istrefi-Peci
Nexhmi Rexhepi
Safet Hoxha
Remzie Istrefi Peci
Remzie Istrefi-Peci
Nexhmi Rexhepi
Safet Hoxha
Remzie Istrefi-Peci
Nexhmi Rexhepi
Safet Hoxha
Remzie Istrefi-Peci
Safet Hoxha
Remzie Istrefi-Peci
Shkëmb Manaj
Nexhmi Rexhepi
Remzie Istrefi-Peci
Emrush Kastrati

Nexhmi Rexhepi
Safet Hoxha
Remzie Istrefi-Peci
Nexhmi Rexhepi
Safet Hoxha
Remzie Istrefi-Peci
Safet Hoxha
Remzie Istrefi-Peci
Shkëmb Manaj
Nexhmi Rexhepi
Safet Hoxha
Remzie Istrefi-Peci
Safet Hoxha
Remzie Istrefi-Peci
Vigan Qorolli
Nexhmi Rexhepi
Safet Hoxha
Remzie Istrefi-Peci
Nexhmi Rexhepi
Safet Hoxha
Remzie Istrefi-Peci
Remzie Istrefi-Peci
Shkëmb Manaj
Nexhmi Rexhepi
Safet Hoxha
Remzie Istrefi-Peci
Nexhmi Rexhepi
Safet Hoxha
Remzie Istrefi-Peci
Nexhmi Rexhepi
Safet Hoxha
Remzie Istrefi-Peci
Nexhmi Rexhepi
Safet Hoxha
Remzie Istrefi-Peci
Safet Hoxha
Nexhmi Rexhepi
Safet Hoxha
Remzie Istrefi-Peci
Safet Hoxha

Shkëmb Manaj
Nexhmi Rexhepi
Safet Hoxhaj
Remzie Istrefi-Peci
Nexhmi Rexhepi
Remzie Istrefi-Peci
Shkëmb Manaj
Nexhmi Rexhepi
Safet Hoxha
Remzie Istrefi-Peci
Nexhmi Rexhepi
Safet Hoxha
Remzie Istrefi-Peci
Nexhmi Rexhepi
Safet Hoxha
Remzie Istrefi-Peci
Nexhmi Rexhepi
Safet Hoxha
Remzie Istrefi-Peci
Nexhmi Rexhepi
Safet Hoxha
Remzie Istrefi-Peci
Nexhmi Rexhepi
Safet Hoxha
Remzie Istrefi-Peci
Nexhmi Rexhepi
Safet Hoxha
Remzie Istrefi-Peci
Nexhmi Rexhepi
Safet Hoxha
Remzie Istrefi-Peci
Nexhmi Rexhepi
Remzie Istrefi-Peci
Vigan Qorolli...
Nexhmi Rexhepi,
Remzije Istrefi-Peci,
Nexhmi Rexhepi,

Safet Hoxha,
Shkëmb Manaj,
Remzije Istrefi-Peci,
Shkëmb Manaj,
Shkëmb Manaj,
Shkëmb Manaj,
Vigan Qorolli,
Safet Hoxha,
Remzije Istrefi-Peci,
Emrush Kastrati,
Nexhmi Rexhepi,
Safet Hoxha,
Remzije Istrefi-Peci,
Remzije Istrefi-Peci,
Nexhmi Rexhepi,
Safet Hoxha,
Remzije Istrefi-Peci,
Nexhmi Rexhepi,
Safet Hoxha,
Remzije Istrefi-Peci,
Nexhmi Rexhepi,
Safet Hoxha,
Remzije Istrefi-Peci,
Nexhmi Rexhepi,
Safet Hoxha,
Remzije Istrefi-Peci,
Nexhmi Rexhepi,
Safet Hoxha,
Remzije Istrefi-Peci,
Remzije Istrefi-Peci,
Shkëmb Manaj,
Safet Hoxha,
Remzije Istrefi-Peci,
Shkëmb Manaj,
Shkëmb Manaj,
Shkëmb Manaj,
Nexhmi Rexhepi,
Safet Hoxha,
Vigan Qorolli,
Nexhmi Rexhepi,

Safet Hoxha,
Remzije Istrefi-Peci,
Nexhmi Rexhepi,
Safet Hoxha,
Remzije Istrefi-Peci,
Nexhmi Rexhepi,
Safet Hoxha,
Remzije Istrefi-Peci,

KRYESUESJA: I falënderoj anëtarët e Komisionit Votues! Kryetari i Komisionit Votus, kryetari i Komisionit për raport, urdhëroni!

HAJDAR BEQAJ: Faleminderit, kryesuese!

Të nderuar deputetë,

Po paraqesim raportin e rezultateve.

Për rezultatet e votimit për propozimin e gjyqtarëve në Gjykatë Kushtetuese të Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 65, pika 11 e nenit 114 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 6 të Ligjit 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të republikës së Kosovës, si dhe nenit 51 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Votues i formuar me vendim të Kuvendit me 6 korrik 2018, në përbërje nga një anëtar përfaqësues të secilit grup parlamentar: Hajdar Beqa PDK, Arbër Rexhaj Lëvizja Vetëvendosje, Frashër Krasniqi PSDK, Shkumbin Demalija AAK, Jasmina Zhivkoviq, Lista Serbe, Albulena Balaj Nisma dhe Bahrim Shabani Grupi 6+.

Në votim kanë marrë pjesë 97 deputetë, të pavlefshme kanë qenë 0 vota. Votat e fituara për kandidatët e propozuar janë:

- Nexhmi Rexhepi ka fituar 63 vota,
- Safet Hoxha ka fituar 64 vota,
- Remzije Istrefi-Peci ka fituar 83 vota,
- Shkëmb Manaj ka fituar 23 vota,
- Vigan Qorolli ka fituar 9 vota,
- Emrush Kastrati ka fituar 8 vota.

Në bazë të Rregullores së votimit dhe shpjegimit që u bë në fillim nga kryetari i Kuvendit, për të marrë mandatin e gjyqtarit kushtetues duhet t'i kemi 2/3-at në shumicën që kanë votuar, do të thotë 2/3-at. Në këtë rast kalon vetëm një kandidat – Remzije Istrefi-Peci, kurse një kandidat hiqet nga lista, Emrush Kastrati që ka fituar 8 vota dhe në garë për raundin e dytë mbeten kandidati Safet Hoxha dhe Nexhmi Rexhepi, Shkëmb Manaj dhe Vigan Qorolli. Mbesin edhe katër kandidatë për dy të zgjedhur. Andaj, tash vazhdojmë me procedurën e dytë, sipas rekomandimit të kryetarit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! E urojmë gjyqtaren e re të Gjykatës Kushtetuese, zonjën Remzije Istrefi-Peci.

Vazhdojnë procedurat Komisioni votues. Futemi në votim menjëherë. Duhet ndërruar listat.

Po vazhdoj me pikat të cilat i kemi, komisioni e vazhdon punën e vet dhe listat ndërrohen.

Urdhëro, zoti Frashër Krasniqi, ka kërkuar fjalën derisa...

FRASHËR KRASNIQI: Një kërkesë prej sekretarisë për shkak të një angazhimi që kemi disa prej deputetëve që jemi në komision me u ndërrua anëtarët e komisionit prej grupeve parlamentare, nëse s'prish punë. Kjo vlen për dy prej nesh, më duket, ose tre.

KRYETARI: Vetëm a kemi kuorum në sallë, më duket që po, se duhet veç votim formal. Atëherë, ma jep propozimin e ndërrimit menjëherë.

FRASHËR KRASNIQI: E propozoj deputeten Shqipe Pantina.

KRYETARI: 65 deputetë. A ka tjetër ndërrim? Hajdar Beqa.

HAJDAR BEQA: Kryetar, faleminderit!

Për shkak edhe të një agjende që e kemi ne do të rrimë e të marrim pjesë në votim, por në komision nëse më lejohet e përfaqëson Partinë Demokratike Evgjenie Thaçi-Dragusha. Faleminderit!

SHKUMBIN DEMALIJA: Edhe nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Rasim Selmanaj më zëvendëson mua.

KRYETARI: Faleminderit shumë! 65 deputetë në sallë janë. A ka mundësi të votojmë në mënyrë formale? Kush është për? Shumica për. A ka kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Atëherë, aprovohet ky ndryshim dhe ky është komisioni i ri në këtë përbërje.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-080 për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian për pjesëmarrjen e Kosovës në programin e Unionit “Konkurrenca e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme”

Komisioni Funkcional për Zhvillim Ekonomik ka shqyrtuar Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes. Ministrin nuk e kemi këtu. Kryetarin e Komisionit Funkcional edhe ajo e ka thënë fjalën e vet. A dëshiron ta arsyetosh apo është i arsyetuar raporti, zonja Sala. A kanë kryetarët e

grupeve parlamentare, ose deputetët, apo shkojmë drejt në votim? Shkojmë drejt në votim për arsye se askush s'u lajmërua.

Duhet 2/3-at e deputetëve për votim. Janë 64 deputetë. Edhe kjo pikë e rendit të ditës mbetet në momentin kur t'i kemi 2/3-at në sallë.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 06/L-079 për efikasitet të energjisë

Komisioni Funkcional për Zhvillim Ekonomik i ka rekomanduar, e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij. Ministrja e Ambientit në emër të ministrit të Tregtisë dhe Industrisë do ta marrë fjalën, të na paraqesë dhe arsyetojë projektligjin. Urdhëro, zonja ministre!

MINISTRJA ALBENA RESHITAJ: I nderuar zoti kryeparlamentar,

Të nderuar deputetë,

I nderuar ministër,

Më lejoni që para jush të prezantoj Projektligjin për efikasitet të energjisë, të cilin e ka hartuar Ministria e Zhvillimit Ekonomik.

Ky projektligj është hartuar duke marrë për bazë të gjitha standardet e Bashkimit Evropian në fushën e efikasitetit të energjisë, me çka Kosova ka bërë një transpozim të direktivës 2012/27 të Bashkimit Evropian, të datës 25 tetor 2012 për efikasitetin e energjisë, si dhe ka krijuar bazë për transpozimin e direktivës 2010/30 të Komisionit Evropian për etiketimin e produkteve të energjisë.

Ky ligj sjell një numër të konsiderueshëm të risive krahasuar me legjislacionin që ka qenë në fuqi deri më tani. Ndër këto risi dhe fusha që rregullon në detaje bëjnë pjesë:

- vendos synimet e Republikës së Kosovës në përputhje me kërkesat e Bashkimit Evropian, sa i përket efikasitetit të energjisë;

- përcakton strukturën dhe përmbajtjen e planit kombëtar të veprimit për efikasitet të energjisë dhe planeve komunale të veprimit për efikasitetin e energjisë, si dokumente kryesore strategjike.

Ky ligj po ashtu përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e Agjencisë së Kosovës për Efikasitet, duke përfshirë detyrat shtesë që rrjedhin nga transpozimi i direktivës së BE-së, në veçanti në monitorimin e përmbushjes së kërkesave të Ligjit për efikasitetin e energjisë si dhe politikave dhe objektivave tjera nacionale. Gjithashtu, themelon fondin e Kosovës për efikasitetin e energjisë, i cili do të shërbejë si një mekanizëm i qëndrueshëm që do të ndihmojë në arritjen e caqeve të Republikës së Kosovës në fushën e efikasitetit të energjisë. Ky fond do të investojë në projektet e

efiçencës, kryesisht në sektorin publik dhe synohet që investimet të kthehen përmes kursimit të energjisë. Gjithashtu, përcakton në mënyrë të detajuar palët e obliguara edhe në sektorin privat e po ashtu, edhe mundësinë që sektori publik të ndërmarrë masa të politikave dhe investimeve me qëllim të arritjes së caqeve që Kosova ka marrë si obligim, duke qenë pjesë e komunitetit të energjisë.

Ky ligj do të shoqërohet edhe me legjislacion sekondar, të cilin Ministria e Zhvillimit Ekonomik është në proces të përpilimit konform akseseve të direktivës evropiane.

Vlen të theksohet se ky projektligj është hartuar me ndihmën e projektit të mbështetur nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë dhe janë konsultuar të gjitha palët e interesit. Përveç kësaj, për tekstin e projektligjit është konsultuar edhe Sekretariati i Komitetit të Energjisë dhe janë marrë për bazë vërejtjet dhe sugjerimet e ekspertëve ndërkombëtarë të kësaj fushe.

Kosova do të përfitojë rreth 10 milionë euro nga Komisioni Evropian në formë granti me hyrjen në fuqi të këtij ligji. Kjo para do të implementohet nga fondi për efiçencën e energjisë. Pjesë e rëndësishme e financimit të projekteve të efiçencës përmes këtij fondi do të jetë edhe Banka Botërore. Kontributi i tyre fillestar parashihet të jetë diku 5 milionë dollarë. Fondi në bashkëpunim me donatorët do të përcaktojë skema të ndryshme të përfitimit. Qëllimi i përgjithshëm është që aktivitete e fondit të përfshijnë të gjitha komunat, edhe pse statusi i tyre financiar për të hyrë në marrëdhëniet kontraktuale me fondin është i ndryshëm.

Prandaj, duke e konsideruar këtë projektligj si mjaft të avancuar dhe i cili është hartuar duke respektuar standardet e Bashkimit Evropian në fushën e efiçencës së energjisë, kërkoj nga ju, të nderuar deputetë, që të votoni për miratimin e këtij projektligji. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zonja ministre! Fjalën e ka zonja Sala Berisha-Shala në emër të Komisionit Funkcional.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Përshëndetje ministre dhe ministër që jeni të pranishëm!

Të nderuar kolegë dhe kolege deputetë,

Komisioni Parlamentar për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, në bazë të nenit 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit në mbledhjen e mbajtur më 12 qershor 2018, ka shqyrtuar në parim Projektligjin nr. 06/L-079 për efiçencë të energjisë.

Komisioni pas shqyrtimit në parim vlerësoi se projektligji plotëson kushtet e parapara në nenin 54 të Rregullores së Kuvendit dhe i rekomandon Kuvendit për miratim në parim.

Në qoftë se më lejohet edhe në emër të grupit e kisha shfrytëzua rastin të flas, zoti kryetar.

Atëherë, po vazhdoj në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar dhe ka analizuar Projektligjin për efikasitet të energjisë. Me këtë projektligj përcaktohen kornizat ligjore të domosdoshme për promovimin dhe përmirësimin e efikasitetit të energjisë në Republikën e Kosovës, me qëllim të përcaktimit të caqeve të efikasitetit të energjisë dhe arrijen e atyre caqeve në zbatim të planeve të veprimit për efikasitet të energjisë, zhvillimin e tregut të shërbimeve energjetike dhe masat tjera të efikasitetit të energjisë. Elementet kryesore të politikës së propozuar nëpërmjet këtij projektligji përfshijnë aktivitetet që kanë për qëllim zvogëlimin e intensitetit energjetik në ekonominë kombëtare dhe që i kontribuojnë zvogëlimin të ndikimit negativ në mjedis të aktiviteteve që ndërlidhen me sektorin e energjisë.

Ky projektligj është në përputhshmëri me dispozitat e direktivave të BE-së që kanë të bëjnë me rregullat e përbashkët për promovimin dhe përmirësimin e efikasitetit të energjisë, të energjisë në shtetet kontraktuese të komunitetit të energjisë, ku edhe Kosova është pjesë e komunitetit të energjisë.

Ky projektligj kryesisht përmban dispozitat për politikën e efikasitetit të energjisë, planin kombëtar të veprimit për efikasitet të energjisë, planet komunale të veprimit për efikasitet të energjisë, strategjinë e renovimit të ndërtesave publike, auditimet e energjisë dhe sistemet e menaxhimit të energjisë, shërbimet e energjisë, promovimin e efikasitetit në ngrohje dhe në ftohje, etiketimin e energjisë, detyrat dhe përgjegjësitë e Agjencisë së Kosovës për efikasitet të energjisë dhe themelimin e fondit për efikasitet të energjisë.

Vlen të theksohet se risi në këtë projektligj është krijimi i bazës ligjore për themelimin e Fondit të Kosovës për efikasitet të energjisë, si entitet autonom dhe i qëndrueshëm, për të mundur që Kosova të arrijë objektivat e saj për efikasitet të energjisë përmes promovimit, mbështetjes dhe/ose zbatimit të masave të efikasitetit të energjisë si dhe tërheqjes me menaxhimit të burimeve financiare për të financuar dhe zbatuar projektet e investimeve në fushën e efikasitetit të energjisë në mënyrë të qëndrueshme.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës kontributin e vet do ta japë gjatë fazës së amendamentimit të këtij projektligji.

Ju ftoj ta votoni, të nderuar kolegë deputetë! Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Tani është radha e përfaqësuesve të grupeve parlamentare, vetëm Liburn Aliu është nga Lëvizja Vetëvendosje. Urdhëro!

LIBURN ALIU: Si grup parlamentar do ta mbështesim, do ta votojmë këtë ligj. Është jashtëzakonisht ligj i rëndësishëm dhe i nevojshëm.

Ajo çka do të sugjeroja është që kur bëhet fjalë për skemat obligative, mendoj që duhet të shikohet edhe një herë gjatë punës në komision që të mos ndikojmë në çmimin e energjisë elektrike, duke i ngarkuar tash operatorët, pra të mos kemi ndikime në rritjen e çmimit të energjisë elektrike.

Po ashtu ajo çka do të doja të shtoja është që jam dakord me investimet dhe me programet, të cilat ndikojnë në rritjen e efijencës, pra në zvogëlimin e humbjeve energjetike kur bëhet fjalë për ndërtesat publike.

Do të doja që me këtë projektligj t'i kushtoj vëmendje sektorit privat, nëse do t'i kishim kushtuar vëmendje të mjaftueshme sektorit privat, atëherë do të mund t'i arrijmë kërkesat, të cilat na përcaktohen nga direktivat e BE-së. E dimë që traktati i Vjenës që së shpejti do ta ketë mbledhjen do t'i ketë edhe kuotat e reja që do të na përcaktohen. Unë mendoj që do ta kemi të vështirë t'i arrijmë ato, duke pasur në vëmendje vetëm sektorin publik, pra ndërtesat publike.

Mendoj që duhet të kemi program të subvencionimit tek objektet private që qytetarët të kenë mundësi të investojnë në efijencë të energjisë dhe shteti të subvencionojë një pjesë.

Unë besoj që brenda pak vjetësh ky subvencionin do të kthehej në nivelin e përgjithshëm dhe po ashtu ky subvencionim do të ndikonte edhe te kompanitë vendore, private dhe do të ishte qarkullim i brendshëm dhe përgjithësisht do të kishim edhe zhvillim të kësaj veprimtarie.

Me zhvillimin e kësaj dhe uljen e përgjithshme të çmimeve që do të ndikonte ky investim, atëherë do të kishim edhe interesim shumë më të madh të qytetarëve që të investonin në efijencë.

Unë mendoj se çfarëdo lloj investimi në sektorin privat përmes Qeverisë, pra përmes një fondi të veçantë, do të ndikonte në zinxhirin e vazhdueshëm të interesimit të qytetarëve dhe të sektorit privat në efijencë.

Përndryshe, dakord jam që edhe te sektori publik, te ndërtesat publike të investohet, për atë të ketë edhe fonde, por kjo nuk do të jetë e mjaftueshme për të arritur në kuotat, të cilët neve na përcaktohen nga Bashkimi Evropian.

Përndryshe, ne prapë e votojmë, po do të përpiqemi që në komision të japim mendimi tonë. Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Mimoza Kusari-Lila e ka fjalën.

MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit, kryetar!

Gjithashtu konsiderojmë që Ligji për eficiencën e energjisë është tepër i rëndësishëm dhe i domosdoshëm për stabilizimin e situatës së përgjithshme dhe ruajtjen e energjisë.

Megjithatë, ne edhe në komision e kemi ngritur çështjen e fondit që parashihet me nenin 24, themelimin e Fondit për eficiencë të energjisë.

Në kuadër të këtij neni parashihet që shteti i Kosovës të themelojë një entitet të pavarur dhe autonom e të qëndrueshëm, për të mundësuar që Qeveria e Kosovës t'i arrijë objektivat.

Megjithatë, në kuadër të kësaj pavarësie nuk paraqitet asnjë lidhje e këtij entiteti, gjegjësisht të këtij fondi me strukturën qoftë të buxhetit apo me ligjet në fuqi në Kosovë.

Ajo çfarë është kërkuar dhe çfarë duhet të punohet edhe me donatorët, në këtë rast Bankën Botërore dhe Komisionin Evropian, është të gjendet forma e strukturimit të mirëfilltë në kuadër të Ligjit për shërbimin civil për fondin, përgjegjësitë e fondit dhe natyrisht, për strukturën e brendshme të fondit, gjithashtu formave dhe të paraqitjes së politikës së investimeve parashihet që Bordi të miratojë, përderisa në kuadër të ligjit është e paraparë që Bordi i drejtorëve përbëhet nga shtatë anëtarë të emëruar nga ministrat e ministrive përkatëse, ndërsa në kuadër të emërimeve janë disa kufizime politike.

Përvoja e deritashme ka treguar se emërimet e tilla gjithmonë do të kenë lidhshmëri politike të ministrave, kushdo që janë në detyrë.

Prandaj, edhe në këtë element, gjegjësisht të krijimit të menaxhimit apo strukturës së Bordit të drejtorëve të përcaktohen politika të tjera, të cilat do të mundësonin një pavarësi apo një integritet më të madh të fondit për energji eficiente.

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Visar Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit!

Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Të nderuar qytetarë të Republikës,

Është jashtëzakonisht e rëndësishme që po e diskutojmë këtë ligj sot dhe mendoj që mbase është dashur ta diskutojmë në kushte pak më ndryshe se sa në mes të dy votimeve për Gjykatën Kushtetuese, po sido qoftë, ky ligj është shumë i kompletuar, e merr shumë më seriozisht çështjen e eficiencës së energjisë se sa e ka pasur ligji i kaluar, i cili, në mos gabofsha, është

votuar dhe është në zbatim prej vitit 2011 në Republikën e Kosovës. Atëherë më kujtohet e patëm bërë një ligj vetëm sa për sy e faqe, me shumë mungesa, disa prej të cilave janë plotësuar në këtë ligj që po e diskutojmë tash, veçanërisht çështja e financimit, fondit që themelohet këtu, pra një fond, i cili do ta nxiste investimin e rritjen e shfrytëzimit eficient të energjisë nëpër objektet tona dhe në përgjithësi në sistemin tonë energjetik.

Dhe, e dyta, që ky ligj e ka ndryshuar prej të kaluarit është që është zgjeruar edhe në sektorin privat, për sa kohë që i pari ka qenë gati obligativ vetëm për sektorin publik, sepse kjo është një çështje jashtëzakonisht e rëndësishme që ka të bëjë me çështjen e mjedisit, por edhe me rritjen e një mirëqenie ekonomike për qytetarët e Republikës së Kosovës, e një përdorimi të qëndrueshëm të resurseve energjetike që i ka Republika e Kosovës.

Ne si grup parlamentar, natyrisht, e përkrahim ligjin dhe ato vërejtjet tona e amendamentimet eventuale propozimet për këtë ligj do t'i drejtojmë kah Komisioni për Zhvillim Ekonomik.

Po vetëm dy gjëra dua t'i them këtu sa i përket edhe ligjit, edhe fushës.

Së pari, fondi për rritjen e efijencës së energjisë që parashihet të themelohet me këtë ligj është i mirëseardhur, mirëpo duhet që edhe rregullimi i tij, e veçanërisht synimi i tij afatgjatë të merret me kujdes dhe të trajtohet ashtu edhe siç u përmend nga disa prej deputetëve që folën më herët, në mënyrë që ky fond të jetë jo vetëm për të arritur efijencën e energjisë eventualisht nëpër objektet publike, po për ta nxitur investimin në rritjen e shfrytëzimit efikas të energjisë edhe nëpër sektorin privat, veçanërisht te ndërtimet e reja, e veçanërisht te ato të banimit kolektiv, që i kemi parë të jenë ndërtuar shumë ta zëmë në Republikën e Kosovës në periudhën e pas luftës, e të cilat madje e asnjë auditim të mirëfilltë të shfrytëzimit të energjisë nuk e kanë pasur, e lëre më investime në ndërtim që do të kishte shfrytëzim eficient të energjisë elektrike.

Ky fond, i cili po themelohet tash, do të ishte një prej fondeve ose një prej portofolieve, do të thosha ashtu, të një Banke Investive publike, ose publiko- private që domosdoshmërisht duhet të themelohet në Republikën e Kosovës dhe përmes së cilës ne do të investonim nëpër sektorë të ndryshëm të industrisë në Republikën e Kosovës e në ekonomi në përgjithësi, në mënyrë që të kemi zhvillim të qëndrueshëm të ekonomisë. Praktikisht, një prej mbase përvojave gati më të mira në këtë drejtim mund ta shohim nëpër vende të ndryshme skandinave, e veçanërisht në Republikën Federale të Gjermanisë, në të cilën përmes Bankës publike, e cila investon edhe në Kosovë, është ndihmuar jashtëzakonisht shumë rritja e investimeve, veçanërisht në sektorin privat, për sa i përket përgatitjes ose kalitjes së objekteve për një menaxhim efikas të energjisë elektrike.

Në këtë drejtim, konsideroj që fondi, i cili po themelohet tash, duhet ta ketë jashtëzakonisht të precizuar mirë mënyrën se si financohet, por edhe rregullimin edhe vendimmarrjen përbrenda

këtij fondi, në mënyrë që ky synim i arritjes së caqeve për sa i përket efijencës së energjisë të ketë sukses për planifikimin, për të cilën po flasim dhe të cilën e kemi.

Ne deri tash kemi pasur formalisht edhe plane strategjike për të arritur një shfrytëzim më eficient të energjisë elektrike, po disa prej tyre nuk janë zbatuar për shkak të mungesës së mekanizmave edhe financiare, edhe institucionalë që garantojnë zbatimin e tyre.

Dhe çështja tjetër është që duhet të ketë shumë më shumë ndihmues sa u përket pushteteve lokale, komunave në Republikën e Kosovës, në mënyrë që edhe komunat e Republikës së Kosovës ta kenë komponentin e energjisë ose të energjisë efijente shumë më të zhvilluar, ashtu siç do të duhej ta kishin, edhe ashtu siç parashihet edhe me këtë ligj, po siç është paraparë edhe në ligjin aktual.

Përfundimisht, Grupi i Partisë Socialdemokrate e voton këtë ligj dhe presim që amendamentet tona që do t'i dërgojmë në Komisionin për Zhvillim Ekonomik të merren parasysht, në mënyrë që ligji të bëhet më i mirë dhe më i zbatueshëm për Republikën e Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Atëherë, nuk ka deputetë të paraqitur, përfaqësuesi i Qeverisë nuk e ka kërkuar fjalën.

Përfundon çështja e debatit për këtë projektligj.

Të nderuar kolegë deputetë,

Para se të vazhdojmë në procedimin në votim, unë kisha dashur të rikthehem prapë në votim të asaj të cilën e patëm më herët, në mënyrë që ta mbajmë një radhë të procedurës së votimit.

Komisioni të zërë vendet për Gjykatën Kushtetuese.

Le të kthehet komisioni dhe të shkojmë në votim për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese. Komisioni, ju lutem, zini vendet, deputetët le të kthehen në seancë, votimi është shumë me rëndësi.

Komisioni po e shoh ka zënë vend, shkojmë në votim:

Abdyl Salihu, Adem Hoxha, Adem Mikullovc, Ahmet Isufi, Aida Dërguti, Albin Kurti, Albulena Balaj-Halimaj, Albulena Haxhiu, Ali Lajçi, Albert Kinolli, Andin Hoti, Anton Quni, Arban Abrashi, Arben Gashi, Arbër Rexhaj, Arbërie Nagavci, Armend Zemaj, Avdullah Hoti, Bahrim Shabani, Bekë Berisha, Bekim Haxhiu, Besa Baftiu, Besa Gaxherri, Bilall Sherifi, Blerim Kuçi, Blerta Deliu-Kodra, Danush Ademi, Dardan Molliqaj, Dardan Sejdiu, Daut Haradinaj, Donika Kadaj-Bujupi, Doruntinë Maloku-Kastrati, Drita Millaku, Driton Çausi, Driton Selmanaj, Duda Balje, Dukagjin Gorani, Elmi Reçica, Emilija Rexhepi, Enver Hoti, Etem

Arifi, Evgjëni Thaçi-Drăgusha, Fadil Beka, Fatmir Xhelili, Fatmire Kollçaku, Faton Topalli, Fidan Rekalieu, Fikrim Damka, Fisnik Ismaili, Fitore Pacolli-Dalipi, Flora Brovina, Frashër Krasniqi, Gani Dreshaj, Ganimete Musliu, Glauk Konjufca, Hajdar Beqa, Haxhi Shala, Haxhi Avdyli, Hykmete Bajrami, Igor Simiq, Ilir Deda, Imet Rrahmani, Islam Pacolli, Ismajl Kurteshi, Ismet Beqiri, Jasmina Zhivković, Jelena Bontiq, Kadri Veseli, Korab Sejdiu, Kujtim Shala, Labinot Tahiri, Liburn Aliu, Lirije Kajtazi, Luljeta Veselaj-Gutaj, Lumir Abdixhiku, Lutfi Zharku, Memli Krasniqi, Mërgim Lushtaku, Mexhide Mjaku-Topalli, Milaim Zeka, Miljana Nikoliq, Mimoza Kusari-Lila, Mirjeta Kalludra, Mufera Srbica-Shinik, Muharrem Nitaj, Nait Hasani, Naser Rugova, Naser Osmani, Nezir Çoçaj, Ramiz Kelmendi, Rasim Selmanaj, Rexhep Selimi, Safete Hadërgjonaj, Sala Berisha-Shala, Salih Salihu, Sali Zyba, Sami Kurteshi, Saranda Bogujevci, Sasha Milosavljeviq, Shëmsi Syla, Shkumbin Demaliaj, Shqipe Pantina, Slavko Simiq, Slobodan Petroviq, Sërgjan Mitroviq, Teuta Haxhiu, Teuta Rugova, Time Kadrijaj, Valentina Bunjaku-Rexhepi, Valon Ramadani, Verica Qeraniq, Veton Berisha, Visar Ymeri, Vjosa Osmani-Sadriu, Xhavit Haliti, Xhelal Svejçla, Xhevahire Izmaku, Zafir Berisha, Zenun Pajaziti, Zoran Mojsilović.

KRYETARI: Kush ka mbetur pa thirrur ose çdo deputet le t'i drejtohet kutisë së votimit, në mënyrë që të kryejmë procesin zgjedhor. Faleminderit!

Atëherë, kam sinjalizim nga Komisioni votues, mbyllet procesi i votimit. Fillon hapja e kutisë dhe numërimi. Faleminderit!

* * *

ALBULENA BALAJ-HALIMAJ: Për përzgjedhjen e kandidatëve për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, për dy gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës kanë votuar 92 deputetë në rundin e dytë dhe votat janë, si në vijim:

Safet Hoxha,
Nexhmi Rexhepi,
Safet Hoxha,
Shkëmb Manaj,
Safet Hoxha,
Nexhmi Rexhepi,
Nexhmi Rexhepi,
Vigan Qorolli,
Nexhmi Rexhepi,
Shkëmb Manaj,
Nexhmi Rexhepi,
Safet Hoxha,

Nexhmi Rexhepi,
Safet Hoxha,
Nexhmi Rexhepi,
Nexhmi Rexhepi,
Vigan Qorolli,
Safet Hoxha,
Nexhmi Rexhepi,
Shkëmb Manaj,
Safet Hoxha,
Shkëmb Manaj,
Safet Hoxha,
Nexhmi Rexhepi,
Nexhmi Rexhepi,
Vigan Qorolli,
Safet Hoxha,
Nexhmi Rexhepi,
Safet Hoxha,
Nexhmi Rexhepi,
Safet Hoxha,
Nexhmi Rexhepi,
Shkëmb Manaj,
Shkëmb Manaj,
Safet Hoxha,
Safet Hoxha,
Nexhmi Rexhepi,
Nexhmi Rexhepi,
Vigan Qorolli,
Safet Hoxha,
Safet Hoxha,
Safet Hoxha,
Nexhmi Rexhepi,
Safet Hoxha,
Nexhmi Rexhepi,
Safet Hoxha,
Nexhmi Rexhepi,
Shkëmb Manaj,
Shkëmb Manaj,
Safet Hoxha,
Shkëmb Manaj,
Safet Hoxha,

Nexhmi Rexhepi,
Safet Hoxha,
Nexhmi Rexhepi,
Safet Hoxha,
Nexhmi Rexhepi,
Safet Hoxha,
Vigan Qorolli,
Safet Hoxha,
Nexhmi Rexhepi,
Safet Hoxha,
Nexhmi Rexhepi,
Nexhmi Rexhepi,
Shkëmb Manaj,
Safet Hoxha,
Nexhmi Rexhepi,
Shkëmb Manaj,
Nexhmi Rexhepi,
Shkëmb Manaj,
Safet Hoxha,
Nexhmi Rexhepi,
Safet Hoxha,
Nexhmi Rexhepi,
Safet Hoxha,
Nexhmi Rexhepi,
Safet Hoxha,
Nexhmi Rexhepi,
Shkëmb Manaj,
Safet Hoxha,
Nexhmi Rexhepi,
Safet Hoxha,
Nexhmi Rexhepi,
Safet Hoxha,
Nexhmi Rexhepi,
Safet Hoxha,
Nexhmi Rexhepi,
Safet Hoxha,
Shkëmb Manaj,
Nexhmi Rexhepi,
Safet Hoxha,
Nexhmi Rexhepi,

Safet Hoxha,
Nexhmi Rexhepi,
Safet Hoxha,
Nexhmi Rexhepi,
Safet Hoxha,
Shkëmb Manaj,
Safet Hoxha,
Nexhmi Rexhepi,
Safet Hoxha,
Nexhmi Rexhepi,
Safet Hoxha,
Nexhmi Rexhepi,
Safet Hoxha,
Nexhmi Rexhepi,
E pavlefshme,
Nexhmi Rexhepi,
Vigan Qorolli,
Safet Hoxha,
Nexhmi Rexhepi,
Safet Hoxha,
Nexhmi Rexhepi,
Safet Hoxha,
Nexhmi Rexhepi,
Safet Hoxha,
Nexhmi Rexhepi,
Safet Hoxha,
Nexhmi Rexhepi,
Safet Hoxha,
Nexhmi Rexhepi,
Safet Hoxha,
Nexhmi Rexhepi,
Shkëmb Manaj,
Nexhmi Rexhepi,
Shkëmb Manaj,
E pavlefshme,
Safet Hoxha,
Nexhmi Rexhepi,
Safet Hoxha,
Nexhmi Rexhepi,
E pavlefshme,

Safet Hoxha,
Shkëmb Manaj,
E pavlefshme,
Shkëmb Manaj,
Shkëmb Manaj,
Safet Hoxha,
Nexhmi Rexhepi,
Nexhmi Rexhepi,
Shkëmb Manaj,
Safet Hoxha,
Nexhmi Rexhepi,
Safet Hoxha,
Nexhmi Rexhepi,
Safet Hoxha,
Nexhmi Rexhepi,
E pavlefshme,
Safet Hoxha,
Shkëmb Manaj,
Safet Hoxha,
Nexhmi Rexhepi,
Safet Hoxha,
Nexhmi Rexhepi,
Safet Hoxha,
Nexhmi Rexhepi,
Nexhmi Rexhepi,
Shkëmb Manaj,
Safet Hoxha,
Nexhmi Rexhepi,
Safet Hoxha,
Nexhmi Rexhepi.

KRYETARI: Faleminderit shumë, komisionit! Siç duket, ka përfunduar numërimi. Të kemi vëmendjen ta dëgjojmë edhe rezultatin, ju lutem!

EVEGJENI THAÇI-DRAGUSHA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni votues për propozimin e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës paraqet këtë:

R a p o r t
Për rezultatet e votimit për propozimin e gjyqtarëve
në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës

Në mbështetje të neneve 65.11 dhe 114 të Kushtetutës së republikës së Kosovës, të nenit 6 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 51 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni votues i formuar me vendim të Kuvendit më 6 korrik 2018, në përbërje nga një përfaqësues të secilit grup parlamentar, pas procedurës së votimit të fshehtë në rundin e dytë dhe numërimit të votave të deputetëve të Kuvendit për propozimin e gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese, në seancën plenare, të mbajtur më 6 korrik 2018, konstaton:

- Në votim kanë marrë pjesë 92 (nëntëdhjetedy) deputetë,
- Të pavlefshme janë 5 (pesë) fletëvotime,

Votat e fituara për kandidatët e propozuar janë:

1. Safet Hoxha, i ka fituar 62 (gjashtëdhjetedy) vota,
2. Nexhmi Rexhepi, i ka fituar 66 (gjashtëdhjetegjashtë) vota,
3. Shkëmb Manaj, i ka fituar 23 (njëzetetre) vota,
4. Vigan Qorolli, i ka fituar 6 (gjashtë) vota.

KRYETARI: Atëherë, në bazë të raportit të Komisionit votues konstatoj se Kuvendi i Republikës së Kosovës i propozon tre kandidatë për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese për emërim nga presidenti i Republikës së Kosovës, si në vijim:

1. Zonjën Remzije Istrefi-Peci,
2. Zotëri Safet Hoxha dhe
3. Zotëri Nexhmi Rexhepi.

Faleminderit për anëtarët e Komisionit votues.

Të nderuar kolegë deputetë,

Nuk e di sa jemi në sallë! A ka mundësi... 46. Atëherë, po shkojmë... po, po, gjithsesi. Deri në sa ora dëshironi? Deri në orën 16:00. Në orën 16:00 e vazhdojmë seancën. Faleminderit!

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Para pauzës e unë e pata si autorizim që njëri nga nënkryetarët ta vazhdojë, sido kjo është situata në të cilën jemi. Unë ju kërkoj falje personalisht si kryetar, kjo është çka dëshiroj ta ndaj me ju dhe po e shoh që shumica duan ta bëjnë vazhdimin e seancës në një ditë tjetër, po e vazhdojmë të hënën.

A ka mundësi, deklarohuni grupet parlamentare, nëse dëshironi ju unë e bëj si të doni, unë e vazhdoj. As ata nuk kanë faj për këtë arsye, për kuorum ne kemi mundësi për me e zhvillua vazhdimin e seancës, por varet kjo nga dëshira juaj, se kur e kemi filluar seancën ka pasur kuorum, e kjo varet vetëm nga dëshira juaj. Ama vonesa e cila ka ndodhur në kryesimin e seancës, nuk është faji i deputetëve që janë larguar. Për këtë dëshiroj ta bëj publike, se ju e dini që unë e bëj publike edhe pjesën kur kanë faj deputetët. Memli Krasniqi atëherë, Korab mund ta shprehësh një qëndrim tash. Korab, urdhëro!

KORAB SEJDIU: E përfaqësoj nëse duan ta dinë zonjë grupin më të madh parlamentar në këtë Parlament, kështu që jo veç tash prej fillimit aty kam qenë.

Kryetar!

Duke e pasur parasysh që kemi mungesë serioze të deputetëve, mendoj që vazhdimi të hënën do të ishte më adekuat. Po shihet qartë që s'kemi mjaft deputetë, nuk besoj që as diskutimi do të jetë i mirëfilltë, kështu që duke e pasur parasysh që kemi çështje të rëndësishme për të diskutuar derisa të kthehen deputetët është mirë që të vazhdohet të hënën.

KRYETARI: Unë kështu për ta pasur parasysh në fund shumica e grupeve parlamentare, e marr qëndrimin e shumicës në qoftë se një më shumë është nga grupet parlamentare e vazhdojmë. Memli Krasniqi, qëndrimi juaj!

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, zoti kryetar!

Është e vërtetë që ndoshta s'kemi kuorum për të votuar, por kemi mundësi të vazhdojmë, meqenëse është veç vazhdim pas pauzës. Unë mendoj, pavarësisht që të hënën e kemi caktuar një seancë të re për një projektligj, për të cilin u pajtuam javën e kaluar me qenë të hënën, edhe që edhe të enjten e ardhshme të planifikohet një seancë tjetër, ne kishim preferuar sot të vazhdojmë me shqyrtimin e këtyre projektligjeve që i kemi në lexim të parë, ato që janë në lexim të dytë pa dyshim që s'mund t'i kalojmë se s'ka deputetë për t'i votuar dhe pastaj t'i shqyrtojmë, besoj edhe raportet, të cilat janë pjesë të rendit të ditës.

Ma merr mendja që këto së paku sa janë, gjashtë pika kishim mundur t'i kryejmë sot tani, dhe momentin që ato përfundojnë pas një orë apo një orë e gjysmë sado që të jetë për ta përfunduar seancën.

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Albulena Haxhiu, urdhëro!

ALBULENA HAXHIU: Për Grupin Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje është goxha e papërgjegjshme kjo çka po ndodh, s'po kemi mundësi që ta mbajmë asnjë seancë siç duhet. Pra, po detyrohemi shumë çështje që t'i anashkalojmë vetëm për shkak të mungesës së kuorumit, por jo vetëm për shkak të mungesës së deputetëve. Kemi shumë projektligje këtu, por në anën tjetër s'i kemi ministrat për t'i prezantuar ato projektligje. Prandaj, ne si grup parlamentar mendojmë që debati me 20 deputetë në sallë është goxha kot, fillimisht ne jemi që kjo seancë të shtyhet dhe jo të vazhdojmë kështu duke e bërë, apo duke u tallur me njëri-tjetrin.

Prandaj, edhe sa i përket pikës së tetë të rendit të ditës është: Shqyrtimi i parë i Projektligjit për vërtetimin e pasurisë së pajustificueshme që është nismë e Vetëvendosjes. Nuk bën që ky projektligj tepër i rëndësishëm të diskutohet me 20 persona në sallë, në asnjë rrethanë. Prandaj, ne kërkojmë që seanca të vazhdojë javën e ardhshme. Sa u përket dy kërkesave që i pata pak më herët nga ju si kryetar Kuvendi, është që Komisioni për Legjislacion t'i përfundojë në parim dy projektligje, atë për konfiskimin e pasurisë të proceduar nga Ministria e Drejtësisë dhe atë për sinjalizimin. Ne si komision natyrisht do të mblihdemi të martën, në mënyrë që këto dy projektligje të shqyrtohen të enjten në seancë. Meqë po thuhet edhe kjo është kusht për liberalizim të vizave.

KRYETARI: Faleminderit! Partia Socialdemokrate, Dardan Sejdiu e ka fjalën.

DARDAN SEJDIU: Faleminderit, kryetar!

E para, e punës ideja ka qenë që të fillojmë në orën 16:00 dhe në orën 16:50, 50 minuta më vonë pas përfundimit të pjesës së parë të lojës, nuk po e di, por si duket Kampionati Botëror po bëhet më i rëndësishëm se Parlamenti i Republikës së Kosovës.

Është për keqardhje që me 50 minuta vonesë diskutojmë a vazhdojmë me seancë apo jo. Gjithashtu, është për keqardhje që numri i deputetëve sot në vazhdim të seancës është minimal dhe nuk besoj që kjo i bën nder asnjë grupi parlamentar, e sidomos atyre grupeve që nuk mundën as gjysmën e deputetëve të tyre me e sjell në sallë. E ka grupe këtu që nuk e kanë asnjë si duket. Pra, kryetar ideja e një Kuvendi me kuorum, pra me 60 deputetë së paku 61 deputetë në sallë është dhe debati të jetë i mirëfilltë. Cili është kuptimi të diskutojmë mbi raporte e projektligje nëse së paku gjysma e deputetëve nuk janë në sallë, ndoshta dikush e ka një ide, një analizë, një mendim më të mirë se tjetri. Pra, kështu që besoj dhe jam i bindur që secili prej nesh duhet të

respektojmë edhe kohën e njëri-tjetrit, por edhe ju si kryesues e kryetar, mos na lini të presim 50 minuta.

Rrjedhimisht, po sugjeroj normalisht ky është vendim tashmë as me votë nuk mundet të kalojë se s'ka as kuorum. Pra, nuk besoj që ka kuptim të vazhdohet me seancë kur trajtojmë ligje e herën tjetër veç votojmë e nuk i kemi shtjerrë debatin për asnjë ligj qysh duhet e as për raporte. Grupi Parlamentar i Partisë Socialdemokrate është që seanca të vazhdohet të hënën. Faleminderit!

KRYETARI: Edhe një qëndrim më vyen dhe më duket Aleanca tash. Zonja Teuta Haxhiu, të lutem regjia!

TEUTA HAXHIU: Faleminderit! Ajo që u pa paradite, pra që deputetët e Grupit më të madh Parlamentar që nuk janë fare këtu ishin nëpër zyrat veta të grupeve duke na shikuar prej ekraneve, por po konfirmohet edhe tash, tash sigurisht janë më e rëndësishme është për ta futbollit, kjo po konfirmohet. Ne jemi për të vazhduar dhe me vazhdua me pikat meqë jemi në vazhdim të seancës, prandaj është e vërtetë ajo që secili deputetë që nuk është këtu nuk është mirë, por megjithatë pasi është vazhdim i seancës ne jemi për të vazhduar edhe me vazhdua me pikat tjera të radhës në seancat e radhës ashtu e ka thënë edhe Glauku dje, është mirë që kemi ardhur në një stad pak më të mirë që Kuvendi të jetë në një agjendë, pra të planifikuar ditë më parë, e jo të jenë pikat e grumbulluara.

KRYETARI: Jemi dy me dy! Bilall Sherifi, nga Nisma!

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryetar! Do të isha njeri më i lumtur sikur futbollit të kishte qenë arsyeja që sot mungojnë, se kjo do t'i binte që seancat që kemi mbajtur deri sot kurrë s'i kemi lënë në gjysmë, kurrë s'kemi pasur mangu deputetët, pra nuk është arsyeja futbollit, së paku unë kështu e shoh se nga 27 deputetë vetëm 1 të jetë në seancë që është Korabi këtu nga Grupi Parlamentar i LDK-së, kjo i bie që LDK-ja krejt futbollistë.

Nuk mendoj që arsyeja është futbollit, por ne qysh kur kërkuam në fillim që ta bartim pikën e rendit të ditës të zgjedhjes së gjykatësve të Gjykatës Kushtetuese e kemi parashikuar pak a shumë se do të ketë vështirësi pasdite, deputetët shkojnë nëpër pushime është e premtë i lidhin shtunë e diel. Tash a është e arsyeshme a është e paarsyeshme kjo është çështje tjetër, unë mendoj që kushte nuk ka, në këto rrethana nuk ka kushte për të vazhduar seanca.

KRYETARI: Atëherë, Bilall si njohës i mirë i Kuvendit ia ka dhënë se edhe... mbeten gjysmë-gjysmë, kështu që ne duhet të orientohemi pak kah opozita pasi janë më pakicë.

Bahrim, a e dëshiron edhe ti fjalën? S'ka nevojë! Atëherë, të hënën e vazhdojmë këtë seancë pas asaj që e kemi për të hënën. Do të thotë, kjo është vendimmarrja. Faleminderit!

E hënë, më 9 korrik 2018

Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 5 korrik 2018

Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,

Atëherë, po vazhdojmë me seancën e mbetur në gjysmë të datës 5 korrik 2018. Po vazhdojmë me procedimin e pikave në vijim:

4. Votimi i Propozim-rezolutës nga interpelanca e kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje dhe Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, në lidhje me vendimin e Qeverisë numër 01/50, datë 5. 6. 2018 për pagesën e 53 milionë eurove shtesë për kompaninë “Bechtel&Enka” në kontratën për ndërtimin e Autostradës R6, “Arbër Xhafari” Prishtinë-Hani i Elezit

Ju njoftoj se diskutimet për këtë pikë të rendit të ditës kanë përfunduar në seancën plenare të mbajtur më 5 korrik. Propozuesi ka kërkuar të harmonizohet teksti i propozim-rezolutës me grupet parlamentare para se të hidhet në votim.

Ftoj përfaqësuesin e interpelancës, kush do të flasë. Armend Zemaj edhe Liburn Aliu janë paraqitur, mos u paraqitni të tjerë, nuk keni të drejtë për diskutim, vetëm propozuesi, diskutimet janë kryer për këtë çështje. Ka përfunduar diskutimi. Ju mund të kërkonit diçka në emër të grupeve parlamentare, keni të drejtë të diskutoni. Zoti Zemaj e ka kërkuar fjalën, në emër të Grupit Parlamentar apo si nënshkruesi i kërkesës.

ARMEND ZEMAJ: Flas në emër të grupit,

Është mirë të na informoni, zoti kryesues, pasi e filluat, sepse edhe deputetët janë konfuzë, është marrë vendim të vazhdojë seanca paraprake, sepse sot jemi të thirrur me një pikë të rendit të ditës dhe tash ne nuk po e dimë se cila pikë është duke u trajtuar dhe për cilën seancë jemi të thirrur të vazhdojmë.

Seanca e sotme ka qenë vetëm për Ligjin për Dhomat e Posaçme dhe ajo përfundoi. Ju lutem na njoftoni se cili është vendimi, e ne do të vendosim a do të vazhdojmë apo jo. Faleminderit!

KRYESUESI: Unë s’kam qenë në seancën e kaluar, por siç po më informojnë, në seancën e kaluar kryetari i Kuvendit a kryesuesi, kush e ka pasur fjalën, e ka komunikuar një vendim që në këtë seancë e diskutojmë në fillim ligjin, e shqyrtojmë ligji dhe pastaj kalojmë në shqyrtimin e pikave të tjera që kanë ngelur pa u shqyrtuar. Këtë të dhënë e kam prej kolegut këtu që e kam afër.

Ju mund të diskutoni, e drejtë juaja është. A dëshiron dikush tjetër, cili e doni, zoti Nitaj e ka fjalën.

MUHARREM NITAJ: I nderuar kryesues i seancës,
Dy çështje.

E para, kryetari i Kuvendit ka thënë në përmbylljen e seancës së kaluar se vazhdohet me seancën e vjetër.

Deputetët e Lidhjes Demokratike të Kosovës, përpos Korab Sejdiut, nuk kanë qenë të pranishëm në sallë, prandaj, me siguri kolegu Zemaj nuk e di se cili ka qenë vendimi, kjo e para.

Dhe e dyta, përpara se propozuesi i rezolutës, Liburni, edhe kushdo qoftë dalin edhe e justifikojnë, e arsyetojnë rezolutën, duhet thënë se teksti i rezolutës nuk është harmonizuar. Meqenëse nuk është harmonizuar, ose të kërkohet kohë shtesë, ose të mos nxirret fare në votim ose të nxirret dhe të rrëzohet. Faleminderit!

KRYESUESI: Unë jam i obliguar ta nxjerr në votim, në qoftë se kërkuesi i interpelancës kërkon të votohet, në qoftë se e tërheq, atëherë s'kam çka bëj. Mirë ka qenë të merreni vesh mes veti. Zoti Liburn Aliu e ka fjalën.

LIBURN ALIU: Meqenëse jemi mjaft afër harmonizimit të tekstit, kisha kërkuar kohë shtesë që sot brenda ditës të bëjmë edhe një përpjekje që ta harmonizojmë.

E kemi modifikuar prej asaj që ka qenë fillestare dhe po pres tash që mbase edhe mund të harmonizohet plotësisht.

KRYESUESI: Zoti Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Kryesues, më shumë sqarim se sa replikë për kolegun Nitaj. Seancën kur nuk kemi marrë pjesë ne këtu ka qenë vonesa e paarsyeshme prej 50 minutave të kryetarit të Kuvendit dhe deputetët këtu kanë pritur një orë gati dhe nga pritja e tepruar ne kemi ikur për në shtëpi.

Vendimi i thirrjes së seancave kështu në mënyrë arbitrare dhe me porosi, e tejkalon edhe Rregulloren e Punës së Kuvendit edhe praktikën parlamentare.

Kështu që unë kërkova që të njoftohemi, sepse janë dy seanca, të cilat kanë mbetur në vazhdim, për cilën seancë, për cilat pika dhe atëherë po vendosim a të hyjmë në vazhdim apo jo.

Sot është thirrur një seancë me një pikë të vetme të rendit të ditës, ajo pikë besoj që përfundoi dhe ju e konsideruat të mbyllur atë seancë. Për seancën e re, ju lutem, na konsultoni, tregoni pikat e rendit të ditës dhe ne shohim a po procedojmë apo jo.

KRYESUESI: Unë jam i obliguar t'ju informoj.

Unë nuk di jeni marrë vesh apo nuk jeni marrë vesh, por unë jam këtu për ta drejtuar seancën dhe për të dhënë përgjigje dhe llogari për ato çështje që mundem.

Janë rreth 20 pika që ka pasur kjo seancë. Seanca e datës 5, 6, etj. korrik. Pikat e mbetura janë:

4. *Interpelanca e kryeministrit të Republikës së Kosovës,*
5. *Shqyrtimi i Projektligjit numër 06/L-080 për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi pjesëmarrjen e Kosovës në Programin e Unionit "Konkurrenca e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme COSME 2014-2020",*
6. *Shqyrtimi i parë në parim i Projektligjit numër 06/L-079 për efikasitet të energjisë,*
7. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit numër 06/L-082 për mbrojtjen e të dhënave personale,*
8. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit numër 06/L-065 për shqyrtimin dhe vërtetimin e pasurisë së pajustificueshme,*
9. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 06/L-064 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-132 për automjete,*
10. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shërbime postare,*
11. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për masat mbrojtëse në importe,*
12. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit numër 06/L-024 për trajtimin e ndërtimeve pa leje,*
13. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit numër 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës,*
14. *Pika e katërbëdhjetë nuk është më, është kryer.*
15. *Shqyrtimi i raportit vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për vitin 2017,*
16. *Shqyrtimi i raportit vjetor të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2017,*
17. *Shqyrtimi i kërkesave të Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me shpenzimet për lobim nga Presidenca dhe Qeveria e Republikës së Kosovës për miratimin e buxhetit, si dhe për zgjatjen e mandatit, afatit të këtij Komisioni,*
18. *Zgjedhja e një anëtari të Komisionit të Pavarur për Medie,*
19. *Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës,*
20. *Propozimi i Grupit Parlamentar të AAK-së për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare.*

Këto janë pikat e rendit të ditës që kanë mbetur pa u shqyrtuar. Ne diskutuam edhe në mbledhjen e Kryesisë sot që të bëjmë ç'është e mundur për t'i kaluar këto ligje të paktën që kanë ngelur pa u miratua.

Nëse ju keni vërejtje, mikrofoni është i hapur për secilin kryetar dhe secilin deputet.

E dinë që deputetët për rendin e ditës kanë të drejtë të diskutojnë tre minuta dhe kryetarët e grupeve mund ta marrin fjalën.

Zoti Memli Krasniqi e ka fjalën.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Javën e kaluar ne këtë seancë e kemi filluar të enjten, i kemi përfunduar disa pika, pastaj kemi vazhduar të premtën dhe pas pauzës këtu, ata që kemi qenë, kemi folur në emër të grupeve parlamentare, ka pasur propozime të ndryshme dhe shumica është pajtuar që sot, me përfundimin e seancës që e kishte vetëm një pikë të rendit të ditës që përfundoi, ta vazhdojmë seancën e mbetur në gjysmë të premtën.

Unë besoj që kjo nuk është diçka e re për të cilën për herë të parë po njoftohemi këtu, sepse bile ka qenë edhe gjithkund nëpër media. Por po ashtu besoj që edhe përmes sekretarisë është bërë njoftimi për vazhdimin e seancës dhe në këtë kuptim opsioni është ose të vazhdojmë ose ta shtyjmë prapë.

Të premtën propozimi im ka qenë ta vazhdojmë aty për aty ato pika që kemi mundur t'i trajtojmë, nuk ka kaluar. Ka qenë propozimi i pjesës më të madhe të grupeve parlamentare që të vazhdojë sot, ne jemi këtu mund, ta vazhdojmë shqyrtimin e këtyre pikave që kanë mbetur, janë disa projektligje, janë disa raporte, janë disa projektligje në lexim të dytë dhe po ashtu edhe themelimi i disa komisioneve, një zgjedhje, e kështu me radhë. Dhe mua ma merr mendja që do të duhej që të vazhdonte, sepse për këtë tashmë janë të njoftuar të gjithë deputetët. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në qoftë se s'ka ndonjë marrëveshje tjetër shtesë, seanca e datës 5 korrik nuk është kryer. Ne duhet ta vazhdojmë seancën derisa të kryhet, nuk po e kuptoj pse po kërkohet që të merren vendime të reja për seancën. Në qoftë se mbyllet seanca pas diskutimeve dhe deklarohet e mbyllur, përderisa të merret një vendim tjetër i kryesisë, atëherë mund të praktikohet kjo, mund të ndodh kjo që është dashur të bëjmë rend të ri të ditës. Por, unë edhe në mbledhjen e Kryesisë u informova që do të vazhdohet sot dhe tani, edhe Sekretaria po deklaroi kështu, kështu që ne po vazhdojmë, pastaj nuk e di, unë jam dakord në qoftë se ju mund të merreni vesh sa i përket kësaj pike të rendit të ditës, por s'mund të marr rol ndërmjetësues ndërmjet jush. Ju merruni vesh ose me kryetarët e grupeve parlamentare, si të dëshironi, dhe zgjidheni problemin e votimit, ose të tekstit të rezolutës.

Por, unë dua të them që praktika e rezolutave çfarë e kemi ne, është krejtësisht gabim. Rezolutat duhet të jenë publike dhe duhet të jenë të propozuara para se të fillojë debati dhe të debatohet për rezoluta. Jo të diskutohet, pastaj hajt ta shtojmë një pikë, një fjalë, pesë fjalë, tani s'po merremi vesh as për ato pesë fjalë dhe kështu po na merret koha. Po vazhdojmë me pikën e radhës!

Po vazhdojmë pra:

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-080 për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian për pjesëmarrjen e Kosovës në Programin e Unionit “Konkurrenca e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme COSME), 2014-2020”

Komisioni FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri, Zhvillim e ka shqyrtuar Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim. E ftoj ministrin e Tregtisë dhe Industrisë, zotin Bajram Hasani, që ta arsyetojë dhe paraqesë projektligjin. Ministri nuk është këtu nuk e ka ngarkuar askënd. E ftoj kryetarin e Komisionit FunkSIONAL në qoftë se pranohet kështu. Si? Zoti Zemaj. Veç kërkojeni fjalën...

ARMEND ZEMAJ: Zoti kryesues!

Kërkoj falje që po ndërhyj prej këtu! Po shihet qartë që seanca nuk është përgatitur. S'është as Qeveria ta bëjë prezantimin e projektligjeve, qoftë edhe të këtij të tanishëm, dhe nuk mund të kërkonim as nga komisionet dhe as nga deputetët që të involvohen në diçka për çka as këta s'janë të përgjegjshëm paraprakisht për ligjet dhe projektligjet e propozuara. Ne po kërkojmë një trajtim shumë korrekt, sepse deputetët nuk janë të njoftuar për këtë rend të ditës. Nuk kanë njoftim zyrtar, përpos atij që ka qenë në ueb faqe të Kuvendit. Asnjë shkresë nuk u është shpërndarë deputetëve që pikat e mbetura do të trajtohen në këtë seancë plenare dhe ju po e shihni edhe pjesëmarrjen, edhe prezantimin, qoftë në emër të grupeve parlamentare, qoftë edhe në aspektin individual.

Kështu që ju kisha lutur që ta trajtoni automatikisht këtë çështje dhe ta prezantoni, në mënyrë që të dalim nga kjo situatë. Ne nuk mund të vazhdojmë në këtë mënyrë. Si Grup i Lidhjes Demokratike nuk mund të vazhdojmë dhe kjo është jo shumë serioze në raport edhe me punën parlamentare.

KRYESUESI: Unë jam plotësisht dakord që nuk është serioze që ministri ta sjellë projektligjin dhe të mos jetë në sallë, megjithatë ne e kemi proceduar edhe kështu, e kanë autorizuar një ministër tjetër. Në parlamentet tjera, po ju them çka ndodh, kur s'është ministri. Kur nuk është ministri, kryetari i seancës ose kryesuesi e heq prej rendit të ditës propozimin dhe e sjell ose kërkon që të silllet në seancën e radhës në procedurë të re.

Ne nuk e kemi praktikuar asnjëherë dhe nuk po dua ta bëj unë atë veprim, sidoqoftë për procedurë keni të drejtë të diskutojmë. Unë e konsideroj edhe si mocion këtë të zotit Zemaj, por duhet të diskutojmë edhe ne të tjerët. Zoti Bilall Sherifi e ka kërkuar fjalën, në emër të Grupit Parlamentar Nisma.

BILALL SHERIFI: Së pari, sa i përket procedurës, kur një seancë përfundon, jepet një pauzë së paku 30 minuta para se të vazhdohet, qoftë seanca e re, qoftë të vazhdojë seanca, e cila ka mbetur në gjysmë. Nuk mund të ngjitet kështu seanca pa dalë fare në pushim, se as ministri askush nuk mund të jetë evlia ta dijë kur do të përfundojnë debatet dhe kur do t'i vijë rendi seancës tjetër, përkatësisht pikës tij të rendit të ditës dhe të qëndrojë këtu të presë tërë ditën për ta lexuar ekspozenë e tij sa u përket ligjeve.

Pra, unë po kërkoj që të jepet pauzë së paku 30 minuta, në mënyrë që të gjithë deputetët, ministrat, të informohen se pas 30 minutash do të fillojë vazhdimi i seancës së kaluar dhe jo t'i trajtojmë pikat e rendit të ditës së seancës së kaluar brenda seancës që e ka pasur veç një pikë të rendit të ditës. Prandaj, kërkoj që të jepet një pauzë, në mënyrë që të ftohen ministrat që kanë pika të rendit të ditës, të informohen deputetët që përfundoi seanca e kaluar, e reja që u hap sot u mbyll, dhe po hapet ajo e cila ashtu siç jemi marrë veshë ditën e premte të vazhdojë sot të hënën pas seancës që ka qenë e caktuar paraprakisht për ta trajtuar projektligjin në fjalë. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Isufi e ka kërkuar fjalën.

AHMET ISUFI: Faleminderit, zoti kryesues!

Nëse flasim për procedurat, procedurat janë në rregull për shkak se të enjten është dhënë propozimi që të premtën të vazhdohet, e nuk është përkrahur, prandaj është lënë për të hënën edhe në seancë, edhe Kryesia ka vendosur. Prandaj, nuk e di pse ka nevojë që kjo pikë që të diskutohet ende.

Edhe Bilalli e di po ashtu, vetëm që Bilalli e ka vërejtjen pse s'u dha pak pauzë prej pikës që ishte rend i ditës tjetër në këtë rend dite.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Albulena Haxhiu e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Nuk e di në qoftë se keni qenë qysh në fillim të kësaj seance, zoti kryesues, por megjithatë po e theksoj që nga ora 10:30 kur ka nisur kjo seancë ne jemi duke ju thënë dhe jemi duke ju folur shqip - është Qeveri e pakicës, është koalicioni i pakicës, mos shpresoni që opozita do të jua bëjë numrat. Kaq! Kaq e lehtë është. Prandaj, nuk e di edhe sa herë duhet të jua përkujtoj, por nuk e kemi problem në qoftë se edhe për çdo minutë të jua përkujtojmë që jeni Qeveri e pakicës dhe nuk ka këtu asnjë dyshim që ditët e kësaj Qeverie janë të numëruara.

Andaj, edhe zgjidhje për këtë situatë janë zgjedhjet. Nuk ka kuptim që shtatë orë të diskutojmë i keni, a s'i keni, a ka ardhur ministri, deputeti, jo deputetët s'qenkan. Kjo është tallje me qytetarët. Kur keni për t'u mbushur mend! Flasin për marrëveshjen ndërkombëtare, as ministri nuk është këtu! Ku po doni të shkoni tutje? Prandaj, ne si Grup Parlamentar në shenjë proteste ndaj kësaj situatë qysh tani do ta lëshojmë sallën. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Së pari, para se të shkoni, desha të them diçka, përderisa jam këtu, unë nuk jam i Qeverisë, dhe unë jam plotësisht dakord me ty që ministrat duhet të jenë këtu dhe realisht neve s'na ka mbetur kurrëgjë tjetër veç të shkojmë të protestojmë para Qeverisë si deputetë e t'u themi "ejani këtu", se s'kemi kurrfarë mekanizimi tjetër për t'i sjellë.

Por, unë dua të them që zoti Hasani dhe ministri i Arsimit janë ndër ministrat e rregullt që janë në seanca, sot paska koiciduar diçka dhe s'është këtu. Unë mendoj që kërkesa e Bilallit duhet të merret parasysh për të bërë një pauzë 15 minuta dhe le të vijë ministri, e shqyrtojmë rendin e ditës.

* * *

KRYESUESI: Atëherë, zonja dhe zotërinj, sipas kërkesës suaj, ministri ka ardhur, ka mjaft arsye që s'ka qenë këtu. Po fillojmë me seancën.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-080 për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian për pjesëmarrjen e Kosovës në Programin e Unionit "Konkurrenca e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme COSME, 2014-2020"

Komisioni Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal e ka shqyrtuar Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim. E ftoj ministrin e Tregtisë dhe Industrisë, zotin Hasani, që të paraqesë dhe arsyetojë projektligjin. Zoti Hasani, e keni fjalën.

MINISTRI BAJRAM HASANI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Fillimisht ju kërkoj falje për vonesën, por ishte e arsyeshme.

Kam nderin që në emër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë si kryesues i grupit punues nga ana e palës kosovare për negociimin dhe përgatitjen e marrëveshjes ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Kosovës mbi pjesëmarrjen e Kosovës në Programin e Unionit "Konkurrenca e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme COSME, 2014-2020".

Shkurtimisht ta paraqes qëllimin dhe rëndësinë e kësaj marrëveshjeje. Programi COSME i Komisionit Evropian dhe rëndësia e pjesëmarrjes së Kosovës - COSME është program i

Bashkimit Evropian për konkurrueshmëri të ndërmarrjet e vogla dhe të mesme për vitet 2014-2020, financuar nga Këshilli e Evropian dhe menaxhuar nga agjencia ekzekutive për ndërmarrjet e vogla edhe të mesme, me një buxhet prej 2,5 miliardë eurosh, prej të cilave 60%, apo mbi 1,3 miliardë euro janë të dedikuara për instrumente financiare.

Objektiva thelbësore e COSME-s është të mbështesë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, të cilët në mungesë të COSME-s nuk do të kishin qasje në financa. Pra, financimi me risk financiar më të lartë. COSME mbështet qasjen më të mirë të financave për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, qasje në tregjet për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, ndërmarrësinë, kushtet më të favorshme për krijimin dhe rritjet e ndërmarrjeve.

Qasja financiare: një nga objektivat kryesore të COSME-s është të ofrojë qasje më të madhe në financa për ndërmarrje të vogla dhe të mesme në faza të ndryshme të ciklit të zhvillimit të tyre, krijimi, zgjerimi ose transferimi i biznesit.

Për të arritur këtë objektiv Bashkimi Evropian mobilizon kredi dhe investime kapitale për ndërmarrje të vogla dhe të mesme.

COSME afron mbështetje për ndërmarrjet evropiane dhe në këtë rast, edhe ato kosovare që të përfitojnë nga tregu i bashkuar i Bashkimit Evropian dhe të përfitojnë sa më shumë nga mundësia që ofrojnë tregjet jashtë BE-së.

Në këtë drejtim COSME financon Rrjetin evropian të ndërmarrjeve, që është një rrjet i përbërë prej mbi 600 zyrash dhe mbi 50 shtete që ndihmojnë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme të gjejnë partneritet për biznese dhe teknologji.

Të kuptojnë legjislacionin e BE-së dhe të arrijnë qasje në fondet e BE-së.

COSME mbështet implementimin e Planit të veprimit për ndërmarrësinë 2020 për një game të gjerë aktivitetesh. Këtu përfshihet shkëmbimi i mobilitetit, hulumtimi, shpërndarja e praktikave më të mira dhe pilot-projektet në fusha të tilla, si arsimit mbi ndërmarrësinë, mentorimin ose zhvillimi i shërbimeve udhëzuese dhe mbështetjen për ndërmarrësit e rinj dhe potencialë, duke përfshirë ndërmarrësit e rinj, gratë ndërmarrëse dhe ndërmarrësit e moshuar.

Krijimi i kushteve më të favorshme për konkurrueshmërinë: COSME mbështet veprimet që kanë për qëllim reduktimin e barrierës legjislative, administrative dhe procedurale për ndërmarrje të vogla dhe të mesme.

Kjo arrihet kryesisht përmes studimeve dhe analizave të politikave dhe ligjeve të ndryshme. Efektet e tyre mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, duke përforcuar principin e Aktit evropian

për biznese të vogla, ‘mendo nga e vogla fillimisht’ gjatë përpilimit të politikave nacionale dhe regjionale.

Sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe sipas Ligjit për marrëveshje ndërkombëtare, të gjitha marrëveshjet ndërkombëtare që kanë implikime financiare ratifikohen nga Kuvendi nëpërmjet Ligjit të ratifikimit.

Prandaj, ne besojmë dhe jemi plotësisht të bindur që lidhja e kësaj marrëveshjeje do të rrisë qasjen në financa për ndërmarrje të vogla dhe të mesme, qasje në tregjet dhe inkurajimin e ndërmarrësisë dhe krijimin e kushteve më të favorshme për konkurrueshmëri.

Ju ftoj që ta miratoni këtë projektligj në këtë seancë plenare. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Ftoj kryetaren e Komisionit Funkcional, zonjën Sala Berisha-Shala, për arsyetimin e raportit të komisionit me amendamentin e propozuar. Zonja Shala, e keni fjalën.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, nënkryetar!

Përshëndetje, ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Dhe ju të pranishëm,

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal në bazë të neneve 60 dhe 69 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 26 qershor 2018 shqyrtoi Projektligjin numër 06/L-080 për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi pjesëmarrjen e Kosovës në Programin e Unionit “Konkurrenca e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme 2014-2020” dhe vendosi që Kuvendit t’i paraqesë këtë rekomandim.

Të miratohet Projektligjit nr. 06/L-080 për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi pjesëmarrjen e Kosovës në Programin e Unionit “Konkurrenca e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme”, me të vetmin amendamentim si në vijim:

Në titullin e projektligjit fjala “konkurrenca e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme 2014-202” të zëvendësohet me “konkurrenca e ndërmarrjeve dhe ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme” dhe ky ndryshim vlen për tërë tekstin e projektligjit.

A r s y e t i m:

Bazuar në nenin 60 dhe 69 të Rregullores së Kuvendit, komisioni në mbledhjen e rregullt më datën që u përmend më lart e ka miratuar Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes dhe

amendamenti i bërë në titull të projektligjit ka për qëllim të harmonizojë projektligjin me marrëveshjen, sepse projektligji duhet të jetë në përputhje me marrëveshjen, ku përmes vetë këtij projektligji ratifikohet marrëveshja.

Në marrëveshje shënohet qartë “konkurrenca e ndërmarrjeve dhe ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme 2014-2020”, ndërsa si në titull dhe në këtë projektligj është hequr fjala ‘ndërmarrjeve’ dhe ka mbetur vetëm fjalia “Konkurrenca e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme” që rezulton si jo e plotë.

Andaj, në pajtim me nenin 18 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 10 të Ligjit për marrëveshjet ndërkombëtare si dhe nenin 60 të Rregullores së Kuvendit, komisioni i rekomandon Kuvendit që ta ratifikojë këtë marrëveshje ndërkombëtare me procedurë të veçantë, me vota të dy të tretave të të gjithë deputetëve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Berisha! Radha është e përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, fjalën e ka zoti Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryesues!

Më lejoni të potencoj që është joserioze dhe e papranueshme trajtimi i ligjeve të tilla, sidomos këto që kanë karakter ndërkombëtar.

Na vjen mirë që ministri erdhi në mënyrë të ngutshme për të paraqitur para deputetëve të Kuvendit të Kosovës programin e tij dhe obligimet e tij si ministër. Por është i vetmuar, nuk e ka as përkrahjen e pozitës dhe më së paku jemi të obliguar ne opozita që këtë gjendje, nuk po e theksoj që t’ju ndihmojmë, por është një hapje e syve se ku e keni futur Kuvendin e Kosovës edhe institucionet legjitime të vendit.

Jeni duke i kthyer në jolegjitimitet të plotë, kjo është shumë e qartë, po shihet, mund të fokusoheni edhe në ulëset e Kuvendit, edhe të deputetëve pozitë dhe opozitë dhe sinqerisht është shumë e papranueshme.

Jo vetëm kjo, e cila kërkon 2/3, por ishte edhe ligji paraprak i Dhomës së Posaçme, i cili nuk i kish votat e pozitës dhe po ashtu sigurisht edhe me ndihmën e ndonjë subjekti opozitar, por ne nuk do t’ju ndihmojmë në këtë aspekt.

Do t’ju tregojmë juve edhe qytetarëve të vendit që jeni mazhorancë minore dhe kjo po ndodh çdo ditë, po tentoni të kamufloni, është e padrejtë, e pa sinqertë dhe duhet të jeni real para kësaj gjendje.

Marrëveshja është e mirë, është e pranueshme edhe për Grupin Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, por jo në këtë formë dhe jo në këtë mënyrë se si ju po i trajtoni si Qeveri e koalicionit.

KRYESUESI: Faleminderit! Ne po vazhdojmë seancën, Armend, unë s'i kam askujt faj pse nuk rri në seancë, as nuk mund ta sjell me zor, as ti s'mundesh, me siguri. Fjalën e ka zoti Memli Krasniqi.

MEMLI KRASNIQI: I nderuar kryesues,
Më duket që ka mbetur prej herës së kaluar, në emër të grupit fol zonja Sala Berisha-Shala.

KRYESUESI: Fjalën e ka deputetja Sala Berisha-Shala.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, nënkryetar!
Mua më vjen keq që në raste të tilla, kur kemi të bëjmë sidomos me marrëveshje ndërkombëtare, nga të cilat përfitojnë qytetarët e Kosovës dhe vetë Kosova, të gjejë edhe kësi arsyetimesh të tilla opozita dhe të mos qëndrojnë në Kuvend t'i miratojmë këto marrëveshje, për çka kërkohen 2/3 e të gjithë deputetëve.

Raste të tilla, momente të tilla duhet t'i tejkalojnë të gjitha ngjyrimet politike dhe të tjerët, ndërkombëtarët, Evropa nuk na sheh neve pozitivë e opozitë, po na sheh si të tërë, si Kosovë. Prandaj, duhet të kemi kujdes dhe duhet të jemi në nivelin e detyrave, pa dashur të shfajësoj as mazhorancën, po fajin e kemi të gjithë bashkë.

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës ne e mbështesim këtë marrëveshje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Frashër Krasniqi, në emër të PSD-së apo Dardan, cili e keni?.

DARDAN SEJDIU: Faleminderit, kryesues!
Në fakt, në këto rrethana të diskutohet edhe për marrëveshje ndërkombëtare më duket pak e çuditshme, po sido që të jetë, në Komisionin për Zhvillim Ekonomik i kam shprehur disa shqetësime, ose më mirë të them i kam bërë disa pyetje, për të cilat besoj do të ishte mirë t'i diskutojmë para se ta votojmë marrëveshjen, kurdo që janë numrat për atë marrëveshje, është mirë që ministri të na i adresojë.

Marrëveshja ka të bëjë me qasjen në financim për ndërmarrjet e mesme dhe të vogla dhe me sa e kam kuptuar atë ditë kur është bërë prezantimi nga stafi juaj në komision duhet formohet një lloj trupe, e cila i klasifikon ato.

Do të ishte mirë të na shpjegoni, përveç se e lidhim këtë marrëveshje, të na shpjegoni se si bëhet përzgjedhja e ndërmarrjeve, kush e bën përzgjedhjen e atyre ndërmarrjeve, në mënyrë që të kuptojmë edhe mekanizmat për shpërndarjen e këtyre mjeteve të cilat mund të vijnë si pjesë e marrëveshjes COSME.

Mendoj që instrumente të tilla janë të mirëseardhura, janë tepër të rëndësishme e të domosdoshme, por instrumente të tilla bëhen edhe të dobishme kur ekziston një mekanizëm, i cili sigurohet që procesi i qasjes në fonde për ndërmarrjet në këtë Republikë është proces i cili është meritore dhe i cili nuk është problematik.

Dy gjëra që i kam adresuar ka qenë: një, definimi i ndërmarrjes së vogël dhe të mesme, dallon definimi i ndërmarrjes së vogël që i kemi ne në Kosovë prej ndërmarrjes së vogël që i kanë në Bashkimin Evropian.

Në Kosovë ndërmarrjet e vogla definohen vetëm për numër të punëtorëve, në Bashkim Evropian ndërmarrjet e vogla definohen edhe për nga qarkullimi vjetor dhe normalisht që kjo e bën si të thuhet të rëndësishme edhe mënyrën se si e ndërtojmë mekanizmin për të adresuar se kush ka qasje në financim.

Dhe në fund fare, e thashë dhe po e përsëris, pra ky mekanizëm si është i menduar që të sigurohemi në pjesëmarrjen meritore të ndërmarrjeve adekuate sipas marrëveshjes në këto fonde.

I nderuar ministër,

Edhe në komision ju kisha lutur që temat e këtilla t'i adresoni me seriozitet dhe ju t'i adresoni si ministër, ndërsa marrëveshje të tilla duhet të jenë të sqaruara gjerë e mirë edhe para se të votohen, sepse kanë implikime edhe procedurale, edhe financiare. Është mirë që secili prej nesh të kuptojmë çka po votojmë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Nitaj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, e ka fjalën.

MUHARREM NITAJ: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Që opozita ka kohë që nuk po tregohet konstruktive në punën e Kuvendit të Kosovës, kjo nuk ka asnjë dilemë. Unë realisht edhe e kuptoj, po nuk arrij të kuptoj, për shembull, pse shumica parlamentare nuk është e vetëdijshme për përgjegjësitë që i ka dhe të jetë më e mobilizuar në punën e saj në Kuvend dhe në praninë e saj në Kuvend.

Tani nëse flasim se kush është më i mirë e kush është më i keq, nuk besoj që mbetet shumë hapësirë për të bërë krahasime të kësaj natyre.

Po flasim për marrëveshjen. Marrëveshjen e mbështesim dhe do ta votojmë në momentin që do të sigurohen votat për të.

Kam një pyetje për kryetaren e komisionit, nuk e di nëse unë e kuptova drejt ose jo!

Në amendamentin e propozuar e kanë ndryshuar amendamentin ekzistues me formulimin “Ndërmarrjeve, ndërmarrjeve të vogla dhe ndërmarrjeve të mesme”. Nëse kjo që po them unë është e saktë, unë besoj, për shembull, që kjo shtesa e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në kohën kur ekziston fjala ‘ndërmarrjeve’, s’ka fare nevojë të ekzistojë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Bilall Sherifi e ka fjalën.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryesues!

Edhe Nisma gjithashtu e mbështet marrëveshjen dhe nëse më lejoni do t’i kisha thënë edhe 2-3 fjalë rreth luftës që po bëhet mes opozitës dhe pozitës sa u përket numrave.

Unë e kuptoj dhe mund t’i jap të drejtë opozitës kur flet për ligje të zakonshme pse mazhoranca nuk i ka deputetët e saj për t’i shtyrë, por nuk mund të kërkosh nga asnjë mazhorancë të ketë 80 deputetë me çdo kusht, në mënyrë që të arrijë vetë ajo t’i kalojë ligjet të cilat kanë të bëjnë me marrëveshjet ndërkombëtare, siç është kjo e sotshmja, sepse madje nuk është as e shëndetshme që mazhoranca t’i ketë 80 deputetë për faktin se pastaj e ajo bëhet shumë arrogante, siç kemi pasur rastin të shohim qeveritë të cilat i kanë pasur 2/3.

Mendoj që nga opozita me të drejtë kërkohet që sa u përket marrëveshjeve ndërkombëtare të jetë këtu, në mënyrë që ato të kalohen, sepse nuk përfiton vetëm mazhoranca, po përfiton në përgjithësi vendi dhe sidomos në këtë rast ekonomia e vendit. Sa më shumë që të shtyhet kjo marrëveshje, aq më e gjatë dhe më e vështirë do të bëhet rruga drejt qasjes në ato fonde.

Kritika e tyre qëndron sa u përket ligjeve të zakonshme, por jo sa u përket marrëveshjeve ndërkombëtare, ku kërkohen 80 vota, sepse siç thashë, rrallë ndodh dhe do të kisha pasur dëshirë që asnjëherë të mos ndodhte këtu në Kosovë mazhoranca t’i ketë 80 deputetë. Faleminderit!

KRYESUESI: Nuk ka të tjerë të paraqitur për diskutim. Zoti ministër, e dëshironi fjalën? Fjalën e ka ministri Hasani.

BAJRAM HASANI: Faleminderit!

Ne më herët, deputet Sejdiu, e thamë pak, e shpjeguam ekspozenë, por vlen të theksohet se ne e kemi për obligim që t’u mundësojmë ndërmarrjeve tona, me ratifikimin e kësaj marrëveshjeje ka mundësi, për shkak se kjo edhe na kushton kosto financiare, siç e përmendët, diku afërsisht 450 mijë euro kushton për tre vjet, diku 150 mijë për vit.

Kështu që shteti apo institucionet nuk kanë më obligim që ndërmarrjet një farë forme nuk kalojnë nëpërmjet institucioneve për të aplikuar në fondin e Bashkimit Evropian.

Kjo realisht do të thotë që i jepet mundësia çdo ndërmarrjeje të Kosovës të mund të aplikojë. Natyrisht prioritetet për qasjen e këtyre fondeve na jepen paraprakisht, na i dërgon pas ratifikimit të kësaj marrëveshjeje Bashkimi Evropian se cilat janë fushat e interesit që ata do t'i mbështesin.

Po shqetësimi ynë është, personalisht edhe imi, se sa janë ndërmarrjet tona të përgatitura për aplikimin apo thithjen e këtyre fondeve që ndoshta ne pas ratifikimit duhet të mendojmë që t'u afrojmë konsulencë ndërmarrjeve tona që të jenë të përgatitura për t'i marrë këto fonde, se ka shtete të rajonit që janë anëtarë të këtij fondi, kanë qasje, mirëpo nuk kanë përfituar. Mungesa e projekteve, sepse në Bashkimin Evropian për të aplikuar duhet një projekt i detajuar, natyrisht që e them edhe fushat që janë në interes që të mbështeten. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër!

Ne nuk kemi akoma kuorumin e duhur, po konsideroj që debati ka përfunduar për këtë. Në momentin që kemi numrin e mjaftueshëm të deputetëve në sallë, e qesim për votim.

Në goftë se ke diçka, po të tregoj që nuk është praktikë të diskutohet pasi të diskutojë ministri.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit numër 06/L-079 për eficiencë të energjisë

Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Nuk ka kuorum as kjo pikë.

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit numër 06/L-082 për mbrojtjen e të dhënave personale

Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Kryeministri nuk është këtu, është dashur ta prezantojë, kjo pikë e rendit të ditës hiqet prej rendit të ditës dhe e vendosim pas mbledhjes së Kryesisë.

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit numër 06/L-065 për vërtetimin e pasurisë së pajustificueshme

Komisioni Funkcional për Legjislacion, Mandate dhe Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar mosmiratimin e tij.

Ftoj përfaqësuesin e Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, në cilësinë e propozuesit, ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin.

Lëvizja Vetëvendosje nuk ka askënd në sallë, kështu që s'ka propozues. Nuk është as kryetarja e Komisionit FunkSIONAL, zonja Haxhiu.

Edhe kjo pikë e rendit të ditës hiqet prej rendit të ditës sot dhe shqyrtohet pastaj në Kryesi edhe një herë çështja e pikës në fjalë.

9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 06/L-064 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 05/L-132 për automjete

Komisioni FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

Ftoj deputetin Mërgim Lushtaku që në cilësinë e propozuesit ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin. Zoti Lushtaku, e ke fjalën.

MËRGIM LUSHTAKU: Faleminderit!

I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Dhe shumë të nderuar qytetarë,

Shumë qytetarë më kanë ngritur një shqetësim të tyre lidhur me Ligjin për automjete ose kryesisht me disa dispozita të tij. Pas kësaj kam konsultuar ligjin në fjalë, por edhe jam konsultuar me një zyrtar përgjegjës dhe ekspert në këtë ligj dhe të kësaj fushe.

Duke krahasuar rregullimin kosovar dhe atë evropian të kësaj çështjeje, sigurisht që më ka shqetësuar dëmtimi që u bëhet qytetarëve dhe bizneseve.

Me këtë ligj kemi disa shkelje, prandaj kam arsye të fortë që kam bërë një nismë ligjore për të bërë plotësim-ndryshimin e ligjit.

Konkretisht, Ligji për automjete ka disa shqetësime lidhur me nenin 44, nenin 63 dhe nenin 89.

Në nenin 44, paragrafi 2, thuhet se në Kosovë nuk mund të importohen veturat më të vjetra se 10 vjet.

Pas kësaj kam shqyrtuar në vendet e Evropës dhe SHBA-së, kryesisht Perëndimi dhe e kam parë se nuk kemi ndonjë ndalesë në vite, po kemi në aspektin e standardeve dhe në këtë drejtim kemi probleme mjaft serioze, pasi që edhe kushtet ekonomike të familjeve kosovare e kanë shumë

vështirë që të kenë në dispozicion vetura të reja dhe në këtë drejtim besoj që është e domosdoshme që kjo dispozitë të largohet.

Gjithashtu në BE qarkullojnë edhe shumë vetura ‘oltajmers’ si quhen, ose të koleksioneve të vjetra që qarkullojnë në BE dhe nuk e kanë asnjë problem.

Gjithmonë është në dispozicion ose në përkushtimin tonë që të kujdesemi ndaj ambientit. Prandaj, edhe kam menduar që në këtë dispozitë të parashtrohet dispozita ku thuhet se nuk do të importohen veturat minimalisht me standardin EURO 4.

Pastaj te neni 63 kemi gjithashtu një shkelje flagrante të të drejtave të qytetarëve.

Në paragrafin 1 është çlajmërimi i mjetit për shkak të ndërrimit të pronarit është i mundur vetëm nëse në të njëjtën kohë e regjistrojnë pronarin e ri në evidencë.

Dhe nën dy, gjatë bartjes së pronësisë pronari i ri i regjistrimit të mjetit në emër të tij në afatin kohor prej 30 ditësh nga data e blerjes së mjetit.

Sipas këtij neni, për të bërë ndërrimin e pronësisë së automjetit, nëse nuk e ndërron pronësinë deri në 30 ditë, duhet të bëhesh pronar i ri nga fillimi ose me fjalë të tjera, regjistrimi shkon huq.

Nëse nuk e ka bërë ndryshimin brenda 30 ditëve dhe pas saj vetëm sigurimi i bartet pronësisë, ndoshta regjistrimi, kontrolli teknik dhe të gjitha taksat duhet t’i paguajë nga fillimi.

E kam shqyrtuar gjithashtu edhe këtë çështje se si është rregulluar në SHBA apo në vendet evropiane. Edhe këtu bëhet ndërrimi i pronarit e gjithë mjetet dhe regjistrimet i barten pronarit të ri ose i kthehen të gjitha paratë pronarit të vjetër, por ato para nuk mbeten te shteti. Dhe, në këtë drejtim, kam pasur edhe shumë shqetësime nga qytetarët, të cilët më kanë thënë që kjo është plaçkë, dhe realisht është plaçkë ndaj qytetarëve, pasi këto para nuk vazhdojnë me sigurimin e pronarit të ri, por as nuk i kthehen pronarit të vjetër.

Dhe ky nen kam thënë që do të ndryshohet tërësisht që të gjitha tatimet, taksat t’i barten pronarit të ri, vetëm të paguhet taksa e ndërrimit të pronarit. Dhe, neni 89, paragrafi 3, ka të bëjë me kontrollim teknik. Kontrollimi teknik i mjeteve mund të bëhet vetëm brenda komunës ku ka vendbanim pronari i atij mjeti, ndërsa brenda komunës nuk ka subjekt për kontroll teknik, atëherë kontrolli bëhet brenda rajonit ku e ka vendbanimin pronari i mjetit. Kontrollimet teknike nuk duhet të kufizohen brenda një komunës, sepse nuk është duke u kontrolluar personi, por automjeti. Për përkufizim, edhe pse në shikim të parë duket favorizuese për bizneset komunale, kjo bie ndesh me konkurrencën e lirë të tregut. Dhe, në këtë drejtim, kemi shumë dëmtime të qytetarëve dhe të bizneseve, në përgjithësi. Kemi raste që disa biznese e kanë në selinë e tyre në

një qytetet, si për shembull në Mitrovicë, pastaj nëse ato automjete të rënda të bizneseve, siç janë kamionët, janë duke punuar në Kaçanik, sigurisht që nëse u kalon afati, ata duhet t'i kthejnë të gjitha mjetet e tyre në vendbanimin ose në selinë e tyre ku e kanë dhe kjo është një kosto e madhe për biznesmenët, por sigurisht edhe për qytetarët.

Andaj, edhe këtë pikë besoj që është mirë ta ndryshojmë dhe të jemi koherentë me konkurrencën e lirë të tregut dhe njëkohësisht dua ta falënderoj edhe Komisionit për Zhvillim Ekonomik për mbështetjen e kësaj nisme ligjore. Besoj që edhe nga ju të nderuar deputetë do të kemi mbështetjen tuaj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Sala Berisha-Shala, si kryetare e Komisionit, e ka fjalën për arsyetimin e raportit të komisionit.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, nënkryetar!

Përshëndetje ministër,

Kolegë dhe kolege deputetë dhe

Ju të pranishëm.

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, në bazë të nenit 56 paragrafit 2 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 26 qershor 2018, e shqyrtoi në parim Projektligjin nr. 06/L-064 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-132 për automjete dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

Rekomandim

Të miratohet në parim Projektligji nr. 06/L-064 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-132 për automjete.

Arsyetim

Në bazë të nenit 56 paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional para shqyrtimit të parë të Projektligjit në mbledhje plenare, e shqyrton në parim Projektligjin. Komisioni, pas shqyrtimit në parim të Projektligjit nr. 06/L-064 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-132 për automjete, vlerësoi se projektligji i plotëson kushtet e parapara në nenin 54 të Rregullore së Kuvendit dhe ia rekomandon Kuvendit për miratim në parim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Zoti Memli Krasniqi, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Nisma legjislative për plotësim-ndryshimin e Ligjit për automjete, edhe pse i ka trajtuar vetëm tri nene, megjithatë e ka marrë vëmendjen e të gjithë neve, por edhe të opinionit publik dhe unë mendoj që propozimet janë shumë racionale dhe ne e kemi mbështetur si grup, e veçanërisht dy

ndryshimet, të cilat nënkuptojnë transferimin apo bartjen e validitetit, periudhës së vlefshmërisë të regjistrimit të automjetit dhe taksave të tjera që të mos u shkaktohen shpenzime qytetarëve në momentin e transaksionit të shitblerjes së automjeteve.

Dhe, po ashtu, të drejtës që qytetarët të kenë mundësi ta realizojnë kontrollin teknik kudo në Kosovë dhe jo domosdoshmërisht lidhur me komunat e tyre. Ndërsa, sa i përket çështjes që ndërlidhet me limitin e moshës, apo kohës së prodhimit sa i përket importit të veturave, nëse shumica e njerëzve që edhe e kanë mbështetur limitin e kësaj periudhe në këtë kaluarën kanë pasur shqetësime që ndërlidhen me preokupime ambientale, unë besoj që propozimi që të standardizohet që asnjë prej veturave s'mund të jetë ndër standardin "Euro 4", megjithatë e adreson në mënyrë të drejtë këtë shqetësim. Gjithsesi, ne besojmë që pas kalimit në parim dhe miratimit në lexim të parë të këtij projektligji, Komisioni Funkcional, por edhe komisionet e tjera, do ta thonë fjalën e tyre, ndoshta mund t'i saktësojnë në mënyrë edhe më të mirë këto amendamente që i kemi para nesh, por besoj që në fund përfitimet do të jenë evidente për qytetarët e Kosovës pas miratimit final të ndryshimeve të propozuara. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Dardan Sejdiu e ka fjalën, në emër të PSD-së.

DARDAN SEJDIU: I nderuar kryesues, faleminderit për fjalën!

Gjithsesi si anëtar i Komisionit për Tregti e Industri, këtë nismë të deputetit Lushtaku e kemi proceduar për seancë dhe tri amendamentet që i ka propozuar për ne, dy janë amendamente që kanë kuptim dhe duhet të ecin përpara, ajo që është lidhur me koston e transferimit të automjetit te një palë tjetër, pra pas blerjes, dhe e dyta që ka të bëjë me kontrollin teknik.

Sa i përket vjetërsisë së veturës, unë mendoj që trajtimi duhet të jetë jo vetëm për kah aspekti ambiental, por edhe për nga aspekti i sigurisë. Në këtë drejtim, nëse më lejohet, unë do të tregoj ca statistika, ca numra që lidhen drejtpërdrejt me vjetërsinë e veturës dhe gjithashtu do të flas pak edhe për konceptin që ka të bëjë me emetimin e gazrave nga veturat që janë nën standard të caktuar dhe kapacitetin e kësaj republike për t'i mirëmbajtur vjet për vjet me standardin "Euro-4" pas importit të veturës për herë të parë. Sa për informatën tuaj, mesatarisht në Kosovë ndodhin 12 vrasje në vit. Ndërsa, nga aksidentet mesatarisht vdesin 160 persona në vit dhe qindra tjerë janë me lëndime të rënda, e me mijëra më të lehta.

Pra, problemi i vdekjeve të dhunshme në Kosovë lidhet kryekëput me aksidentet në trafik. Dikush mund të argumentojë që kjo nuk lidhet vetëm me vjetërsinë e veturave, por për hir të diskutimit dhe për hir të korrektesisë edhe ndaj temës, unë e kam bërë një hulumtim të vogël dhe e kam shikuar Agjencinë "Euronkap". "Euronkap" i publikon vit për vit testet e veturave në ato goditjet për ta parë se si një veturë reagon në shpejtësi të caktuar, dhe Agjencia "Euronkap" vitin e kaluar publikoi pas 20 vjetësh testimesh ngritjen e kapacitetit të sigurisë së veturës në komunikacion. Një veturë e vitit 1997 dhe një veturë e vitit 2017, në kushtet dhe rrethanat e

njëta, me shpejtësi prej 60km/h, në veturën e prodhuar të vitit 1997 ndodhin vdekjet, fataliteti. Në veturën e vitit 2017 nuk ndodh as lëndim. Pra, kemi avancime teknologjike të jashtëzakonshme për 20 vjetët e fundit, dhe këto avancime teknologjike kanë ndodhur kryesisht në dhjetëvjeçarin e fundit. Pra, me masat e sigurisë që janë marrë në këto.

Një studim tjetër i rëndësishëm që ka ndodhur është bërë në Australi dhe ky studim në detaje i ka analizuar të gjitha aksidentet dhe i njëjti studim vjen në përfundim që nëse mbërrihet të ulet mesatarja e vjetërsisë së veturës në komunikacion vetëm për një vit, pra nga 10 në 9, në 20 vjetët e ardhshme shpëtohen 1 300 jetë. Pra, këtu kemi të bëjmë edhe me diskutimin e sigurisë, jo vetëm me diskutimin e emetimeve të gazrave. Veturat më të vjetra se 10 vjet, apo mbajtja mesatare së veturës për 1 vjet më të re, shpëton jetë njerëzish.

Frashri do të flasë pak për mënyrën se si mund ta ruajmë këtë 10-vjeçar, e me anë të politikave fiskale të sigurohemi që qytetarët të kenë qasje në vetura, por të mos e trajtojmë temën vetëm për nga aspekti ambiental.

Tjetra? Dua të flas për emetimet dhe implementimin e një rregulli të tillë. “Euro-4” gjithsesi se duhet të jetë minimumi i veturave në qarkullim, por kjo nënkupton që një filtër që i thonë “DPF”, që është filteri i cili ndal grimcat partikulare inoksin, emetimin, pas një kohe të caktuar duhet të ndërrohen. Dhe, në Kosovë këto nuk ndërrohen fare. Çfarë ndodh, është që prishen dhe është që në kontrollat teknike nuk shikohet fare se çfarë po ndodh me “DPF-in”. Mesatarja e veturave të importuara mbi 10 vjet në kilometra të kaluar është mbi 150 mijë kilometra që kalohen dhe ky filtër duhet të ndërrohet në atë moment. Në momentin pra që importohet një veturë më e vjetër se dhjetë vjet, importohet me “DPF” ose të shkatërruar, ose me “DPF” i cili nuk është në gjendje ta ndalë emetimin e gazrave. Dhe ne nuk kemi kapacitete si republikë për t’u siguruar që çdo vit në kontrollim teknik ta fusim qytetarin ta ndërrojë këtë filtër. Kostoja e këtij filteri do ta rrisë për shumëfish koston e veturës për qytetarin, sepse duhet ndërruar çdo vit. Në mënyrë që të marrim vendime për këso lloj politika, kryetar. Pra, nuk është fare e thjeshtë, deputetë të nderuar, të themi po e heqim një kufizim, e po e vendosim një standard. Në mënyrë që të bëjmë politika të sakta të kësaj natyre, duhet të kemi statistika të sakta.

Çka ndodh nëse e heqim këtë kufizim 10-vjeçar dhe e vendosim kufizimin vetëm “Euro-4”. Veturat “Euro-4” prodhohen që nga viti 2005, pra i bie që automatikisht mosha e vjetërsisë së veturave që lejohet për t’u importuar është 5 vjet më e vjetër. Unë jua tregova statistikën vetëm për një vit çka ndodh me aksidente nëse rritet vjetërsia e veturave.

Tutje? Veturat më të vjetrat në Ballkanin, Perëndimor kështu qysh po i thonë tash, janë në Shqipëri, 20 vjet, në Kosovë është 19. Dhe, logjika e gjërave është që të sigurohemi që me instrumente dhe kapacitete fiskale ta ulim koston për qytetarin që të sjellë veturë edhe të sigurt për të dhe fëmijët e tij, hiç më larg se dje e keni pasur një aksident i cili është shpërfaqur në

medie, dhe, në anën tjetër, të sigurohemi që e ruajmë ambientin duke pasur masa që mund ta zbatojnë një politikë të caktuar. Nëse ne si Kuvend vendosim ta heqim kufizimin 10-vjeçar dhe ta vendosim standardin “Euro-4”, për dy amendamentet tjera të zotit Lushtaku jemi dakord, por për këtë jam thellësisht i brengosur. Nëse vendosim ta heqim këtë kufizim, atëherë duhet të ngremë kapacitete që secilën veturë, e cila qarkullon në Republikën e Kosovës, ta testojmë për “Euro-4”, dhe jo vetëm në import.

E, pra çdo vit në kontrollim teknik duhemi të kemi pajisje, mekanizëm që e kontrollon kontrollin teknik, se ju e dini si bëhet kontrolli teknik, bëhet me fotografi të veturës dhe kjo është temë për një interpelancë sigurisht, atëherë përfundojmë në ruajtjen e vjetërsisë së veturave, në ngritjen e potencialit për aksidente me fatalitet dhe në uljen apo në mosluftimin e ndotjes, ndonëse e kemi votuar këtu një rezolutë, nëse e mbani në mend, e cila lidhet saktësisht me temën e ndotjes së ajrit. Pra, të nderuar deputetë, është tepër me rëndësi që për tema të këtilla, sidomos kur kanë të bëjë me siguri e ambient, aksidente me fatalitet dhe pa to, t’i kemi saktë numrat, saktë analizën para se të vlerësojmë nëse e heqim një standard, i cili unë besoj ka shpëtuar shumë jetë të njerëzve në Kosovë, duke pasur parasysh importin që e kemi bërë me dhjetë vjet.

Në anën tjetër, nëse duam që qytetarët tonë të kenë qasje në vetura me kosto të përballueshme, atëherë duhet t’i mendojmë politikën që lidhen me zhdoganime, lidhur me koston e importit të veturës së re, apo edhe veturave që janë deri në dhjetë vjet të vjetra, por assesi të ecim tutje duke menduar heqjen e kësaj mesatareje dhe ngritjen e potencialit për importim të veturave më të vjetra se dhjetë vjet.

Qëndrimi i Partisë Socialdemokrate sa i përket kësaj teme është që jemi në përkrahje të dy amendamenteve: e para, që ka të bëjë me kontrollin teknik, dhe e dyta, që ka të bëjë me koston për bartjen e pronësisë së veturës, por jemi kundër amendamentit, i cili e heq vjetërsinë e veturës mbi dhjetë vjet dhe e vendos në “Euro4”. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Muharrem Nitaj e ka fjalën.

MUHARREM NITAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Nuk ka asnjë dyshim që nisma për ndryshimet në këtë listë është një nismë e jashtëzakonshme, shumë e domosdoshme, e nevojshme, ka shumë mangësi, të cilat duhet të korrigjohen. Mirëpo, edhe ne i kemi rezervat tona për sa i përket vjetërsisë së automjeteve, e që është amendamenti i 3-të nga propozuesi.

Besojmë për shembull që nuk duhet ta krijojmë një mekanizëm, një hapësirë, një instrument për importin e bërllokut që vendet e zhvilluara të Bashkimit Evropian moti e kanë hequr nga tregu i tyre, në mënyrë që Kosovën ta shndërrojmë në njëfarë lloj strehe apo varreze të automjeteve me

të cilat kompani të ndryshme ka kohë që bëjnë biznes në Kosovë dhe sigurisht duke e rrezikuar edhe jetën e qytetarëve. Edhe në sqarimin ose në propozimin e zotit Lushtaku, me aq sa unë arrita të evidentoj, ka ose pati shumë paqartësi, sigurisht që në lexim të parë do ta mbështetim, por do të jemi shumë të fokusuar, të interesuar dhe të përfshirë në përpilimin e saktë të amendamenteve dhe ndryshimeve që janë të domosdoshme, posaçërisht në trajtimin e amendamentit 3, në mënyrë që të mos shndërrohet thashë në njëfarë lloj leve që ta bartim bërlllokun e nxjerrë jashtë përdorimit nga vendet e zhvilluara në Kosovë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Sherifi, e keni fjalën.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, zoti kryesues!

Në parim, ne edhe në komision u kemi dhënë mbështetje amendamenteve të deputetit Lushtaku, sidomos këtyre dy amendamenteve që kanë të bëjnë me kontrollin teknik dhe bartjen e kostos. Ndërsa, po ashtu edhe në komision sa i përket vjetërsisë së veturës e kemi pasur një debat për të cilin në parim unë mendoj që deputeti Lushtaku ka të drejtë. Në parim. Mirëpo, atë që e kam thënë në komision, po ia them edhe në seancë. Si deputetë të mazhorancës kemi për detyrë që të koordinohemi kur bëjmë propozime, amendamente në funksion të ndryshimit të ligjit, të konsultohemi së paku me ministrinë përkatëse dhe nëse jo me të gjitha ministrinë, së paku me dy ministrinë që kanë të bëjnë me temën, siç është ajo e Transportit dhe Ministria e Ambientit, në mënyrë që të vijmë të harmonizuar.

Unë e di që është e padrejtë ashtu siç edhe argumentoi zoti Lushtaku atëherë në komision, që qytetarët nuk kufizohen për nga mosha e veturës, vjetërsia, nëse ai i plotëson standardet “Euro-4”, siç edhe elaboroi kolegu Sejdiu mjaft mirë.

Ne e kemi krijuar këtu në Kosovë një traditë që në mungesë të kapaciteteve administrative pastaj bëjmë kufizime në bllok për gjithçka. Për shembull, meqë nuk arrijmë të mbledhim taksën për Radiotelevizionin e Kosovës, ne e kushtëzojmë me pagesën e rrymës. Pra, e shtijmë qytetarin të paguajë aty ku e zëmë, në mungesë të ngritjes së kapaciteteve administrative. Tash, nëse argumenti i deputetit qëndron në atë se po bëhet padrejtësi duke ia mohuar një të drejtë qytetarit që të sjellë një veturë e cila i përmbush standardet e “Euro-4, Euro-5”, e kështu me radhë, në mungesë të kapaciteteve administrative, zgjidhja nuk mund të jetë sa i përket këtij amendamenti, që meqë s’ka kapacitete hajde tash ta lejojmë. Pra, asnjëra nuk e përjashtojnë njëra-tjetrën, mendoj që në të dyja duhet të punohet paralelisht.

Në parim, kjo çështje duhet të mbështetet, por në konsultim me Qeverinë, me ministrinë përkatëse kur, në çfarë periudhe kohore do të mund të bëhej ky ndryshim, kur Qeveria, përkatësisht ministrinë përkatëse, do të mund të krijojnë siguri se veturat “Euro-4” në letër, vërtet edhe në rrugë do të jenë “Euro-4”. Pra, a do t’i kenë ata filtra vazhdimisht efikas për ta kryer funksionin e tyre, apo nuk do t’i kenë. Për këtë pastaj hynë në punë dhe do të duhej të

kontrollohen qendrat e kontrollit teknik. A e bëjnë si duhet atë kontroll teknik, apo nuk e bëjnë? Nëse nuk e bëjnë, njëherë së pari duhet të ngrihen kapacitetet që të sigurohemi se ato vetura jo vetëm që janë funksionale vetëm kur të hyjnë në Kosovë, por vazhdojnë të qëndrojnë funksionale dhe të jenë “Euro-4” edhe kur të jenë në rrugë pas 6 muajve, pas një viti, e kështu me radhë.

Unë mendoj që kjo çështje, sidomos që u përmend edhe në aspektin e sigurisë, po duhet gjithsesi në analizën e ministrisë, së bashku me deputetin, së bashku edhe me komisionin të analizohet edhe ky këndvështrim dhe të shihet që në këtë fazë së paku të mbështeten këto dy amendamente dhe të bëhet ndryshimi në këto dy nene të ligjit, sepse këtu vërtet është totalisht e pakuptimtë që paratë i paguan blerësi i parë të mos barten tek tjetri dhe të mos mund ta bëjë kontrollin teknik edhe në komunat tjera, por gjithsesi të jetë i detyruar në komunën e tij. Pra, këtu vërehet se në mënyrë të njëhershme do të mund të lehtësohet ta quaj ashtu “jeta e qytetarëve”, të cilët kanë nevojë për këto shërbime administrative. Ndërsa, çështja e vjetërsisë le të mbetet, të mos e bëjmë ne njëanshëm, por le të bëhet në koordinim me ministrinë përkatëse kur ato do të mund të zotoheshin se do të fillojnë punën me ngritjen e kapaciteteve administrative dhe në çfarë periudhe do të mund ta marrim në konsideratë ndryshimin edhe të këtij amendamenti, duke pasur parasysh pra edhe ambientin dhe siç e elaboroi në mënyrë jashtëzakonisht të mirë kolegu Sejdiu, edhe në rrafshin e sigurisë.

Pra, në këtë fazë do ta mbështetim ligjin në tërësi, në lexim të dytë shpresojmë që së bashku me deputetët dhe ministrinë do të arrijmë që t'i ndajmë këto tri amendamente, njëra siguria dhe ambienti, që ka të bëjë me atë nenin për vjetërsinë të ndahet veç, dhe këto të dyja të procedohen menjëherë, por çështja e vjetërsisë të mbetet për një fazë më të vonshme dhe të ecim përpara. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Frashër Krasniqi e ka fjalën.

FRASHËR KRASNIQI: Të nderuar deputetë!

Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,

Mendoj që nëse flasim për atë se çfarë ndikimi ka ky kufizim te qytetarët, atëherë mendoj që tema thelbësore nuk është kufizimi kohor i vjetërsisë së një makine, për mua tema e cila i prek realisht qytetarët është politikat fiskale në lidhje me importin e makinave.

Kosova ka politika fiskale të tilla, të cilat importin e makinave, qofshin ato normalisht, pavarësisht vjetërsisë së tyre, e bëjnë shumë të shtrenjtë. Unë konsideroj që edhe nëse e heqim këtë kufizim kohor, nuk është se po ia lehtësojmë jetën qytetarit, ose po ia bëjnë çmimin më të lirë për blerjen e një veture, ndërkohë që po krijohen probleme të tjera shtesë, si ato të ambientit dhe të sigurisë. Prandaj, për mendimin tim, nëse si pikënisje do ta kishim interesin e qytetarëve karshi blerjes ose importit të makinave, do të duhej ta ndërmerim një nismë legjislative për

uljen e akcizës ose pagesave tjera që lidhen me zhdoganimin dhe importimin e makinave nga jashtë dhe po e them këtë për shkak se Kosova momentalisht ka politika të tilla fiskale sa i përket importit të makinave që do të mund të ishin të justifikueshme nëse ne si shtet do të prodhohim makina dhe për hir të mbrojtjes së prodhimit vendor atëherë do t'i rritnim akcizat dhe taksat doganore e kështu me radhë, në mënyrë që t'i japim përparësi prodhimit vendor dhe jo importit të makinave.

Mirëpo, ne e dimë që jemi shumë larg prodhimit të makinave dhe nuk kemi prodhim vendor për këtë çështje, kështu që për mendimin tim, politikat tona fiskale në raport me importimin e makinave janë komplet të pajustificueshme dhe të paarsyeshme. Besoj që si pikënisje e kanë thjesht mbushjen e Buxhetit të Kosovës me para, për shkak se burimi kryesor i Buxhetit të Kosovës ne e dimë që janë Doganat. Kjo është problem dhe këtë problem, për shembull, vendet e rajonit e kanë trajtuar ndryshe, ne e kemi edhe Shqipërinë, e kemi edhe Malin e Zi, besoj se edhe vendet tjera, por për këto dyja kam më shumë informacion, të cilat e kanë pagesën 4 ose 5 herë më të ulët për zhdoganim të veturës ose për import (akcizat e këto...) i kanë 4-5 herë më të ulëta se sa i ka Kosova.

Prandaj, unë konsideroj se miratimi i një ligji të këtillë nuk do të kishte efekt të rëndësishëm në jetën e qytetarit, në kuptimin e asaj se me çfarë çmimi, ta zëmë, e blen një makinë. Sot pothuajse njëjtë është sikur nëse e blen një makinë të vitit 2008, 2007, 2006, sikurse nëse e blen një makinë më të re, sa i përket zhdoganimit dhe importimit të saj qytetarët e Republikës së Kosovës do të paguajnë njësoj.

Konsideroj që nuk ka ndonjë efekt kjo politikë dhe do të mund të përmirësohej kjo çështje shumë më mirë, po qe se bëjmë një nismë legjislative për ndërrimin e politikave fiskale karshi importimit të veturave. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Reshitaj si përfaqësuese e Qeverisë, që të paraqesë qëndrimin e Qeverisë për projektligjin. Zonja Reshitaj, e keni fjalën.

MINISTRJA ALBENA RESHITAJ: I nderuar nënkryetar,

I nderuar ministër,

Të nderuar deputetë,

Që nga ardhja ime në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor kam tentuar që me masa proaktive kufizuese të ndryshojmë gjendjen e përgjithshme të mjedisit dhe posaçërisht reduktimin e ndotjes së ajrit.

Që në takimin e parë të task-forcës ndërministrrore për trajtimin e mjedisit, të cilën e udhëheq, kam shprehur shqetësimin mbi ajrin e ndotur dhe lirimin enorm të gazrave të dëmshme. Kam

kërkuar nga Ministria e Infrastrukturës që të fillojë kontrollimin e gazrave të veturave gjatë kontrollimit teknik.

Të nderuar deputetë, ne mbajtëm edhe një seancë, faktikisht ju mbajtët një seancë të jashtëzakonshme për të shikuar se si mundemi bashkërisht të ulim nivelin e ndotjes së ajrit dhe nga ajo seancë doli një rezolutë e Kuvendit, e cila u miratuar në shkurt të 2018-ës. Rezoluta e Kuvendit që ju e keni miratuar para 5 muajve kërkon nga Qeveria që të kontrollojë cilësinë e gazrave që emetohen nga automjetet, ndërsa ju sot para vetes keni një projektligj mbi ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të automjeteve, që rrezikon implementimin e kësaj rezolute, nga se ky projektligj parasheh lejimin e importimit të veturave më të vjetra se dhjetë vite.

Të nderuar deputetë,

Ju pyes juve që votuat rezolutën e shkurtit, se si është e mundur të reduktohet ndotja nga lirimi i gazrave të automjeteve, kur me anë të këtij projektligji parashihet lejimi i importimit të veturave të vjetra, që shumica nuk i plotësojnë standardet minimale të kërkuara nga Bashkimi Evropian. Si ministri jemi duke bërë një vlerësim gjithëpërfshirës së cilësisë së ajrit në bashkëpunim me Agjencinë Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe sipas të gjitha parashikimeve veturat e vjetra ndikojnë në mënyrë substanciale në ndotjen e ajrit. Andaj, sot është në dorën tuaj, deputetë të nderuar, të ndalni apo të rrisni nivelin e ndotjes së ajrit, të rrezikoni apo të mbronni jetët e qytetarëve tanë në komunikacion, pasi që veturat e vjetra janë të pasigurta dhe si pasojë e mungesës së sigurisë mund të shtohen aksidentet në komunikacion.

Me heqjen e kufizimit të vjetërsisë, siç e sheh projektligji, ne rrezikojmë importimin e veturave që nuk janë në përputhshmëri me standardet minimale të Bashkimit Evropian, konkretisht jo të pajisura me katalizatorë të standardit Euro-4. Për faktin që sektori i automjeteve është një ndër burimet e ndotjes së ajrit, veçanërisht në Kosovë, ku qarkullojnë një numër i madh i automjeteve të vjetra, kërkojmë nga Kuvendi i Kosovës që në fazën e amendamentimit të Ligjit për automjete të merren parasysh edhe çështjet mjedisore. Të rishikohet vendimi për importimin e automjeteve, të implementohen dispozitat e Udhëzimit Administrativ 08/2016 për normat e lejuara të shkarkimeve në ajër nga burimet e lëvizshme të ndotjes. Ky udhëzim administrativ i lëshuar nga Qeveria pas kërkesës së Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor rregullon në mënyrë të detajuar normat e lejuara të shkarkimeve në ajër nga automjetet.

Ne mendojmë se lejimi i importimit të veturave të vjetra dhe pa standard minimal të Bashkimit Evropian do të bëjë të pamundur zbatimin e Udhëzimit Administrativ të nxjerrë nga Qeveria dhe është në kundërshtim me Rezolutën e Kuvendit të miratuar në shkurt nga ana juaj.

Krejt në fund, dëshiroj ta bëj të qartë një gjë. Ne nuk jemi kundër importimit të automjeteve më të vjetra se dhjetë vite dhe privimit të qytetarëve tanë nga e drejta për të importuar një automjet më të vjetër se dhjetë vite, mirëpo jemi për respektimin e normave minimale të Komisionit

Evropian në fushën e ajrit, që nënkupton që çdo automjet në qarkullim dhe që importohet duhet të plotësojë të paktën normën minimale të Bashkimit Evropian, që së paku të posedojë katalizatorin Euro-4. Gjithashtu, ky ligj duhet të rregullojë kontrollin teknik të automjeteve në qarkullim në Republikën e Kosovës e që nuk janë më pak se 350 000 automjete, shumica e të cilave nuk i plotësojnë këto standarde.

Të nderuar deputetë,

Sot jeni para një vendimi, të lejoni importimin e veturave të vjetra, që do të kontribuonte në të hyrat nga importi, por që do të ndikonte negativisht në mjedis në përgjithësi dhe në shëndetin e qytetarëve, në veçanti. Zgjidhja është e juaja. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti, shoku Milaim Zeka e ka fjalën.

MILAIM ZEKA: Faleminderit, shoku Xhavit! Shumë faleminderit!

Unë shkurt dua t'i mëshoj. Veç arsyeja pse e mora fjalën është kjo: Me e ditë qytetarët e Kosovës se ligji i propozuar sot nga ministri i Drejtësisë, zoti Abelard Tahiri, nuk kaloi vetëm për shkak të fajit të Partisë Demokratike të Kosovës.

Tre deputetë s'keni qenë në sallë kur u votua. Pesëdhjetetë vota qenë, po shkoni nëpër të pame a s'di unë kah po ngani teposhtë e përpjetë. Kështu që, kërkojuni falje qytetarëve. Nuk keni nevojë, as të shisni hipokrizi, as ta kritikoni opozitën. Çohuni atje, thoni "Na falni, se për fajin tonë s'kaloi ligji!". Ne nuk jemi këtu si pozitë që ta lusim opozitën të na i aprovojë ligjet, as të na ndihmojë. Opozita e ka veç një detyrë, po të mundet sa më shpejt, jo të na rrëzojë, po të na gjuajë në llagëm.

Kështu që, në qoftë se ne nuk jemi seriozë si pozitë për ligjet tona, të vijmë me rregull në seanca, mos e kritikoni opozitën. Kjo e para.

E dyta, Dardani s'qenka këtu. Ai dhe ministrja folën për katalizator. Po të mund të na bëhej edhe ndonjë katil... katalizator të trurit, kështu që të na e filtrojë nga pak edhe trurin do të bohej mirë, se i kemi në Kosovë njëmijë e pesëqind deponi ilegale, ministre.

E treta, propozim për ligjin konkret që u propozua, që e kam për zotën Lushtaku e që e falënderoj shumë për këtë iniciativë. Me sa e di unë, në Skandinavi bëhet regjistrimi i makinave një herë në dy vjet. Kështu që, verifikojeni mirë. Do të ishte mirë, që qytetarëve të Kosovës t'u hiqet kjo barrë, që çdo vit i regjistrojnë makinat edhe është një kosto tepër e lartë. Unë e kam njëfarë kerri "xhangalle" aty, por kur po i paguaj të gjitha gjërat që po m'i kërkojnë, po shkon deri në 400-500 euro. Është mirë me e futë një klauzolë aty, që një herë në dy vjet të bëhet regjistrimi i kerreve, jo sigurimi po regjistrimi i makinave. Kaq. Faleminderit!

KRYESUESI: Milaim, kontrolli teknik për makinat e reja bëhet një herë në dy-tre vjet, por regjistrimi bëhet çdo vit gjithkund. Unë ashtu e di, në rregull. Zonja Haxhiu e ka fjalën.

TEUTA HAXHIU: O nënkryetar, përmende emrin, Teuta Haxhiu, prandaj, se ajo zonja Haxhiu që ishte e zënë pasdite e mori në qafë edhe grupin, sepse e kritikuan e shkoi. Prandaj, përmende emrin çdoherë. A mund të vazhdoj tash, edhe pse jam me kartelë të kolegut Kuçi.

Duke mos qenë shumë e mishëruar në këtë pjesë të këtij ligji, unë po e ngre një shqetësim që vjen prej qytetarëve, ngase kisha dashur me... nuk e di se cili prej ligjeve e rregullon, por meqë po e diskutojmë ligjin e propozuar nga kolegu Lushtaku për automjetet, një shqetësim i qytetarëve që vazhdimisht më është adresuar, është që nëse qytetarët sjellin nga një shtet i Evropës një veturë, edhe pse është brenda dhjetëvjetëshit, problemi kryesor është se në Dogana në qoftë se ata nuk e prezantojnë çmimin se sa e kanë marrë atje apo mund, kushtimisht të them, t'i mashtrojnë që është dhuratë, shkojnë sipas një katalogut në Doganë. Në të kundërtën, nëse sinqeriteti i qytetarëve vjen dhe ata prezantojnë veturën sa e kanë marrë atje, atëherë po e jap një rast konkret. Një Golf i blerë në fakt prej 4000 euro atje, ka kushtuar 2700 euro doganë, i vitit 2002.

Domethënë, ky është një mashtrim që tregon edhe një herë se nuk duhet qenë të sinqertë, por duhet çdoherë të manipulohet për të ardhur në vend, pra me dokumente që rregullohen prej ligjeve të caktuara.

Pra edhe një herë, në këtë rast siç është thënë, një katalog në Dogana, pra duhet me e rregullua edhe këtë aspekt. Nëse vetura është e vitit që është e paraparë, ta zëmë 2002-sh, apo 2003-sh, do të duhet të vlerësohet ashtu siç është e paraparë në katalog e jo të vlerësohet dyfish apo 100% në vlerën më tepër se sa vet vlerësimi që i është bërë. Unë konsideroj që ky vërtet është një mashtrim dhe ishte dashur të jetë e rregulluar. Nuk e di, thash edhe në fillim, nëse e rregullon ky ligj apo ligjet tjera. Në këtë aspekt, nëse ka mundësi që brenda këtij ligji, është mirë edhe këtë aspekt të shihet mundësia për ta rregulluar. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Reçica e ka fjalën.

ELMI REÇICA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Kërkova fjalën më herët për ta sqaruar një situatë, jo për të replikuar.

Së pari, duhet ta kemi parasysh që vërtet është dëshmuar që jemi të padisiplinuar dhe nuk jemi të rregullt, edhe deputetët, edhe Qeveria, edhe ata që po e udhëheqin seancën.

Në anën tjetër, do të duhej këta që jemi së paku të jemi korrektë dhe të jemi të saktë, si dhe të jemi të përgjegjshëm. Në ligjin të cilin e përmendi zoti Zeka më herët, vërtet kanë munguar

vetëm shtatë deputetë të PDK-së dhe nuk është e rëndësishme sa kanë munguar deputetë të PDK-së, po kanë munguar një pjesë e madhe e deputetëve si tërësi. Prandaj, do të ishte mirë që jemi tash kah fundi i këtij muaji, kur Kuvendi duhet ta përmbyllë sesionin pranveror të punimeve, do të duhej bile së paku kah fundi, se po e vëreni edhe në sport dikur kah fundi edhe lojtarët vet pak mobilizohen më shumë për të realizuar atë që është interes i atyre që i shikojnë dhe që realisht janë të përgjegjshëm për punën dhe angazhimin e tyre. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Haradinaj e ka fjalën. Ah, replikë Milaimi, a?

MILAIM ZEKA: Veç desha ta falënderoj zotin Reçica, që e konfirmoi atë që e thashë. Jo, e konfirmoi, tha... prit, prit, ngadalë, ani çohu fol ti. Unë me Reçicën e kam, s'po ta përmend ty emrin. E konfirmoj se ju keni munguar sot edhe deputetët tjerë. Deputetët e Nismës kanë qenë të gjithë në sallë. Tash, s'po flas unë me emra e mbiemra. E vërteta është që edhe Çoçaj gjithnjë mungon, ose rri atje jashtë e nuk vjen të votojë, duke pirë cigare edhe qe qashtu. Ta përmenda emrin, tash repliko. Po, e vërteta është se keni munguar edhe s'keni qenë në sallë dhe më vjen keq që s'kaloi ligji. Kurrgjë për të keqe s'e pata, veç këshillë, se s'e pata për të keq. Prapë mungoni, s'ka problem.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Reçica e ka fjalën për kundër-replikë.

ELMI REÇICA: I nderuar zoti Milaim Zeka, Ju thatë, "as tre deputetë të PDK-së nuk kanë qenë në votim". Më dëgjo, "as tre deputetë", kjo u tha. Nëse dëshiron ta demantosh vetveten, urdhëro! Por, nuk është e vërtetë. Kjo nuk është hera e parë, që unë po e them një realitet që po e shohin të gjithë. Nuk jam struc ta fus kokën në zallë, por po e them atë çfarë po shihet. Megjithatë, nuk është mirë me e teprua, me shkua përtej asaj që është reale dhe e dukshme. Kaq!

KRYESUESI: Zoti Çoçaj Replikë, se ia... edhe mos reagoni, bre, për emrat, se po ua përmend emrin...

NEZIR ÇOÇAJ: Faleminderit, zoti nënkryetar.

Sa për sqarim, nëse dikush nuk pi duhan, jam unë që nuk pij duhan në këtë Kuvend të Kosovës si deputet. Po, nëse dikush s'pi hiç bash hiç, edhe se e kam mërzi të rri me duhanxhi dhe me tym të duhanit jam unë.

Tjetra, Milaimi e ka mirë, se i ka tre deputetë edhe kur të dojë i mbledh, por ne që jemi 25 a 30 ku t'i mbledhim, o Milaim. Ju tre i keni, kollaj e keni, veç me emra me i thirr kështu, dalin kollaj.

KRYESUESI: Milaimi e ka fjalën, replikë.

MILAIM ZEKA: E para, zoti Reçica, nuk thash “as tre deputetë”, thash “na kanë munguar tre deputetë, se pesëdhjetetë kemi votuar”. Eh, thash “kanë munguar tre deputetë”, njëri prej atyre që keni munguar ke qenë ti me dy vetë djathtas. Një.

E dyta, ne nuk jemi tre, zoti Çoçaj, por jemi gjashtë e kur të duash edhe ne të gjashtëve ta biem atë mocionin prapë edhe ju rrëzojmë kur të duash, s’është kurrfarë problemi. Në kokërr të shpinës ju qesim. Si për hair, si për sherr, për hundësh ju dalim, eh!

KRYESUESI: Zoti Çoçaj ka kundër-replikë.

NEZIR ÇOÇAJ: Faleminderit!

Edhe një herë, se po bie me u marrë me Milaimin shumë, po pasi që e kemi kolegë të kamotshëm.

Milaim, kurrë PDK-ja s’është tutë për zgjedhje, jo... sot, sonte mundemi në ora njëzetetë me shkua në zgjedhje, jo mbas një jave, mbas një muaji a mbas gjashtë muajsh. Ti, pas një ore, kur të duash, veç e thërrasim kryetarin, i njoftojmë të partisë edhe i hapim zgjedhjet.

KRYESUESI: Mua po më duket edhe ti edhe Milaimi, po flisni pa u konsultua në parti. Kështu që, kini parasysh që ka njëfarë strukture të partisë e ka rregulla të tjera. Mos i jepni vetes të drejtë të flisni edhe për zgjedhje edhe për parti, si individë. Kemi ne... këta e kanë Fatmirin, ne e kemi Kadrinë, kemi Kryesinë, ngadalë... se, desha të them diçka dhe... A dëshiron ta marrësh fjalën? Por, jo për replikë, diskutim. S’ke të drejtë në replikë.

Hajde, zoti Reçica, mbasi tanët qenkemi të gjithë, s’hidhërohet kush. Fjalën e ka zoti Reçica.

ELMI REÇICA: Jo që s’hidhërohet, po edhe gëzohet opozita, thonë ja si po polemizojnë pozita ndërmjet vete.

Unë porosita, kërkova në të vërtet, që të nxirret votimi për ligjin në fjalë që e diskutuam deri tash. Nëse del që unë nuk kam votuar, i kërkoj falje zotit Zeka. Por, duke e njohur Zekën, që është shumë korrekt në këtë aspekt, besoj që do të kërkojë falje kur të merret vesh se unë kam votuar, dhe kam votuar për atë ligj, dhe kam qenë këtu.

KRYESUESI: Faleminderit! Ju keni të drejtë ta shihni listën e votimeve. Është publike, nuk është ndonjë sekret. Veç diçka, meqenëse kështu... ju e dini që kryetari, respektivisht Kryesia ka marrë një vendim, që kur të ketë seancë me votime nuk duhet dalë jashtë vendit, ose duhet spostuar seancën. I kemi disa deputetë që janë jashtë vendit, disa që kanë me shkua nesër dhe po ju them që nuk është mirë, që nesër ta vazhdojmë seancën pa deputetë në sallë.

Është mirë, vërtet edhe një herë po ua përsëris, që të bisedoni, se detyra jonë është këtu, jo diku tjetër. Por, kur ka nevojë, kur është domosdoshmëri, mund ta rregullojmë me e bë postimin e seancave, me i rregullua afatet dhe kohën kur është e domosdoshme me dalë jashtë Kosovës.

Zoti Bekim Haxhiu e ka fjalën.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Përpara se të futem në çështje, unë mendoj që mungesa sot e opozitës në diskutimet për ligjet të cilat nuk janë dhe s'do të jenë vetëm në shërbim të partisë në pushtet apo të partive në pushtet, por do të jenë ligje për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës. Edhe zoti Zeka po mundohet atë vakum të opozitës me e plotësua me disa gjuajtje të vogla brenda koalicionit qeveritar, që mendoj se veç pak japin një ngjyrim diskutimeve në Parlament por që nuk do të kenë ndonjë efekt, përveç një shprehje dëshire apo individuale të zotit Zeka, të cilin e respektojmë të gjithë për shkak se nganjëherë di t'i nxisë këto debate, por që nuk kanë ndonjë efekt përmbajtësor, ose që nuk do të prodhojnë ndonjë efekt tutje.

T'i kthehemi ligjit për të cilin po diskutojmë, duke e njohur edhe lexuar marrëveshjen e Kosovës apo pranimin e Kosovës në MSA, obligimet e Republikës së Kosovës të cilat dalin nga MSA-ja, mënyrën e regjistrimit, doganimit apo të zhdoganimit të automjeteve. Ky ligj apo ky propozim ligji bash nuk përkon me atë. Unë kam pritur që ne si deputetë të trajtojmë çështjen e regjistrimit apo që Ministria e Financave bashkë me Doganat të rregullojnë një çështje, e cila prej se është miratuar Ligji për invalidë dhe familje të dëshmorëve nuk po arrihet të implementohet si duhet, ajo lehtësi që ua kemi dhënë familjeve të dëshmorëve apo invalidëve për regjistrimin e automjeteve apo lirim të tyre nga doganat e të cilët nëse pas pesë vjetësh duhet ta ndërrojnë automjetin, atëherë ajo për të cilën janë liruar pesë vite më parë duhet ta paguajnë sërish dhe duhet ta paguajnë në vlerën me të cilën është vlerësuar pesë vite më parë automjeti i tyre.

Ju e dini që kur ligji në fjalë ka kaluar në Parlament dhe ka hyrë në fuqi ka qenë një periudhë kohore, kur numri i automjeteve të sjella nga jashtë vendi ka qenë enorm, deri në kohën kur është lejuar futja e tyre, e automjeteve më të vjetra se dhjetë vjet. Mendoj që aq shumë automjete janë futur në Kosovë në atë periudhë kohore, sa që edhe për disa vjet nuk ka nevojë më të lejohet një gjë e tillë. Kërkesa më shumë mund të ketë impakt biznesi, se sa impakt për qytetarin. Automjetet nuk e rregullojnë çështjen sociale, janë mjete transporti. Po qe se mendohet t'u ndihmohet kategorive sociale, atëherë mund të diskutojmë për lirim të çmimeve apo ofrimin e mbështetjes së tyre, të kategorive sociale që të mbulohet pagesa e transportit të tyre me automjete të transportit publik. Por, që t'u ndihmojmë kategorive sociale apo në emër të kategorive sociale të kërkohet të bëhet një ndryshim i tillë, që të futen automjete të cilat nuk i plotësojnë standardet e në veçanti janë në kundërshtim edhe me kriteret brenda MSA-së, mendoj që ky Parlament nuk

duhet votuar një projektligj të tillë. Nuk e mbështes, përveç asaj që “Euro-4” është standard që do të duhej të plotësohej nga të gjitha institucionet tona, por edhe ka mundësi si qytete apo kuvende komunale që për qarkullim nëpër qytete të tyre, për shkak të ruajtjes së ambientit, të vendosin edhe kritere të tjera. Ta zëmë, ju e dini që në disa qendra të qyteteve evropiane kanë kriter, që për t’u futur në qendër duhet të ketë automjeti të paktën “Euro-5”, ose “Euro-6”, varësisht prej nivelit të cilin e vendos vetë, ose sa i kushton rëndësi vetë qyteti ruajtjes së ambientit.

E mbështes plotësisht diskutimin e ministres, i cili vërtet ishte në frymën e asaj që ne kemi diskutuar këtu në Kuvend, kur ambientit në vetë kryeqytetin ishte jashtë çdo norme të lejueshme edhe ne në Prishtinë kishim ndotjen më të madhe të ambientit nga qytetet botërore dhe nëse ato masa i kemi votuar në Kuvend, atëherë ne duhet t’i mbrojmë si deputetë. Faleminderit!

KRYESUESI: I fundit është propozuesi, zoti Lushtaku.

MËRGIM LUSHTAKU: Së pari ju falënderoj të gjithëve për kontributin në debat për këtë projektligj dhe për këtë nismë ligjore.

Gjithashtu i falënderoj gjithë ata deputetë që e kanë mbështetur këtë nismë ligjore, në mesin e tyre Nezir Çoçaj, Ganimete Musliu, Sala Berisha-Shala, Evgjenia, Luljeta, Andini e të tjerët.

Sa u përket çështjeve të ngrehura, këtu kishim çështje të dy rrafshëve që e kam vlerësuar që kanë prekur. Është çështja e sigurisë dhe çështja e ambientit.

Dardan Sejdiu e përmendi, fatkeqësisht nuk është këtu, e falënderoj që i ka mbështetur pikat tjera ose nenet tjera.

Po te çështja e importimit të veturave më të vjetra se 10 vjet, u tha nga Dardani, por edhe nga shumë deputetë, se do të rrezikojnë ambientin dhe njërin ndër rastet e përmendi edhe çështjen e aksidentit fatal fatkeqësisht të një familje që e ka humbur jetë, së cilës i shpreh ngushëllime.

Por, me sa di vetura e atij personi të atyre familjarëve ka qenë një veturë më e re dhe faktori nuk ka qenë çështja e veturës së vjetër.

Dhe, është keq të keqpërdoret kjo nismë ligjore dhe me arsyetim se kjo do ta rrezikonte jetën e qytetarit.

Ne e dimë shumë mirë që nëse kemi dogana të vërteta, kontrollime teknike të vërteta, homologim të vërtetë, edhe siguria është gjithmonë në nivel, pasi edhe vjetërsia e veturave edhe në Evropë, siç e thashë në fjalimin tim, nuk është e domosdoshme që vjetërsia të jetë pika kyçe e

sigurisë. Pasi shumica e veturave të vjetra janë në qarkullim në BE, besoj që shumica e deputetëve kemi rastisur dhe kemi shkuar në shumë vende të Evropës dhe e kemi parë se atje ka vetura të vjetra, edhe më të vjetra se në Kosovë, dhe nuk është rrezik vjetërsia.

Ndër statistikatat e fundit që ka për çështjen e rrezikimit në komunikacion është vetë shpejtësia. Përveç shpejtësisë, kemi edhe moszbatimin e ligjit ose kujdesin ndaj shenjave të komunikacionit e tjera e tjera, por nuk është vjetërsia e veturave.

Fatkeqësisht nuk e kemi një statistikë të qëndrueshme që thotë që vjetërsia e makinave është shkaku kryesor i aksidenteve në Kosovë.

Duhet ta dimë që për këto statistika kemi nevojë dhe ne si deputetë edhe si Kuvend edhe të gjitha institucionet për arsye se në bazë të këtyre statistikave mund ta krijojmë edhe një imazh më të mirë sesi t'i krijojmë politikat tona karshi qytetarëve duke i zbatuar ato dhe duke i hartuar ato në ligje.

U përmend gjithashtu nga Dardan Sejdiu që filtrat nuk do të kontrolloheshin nëse do t'i lejonim importin e veturave. Unë e shtroj pyetjen pse janë atëherë kontrollimet teknike? Ne do ta rritim mbikëqyrjen më të madhe të kontrollimeve teknike, së pari për çështjen e sigurisë, pastaj edhe të ambientit.

Dhe, në këtë drejtim, të mos them hipokrite, por nuk është e domosdoshme që gjithmonë t'i vuajë pasojat qytetari pse institucionet e Kosovës, institucionet përgjegjëse, Policia e Inspektorati, nuk e bëjnë një mbikëqyrje më të mirë ndaj kontrollimeve teknike dhe për shkak se ne nuk jemi në gjendje të bëjmë një mbikëqyrje të kontrollimeve teknike të mos e lejojmë importin e veturave më të vjetra se 10 vjet.

Edhe një herë sa i përket sigurisë, unë besoj që nëse e kemi një kontroll të duhur sikur te homologimi, te kontrollimi teknik, asnjëherë nuk ka qenë në rrezik komunikacioni në Kosovë, por as në Evropë.

Në këtë drejtim, besoj që ne duhet ta rritim kontrollin në homologim në Dogana dhe gjithashtu në vetura që qarkullojnë në Kosovë të çështja e kontrollit në dy aspekte, në çështjen e sigurisë dhe në aspektin e ambientit të Kosovës.

Nga ministrja është vlerësuar se kjo nismë është kundër asaj që e kemi miratuar një rezolutë për ruajtjen e ambientit. Fatkeqësisht po më vjen keq prej ministres, por me sa duket nuk e ka lexuar mirë listën ligjore.

Unë që nga fillimi e kam thënë që duhet të ruhet standardi “Euro4”, që është standard minimal dhe po citoj: “Euro4 është standardi i veturave të cilët kanë një lirim të kufizuar të ndotjes së gazrave dhe janë ekonomikisht më të mira dhe harxhojnë më pak. Ajo që është kryesorja nuk e ndotin ambientin sikur e ndotin veturat që janë më të vjetra se sa versioni Euro4”.

Atëherë zonja ministre më vjen keq pse e keni bërë këtë konstatim se gjoja ne do ta ndotim ajrin nëse do ta heqim kufizimin 10 vjet.

Pasi unë kam kërkuar që nga vëllimi që “Eurodizel4” të jetë standard për importin e veturave. Nëse veturat më të vjetra se 2005 nuk e kanë këtë standard, atëherë detyrohen të importojnë ose ta rregullojnë katalizatorin që ato ta kenë standardin “Euro4”.

Edhe duhet të dimë që duhet të ketë një standard ose një analizë, besoj që edhe e kemi trajtuar kur është biseduar çështja e ambientit të ndotur.

A kemi statistika të mira, ose të sakta se kur ndotet ajri më shumë? Ne e dimë se ndotja e ajrit më e madhe është në kohën e dimrit, kur shkollat ngrohen me qymyr, e jo në kohën e verës, kur veturat janë në qarkullim.

Njëri ndër faktorët mund të jetë edhe veturat e vjetra që qarkullojnë, por jo ato që importohen. Shumica e veturave që importohen janë vetura zakonisht më të reja dhe zakonisht me standarde efikase dhe më të mira.

Konsultimi, zoti Bilalli e përmendi faleminderit, i nderuar deputet, çështjen e konsultimeve si mazhorancë që na takon, edhe unë jam i pajtimit sigurisht që do të ketë një konsultim më të mirë. Fatkeqësisht, ne si deputetë e kemi një problematikë që nuk e kemi ndoshta një mbështetje edhe një staf qysh e kanë ministrat edhe të tjerët, edhe pse tash ministrat po i marrin rrogat më të mëdha, ndoshta na takon neve tash si deputetë të marrim staf më shumë, pasi i kanë rritur rrogat.

Por, sidoqoftë, konsultimi me institucionet është gjithmonë i domosdoshëm, dhe në këtë drejtim besoj që ia vlen ta kemi një konsultim.

Sigurisht pas leximit të parë do ta kemi një konsultim më të thuktë dhe do të shikojmë sesi t’i rregullojmë këto nene që i përshtaten edhe ekonomisë së lirë të tregut, i përkasin edhe sigurisë, edhe ambientit më të mirë në Kosovë.

Çështjen e politikave fiskale, zoti Frashëri e përmendi për çështjen e veturave se nuk është problem. Unë besoj që është problem edhe çështja e akcizës, pas insistimit dhe nismës së Ligjit për automjetet dhe kryesisht për vjetërsinë e veturave kam pasur komente të shumta, e ato komente kanë qenë shumë pozitive, por ka pasur edhe kritika sigurisht, që i mirëpres.

Dhe, kam hasur në disa kritika edhe në ligje tjera, edhe në akcizën që bëhet për veturat, sigurisht që shumica e vendeve që vënë akciza për vetura tjera është për shkak se ato vetë prodhojnë vetura dhe për çështje të konkurrencës vënë akciza të veturës, prandaj besoj që edhe këtë çështje duhet shikuar, por kjo çështje nuk rregullohet me këtë ligj.

Sa i përket çështjes së MSA-së, e kemi edhe marrëveshjen e MSA-së, të cilën ne si mazhorancë në tërësi e zbatojmë dhe besojmë që gjithmonë jemi insistues të zbatohet më shumë dhe të gjitha ligjet të jenë karshi kësaj marrëveshjeje.

Sigurisht që kjo çështje është në harmoni të plotë, pasi që ne, siç e thashë edhe më herët, çështjen e sigurisë dhe të ambientit e kemi të përkushtuar dhe me propozimin tim nuk rrezikon asgjë, përkundrazi e favorizon çështjen e ambientit dhe sigurisht që ndoshta kemi mundësi edhe në çështjet e komunave, siç është Komuna e Prishtinës, pasi e kemi një komunikacion më të dendur, të kemi mundësi të kemi ndonjë standard më të madh se “Euro4”, por kërkesa ime ka qenë që “Euro4” të jetë standardi minimal.

Dhe, për fund, i ftoj të gjithë që ta votoni këtë projektligj me qëllim që t’i lehtësojmë qytetarëve një ambient më të mirë të veprimit të jetës në Kosovë dhe për këtë qëllim është bërë edhe kjo nismë ligjore.

Në këtë drejtim, besoj që edhe të gjithë paragrafët e kanë pasur këtë për qëllim. Sigurisht që, pasi t’i kalojmë në lexim të parë, kemi mundësi edhe të japim edhe komentet tjera dhe të bëjmë plotësim-ndryshime të tjera. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka tjerë të paraqitur. Kur bëhet kuorumi, e shqyrtojmë, e votojmë. I kemi pikat 10, 11, 12, 13, të cilat janë lexime të dyta dhe për të cilat duhet të kemi kuorum për të votuar.

Pika e pesëmbëdhjetë, është:

15. Shqyrtimi i raportit vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për vitin 2017

Komisioni Funkcional për Administratë Publike Qeverisje Lokale dhe Medie e ka shqyrtuar raportin vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për vitin 2017 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Gjithashtu, edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar raportin vjetor financiar të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për vitin 2017 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

E ftoj kryetarin e Komisionit Funkcional për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Medie, zotin Nait Hasani, për arsyetimin e raportit të Komisionit funksional. Zoti Hasani, e keni fjalën.

NAIT HASANI: Faleminderit, nënkryetar!

Mirë se erdhe kryetar,

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Medie e ka shqyrtuar raportin më 12. 6. 2018 dhe ia rekomandon Kuvendit për miratim.

Është një raport i plotë që i plotëson të gjitha kushtet për miratim në Kuvend.

Prandaj, lus deputetët që ta miratojnë këtë raport.

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, zoti Kadri Veseli.)

KRYETARI: Faleminderit! Nga Komisioni për Buxhet dhe Financa, nuk është kërkuar fjala.

Nga grupet parlamentare, Partia Demokratike e Kosovës, zonja Xhevahire Izmaku.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje e nderuar ministre, e vetmja që je sot me ne bashkë këtu,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka shqyrtuar raportin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të shërbimit Civil të Kosovës dhe po ashtu ne si anëtarë të komisionit përkatës e kemi përcjellë në vazhdimësi punën e këtij këshilli.

Si agjenci, si kategori kushtetuese, në vazhdimësi është bërë një punë shumë e mirë, veçanërisht në periudhën e fundit me anëtarët e pranishëm që janë tani si anëtarë të Këshillit. Kjo agjenci e ka rritur kualitetin e punës së vet, duke marrë parasysh që veçanërisht viti 2017 ka shënuar një ngritje shumë të madhe të personave apo shërbyesve civilë, të cilët kanë paraqitur ankesat e tyre pranë këtij këshilli.

Meqenëse është një ngritje enorme e kërkesave ose ankesave të shërbyesve civilë, ne po ashtu kemi menduar edhe si deputetë, domethënë është në pyetje që ka një ngritje të ankesave nga shërbimi civil, apo ka një krijim besimit nga shërbyesit civilë pranë kësaj agjencie.

Pra, kemi gjithsej 817 ankesa gjatë vitit 2017, ndërsa gjatë vitit 2016 ka pasur 514 ankesa. Është pra një ndryshim shumë i madh, por megjithatë si deputetë dhe anëtarë të komisionit përkatës konsiderojmë që ka një ngritje të vetëdijes të shërbyesve civilë, pra besim në organe shtetërore, që të drejtat e tyre edhe ankimimet të cilat i paraqesin kanë për t'u realizuar me sukses.

Nëse i krahasojmë dy kategoritë pra të nivelit qendror dhe të institucioneve të nivelit lokal, e kemi një numër të tillë gjithsej 432 ankesa ose 53,20% e numrit të përgjithshëm të ankesave janë parashtruar kundër vendimeve të institucioneve të administratës qendrore, përdërisa i kemi 380 ankesa ose 46,80% të numrit të përgjithshëm të ankesave që i janë parashtruar kundër institucionit të administratës lokale. Prej komunave, më së shumti kemi në Komunën e Prishtinës, që janë adresuar ankesa kundër vendimeve të komunës në raport me numrin e shërbyesve civilë, të cilët janë ankuar në procesin e rekrutimit të vendeve të punës. Pas kësaj vjen Komuna e Gjakovës. Megjithatë, nuk janë të gjitha ankesat të cilat ka mundësi t'i shqyrtojë ky këshill, pra janë ankesa, në të cilat shpeshherë bëhen edhe gabime në adresim, sepse fatkeqësisht përveç Inspektoratit të Punës nuk kemi tjetër agjenci që i shqyrton veçanërisht pra të ndërmarrjeve publike, por edhe të personave punëtorë, të cilët punojnë në sektorin privat. Pra, shpeshherë ka lindur edhe çështja e dilemave, diskutimi nëse duhet të kemi një agjenci tjetër që do t'i kishte shqyrtuar veçanërisht atakimet e padrejtësive që bëhen në sektorin jopublik.

Sigurisht që ne si deputetë i përgëzojmë anëtarët për profesionalizmin që e kanë treguar gjatë shqyrtimit të ankesave nga organizata të ndryshme buxhetore të shtetit, pra në përgjithësi të shërbyesve civilë. Po ashtu, ky Këshill ka marrë pjesë në hartimin e ligjit të ri, i cili tani është në miratim e sipër, ndërsa ne do të ndihmojmë si deputetë që të rritet autoriteti i kësaj agjencie. Pra, konkretisht, adresimi do të bëhet te zyrtarët, të cilët nuk i zbatojnë vendimet e Këshillit, ata do të kenë penalizime në pagën e tyre. Pra, le të përgatiten të gjithë ata zyrtarë, të cilët nuk do t'i realizojnë ankesat e shërbyesve civilë, që do të ketë penalizim në pagë. Sepse, ka vendime të cilat rrinë pezull me vite të tëra dhe nuk e realizojnë të drejtën ata shërbyes civil të cilët kanë të drejtë. Pra, edhe humb buxheti i shtetit, sepse ne jemi detyruar t'i kthejmë komplet ato paga, me të cilat ata dëmtohen dhe njëkohësisht dhe humb dhe bie autoriteti i një agjencie, siç është Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës.

Po ashtu, ky Këshill, pra anëtarët e vet kanë dhënë kontribut gjatë hartimit të legjislacionit të ri që tash e kemi në ardhje e sipër, pra të ligjeve të reja që është detyrim edhe nga Bashkësia Evropiane, ligje të cilat do të vijnë nëpërmjet Administratës Publike për reforma, ku besojmë që do t shikojmë shumë mirë edhe pozicionin e shërbyesve civilë edhe në raport me pagat e tyre. Përveç atakimit që u bëhen kandidatëve dhe shërbyesve civilë për pranim në shërbim civil, po ashtu ky Këshill edhe rekruton pozita drejtuese. Pra, është një pozicion interesant ku gjatë vëzhgimit prej 312 pozitave të rekrutimit kemi aprovim të pjesshëm të këtyre pozitave nga rekrutimi, e po ashtu vërejtjet të cilat janë mbi 500 gjatë procesit të intervistimit, ku shihet që zyrtarët nuk janë të ambientuar, posaçërisht në nivelin lokal me legjislacionin e ri. Pra, kemi nevojë për t'i ambientuar me ligjet, sepse shpeshherë ndodh që ne miratojmë ligje, por zyrtarët nëpër komuna nuk janë që ne u përshtatemi shumë, ose thjesht nuk i njoftojmë, nuk trajnohen për rregullativat e reja ligjore.

Është e rëndësishme ta theksoj edhe një të dhënë, pra nga gjithsej 891 ankesa që kanë qenë në shqyrtim gjatë vitit 2017, Këshilli ka vendosur në mënyrë meritore, ndërsa 74 ankesa janë bartur për t'u vendosur në vitin 2018. Do të përmend që Administrata Tatimore ka pasur prej institucioneve qendrore gjithsej 56 ankesa për vitin 2017.

Këshilli gjatë periudhës raportuese i ka aprovuar 159 ankesa prej 817, pra ankesat janë shumë më të mëdha se ato që aprovohen në fund, sepse një pjesë e tyre refuzohen, sepse adresohen gabimisht ose thjesht nuk kanë bazë. Mirëpo, gjatë periudhës raportuese vërehet që është refuzuar numri prej afro 300 ankesave ndaj tyre.

Sasi të palejuara gjithsej kanë qenë 147 ankesa. Këshilli ka monitoruar 81 institucione dhe ka konstatuar mbi 500 të gjetura, që përfshijnë shkeljet e dispozitave. Pra, edhe një herë po e theksoj që shpeshherë zyrtarët ligjorë nuk ambientohen me rregullativën ligjore. Sidoqoftë, me gjithë këto, ky Këshill e ka kryer në mënyrë të shkëlqyer punën e vet dhe ne si deputetë të Partisë Demokratike e mbështesim raportin për vitin 2017. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zonja Izmaku!

Më lejoni të dal nga tema pak. Kam kënaqësinë e madhe që të ju njoftoj se Kuvendi i Kosovës sapo është votuar që të anëtarësohet në Asamblenë Parlamentare të Frankofonisë. Jam shumë i lumtur që në fakt e kemi ndërmarrë këtë iniciativë dhe në të njëjtën kohë Kuvendi për herë të parë anëtarësohet në organizatën më të madhe parlamentare. Ne në fakt, po flas për ne, se ka organizata edhe më të mëdha ndërkombëtare parlamentare. Është moment i mirë edhe për diplomacinë tonë parlamentare për arsye se e forcojmë subjektivitetin ndërkombëtar edhe të shtetit tonë të pavarur e sovran. Urime! Zonja Flora Brovina është aktualisht atje duke marrë pjesë në Kanada! Faleminderit!

Tani e vazhdojmë me seancën. Fjalën e ka zoti Rasim Selmanaj, nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës.

RASIM SELMANAJ: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për vitin 2017 e ka bërë një punë të mirë, duke realizuar obligimet që dalin nga ligji.

Ky Këshill ka arritur ta shqyrtojë shumicën e kërkesave të shërbyesve civilë, po ashtu edhe t'i monitorojë proceset e emërimeve për pozitat e larta menaxhuese në të gjitha institucionet, duke performuar me rezultate të prekshme në këto detyra. Nga raporti del se viti 2017 kishte rritje të detyrimeve, ngase ka pasur bartje të ankesave nga viti paraprak.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës po ashtu ka ndihmuar edhe në hartimin e ligjit të ri, i cili rrit kompetencat e këtij institucioni. Pa dashur të përsëris ato shifrat që i tha kolegja Izmaku, në fund them se Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës i jep mbështetje raportit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Milaim Zeka e ka fjalën, nga Nisma.

MILAIM ZEKA: Faleminderit, kryetar!

Meqenëse je në sallë para se të flas për raportin shkurtimisht, dëshiroj të të drejtohem ty personalisht si kryetar i Kuvendit dhe si kryetar i Partisë Demokratike të Kosovës.

Me shumë të drejtë gjatë mbajtjes së parë të seancës polemizove dhe kërkove korrektësi nga opozita për miratimin e ligjeve dhe sidomos për miratimin e një ligji shumë të rëndësishëm dhe tepër serioz që sot ministri i Drejtësisë e paraqiti para Kuvendit të Kosovës. Po ju njoftoj se janë pikërisht këta deputetë të partisë suaj që janë shkaktarët kryesorë sot për mosvotimin e këtij ligji dhe këta janë Nait Hasani, Mërgim Lushtaku, Sala Berisha-Shala, Teuta Haxhiu, Andin Hoti, Bekim Haxhiu, i cili në replikën e tij tha se debatet e mia nuk prodhojnë gjëra serioze. E dëshiroj t'i them që debatet nuk janë mish për të prodhuar suxhuk, as patate për të prodhuar sallatë, por debatet prodhojnë gjithmonë diçka dhe gjithmonë të paktën debatet e mia prodhojnë diçka se mundohem të jem konstruktiv.

Dhe, po vazhdoj më tutje. Ganimete Musliu po ashtu nuk ka votuar dhe i fundit është Zenun Pajaziti. Do të thotë, tetë deputetë të pozitës nuk e kanë votuar ligjin. Nuk e thashë me asnjë të keqe, por e thashë vetëm me një këshillë, që të kërkohet seriozitet nga pozita në radhë të parë, e tani nga opozita. Kaq!

Sa i përket raporti edhe ne jemi ndarë shumë të kënaqur edhe si Grup Parlamentar i Nismës i japim shumë mbështetje.

KRYETARI: Faleminderit! Veç e ke bërë një gabim Milaim, se zonja Teuta Haxhiu nuk është e PDK-së. Do t'ia fillojmë me zonjën Teutë, shkojmë te Bekimi Haxhiu, pastaj Naiti dhe Ganimetja, kanë kërkuar replikë.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Unë e kuptoj zotin Zeka që e ka natyrën çfarë e ka, e nganjëherë flet diçka sa për të thënë, por sinqerisht jo vetëm se e diskutoj atë çështjen se ku isha unë, por nuk kam nevojë që të tregoj nëse dikujt i ka mbetur hatri për të qenë bashkë me opozitën, të cilët po lodhen pasdite dhe aq më tepër po flasin katër orë rresht sot, prej fillimit “a po ia nisim tani, apo pastaj”. Nëse e shihni transkriptin, katër orë jemi lodhur duke dëgjuar kur po e fillojmë atë seancë të famshme për ligjin në fjalë dhe nga katër orë nuk kanë qenë efektive as katër minuta.

Edhe deputetët janë njerëz, mund të kenë plot 100% arsye, nuk kam arritur të jem në kohën e minutazhës për të votuar, por megjithatë duhet dakorduar dhe lënë kohën kur të votohet, e deputetët që janë më të përgjegjshëm nuk kanë nevojë të flasin kur janë në seanca. Mirëpo, jo vetëm se jemi grup i përgjegjshëm si Aleancë, por kemi qenë dhe nuk do të thotë pse flet, nganjëherë ia qëllon, por mbi të gjitha edhe një herë sot rasti i opozitës se sa kanë folur dhe çfarë kanë kërkuar dhe mënyra se si kanë dalë, tregon edhe një herë që jo vetëm që janë të lodhur, nëse dikujt i ka mbetur hatri mund t'i bashkëngjitet, por nuk janë kurrkund, ama bash kurrkund të gatshëm dhe ne jo vetëm se jemi këtu, por jemi çdoherë të gatshëm për çka do qoftë. Nëse dikush ka hapësirë pak më shumë sesa e meriton, ajo është krejt çështje që e vlerësojnë një ditë edhe qytetarët.

KRYETARI: Faleminderit për korrektësi! Dua ta përgëzoj Grupin Parlamentar 6+, të cilët janë 100% sot në sallë. Faleminderit! Bekim Haxhiu, replikë!

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Dola për të diskutuar këtu, sepse kam qejf çdoherë diskutimin sy më sy, i nderuar Milaim dhe kushëri...

Thatë kështu “as tre deputetë të PDK-së nuk kanë qenë për ta votuar ligjin”. Ose ballafaqohesh me transkriptin ose me pasqyrën, dy janë. Dhe, u ktheve në atë që e tha zoti Reçica, domethënë e plotësive dhe i mbete borxh për t'i kërkuar falje, një. E dyta, për tri mandate në Parlamentin e Kosovës, Milaim Zeka, jam ndër deputetët më të rregullt edhe më aktiv. E votoj një ligj, a s'e votoj, ty nuk të jap llogari. U jap qytetarëve dhe Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike me të cilët bashkëpunoj dhe me të cilët koordinohem. Kështu që nuk ke nevojë të qëndrosh kujdestar i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, s'të kemi angazhuar për atë punë, angazhohu në punët tua, faleminderit, bëhu korrekt dhe ruaje nivelin e Parlamentit, do të thotë edhe të debatit, diskutimeve dhe diskurseve këtu, sepse ti e dinë shumë mirë që disa herë të është ndërprerë fjala në këtë foltore për shkak të atij degradimi që nganjëherë di ta bësh në këtë Kuvend.

KRYETARI: Milaim, kanë për të folur këta 3-4, a po i lë bashkë t'i bëj tani bashkë, e ke një minutë kundër-replikë, çdo herë të bëhen bashkë. Kush e dëshiroi tjetër kush fjalën për replikë? Nait, a e kërkoje fjalën? Naiti, vetëm nga një minutë e ka Milaimi për secilin pastaj, ta kemi parasysh.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Unë vetëm desha të them që raporti i Këshillit është një nga raportet më të mira që besoj që e ka lexuar edhe Milaimi, dhe e falënderoj shumë. Ne i kemi të aprovuara ankesa 159, pjesërisht të aprovuara 7, të refuzuara i kemi 249, por kemi vërejtje në ato që po vonohen shqyrtimet e tyre, zbatimi i tyre dhe kemi mjaft ankesa ose kërkesa, rekomandime nga Këshilli te zbatimi i tyre. Prandaj, kjo është çështja jonë - le t'i zbatojmë detyrat tona. Faleminderit!

KRYETARI: Milaim, kjo nuk ishte kundër-replikë. Ganimete Musliu, e keni fjalën!

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

E nderura ministre,

Të nderuara kolege dhe ju kolegë deputetë,

Po, Milaim faleminderit për kujdestarinë dhe kisha dashur shumë, meqë nuk po gjejmë asnjë mënyrë për ta bërë funksional këtë Kuvend, ndoshta është e mirë dhe e dhunës që të fillojmë të kujdestarojmë ne për njëri-tjetrin dhe unë të jam mirënjohëse për këto vërejtjet që i bëre. Nuk e kam për të replikuar, ndërsa e ndiej për obligim moral para qytetarëve të Republikës së Kosovës që të lajmëroj ose të informoj drejt, e jemi ftuar në orën 10:00 për ta miratuar këtë ligj dhe thjesht neglizhenca e shumë deputetëve këtu në sallë, por edhe qeveritarëve tanë, e ka shtyrë që ky ligj të votohet në orën 15:24 minuta, dhe është e vërtetë, jo nuk e kam kundërshtuar ligjin, por nuk kam qenë fare në sallë në atë kohë. Jemi njerëz, kemi edhe ne nevoja personale dhe kemi raste.

Unë personalisht dua të sqarohem për opinionin se kam qenë me një të pame Milaim, po e sqaroj kështu tekstualisht, dhe nuk kam mbërrë në kohë për dhjetë minuta dhe ndihem shumë mirë që kam qenë për “krye shëndosh” në atë familje të vlerësuar dhe të merituar, sepse është më mirë që të jemi pranë njerëzve, të cilët kanë dhimbje në raste të tilla, sesa të jemi të dëgjojmë demagogji të njëri-tjetrit dhe neglizhencën e njëri-tjetrit.

KRYETARI: Faleminderit! Nuk ia ka përmendur emrin. Milaim deri këtu më duket është me replika, urdhëro! Tash kundër-replikë, se Elmiu dhe Dauti janë për diskutim. A nuk janë asnjëri, a? Dauti pastaj ka diskutim.

MILAIM ZEKA: Faleminderit!

Edhe unë po dal ballë për ballë kështu me Bekimin. Bekim, janë tri gjëra që e dallojnë çdo njeri: shenjat e gishtave, mendimi dhe era e trupit. Ti edhe 2 000 vjet me t’i falë zoti jetë s’mund ta kesh as fjalorin tim, as oratorinë time. Ju këtu edhe jeni rrahur në Parlament e s’u bë nami, gjithkush e ka mënyrën e vet të sjelljes. Unë nuk e kam edukatë familjare ta fyej kurrkënd në debat pa e kërkuar, kur e kërkon tani i mëshoj. Problemi ishte, shiko Ganimetja sa mirë tregoi që ka qenë në të pame, janë të njerëzishme, ajo ishte vetëm këshillë dhe këtë këshillë nuk jua dhashë juve, ia dhashë kryetarit të juaj.

Ne kemi qenë komplet, e zoti Çoçaj na nënçmoi tha jeni tre deputetë, ne gjashtë jemi, dhe unë s’u preka për atë hiç. Jo, gjashtë kemi qenë, shikoi të gjithë, gjashtë deputetë kemi qenë prej fillimit dhe kemi votuar, shikoje listën. Kur fole the tre, por jam edhe një herë duke thënë, vetëm kërkoja përgjegjësi, kurrfarë nënçmimi për kurrkënd s’e pata. Në qoftë se mua ma jep dikush një këshillë, për shembull qysh më keni thënë për të mos sharë këtu, e kam lënë më s’po shaj, atë e kam marrë si këshillë, s’e kam marrë unë si diçka të keqe. Je edhe Mërgimi s’ishte këtu për të votuar. Prandaj, po them edhe një herë, nuk jam duke folur me grepa, nuk jam duke folur me

tendenca, me fyerje. Në qoftë se ne nuk jemi më seriozë, ne nuk kemi për t'i kaluar ligjet. Opozita e ka vërejtur që goxha na ka vënë në penallti, e kur të vë në penallti ta jep gol. Për të mos na dhënë gol opozita, prandaj ju bëra thirrje, edhe zotit Reçica i kërkoj falje, por edhe një sqarim: Nuk kam thënë as tre deputetë, në qoftë se kam thënë është gabim, kam thënë për tri vota s'na kaloi. Mirë, bre mirë kam thënë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Daut Haradinaj, fjala për ju!

DAUT HARADINAJ: Faleminderit!

Kjo ishte edhe arsyeja më duket që edhe vetë kryetari në mëngjes kërkoi të caktohet një orar dhe po mendoj që deputetët kanë obligime edhe jashtë kësaj seance dhe nuk mund të qëndrojnë këtu gjithë ditën e gjatë, përderisa për temat janë anëtarët e komisionit përkatës, të cilët i trajtojnë për ligjet konkrete. Unë e pata vetëm një vërejtje për raportin, dhe ajo vërejtje është domethënë pse nuk i trajtojnë sidomos ushtruesit e detyrës të drejtorëve të departamenteve brendapërbrenda ministrive, dhe vërejtjen e dytë, që po ma adresojnë dhe që kisha pasur dëshirë ta ndajë me ju gjithëve këtu, janë vonesat në kthimin e përgjigjeve.

Do të thotë, duhet të shkurtohet afati i kthimit të përgjigjeve dhe shpresoj që janë duke na dëgjuar dhe kanë konsideratë. Por, më lejoni, në qoftë se është dhe po shpresoj që është drejtpërdrejt, sot kryetar e kemi pas Ligjin në lexim të dytë për trajtimin e ndërtimeve pa leje. Është një ligj, për të cilin ka kohë që bëhet presion edhe prej qytetarëve, po ashtu edhe prej vetë juve. Shpresoj që në seancën e radhës, të enjten e ardhshme, të vijnë edhe deputetët, ta kalojmë atë ligj, sepse i trajton mbi 72% të qytetarëve të Republikës së Kosovës. Do të thotë është tepër i rëndësishëm, ia kemi hequr burokracinë, e kemi thjeshtësuar ligjin edhe ta marrë dritën jeshile të Kuvendit të Kosovës, të implementohet, sepse është tepër me rëndësi, edhe një herë po e përsëris, për të gjithë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nuk ka asnjë deputetë tjetër aktualisht të lajmëruar për këtë pikë të rendit të ditës dhe të njëjtën kohë në votim në momentin kur të arrijmë kuorumin.

16. Shqyrtimi i raportit vjetor të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2017

Komisioni FunkSIONAL e ka shqyrtuar raportin vjetor për vitin 2017 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Gjithashtu, edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar raportin dhe i ka rekomanduar Kuvendit miratimin e tij. Ftoj kryetaren e Komisionit, zonjën Sala Berisha-Shala për arsyetimin e raportit të Komisionit FunkSIONAL.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, kryetar Veseli!

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal në bazë të nenit 72 të Rregullores së Kuvendit shqyrtoi raportin vjetor të punës për vitin 2017 të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale në mbledhjen e mbajtur më 2 qershor të vitit 2018 dhe vendosi që Kuvendit t'i paraqesë këtë:

R e k o m a n d i m

Të miratohet raporti vjetor i punës për vitin 2017 i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale.

A r s y e t i m

Në bazë të nenit 58 të Ligjit nr. 03/L-163 për minierat dhe mineralet brenda 90 ditësh nga përfundimi i çdo viti kalendarik KPMM-ja do të përgatisë, publikojë në faqen zyrtare dhe dorëzojë Kuvendit një raport vjetor.

Komisioni në mbledhjen e mbajtur më 22 maj të vitit 2018 shqyrtoi raportin vjetor të punës për vitin 2017 të KPMM-së, të cilin e paraqiti para deputetëve kryesuesi i Bordit të KPMM-së. Komisioni vlerësoi se raporti i punës për vitin 2017 i parashtruar nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale është në pajtim me nenin 58 të Ligjit nr. 03/L-163 për minierat dhe mineralet dhe i rekomandon Kuvendit për miratim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zonja Berisha-Shala! Komisioni për Buxhet dhe Financa aktualisht nuk është këtu.

Nga përfaqësuesit e grupeve parlamentare, Blerta Deliu-Kodra.

BLERTA DELIU-KODRA: Kryetar!

Desha sapo të përfundojë diskutimi për këtë pikë të kthehemi edhe një herë te pika e 10-të, se e kemi kaluar, është Projektligji për shërbimet postare dhe në cilësi të kryetares vetëm desha një sqarim, edhe pse nuk ka kuorumin e nevojshëm për t'u miratuar.

KRYETARI: Atëherë, Gani Dreshaj. Sala Berisha-Shala, prapë në emër të grupit, a? A e ke kërkuar fjalën?

SALA BERISHA-SHALA: Po dua ta plotësoj kolegen time Blerta Deliu, ato pika të cilat nuk janë shqyrtuar në vazhdimësi kanë mbetur në mungesë të kuorumit ashtu, sepse duhet të votohen. Janë raporte me amendamente të punës së Komisionit FunkSIONAL të cilin e udhëheq unë. Blerta nuk ishte këtu, por prandaj u shtynë për një seancë tjetër, kur Kuvendi do ta ketë kuorumin e nevojshëm për të hyrë në votim.

Unë nuk e shoh shumë të arsyeshme, vlen edhe për tek shërbimet postare.

KRYETARI: OK në rregull! Faleminderit! Gani Dreshaj, të lutem, fjala për ju.

GANI DRESHAJ: Faleminderit, kryetar!

Faleminderit, deputetë!

Unë, e nderuara kryetare Berisha, isha ndalur pak te kjo çështja e minierave dhe mineraleve.

Kemi dhënë shumë licenca, ose i kemi duruar shumë njerëz për të punuar në gurëthyes, të cilët kanë bërë pastaj investime nëpër miniera të ndryshme dhe më në fund u është ndalur puna. Ato makineri, ato investime kanë mbetur shkret. Një rast të ngjashëm e kam në fshatin tim. Dy gurëthyes kanë punuar qe sa vjet, njerëzit i kanë paguar lekët diku, nuk kanë marrë licencë kurrë, tash kanë mbetur ato makina të shkreta. Është ndërprerë prej Ministrisë së Ambientit, që ka qenë shumë me vend, por ata po e ndjejnë veten se kjo Qeveri ua ka ndalur punën.

Ishte dashur një kujdes më i madh aty ku jepen licencat për gurëthyes, ose e merr njeriu licencën, ose nuk i merr lekët e mos me ua dhënë licencën. Kjo ishte pyetja ime.

KRYETARI: Faleminderit shumë! Kjo është çështje e komisionit... Atëherë, tjetërkush s'ka për diskutim apo... zonja Shala, në emër të komisionit, a mund të përgjigjeni për këtë pyetje. Fjala për ju.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, kryetar!

Në emër të Grupit Parlamentar sipas procedurës që duhet të prononcohen grupet parlamentare në lidhje me raportin e punës vjetore të agjencive të ndryshme, në këtë rast te Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, ia vlen të prezantohet raporti vjetor të këtij institucioni të rëndësishëm, i cili i përgjigjet Kuvendit të Kosovës.

Mendoj se deputetët e kanë pasur në dorë raportin, materialin që paraqet raportin e kanë analizuar brenda mundësive të tyre dhe ne si Grup Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e kemi analizuar me vëmendje këtë raport të punës. Ky raport në mënyrë përmbledhëse dhe analitike e të hollësishme pasqyron të dhënat e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale gjatë vitit 2017, të dhëna të hollësishme mbi industrinë minerale në Republikën e Kosovës, si dhe paraqet vështirësitë dhe sfidat që kanë përcjellë këtë agjenci gjatë vitit 2017.

Për të mos marrë shumë kohë ne i kemi në raport të përfshira brenda vitit 2017 sa licenca janë lëshuar, ndoshta tani vlen të përmendet se janë lëshuar 186 licenca dhe leje, prej tyre 89 janë të hulumtimit, 31 shfrytëzimi dhe leje për aktivitet të veçantë 66. Inspektorati i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale gjatë vitit 2017 ka pasur një dinamikë të lartë të punëve, të vizitave, ose inspektimeve në terren. Gjatë kësaj periudhe janë realizuar vizita dhe inspektime diku mbi 100 vizita dhe inspektime. Këtë numër e përbëjnë 160 vizita të rregullta, mbi 1000 inspektime të kërkesave dhe lejeve për punime për minime masive, 27 vizita janë lëshuar për vërejtje, 79 inspektime për veprimtari të jashtëligjshme, e kështu me radhë.

Këtë vit janë përcjellë 76 kallëzime penale në veprimtari minerare të jashtëligjshme, e cila është edhe sfidë e këtij komisioni, që duhet të bashkëpunojë me institucionet tjera, në këtë rast edhe me Policinë e Kosovës, sidomos me gjyqësinë, në të cilën presin shumë lëndë të pashqyrtuara dhe çdoherë mbetet si pikë e zezë, ose sfidë për Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale këto punë të cilat nuk i kryejnë institucionet tjera që janë jashtë Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale.

Prokuroritë kompetente në bazë të raporteve që kanë ardhur nga terreni për operime pa licencë dhe janë në procedurë shqyrtimi nga gjykatat, Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale gjatë vitit 2017 ka përgatitur 80 aktvendime për gjoba administrative lidhur me operimet e palicencuara, duke respektuar ligjet dhe normat ligjore në fuqi.

Si sfidë gjatë vitit 2017 në raport përmendet ngritja e kualitetit dhe sigurisë në punë në veprimtari minerare, vonesat në trajtim të lëndëve në gjykata, problemet me operime ilegale, inkasimin e borxheve, realizimin e planit për menaxhimin e resurseve minerale, mandej nga faktorët kryesorë të cilët kanë ndikim direkt në krijimin e stabilitetit të sektorit minerar dhe rrjedhimisht edhe në zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit minerar, si zhvillimi i minierave në ndërmarrjen Trepça si shoqëri aksionare, për të cilën gjë jemi dëshmitarë të asaj se ende Trepça nuk është regjistruar si shoqëri aksionare, duke mbajtur zvarrë miratimin e statutit të Trepçës, që tani është në Kuvend, mandej moszhvillimi i zonave me interes të veçantë të shpallura nga Qeveria, që vlen të përmendet se këto zona kanë mbetur të pazhvilluara që janë shpallur 10 vjet më parë dhe Qeveria ende nuk e ka filluar një proces të zhblokimit të tyre, moszhvillimi i mineraleve energjetike, në këtë rast linjitet, mungesa e bazës ligjore adekuate për të nxitur shfrytëzimin e këtij resursi, për çka dëshiroj të përmend se tani e kemi në procedurë në lexim të dytë Ligjin për miniera dhe minerale, i cili të gjitha këto sfida që i kanë përmendur Komisioni i Pavarur në raportin e punës së tyre, i adreson ligji. Kërkoj nga ju, kryetar, që ta sillni në rend dite këtë ligj dhe kërkoj nga deputetët që sa më parë të miratohet, në mënyrë që të gjitha sfidat që janë të adresuara nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale do ta gjejnë zgjidhjen dhe përgjigjen në ligjin e ri që pret në procedurë, për të cilën gjë ka marrë pjesë edhe në hartimin e tij ka marrë pjesë edhe Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale.

Nevojat për investime afatgjata në hulumtime për zbulim të zonave të reja të pasura me minerale energjetike është edhe një sfidë tjetër, që paraqet komisioni në punën e tij. Nga ajo që ishte në të kaluarën, sot sektori i minierave në Kosovë është në një stad më të avancuar dhe më të zhvilluar, përkundër shumë vështirësive që kemi si shtet i ri, në formim dhe i cili dëshiron dhe po punon pandalshëm për krijimin e kushteve më të mira për zhvillimin e biznesit e me këtë edhe të sektorit minierar, që do të krijojë një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm që do të jetë në shërbim të mirëqenies së qytetarëve dhe do të krijojë kushte edhe më të mira për brezat që do të vijnë.

Krejt në fund të raportit janë përmendur në mënyrë të detajuar sfidat, siç janë: parandalimi dhe ndalimi i operimeve të jashtëligjshme dhe ngritja e kualitetit dhe sigurisë në punë; ngritja e kualitetit dhe sigurisë në operimet minerale; mostrajtimi në kohë i lëndëve të paraqitura në gjykata, e shumë çështje të tjera që janë shumë të detajuara në këtë raport të punës për vitin 2017 të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale.

Si Grup Parlamentar i PDK-së mbështesim këtë raport. Do ta votojmë dhe kërkoj edhe nga kolegë deputetë, që të miratohet. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Enver Hoti.

ENVER HOTI: Faleminderit, kryetar!

Raporti i Komisionit për Miniera dhe Minerale paraqet të dhëna të sakta dhe ne e mbështesim, por ajo që mbetet shqetësuese dhe mendoj që duhet të potencohet, është se ende vazhdon edhe më tutje degradimi i natyrës, ende vazhdon një mosbashkëpunim ndërinstytucional për rekomandimet që jep, edhe ky komision, por edhe inspektoratet, shihet ende që ka mungesë të inspektorëve, ka moskoordinim dhe mosaktivitet të institucioneve, sidomos të sigurisë dhe të sistemit të drejtësisë.

Ende nuk shohim asnjë masë aktive, që do të ishte në funksion të ruajtjes dhe të vënies në ligjshmëri në këtë fushë të interesit. Ende shohim degradim të ambientit dhe të lumenjve dhe me keqardhje duhet të konstatojmë, se ky raport nuk përfilllet nga mekanizmat dhe nga institucionet tjera, që kanë për detyrë të marrin raportin, të shohin të dhënat e këtij raporti dhe të intervenojnë apo të marrin masa konform ligjeve që janë të obligueshme.

Ne si grup parlamentar e kemi trajtuar raportin e komisionit dhe e mbështesim, por njëkohësisht kërkojmë nga institucionet tjera që të marrin masa aktive, sidomos ndaj operatorëve të paligjshëm, që janë bërë të vështirë, të rrezikshëm, jo vetëm në aspektin e degradimit të ambientit, por edhe në aspektin e të hyrave në lëndimin, do të thosha, apo në pengimin e zhvillimit ekonomik. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Edhe Bekim Haxhiu e ka fjalën.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Duke e shfrytëzuar rastin për raportin e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale dua të ngre një shqetësim të qytetarëve dhe të vetë punëtorëve të ish-Minierës së Linjtit në Babush të Muhaxherëve, e cila është mbyllur për shkak të punimeve të Bechtel&Enkas dhe një gjë e tillë nuk paraqitet në raportin që e kemi para nesh.

Mbi 200 punëtorë të kësaj miniere, që dikur punonin në këtë Minierë të Linjtit në Babush të Muhaxhirëve, përfundimisht kanë shuar shpresat se ndonjëherë do të rifillojë puna në këtë minierë dhe një gjë e tillë është bërë edhe me pëlqimin apo mbyllja e kësaj miniere të linjtit është bërë edhe me pëlqimin e kryetarit të Komunës së Lipjanit, zotit Imri Ahmetit, e për të cilët ish-punëtorët e kësaj miniere kanë shprehur shqetësimet e tyre. Unë kërkoj nga Komisioni për Miniera dhe Minerale që të dalë në vendin e ngjarjes, sepse sipas dëshmimeve dhe deklarimeve të banorëve vendës, edhe makineria që dikur shfrytëzohej në këtë minierë ka mbetur brenda minierës dhe është mbyllur për shkak të punimeve të “Bechtel&Enka”-s dhe kjo paraqet një shqetësim dhe do të duhej në vend se ne të aktivizohemi për riaktivizimin e resurseve tona minerale, kjo është në kundërshtim të asaj.

Dhe krejt në fund, dua t’i them kolegut tim, Milaim, me të cilin vijmë nga i njëjti vend, por që karrierën politike e kemi të ndryshme dhe dallojmë shumë, as nuk e synoj e as nuk e lakmoj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nuk ka deputetë të tjerë. Për shkak të mungesës së kuorumit edhe kjo pikë për votimin e raportit do të shqyrtohet në seancën kur e përcaktojmë vazhdimin e kësaj seance.

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë kisha propozuar që tani ta përfundojmë për sot këtë seancë. Vazhdimin e seancës ta kemi ditën e enjte, kur e kemi seancën e rregullt, para se ta fillojmë seancën e rregullt, pastaj vazhdojmë me këtë seancë për të kaluar në pjesën e seancës së rregullt.

Faleminderit! Mirupafshim të enjten!

* * *

E enjte, më 12 korrik 2018

Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 5 korrik 2018

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas rendit të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 9 korrik 2018.

Janë 75 deputetë në sallë.

Të nderuar deputetë,

Para se të fillojmë shqyrtimin e pikave të rendit të ditës, ju njoftoj se Grupi Parlamentar i Listës serbe e ka propozuar deputetin Adem Hoxha për anëtar në Komisionin Hetimor Parlamentar, të formuar në seancën plenare më 28 qershor 2018, në lidhje me emërimet e shërbyesve të lartë civilë në administratën shtetërore të Republikës së Kosovës.

Kërkoj nga ju që me ngritje dore ta bëjmë këtë aprovim formal. Faleminderit!

Kuvendi e miratoi propozimin e Grupit Parlamentar Lista serbe për emërimin e deputetit Adem Hoxha në Komisionin Hetimor Parlamentar në lidhje me emërimet e shërbyesve të lartë civilë në administratën shtetërore të Republikës së Kosovës.

Vazhdojmë me rendin e ditës si në vijim:

Pikat e papërfunduara nga seancat plenare të mbajtura më 8, 14, 19, 28 qershor dhe 5, 6 dhe 9 korrik 2018.

Të nderuar deputetë,

Diskutimet për pikat e rendit të ditës 1, 2, 3, 4, 5, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, dhe 20 kanë përfunduar në seancat plenare të mbajtura në ato ditë që i përmenda më lartë, po nuk ka pasur kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje.

Shkojmë në votimin e tyre, përveç një pike, pika 5 tërhiqet nga rendi i ditës për kohësisht. Kemi marrë një shpresë deri në qartësimin e situatës, pastaj e rikthejmë prapë në momentin kur të kemi përgjigje.

80 deputetë janë aktualisht në sallë.

Vetëm pak ta verifikoj, nga sekretari e mora, veç e interpretova tash edhe një herë. Për miniera dhe minerale është tërhequr pika e gjashtë. Kërkoj falje, atëherë pika e gjashtë tërhiqet, Projektligji për miniera dhe minerale.

Do të thotë jemi te pika e parë.

5. Votimi i Projektligjit numër 06/L-080 për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi pjesëmarrjen e Kosovës në Programin e Unionit “Konkurrenca e Ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, COSME, 2014-2020”

Duhen dy të tretat e votave, sa deputetë i kemi në sallë? Në qoftë se nuk janë 81, po e kaloj deri të bëhen 81. 81 deputetë janë në sallë.

Deputetët të përgatiten për votim.

Në këtë projektligj është propozuar një amendament nga Komisioni FunkSIONAL, për miratimin e tij kërkohet së paku 80 vota për, do të thotë jemi në fazën një herë një amendament. Jemi për amendamentin, jo në tërësi projektligjin.

Përgatitemi për votim, 81 deputetë janë sallë, 80 duhen, po e presim edhe Haxhiun.

Amendamenti 1.

Kërkohen së paku 80 vota.

Përgatitemi për votim, votojmë tash:

69 deputetë kanë votuar, 64 për, 5 abstenime, edhe një herë po e hedh në votim, pasi nuk ka kaluar 80-shin.

Edhe një herë përgatitemi për votim, në qoftë se edhe këtë herë nuk kalon, vazhdojmë pikën tjetër, shohim çfarë bëjmë më tutje.

Përgatitemi për votim,

Amendamenti 1.

82 deputetë janë në sallë, votojmë tash:

70 deputetë kanë votuar, 64 për, 6 abstenim. Për shkak të mungesës së deputetëve për ta votuar, mbetet pezull.

* * *

6. Votimi në parim i Projektligjit numër 06/L-079 për efikasitet të energjisë

Komisioni Funksional e ka rekomanduar miratim e këtij projektligji.

Votojmë në tërësi projektligjin në parim. Votojmë tash:

74 deputetë kanë votuar, 62 për, 8 kundër dhe 4 abstenime. Kuvendi e miratoi në parim Projektligjit numër 06/L-079 për efikasitet të energjisë.

Ngarkohen Komisioni Funksional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

9. Votimi në parim i Projektligjit numër 06/L-064 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 05/L-132 për automjete

Komisioni Funksional e ka rekomanduar miratim e këtij projektligji.

Votojmë në parim projektligjin tash:

61 deputetë kanë votuar, 37 për, 11 kundër dhe 13 abstenime. Kuvendi e miratoi në parim Projektligjit numër 06/L-064 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 05/L-132 për automjete.

Ngarkohen Komisioni Funksional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

85 deputetë janë aktualisht në sallë, do të hyj edhe një herë shpejt në votim...88 janë.

5. Votimi i Projektligjit numër 06/L-080 për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian për pjesëmarrjen e Kosovës në Programin e Unionit “Konkurrenca e Ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, COSME 2014-2020”

Duhet 2/3, duhen 80 vota edhe për amendament, edhe për këtë projektligj, votojmë një herë, është propozuar një amendament nga Komisioni Funksional, për miratimin e tij pra kërkohen 80 vota. Votojmë tash!

89 deputetë janë. 74 kanë votuar, 66 për, 8 abstenime. Mungesë kuorumi.

10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shërbime postare

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

E ftoj kryetaren e Komisionit FunkSIONAL, zonjën Sala Berisha, për arsyetimin e raportit me rekomandime. Zonja Sala Berisha-Shala, fjala për ju.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, kryetar!

Komisioni i ka dhënë rekomandime seancës që të votohet raporti me rekomandime për Projektligjin për shërbimet postare.

Ju ftoj ta votoni. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në këtë projektligj janë propozuar gjithsej 23 amendamente.

Vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara sipas radhitjes së paraqitur në raport nga Komisioni FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal.

Po e lexoj, se paska qenë bukur shumë, po e lexoj çka ka thënë Komisioni për Integrimë.

Komisioni për Integrimë Evropiane nuk e ka shqyrtuar projektligjin me amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit.

Në ndërkohë pas dorëzimit të raportit final nga Komisioni FunkSIONAL, Komisioni për Integrimë Evropiane e ka shqyrtuar projektligjin me amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL dhe ka konstatuar se: amendamentet 2, 6, 7, 8 dhe 9 nuk janë në përputhje me legjislacionin e BE-së.

Do të thotë, edhe një herë e përsëris. Amendamentet 2, 6, 7, 8 dhe 9 nuk janë në përputhje me legjislacionin e BE-së dhe i ka rekomanduar Kuvendit mosmiratimin e tyre. Kjo është.

Shkojmë me amendamentet një nga një. Urdhëro, Armend!

ARMEND ZEMAJ: Kryetar,

Në emër të Grupit Parlamentar ju kisha lutur që t'i renditni në mënyrë të rregullt pikat e rendit të ditës, sepse keni krijuar konfuzitet edhe te deputetët në mënyrën e votimit edhe të procedimit të votimit. Edhe seanca edhe ashtu nisi me shumë vonesë, arsyet duhet t'i shpjegoni ju.

Por kjo ka të bëjë me takimin e Komisionit për Integrimë Evropiane, i cili nuk ka pasur kuorum për vendimmarrje dhe në këtë arsyeshmëri amendamentet janë shqyrtuar dhe janë dorëzuar jashtë afatit të paraparë.

Ne i kemi dërguar komisionit në fjalë, po flas në emër të Komisionit për Integritet Evropian, katër amendamente janë në kundërshtim, ka reagim edhe nga Zyra e Komisionit Evropian, sigurisht këta janë edhe të njoftuar. Kështu që i lusim që ta tërheqin projektligjin, le t'i harmonizojnë këto qëndrime dhe projektligji mund të vijë, ose përndryshe ato amendamente që ju i potencuat nuk duhet të përkrahen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, sepse do të nxjerrin probleme në të ardhme.

E kemi këtu edhe ministren e Integritetit, edhe kjo është në dijeni. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Për shkak të ndjeshmërisë, do të shkoj një nga një te amendamentet e propozuara.

Pjesa e ngritur nga kolegu deputet është se seanca ka filluar kur ka pasur kuorum, kam qëndruar tërë kohës me ju, s'e kam ngritur këtë çështje, po në momentin kur e kam vërejtur që janë mbi 61 deputetë, e kam nisur seancën. Në fakt, kur kemi filluar seancën, me 25 minuta vonesë, 30 në fakt, kanë qenë 65 deputetë.

Edhe në radhitje po shkoj një nga një, të keni parasysh. Bile nuk i kam ikur këtë herë, si rrallë ndonjëherë.

Dardan Sejdiu, ndërkohë, po për këtë projektligj ka kërkuar fjalën. Urdhëro, zoti Sejdiu!

DARDAN SEJDIU: Faleminderit, kryetar!

Do të isha shumë mirënjohës, kryetar, nëse kur kaloni nëpër amendamente, të tregoni se cilat janë amendamentet e Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Tregti dhe Industri. Faleminderit!

Meqë kjo, besoj, edhe do të saktësonte llojin e amendamentit që po e votojmë.

Më duhet të potencoj dhe të ftoj deputetët që të votojnë ligjin ashtu siç ka ardhur prej Komisionit Funkcional, sepse në këtë mënyrë sigurohem që sa objektiva që i kemi për zhvillimin e Postës dhe shërbimeve postare t'i trajtojmë në mënyrë të duhur dhe sipas kërkesave edhe të industrisë, por edhe të njëjtën kohë, sipas nevojave të Republikës.

Kështu që do isha shumë mirënjohës nëse shkojmë amendament për amendament, të jemi të saktë të cilit komision janë.

KRYETARI: Më fal, zoti Sejdiu, si bashkëbisedim. Cili është qëndrimi i komisionit, se e kemi një qëndrim, i cili është për mosmiratimin. Unë do t'i përmend një nga një, por ju, edhe

përkundër qëndrimit të Komisionit për Integritim Evropian, ju thirrni t'i votoni, kjo është, ta keni parasysh.

Atëherë, unë do të shkoj një nga një, nuk do t'i bëj bashkë.

Në këtë projektligj janë propozuar gjithsej... Zoti Krasniqi e do fjalën para se të shkohet në votim.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit!

I nderuar kryetar,

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Jemi në një situatë ku një ligj shumë të rëndësishëm Komisioni Funkcional e ka punuar për një kohë të gjatë, i ka sjellë amendamentet, po në ndërkohë siç u shpjegua edhe nga anëtari i Komisionit për Integritim Evropian, ne e kemi marrë pastaj edhe një shkresë, ku për pesë amendamente në mënyrë goxha të saktë shpjegohet se nuk janë në pajtim me direktiva të caktuara të legjisllacionit evropian që rregullojnë këtë çështje.

Normalisht që jemi në një situatë të vështirë, sepse qëllimi i këtyre amendamenteve pa dyshim që ka qenë ndihma që e ka shumë të nevojshme Posta e Kosovës. Dje kemi pasur edhe një dëgjim publik, ku jemi njoftuar në detaje për probleme dhe vështirësi që kjo ndërmarrje publike i ka, përkundër faktit që deri tash ka qenë ndërmarrje që ka afaruar pozitivisht dhe normalisht që qëllimi është i mirë. Po, në anën tjetër, edhe obligimi jonë është që cilindo ligj, amendament legjisllacioni në përgjithësi ta kemi në pajtim me direktivat e BE-së, se na ka ndodhur në të kaluarën që e kemi miratuar ndonjë ligj edhe që s'ka qenë në pajtim, e pas nja gjashtë muajve jemi kthyer prapë e kemi bërë plotësim-ndryshimin pikërisht për t'i ndryshuar ato që i kemi miratuar vetë, sepse kemi edhe obligime karshi Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit, po kemi edhe obligime që legjisllacioni i miratuar të jetë në pajtueshmëri me 'acquis communautaire'

Tani, pa dashur të imponoj mënyrën e votimit, unë ju ftoj, zoti kryetar, që për secilin amendament, pa dyshim që ta votojmë veç e veç, së paku që të jenë të njoftuar deputetët saktësisht. Amendamentet që kanë marrë një opinion kundërshtues prej Komisionit të Integritimit Evropian të na bëjë me dije. Ta zëmë, amendamenti i parë është në rregull, amendamenti i dytë thuhet se nuk është në pajtim, vetëm ta specifikoni para votimit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Ju lutem për vëmendje! Po tash u sqaruam, urdhëro, zonja Shala Berisha.

SALA BERISHA- SHALA: Kryetar, po e shoh të arsyeshme të bëj një sqarim para seancës dhe opinionit publik që na përcjellin. Amendamentet që kanë ardhur nga Komisioni për Integritime Evropiane kanë ardhur pas kohës në komision. Kështu që kjo je të jetë një rast dhe një thirrje komisioneve të përhershme që t'i shqyrtojnë me kohë amendamentet që vijnë nga komisionet e tjera, në mënyrë që të mos kemi kesi mospajtimesh ose paqartësi për seanca gjatë shqyrtimit të amendamenteve.

Vetëm le të sqarohet se Komisioni Funkcional, të cilin e udhëheq unë, i ka kryer detyrat e veta në kuadër të afatit kohorë që parashihet dhe nuk kemi marrë vërejtje nga Komisioni i Integritimeve në kohën e duhur, pasi është proceduar ligji për seancë, kanë ardhur vërejtjet e Komisionit për Integritime Evropiane.

KRYETARI: Zonja Hykmete Bajrami e ka kërkuar fjalën.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Meqenëse ministrja e Integritimeve Evropiane është këtu, unë me të vërtetë si anëtare e Komisionit Funkcional kisha pasur dëshirë ta dëgjoj edhe opinionin e ministres për Integritime Evropiane para se të hyjmë në votim lidhur me pesë amendamentet e Komisionit Funkcional, të cilat në këtë rast kontestohen me të drejtë nga Komisioni për Integritime Evropiane, të shohim se cili do të jetë dëmi i vendit tonë në rrugën për integritime evropiane nëse votohen këto amendamente, sepse mendoj që është krijuar një lloj konfuzioni, disa thërrasin për t'i votuar, të tjerët thërrasin për të mos i votuar, kështu që ministre të kisha lutur që të kemi edhe opinionin tuaj. Faleminderit!

KRYETARI: Zonja ministre, Armendi, pastaj ta lëmë zonjën ministre të flasë. Urdhëro, deputet Armend Zemaj!

ARMEND ZEMAJ: Kryetar!

Unë e kuptoj ndonjëherë garën ndërmjet komisioneve, por ky është ligj i rëndësishëm së veçantë. Ne i kemi specifikuar pesë direktiva, të cilat bien ndesh me këto amendamente dhe ashtu siç vepruat me Projektligjin për miniera dhe minerale, ju kisha lutur që ta tërhiqni ligjin, ose po paraqes mocion përmbajtjesor në emër të Komisionit për Integritime dhe të harmonizohen këto qëndrime. Nuk ka diçka tjetër, ndonjë arsyeshmëri, vetëm futemi në konfuzion dhe duhet të shpjegojmë çdo amendament me cilën direktivë të BE-së është në kundërshtim.

Ne i kemi të evidentuara për shkak të kuorumit, po e përsëris edhe një herë, nuk ka pasur vendimmarrje për t'i adresuar këto amendamente, dhe kjo është esenca. Kështu që për një javë besoj që nuk ndodh kiameti që të shtyhen dhe të harmonizohen apo të eliminohen këto defekte,

të cilat janë paraqitur në propozim-amendamentet e Komisionit Funkcional. Ne e admirojmë për punën, askush nuk po thotë që nuk kanë bërë punë të mjaftueshme dhe për të arritur efikasitetin e Postës dhe Telekomit të Kosovës, por ne duhet të përshtatemi dhe tash jemi të detyruar t'i harmonizojmë edhe ligjet, edhe amendamentet me direktivat e BE-së. Kaq!

KRYETARI: Faleminderit! Kjo është një situatë të cilën komisionet parlamentare kanë mundur ta përfundojnë para se të vijë këtu, por tash jemi në seancë. Ka një mundësi, si the Armend? Çfarë mocioni deshe që të iniciosh? Mentori im i Rregullores, jo përmbajtjesor por procedural... Atëherë, a shkojmë ta pyesim ministren cilat janë, apo dëshironi të shkoni me mocion procedural? Zonja ministre, fjala për ju, ndërkohë deputetët le të mendojnë si do të veprojnë. Në qoftë se nuk ka mocion procedural, atëherë unë shkoj një nga një, në fund të fundit edhe ashtu nuk prish punë. Urdhëro, zonja ministre!

MINISTRJA DHURATA HOXHA: Këtu u theksua shumë qartë që disa nga nenet në këtë projektligj janë në kundërshtim me pesë direktivat evropiane, pra 'acquis', prandaj unë kisha propozuar që ndoshta të shkojmë propozim për propozim, amendament për amendament, mirëpo nëse ka kohë kishte qenë mirë që të mos i kthehem dy herë, sepse herët a vonë ne duhet gjithashtu ta harmonizojmë edhe një herë këtë ligj në plotëni me direktiva dhe nëse ka hapësirë procedurale sipas rregullave të procedurës, ndoshta kishte qenë mirë që dy komisionet, edhe ai i Integritimit Evropian, edhe ne si Ministri e Integritimit jemi të hapur që t'u ofrojmë ekspertizën tonë në lidhje me harmonizimin sa më të mirë të këtyre dispozitave, të cilat janë në kundërshtim me direktivat.

KRYETARI: Faleminderit! Dardan Sejdiu e ka fjalën dhe përgatitemi të shkojmë në procedurë, të mos i marrim shumë kohë vetes, ashtu-kështu qëndrimet politike janë të përbashkëta.

DARDAN SEJDIU: Faleminderit, kryetar!

Unë vetëm dua të propozoj që të shkojmë amendament për amendament dhe të ecim tutje. Besoj që trajtimi i kësaj teme është një çik dhe sa jemi të gatshëm që për një periudhë të caktuar kohore t'i rrimë karshi Postës. Kjo është pyetja. Nëse jemi gati t'i ndihmojmë Postës, jemi gati të punojmë në këtë drejtim, ligji gjithmonë mund të amendamentohet, por për një periudhë të caktuar na duhet një lloj ligji, i cili i ndihmon postës të ecën përpara.

KRYETARI: Kisha kërkuar në qoftë se ka mirëkuptim, më duket se Armendi po do ta iniciojë mocionin procedural dhe le të marrë seanca vendim, për arsye se po hapim diskutime. Po, zoti Isufi, po tash të shkojmë me mocion procedural, e vendosni ju, pastaj e marrin një drejtim, veç votoni. Urdhëro, zoti Zemaj!

ARMEND ZEMAJ: Veç ju kisha lutur ta bëjmë dallim për çka po flasim, sepse interesimi ynë i përbashkët është që ta avancojmë ligjin në këtë drejtim, por nuk mund të avancojmë ne një ligj, i

cili është në kundërshtim me direktivat bazë të BE-së. Edhe vetë sponsorizuesit e dinë që tejkalimet që janë bërë këtu janë bërë pa një arsyeshmëri dhe pa harmonizim me këto direktiva, dhe kjo nuk do të thotë qoftë në një periudhë të shkurtër kohore, qoftë afatgjate, e cila nuk do të ketë problematikë në të ardhmen.

Unë për hir të mirëkuptimit që komisionit të mos i hyjmë në brendësi, domethënë në përmbajtje dhe mund ta dëmtojmë atë që këta e kanë propozuar, por ta harmonizojmë me këto qëndrime, kërkoja që t'i japim një javë kohë shtesë që këta t'i harmonizojnë dhe t'i eliminojnë këto defekte, sepse mund të jetë ndonjë amendament këtu që këta e kanë propozuar, i cili mund të riformulohet, por i cili nuk mund të bjerë ndesh me direktivën e BE-së. Për këtë arsye kërkoja që të shtyhet, përndryshe ne mund të shkojmë me votim kundër këtyre amendamenteve nëse këta janë të gatshëm që t'i pranojnë.

KRYETARI: Faleminderit! Edhe Milaimi e ka kërkuar fjalën, por a shkojmë në mocion procedural? Atëherë, Milaim urdhëro, por atëherë shkojmë se po marrim kohë edhe vetëm po sillemi rreth një cikli të njëjtë.

MILAIM ZEKA: Kryetar!

Vetëm desha të mbështes në mënyrë absolute propozimin e deputetit Zemaj, edhe ministrja është këtu, nuk bëhet kiameti për një javë ta shtyjme këtë, sepse unë mendoj se Postë-Telekomit të Kosovës i ndihmojmë vetëm në qoftë se e futim Prokurorinë atje. Asnjë ligj nuk u ndihmon atyre, pos prokurori. Kështu që unë propozoj ta shtyjme këtë ligj për një javë.

KRYEARI: Faleminderit! Të nderuar deputetë, a ka mundësi për koncentrim? Pati shumë fjalë, por nuk pati iniciativë. Shkojmë në votimin e amendamenteve një për një.

Amendamenti 1, me përkrahjen e Komisionit Funkcional... a po e inicion? A propozove? Atëherë, shumë mirë! Jo, se s'dëgjova kërkoj falje për atë. U krye! Mocionin përmbajtjesor e ka iniciuar deputeti edhe në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Armend Zemaj. Memli Krasniqi, qëndrimi?

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, kryetar!

Meqenëse shumë projektligje na janë vonuar, ne megjithatë mendojmë që duhet të shkojmë në votim, andaj në këtë rast, megjithëse ka absolutisht arsye kërkesa e deputetit, unë duke qenë edhe vetë anëtar i Komisionit për Zhvillim, e di që është diskutuar disa herë, nuk shoh ndonjë perspektivë të arritjes së ndonjë kompromisi ndërmjet dy komisioneve. Kështu që për të mos e shtyrë tutje të njëjtën situatë, unë kisha thënë të votojmë amendament për amendament dhe në fund projektligjin. Kështu që s'e mbështetim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Konjufca, në emër të Lëvizjes Vetëvendosje?

GLAUK KONJUFCA: Po, këtu duhet patjetër të ketë një harmonizim për arsye që unë i lexova edhe një herë rekomandimet që jepen, faktikisht prej zyrës e cila është kompetente për vlerësimin e harmonizimit të legjislacionit tonë me ‘acquis communautaire’ dhe është e domosdoshme që të mos hyjmë në proces të votimit pa u përfshirë vërejtjet e tyre dhe pa u integruar në tekstin përfundimtar të ligjit.

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Sejdiu, fjala për ju!

DARDAN SEJDIU: I nderuari kryetar!

‘Acquis communautaire’ dhe vendosja e ligjeve tona në përputhje me direktivat e BE-së është një proces i cili lidhet me hyrjen tonë apo të qenët shtet anëtar në BE. Pra, për të qenë shtet anëtarë në BE, apo për të pretenduar për të qenë shtet anëtar në BE, në një moment të caktuar i gjithë legjislacioni duhet të jetë në përputhje me direktivat e BE-së. Por, këtu ekziston një afat kohor prej sot e deri në ditën kur ne duhet të jemi plotësisht në përputhje me direktivat e BE-së. Besoj që secili në këtë sallë e di që ka kohë. Pra, nuk do të jetë nesër, as nuk do të jetë për pesë vjet. Me punën që e kanë bërë qeveritë në 18 vjet e fundit, do të marrë pak më shumë kohë.

Unë çfarë po propozoj dhe çfarë ka propozuar komisioni është që Posta ta ketë një status të caktuar sa u përket sa dërgesave. Kaq! Por, nëse kjo është problematike për anëtarësimin e Republikës së Kosovës në BE, atëherë dakord. Në rregull!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Isufi, qëndrimi juaj?

AHMET ISUFI: I nderuar kryetar!

Amendamentet kanë ardhur në seancë, prandaj kërkojmë t’i votojmë të gjithë një nga një. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Lista serbe, zoti Milosavljeviq, fjala për ju.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala, predsedniče!

Mi se slažemo, pošto su svi amandmani već na sednici Skupštine, da se glasaju pojedinačno. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Sherifi, qëndrimi i grupit të juaj parlamentar që po fuqizohet dhe po forcohet.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryetar!

A po e sheh kryetar kur ta kesh punën e parë, kryetari i ngatërron, në vend të Listës serbe ia jep fjalën një partie tjetër.

KRYETARI: Unë mendova që e keni kaluar edhe Listën serbe me deputetë.

BILALL SHERIFI: Po qysh kemi nisur, do të ju kalojmë edhe juve kështu ngadalë-ngadalë. Shpresoj shumë.

Mendoj që ky projektligj të cilin sot e kemi në lexim të dytë meriton vëmendje të veçantë dhe nuk është mirë që të shtyhem në mënyrën qysh po shtyhem, se askush këtu nuk është kundër përafritit të legjislacionit me Bashkimin Evropian. Ne si komision i kemi futur disa, ia kemi dhënë ekskluzivitetin Postës për disa shërbime për një periudhë të caktuar kohore, derisa të rimëkëmbet, të ringjallet dhe kjo nuk do ta dëmtonte aspak procesin e integritimeve evropiane.

Imagjinojeni, në një vend ku kemi monopole për shumë shërbime në Kosovë, flasim se po e rrezikojmë integrimin, apo rrugën tonë integruese për kaq pak, e nuk besoj që është rasti i tillë. Por, sidoqoftë e mbështes mocionin e zotit Zemaj në emër të LDK-së që të japim kohë siç tha edhe ai që ta harmonizojmë, le të përfshihet brenda ligjit edhe integrimi, edhe intenca që ka pasur komisioni që Posta të ndihmohet, të mbështetet siç mbështeten postat në të gjitha vendet, jo vetëm në rajon, por edhe më gjerë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Kinolli, qëndrimi juaj dhe shkojmë në votim.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Duke pasur parasysh që nuk ka një harmonizim të qëndrimeve, ka një papajtueshmëri, dhe duke pasur parasysh vetë faktin që veç amendamentet i kemi para nesh, mendoj që në këtë rast më së miri është që vota të jetë përcaktuese. Andaj, ne votojmë që të hyjmë në votim amendament për amendament. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Jemi në mocion procedural për pikën e rendit të ditës Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shërbime postare, a do të vazhdojmë në rendin e ditës apo do ta tërheqim, vota është e juaja, ju e vendosni, duhet shumica e thjeshtë. Të tërhiqet për seancën e radhës, do të thotë është ideja, jo për seancën e sotme, se e kemi seancën pas kësaj përfundimit, jo për sot, por në të radhës, që e përcaktojmë pas të sotme.

Atëherë, votojmë tash! Më fal edhe pak, tërhiqeni votimin, ndaleni! Është e saktë kërkesa e zotit Zemaj, ka kërkuar mocion procedural. E përkrahni, s'e përkrahni mocionin procedural të zotit Zemaj, në qoftë se votoni për, tërhiqet për seancën e radhës kjo pikë e rendit të ditës, në qoftë se votoni kundër vazhdojmë në bazë të procedurave kjo është. Atëherë, përgatitemi për votim. Votojmë tash!

75 deputetë kanë votuar, 43 janë për tërheqjen e projektligjit nga pika e rendit ditës për shërbime postare, 26 janë kundër, 6 janë abstenime.

Tërhiqet për seancën e cila do të përcaktohet pas mbledhjes së Kryesisë. Komisionet ndërkohë besojmë se javën tjetër e përfundojnë.

11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për masat mbrojtëse në importe

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e me amendamentet e propozuara. Zonja Sala Berisha-Shala, e keni fjalën për arsyetimin e raportit me rekomandime. Urdhëroni!

SALA BERISHA-SHALA: Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, në bazë të nenit 57 dhe 68 të Rregullores së Kuvendit, në disa mbledhje të mbajtura e shqyrtoi Projektligjin nr. 06/L-040 për masat mbrojtëse në importet, të propozuar nga Qeveria. Ndërsa, në mbledhjen e mbajtur më 21 qershor 2018 vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë raport me rekomandime, që besoj që e kanë të gjithë deputetët përpara, materialin dhe raportin me rekomandime. Shkojmë nen për nen, se është leximi i dytë.

KRYETARI: Faleminderit, zonja Sala Berisha! Në këtë projektligj janë propozuar gjithsej 39 amendamente, keni dy mundësi: një mundësi është kjo çfarë e propozoi zonja kryetare, për të shkuar nen për nen, nën dy e keni një mundësi të artë, t'i kalojmë 39 përnjëherë. Të gjitha bashkë, po e shoh reagimin, është për të gjitha bashkë. Atëherë, unë do t'i hedh në votim amendamentet e propozuara edhe përkrahjen nga Komisioni Funkcional 1 deri 39 në tërësinë e vet, në qoftë se ka dikush vërejtje edhe një herë para se ta hedhim në votim, ngriheni dorën. S'ka vërejtje!

Shkojmë në votim 1 deri 39 të gjitha bashkë. Lus dhe deputetët të përgatiten për votimin e amendamenteve 1 deri 39. Votojmë tash!

Kanë votuar 63 deputetë, 61 për, 1 kundër, 1 abstenim.

Konstatoj se u miratuan amendamentet 1 deri 39. E votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Regjia dhe deputetët përgatitemi për votim. Votojmë tash!

Kanë votuar 69 deputetë, 65 për, 4 kundër, asnjë abstenim.

Konstatoj se Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 06/L-040 për masat mbrojtëse në importe.

12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-024 për trajtimin e ndërtimeve pa leje

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara. E ftoj raportuesin e Komisionit FunkSIONAL, zotin Liburn Aliu, për arsyetimin e raportit me rekomandime.

LIBURN ALIU: Faleminderit!

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural dhe Planifikim Hapësinor e ka trajtuar projektligjin, i ka trajtuar të gjitha fjalimet, të cilat janë mbajtur në seancën e leximit të parë, i ka shqyrtuar të gjitha vërejtjet që i kemi marrë si nga Zyra Ligjore e Kuvendit, po ashtu edhe sugjerimet e ndryshme nga shoqëria civile, e po ashtu i kemi marrë edhe amendamentet tjera dhe e kemi bërë këtë rekomandim për të gjitha amendamentet, të cilat janë mbështetur nga komisioni parlamentar, unë kërkoj që të votohen.

Është projektligj jashtëzakonisht i rëndësishëm dhe besoj që do të votohen. Po ashtu, kemi një varg amendamentesh, të cilat janë propozuar nga Grupi Parlamentar i Listës serbe, të cilat janë pa përkrahjen e komisionit funksional, për arsye se pothuaj të gjitha ato amendamente që janë dhënë tanimë janë në ligjin, në nenet tjera në kuadër të këtij ligji dhe nuk ka nevojë për duplifikime. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në këtë projektligj janë propozuar gjithsej 28 amendamente. Kërkoj falje, po dashka të shkojmë një nga një, me aq sa e shoh, duhet të shkojmë një nga një për arsye se paskemi...

Amendamenti 1, me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Po shkojmë një nga një për 28 amendamentet, ato që mund i bëj bashkë, por të shkojnë këto të cilat janë më me rëndësi. Regjia dhe deputetët të përgatitemi për votim. Votojmë tash!

Kisha pasur dëshirë vëmendjen tuaj! S'ka kuorum, në fakt s'kanë votuar, se kuorum ka të mjaftueshëm, 81 deputetë janë në sallë. A shkojmë me dorë në votimin e amendamenteve? 81 deputetë janë të pranishëm në sallë. Shkojmë për, kundër apo abstenim? A jeni dakord të shkojmë me dorë, se na merr shumë kohë?

Ju kisha lutur, të nderuar kolegë deputetë, në qoftë se ka dikush kundër të votojmë me dorë. Shkojmë në votim me dorë, Lista serbe edhe Vetëvendosja kanë reagime. Atëherë të shkojmë me dorë, apo doni në mënyrë elektronike, vendos seanca. Jeni 81 deputetë. Ju lus që të votoni, në qoftë se jeni për votim në mënyrë elektronike, votoni për. Në qoftë se jeni për të votuar me dorë, votoni jo në mënyrë elektronike. Nëse jeni për në mënyrë elektronike po, në qoftë se jeni kundër do të thotë me dorë.

Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë për procedurën e votimit të këtyre 28 amendamenteve. Votojmë tash!

S'po funksionojnë, por reagojnë deputetët, edhe një herë. E hedh edhe një herë në votim, në qoftë se s'ka vendimmarrje, 81 deputetë jeni, për procedura të votimit jemi duke folur. Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim, vetëm pak, 83 deputetë janë në sallë, në qoftë se shkojmë në votimin për shkohet në mënyrë elektronike, në qoftë se shkohet kundër, shkohet me dorë. Votojmë tash! Faleminderit!

66 deputetë, 29 kanë qenë për mënyrë elektronike, 37 kundër, do të thotë janë me dorë, 0 abstenim. Shkojmë me dorë për 28 amendamentet.

Ju kisha lutur vëmendje!

Amendamenti 1, kush është për? Regjia!

Shkojmë më mirë kush është kundër dhe abstenim, këta tjerët janë po.

Kush është kundër? S'ka kundër!

A ka abstenim? As abstenim!

Çka u bë, Glauk, ti edhe Sasha sot s'po mund të rehatoheni hiç. Urdhëro!

GLAUK KONJUFCA: Kryetar!

Sasha punët e veta, unë të miat.

Po, po e vërej që këtë ...

KRYETARI: Jo, unë po mundohem në një formë veç me i bë më funksionale, kjo është.

GLAUK KONJUFCA: Jo, dëgjo! Kjo puna e mënyrës së votimit, ju po vëreni që prej fillimit, për shkak të pakënaqësisë sonë lidhur me shumë ligje dhe të cilat nuk duam të kalojnë në asnjë mënyrë, për shkak se janë të ndërtuara dhe të shkruara gabimisht, neve nuk po na mjafton të votojmë thjesht kundër. Por, po duam t'i pamundësojmë këto ligje dhe kemi një koordinim, siç po shihet, edhe me LDK-në. Në këtë kuptim, nuk mund të aplikoni kurrfarë taktike, e cila i bën bisht mospjesëmarrjes sonë nëpër ligje.

Ne nuk po votojmë, as për, as kundër, as nuk po abstenojmë. Duhet ta llogarisni veprimin tonë si mospjesëmarrje në votim. Kjo është mospjesëmarrje në votim e jo të thuash "Kush s'po e çon dorën, pra qenka për", se kjo është manipulim atëherë. Llogarisni që Lëvizja Vetëvendosje nuk është duke marrë pjesë në votim, jo nëse s'po e çoj dorën të më vishet mua vota për, se nuk është fer.

KRYETARI: Faleminderit! A ka mundësi një sqarim për publikun, jo për shkak të sallës.

Qëndrimet politike janë legjitime, në të cilat unë nuk ndërhyj. Ajo që është një situatë aktualisht në këtë seancë, është se të gjitha projektligjet kaluan me përjashtim të asaj 2/3-ve. E patëm një problem, ta keni parasysh, kjo është situata e cila duhet të qartësohet edhe faleminderit që e bëre publik qëndrimin. Të gjitha projektligjet sot kaluan. Nuk kaloi 2/3-at. 2/3-at edhe një projektligj, në të cilin ju nuk votuat e kur e patë se të parën herë kaloi, pastaj të dytën herë insistuat që unë ta nxjerr në votim, kije parasysh, po, po, ne e kemi ende “pending”, e kemi ende... nuk e kemi aprovuar, e votuam një herë, 61 deputetë votuan, kur e patë se nuk ju funksionoi bojkoti, pastaj kërkuat që me e votua.

Ky është ai qëndrimi që po më nxirrni vështirësi në udhëheqjen e seancës, për arsye se as s’po pranoni, as s’po pranoni. Është qëndrimi politik legjitim i juaji, por në momentin kur hyn një herë në votim, atëherë në bazë të këtij qëndrimi vlen votimi i parë. Unë do të duhej të marr vendim për atë projektligjin që e votuam më herët, të parën herë nuk votuat, por kaloi me 61. Për hir të korrektësisë për ju, kur e vërejtët që votuan 61 ju kërkuat edhe një herë votim dhe pastaj nuk kaloi. 75 morën pjesë në votim. Kjo ashiqare të cilën po e thua, po është mirë ta dinë edhe publiku. Cili është qëndrimi këtu unë nuk mund ta ti. Bëre mirë që e bëre publike, por megjithatë unë po mundohem ta gjej një procedurë të votimit. Kjo po shihet se janë 83 deputetë në sallë dhe se në momente të caktuara nuk votojnë 54, si në rastin aktual.

Unë shkoj prapë në mënyrë elektronike dhe në fund të fundit i heq këto dilema të gjitha, i largojmë edhe në fund të fundit votimet janë transparente dhe as nuk i hyj në hak askujt, as nuk konsiderohet pro dikujt, as manipulim. Kështu do të shkojmë.

Amendamenti 1. Armend, po shkojmë në mënyrë elektronike në votim, të njëjtën. Urdhëro! Zoti Zemajt fjalën veç. Se, të shkojmë në mënyrë elektronike, një nga një, Ahmet, s’kemi çka.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar!

Vetëm për hir të sqarimit dhe të korrektësisë, ne këtu në mandatin tonë e kemi edhe mbikëqyrjen e Qeverisë. Nuk jemi vetëm ligjvënës, por njëherësh jemi të detyruar që të mbikëqyrim edhe ligjet e këqija edhe ligjet e mira. Domethënë, kjo është pjesë e mandatin tonë kushtetues. Kështu që, për çdo projektligj dhe ligj ne japim mendimin tonë me votë.

Ju lus, që ta respektoni Rregulloren e Kuvendit. Mospjesëmarrja jonë nën ligjet e caktuara është votim kundër dhe kjo duhet të evidentohet, sepse është pjesë e procesverbalit dhe e përditshmërisë. Ju mund të siguronit dhe jeni të detyruar që ta keni shumicën. Nëse e keni shumicën atëherë edhe votat tona janë minore në raport me atë që ju duhet ta keni të evidentuar e në statistika të votimit. Kështu që, ky është qëndrimi ynë dhe këtë e shprehim në mënyrë publike.

KRYETARI: Bëjeni qëndrimin publik. Rregulloren, Arben, jam duke e respektuar më tepër se sa duhet. Do të shkojmë me e respektua, po shkojmë në votim në mënyrë elektronike e qitni qëndrimin.

(Debat në sallë)

Fjalën e dëshironi? Hajde, ngadalë-ngadalë. Arbenit ia përmenda emrin, qenka i pari, Dauti, Enveri, Bekimi, Memli, Teuta. Arben Gashi.

ARBEN GASHI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Veç sa për sqarim. Qëndrimet politike të Lidhjes Demokratike të Kosovës janë qëndrime që ndërtohen mbi bazën e konsensusit të brendshëm dhe të cilat kanë një rezultat. Rezultati politik është që projektet të kthyer në akte juridike të propozuara nga Qeveria, Lidhja Demokratike e Kosovës nuk merr pjesë në votim.

Mospjesëmarrja në votim është qëndrim politik, për të cilin unë besoj që edhe partitë e pushtetit dhe partitë e opozitës duhet të kenë konsideratë. Sa i përket çështjes së Ligjit për aktet juridike pata një vërejtje procedurale, kryetar. E pata përshtypjen sikur shumica e deputetëve nuk e kuptuan se çfarë po hidhet në votim. Pra, u hodh në votim rekomandimi i komisionit, që të mos aprovohet ky projektligj. Në momentin kur rekomandimi i komisionit nuk kalon, kjo nënkupton që ligji ka kaluar.

Pra, keni parasysh se çfarë po hidhet në votim dhe të jenë të qartë deputetët kur hyjnë në procedurën e votimit, se çka po votojnë. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti Haradinaj, fjala për ju.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryetar!

Unë e kuptoj që ka aleanca të brendshme ndërmjet... serbe dhe LDK-së, por më çudit fakti që deputetët e LDK-së në komision kanë votuar për dhe Lutfi Zharku, Besa Gaxheri kanë votuar për. Liburn Aliu e ka kryesuar këtë nënkomision, ose grup punues, dhe sa për informacion për publikun në këtë rast, dua të ju them që ky ligj, Liburn, nëse e kam gabim ma thuaj. Hiç mos voto, nëse s'ka rëndësi, por ky ligj atakon mbi 73% të qytetarëve të Kosovës. Tash jemi duke folur për procedura qysh votojmë, por disa individë këtu me të vërtetë çuditërisht e vazhdojnë traditën e vjetër.

Shumë jam i lumtur, që Vetëvendosja ka krijuar aleancë të fshehtë, Liburn, edhe me Zemajn. Kjo është çudia më e madhja. Ky ligj nëse s'votohet sot ju keni për ta sjellë në tavolinë në Bruksel, në mes Hashim Thaçit dhe Vuçiqit. Nëse e keni këtë qëllim edhe me dalë në bufe e për të ardhur fshehtë këtu qysh e keni votuar Hashimin për president herën e kaluar ju LDK-ja, mbani mend

që jeni kah gaboni tepër shumë. Jo, e keni votuar me vetëdije të plotë Hashim Thaçin për president edhe ia pafshi hairin edhe kështu keni për ta pasur. Edhe kur të më vijë mua për t'ia dhënë votën, me të dy duart kam për ta votuar. Po, ju e keni votuar dhe prej bufesë keni ardhur, se keni menduar ndryshe në atë kohë. Sot e keni ndërruar mendjen, por po më çudit Vetëvendosja, e aq më tepër, një njeri që e respektoj shumë dhe e di çfarë kemi hequr për të ardhur në këtë tavolinë për këtë ligj, Liburn Aliu.

Nëse nuk e voton sot, le ta dijë populli i Kosovës kush nuk po e voton këtë ligj, nëse e keni shqetësim. Dhjetë amendamentet e Listës serbe, e keni gabim, asnjëherë s'kam për t'i votuar. E nëse keni ju aleancë ndër vete të fshehtë, Zemaj, Liburn Aliu dhe të tjerët, ia pafshi hajrin.

KRYETARI: Jo, ti nuk ke të drejtë, ka Liburni. Liburni, jo, jo, Liburni, ia përmendi emrin. Liburni ka të drejtë në replikë. Urdhëro, Liburn.

LIBURN ALIU: Rëndësinë e Ligjit për trajtimin e ndërtimeve pa leje nuk kam pse e them, e thash atë në emër të komisionit. Vendimi për mosbotim është vendim i yni politik, të cilin e arsyetoi shumë qartë Glauku. Ndërsa, për sa i përket Listës serbe, Listën serbe e keni ju në Qeveri, e kuptoni? S'kemi pse...

KRYETARI: Faleminderit! Zotëri Zemaj, kundër replikë zoti Haradinaj apo po dëshiron e ke një minutë kundër replikë, pastaj edhe zotëri Zemaj edhe një minutë, dy minuta. Kundër replikë, urdhëro zoti Haradinaj.

DAUT HARADINAJ: Ne Listën serbe nuk e kemi ilegalisht, e kemi oficiel, bile s'ka pasur shqetësim që jo vjen, jo s'vjen edhe e kemi pa a janë a s'janë, ministër. Nuk jemi kah themi as është, as jemi, as nuk jemi. Është zyrtarisht, e ke publikisht edhe e ke, qe ku i ke ulëset. Po, jam kah të flas për amendamentet e propozuara nga Lista serbe, nëse e kuptove drejt.

Edhe një herë po ta përsëris, për amendamentet e Listës serbe, të cilët kanë kërkuar që ta kenë nga një përfaqësues permanent në secilin komision komunal për legalizim. A e kuptove? Dhe, ti e di shumë mirë, që të kam thënë edhe atë ditë, edhe një herë po ta përsëris, s'ka me kalua.

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Zemaj. Liburn, nuk ka më. Rregullorja... Arben a e parasheh Rregullorja më tutje? Armend, edhe ti veç dije, Dauti edhe një herë pas teje flet, po ti s'ke të drejtë më. Urdhëro, replikë.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar!

Ne nuk ishim duke e shqyrtuar përmbajtjen e amendamenteve. Dhamë qëndrim politik, por ky zotëria tek është çuar jerm dhe nuk e diti, as për çka jemi duke folur, as çka jemi duke paraqitur këtu sot. Po flet për disa aleanca, për disa takime në Bruksel, sigurisht ka parë ndonjë ëndërr të

keqe, është mirë ta shpjegojë, por këtu jemi në Parlament. Kështu që, jemi duke folur për një pikë të rendit të ditës, ne shprehëm një qëndrim politik, por nuk kemi hyrë, as te përmbajtja, as te amendamentet.

KRYETARI: Zoti Haradinaj, kundër-replikë!

DAUT HARADINAJ: Jam i detyruar edhe një herë t'ia përsëris këtë në fjalë, se s'po ia përmend emrin.

LDK në komision ka qenë për, ka votuar për, Besa Gaxherri, Lutfi Zharku. Nëse ky zotëria në fjalë nuk është konsultuar me anëtarët e komisionit dhe i vlerëson të parëndësishëm deputetët e vet, unë s'di qysh ka me e ditë ky, por mua nuk më çudit fakti që ky s'e di. Unë e di veç një fakt, që jam të shqetësuar në fakt, se janë kah presin diçka tjetër. Por, ka vdekur Jugosllavia, zoti të lashtë shëndosh, Armend!

KRYETARI: Faleminderit! Ishim shkuan ta votojmë, a doni? Jo, jo, unë... po veç jeni shumë, 2, 4, 5.

(Debat në sallë)

Jo, kanë të drejtë deputetët, unë kështu-ashtu jam i obliguar në bazë Rregullores. Po, zotëri Hoti, atëherë urdhëro, fjala për ju.

ENVER HOTI: Faleminderit, kryetar!
Për shkak të korrektësisë...

KRYETARI: Publikisht e thërras, më fal Enver, veç një nënkryetar le të afrohet për ta udhëhequr seancën, se kam takim zyrtar. Në qoftë se, ka mundësi njëri prej nënkryetarëve. Urdhëro, zoti Hoti, vazhdo. Më fal!

ENVER HOTI: Faleminderit, kryetar!

Për hir të korrektësisë mendoj se duhet t'i sqarojmë gjërat, edhe ato që janë vendime politike, por edhe ato që janë në funksion të mbarëvajtjes. Unë dua të falënderoj të gjithë anëtarët e komisionit për punën që keni bërë në Komisionin për Bujqësi dhe Planifikim Hapësinor, e veçmas dua të falënderoj grupin punues që ka udhëhequr zoti Liburn Aliu.

Kemi bërë një punë të mirë dhe mendoj se ky projektligj është me rëndësi të veçantë për vendin dhe për interesin e qytetarëve të vendit. Çdo tërheqje tani, që unë do të them taktike, e një pjese të opozitës duke marrë si vendim politik të tyre ne e respektojmë. Por, nuk kishim dashur dhe nuk mendoj që është zgjedhje e mirë, pavarësisht që është vendim i tyre, për këtë projektligj. Ky

ligj rregullon shumë fusha të rëndësishme, që kanë të bëjnë veçmas me kryeqytetin. Nuk e di, ndoshta është vendim politik, ndoshta mund të jetë diçka përtej saj, por deri më tani pamë se ishin pjesë e disa votimeve dhe mendoj se deputetët, ata të cilët kemi qenë në grup punues, duhet të jemi më këmbëngulës që ky ligj duhet të shkojë, se nëse nuk merr zgjidhje në Kuvend, ndoshta nesër në të ardhmen do të pendohemi, se do të bëhet pjesë e tavolinave të ndryshme jashtë institucioneve të vendit. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetarja e Kuvendit, znj. Aida Dërguti.)

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Bekim Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, e nderuara kryesuese!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese që ka rregulluar çështjen e votimit, si duket edhe në raste të caktuara po abuzohet nga vetë deputetët apo po ka intenca që të keqpërdoret, me qëllim të bllokimit të punës së Kuvendit.

Kur jemi duke e trajtuar një ligj që është shumë i rëndësishëm për trajtimin e ndërtimeve pa leje, duke e ditur se sa është numri i këtyre ndërtimeve pa leje, në cilën periudhë kohore dhe të qeverisjes së kujt kanë ndodhur këto ndërtime pa leje edhe si kanë arritur të vazhdojnë këto ndërtime pa leje edhe në kryeqytet pas ndërrimit të qeverisjes tjetër, kur deputetët në aspektin profesional po edhe politik në komisionet përkatëse e mbështesin Ligjin për trajtimin e ndërtimeve pa leje, në këtë rast zoti Liburn e dha vetë, deputeti Liburn Aliu, që tha ju ftoj ta përkrahni, ta votoni. Kur hymë në procedurën e votimit, njëjtë u deklarua zoti Zemaj se nuk e përkrahim, por që dy deputetë të Lidhjes Demokratike kanë dhënë mbështetjen për këtë projektligj dhe pastaj vijmë me qëndrime politike me e bllokua ligjin, siç e pamë deklarin e zotit Konjca, i cili tha se ne e bojkotojmë. Do të thotë, ne nuk marrim pjesë në votim, por në fakt jemi në seancë, marrim mëditje dhe për ta bllokuar punën e Kuvendit.

Ky mentalitet dhe kjo formë e opozitarizmit, unë mendoj që duhet të ndryshojë. Nëse kanë ide më të mira për Ligjin për ndërtimin pa leje, edhe LDK-ja, edhe Vetëvendosja, edhe subjektet tjera politike, urdhëroni, propozoni cili është vizioni i juaj, cili është projekti juaj për trajtimin e ndërtimeve pa leje. Por, projekt me e bllokua punën e Kuvendit është projekt me e bllokua qytetarin edhe me u krijua vështirësi, edhe atyre që janë sot në qeverisje, edhe në Prishtinë, edhe në qytetet tjera, me i lënë pa ligj për trajtimin e ndërtimeve pa leje edhe me vazhdua krahura ekzistuese në Kosovë. Nëse kësaj i thoni “qëndrim politik”, atëherë unë nuk kam çfarë të komentoj më shumë, veç le të ju vlerësojë qytetari. Po rri në seancë, s’po marr pjesë në votim, edhe pse je i obliguar sipas ligjit dhe Kushtetutës me u deklarua për, kundër ose abstenim, nuk

po do, por po do të rrijë ulur në karrige, për ta bllokuar punën e Kuvendit dhe për t'i marrë paratë prej Kuvendit të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESJA: Glauk Konjufca, replikë!

GLAUK KONJUFCA: Mendoj se kam të drejtë në replikë, sepse u është referuar të gjithë atyre që nuk po marrin pjesë në votim. E tash po i përgjigjem, edhe Dautit, edhe Kamishit.

Kështu, kjo nuk është kurrfarë aleance fshehtë, as kurrgjë që ne nuk po e bëjmë të ditur, kjo është shumë e hapur. Ne kemi marrë vendim, por këtë nuk e kemi bërë në konferencë për shtyp që ju mund ta kuptoni prej veprimeve tona. S'ka nevojë me e kap tupanin edhe me rreh për këtë punë që po e bëjmë. Ne po e bëjmë një veprim të thjeshtë këtu në këtë seancë dhe shyqyr që po e merrni vesh, mazhoranca.

Kjo është kështu, që me ju tregua juve, që nuk e keni shumicën, është shumë e thjeshtë, ama jo për çdo ligj. Ne tre ligje deri tash i kaluam, e kaluam edhe marrëveshjen ndërkombëtare, që mendojmë se është e rëndësishme për interesat e Kosovës.

(Debat në sallë)

Po, mirë de, sillni edhe deputetët e juaj edhe kalon me 80 vota, mirëpo këtu e keni opozitën që voton. Pra, kjo sa u përket vendimeve të Vetëvendosjes. Vetëvendosja e voton marrëveshjen ndërkombëtare, Vetëvendosja e votoi eficiencën për energjinë, Vetëvendosja e votoi ligjin shumë të rëndësishëm për mbrojtjen e importeve dhe Vetëvendosja do t'i votojë edhe disa ligje tjera, mirëpo jo ligjet të cilat ju mendoni t'i shtyni patjetër. Këtë merreni vesh!

Ne nuk jemi këtu që të ju qëndrojmë gatitu, Daut, edhe me ua votua juve çfarë të doni ju. Ne jemi opozitë, i kemi projektet tona dhe mendojmë që në ato ligje ku ne nuk po ju votojmë, mendojmë se e keni totalisht gabim edhe kemi të drejtë të mendojmë kështu. S'keni çka të hidhërohni për këtë punë, kjo është publike, dihet. Nuk ka kurrfarë aleancash të fshehta me kurrkënd, po opozita herë pas here po e aplikon këtë taktikë, vetëm sa...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESJA: Daut Haradinaj.

DAUT HARADINAJ: ... me emër. Më vjen shumë keq t'ia rikujtoj Glaukut që po e shoh që me të vërtetë është i painformuar total. Nëse ky ligj është i parëndësishëm, perfekt. Veç dua t'i them diçka, seancën e komisionit që e kam pasur të parën, i dashur Glauk, me gjithë respektin që kam, ia kam dhënë ushtrimin e detyrës zotit Liburn Aliut, i cili me shumë vështirësi, me një punë

shumë të madhe, me probleme shumë të mëdha, e ka përfunduar këtë projektligj dhe e ka prurë deri në seancë. Liburn Aliu, nuk e di sa je i informuar, dhe nëse ju e vlerësoni këto ligj të parëndësishëm, atëherë po më duket që prapë keni ndonjë problem aty në treshe ju brenda. Por, ky projektligj është tepër i rëndësishëm për qytetarët e Kosovës dhe këtë projektligj nuk e ka kryesuar Daut Haradinaj, po e ka kryesuar Liburn Aliu. Dhe, të gjithë anëtarët e komisionit kemi qenë anëtarë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESJA: Deputeti Bekim Haxhiu, replikë!

BEKIM HAXHIU: Zoti Glauk, unë nuk e di a keni probleme në treshe a s'keni, por një gjë dua të të tregoj, që mazhoranca kur ka votuar për Qeverinë e ka demonstruar shumicën. Edhe katër vjet kështu shkojmë. Kur ju mendoni që e keni shumicën me e rrëzua, demonstrojeni. Por, këto ligje nuk bëhen veç për mazhorancën, këto ligje bëhen për qytetarët e Republikës së Kosovës.

Nëse je duke mbrojtur ndonjë interes biznesor, sepse keni qenë në komunën e Prishtinës edhe doni ta bllokoni për ato arsye, derisa vet përfaqësuesi i subjektit tuaj politik ka dhënë kontributin për ta bërë këtë ligj, atëherë është me i marrë disa mëditje në komision e me ardhë me e bllokua këtu. Përndryshe, nëse ia mohoni punën njëri-tjetrit, do të thotë, unë nuk po e kuptoj çfarë qëndrimi politik është, ose ju ndoshta keni të drejtë. Por, kur të doni me e dëshmuar që ju e keni shumicën, i mblidhni nënshkrimet, e demonstoni, e praktikojmë. Nëse e keni shumicën, shkojmë në zgjedhje, s'bëhet nami, fitojmë prapë edhe vazhdojmë prapë kështu. Faleminderit!

KRYESUESJA: Deputeti Armend Zemaj, replikë!

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryesuese!

Është e qartë, se ata që janë me veprime apo gjithmonë funksionojnë me veprime të nëntokës, të fshehta, gjithmonë në ndërrijen e tyre është që edhe dikush tjetër mund të veprojë. Ne po veprojmë këtu publikisht, po shprehim qëndrimin tonë publik, jo vetëm për këtë ligj, por edhe për të gjitha ligjet dhe kjo është edhe puna dhe mandati ynë.

Ndërsa, Bekim, këtu tash kjo elegjia për paga, për financa e për të tjera, mendoj që nuk përkon me atë që ne po e proklamojmë këtu, kështu që të jemi të sqartë edhe me njëri-tjetrin si kolegë deputetë. Andaj, këto nervozet momentale që i keni dhe këto shqetësimet për ne nuk janë të çuditshme, por mos u mundoni t'i shndërroni në atë që tash populli e njeh "patriotizmin e ulët" tuajin.

KRYESUESJA: Kundër-replikë, Bekim Haxhiu!

BEKIM HAXHIU: Armend, po ia filloj nga e fundit për të dalë te e para.

Nëse për ty është “patriotizëm i ulët” me derdh gjak në këtë vend, atëherë sigurisht patriotizëm është me e braktis vendin edhe me e tradhtua nga fushëbetejat. Nëse kësaj ti i thua patriotizëm, atëherë të gjithë ata që kanë derdhur gjak për këtë vend e që e kanë lagur me gjakun e tyre, nëse kësaj ti i thua patriotizëm, unë të kisha lutur, shikoje veten, se nuk je mirë.

Në anën tjetër, po të flas, të fola praktikisht. Ti je duke e mohuar punën e dy kolegëve tu në komision. Je duke e bllokuar atë punë që ata e kanë bërë. As nuk po dua të mbaj ligjëratë, njihemi këtu, jemi bashkë qe tre mandate deputetë, e njohim punën e njëri-tjetrit dhe sigurisht që e njohim edhe historinë e njëri-tjetrit.

KRYESUESJA: Po ju lexoj emrat, ashtu siç jeni lajmëruar për diskutim: Memli Krasniqi, Teuta Haxhiu, Liburn Aliu, Gani Dreshaj, Sasha Milosavljeviq, Milaim Zeka, Enver Hoti dhe Ahmet Isufi.

Fjalën e ka Memli Krasniqi.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, e nderuar kryesuese!

Për fat të keq, pak a shumë edhe kjo seancë thuaja degjeneroi në diçka që nuk e ka vendin këtu dhe ne, në vend se të merremi me temat për të cilat jemi pajtuar në mbledhjen e Kryesisë, pa dallime politike, sepse nëse ka një qëndrim politik një parti politike, një grup parlamentar, nuk mund ta mbajë një anëtar i atij grupi, disa anëtarë të tjerë të mos e mbajnë, po ky rend i ditës është bërë në pajtueshmëri me krejt përfaqësuesit e Kryesisë. Vetëvendosja nuk ka përfaqësues në Kryesi, po LDK-ja ka përfaqësues, po këtu është ky, thënë butë, josinqeriteti, po ju kuptojeni me term pak më të rëndë dhe më jokorrekt politikisht, çka është duke ndodhur në dy krahët e opozitës, në të djathtë dhe të majtë, LDK edhe Vetëvendosje, qe sa absurde janë argumentet e tyre.

Armend Zemaj doli dhe e bëri një mocion përmbajtjesor që kjo seancë ia mbështeti, se ishte preokupuar qysh pahiri disa amendamente janë në kundërshtim me direktivat e BE-së, ndërsa i njëjti, me grupin e vet parlamentar nuk e votoi marrëveshjen e Kosovës me BE-në, e cila i mbështet ndërmarrjet e Republikës së Kosovës, për herë të parë u mundësohet me marrë pjesë në programin e UNION-it. Tash me kë jeni? “A me shehër, a me Barilevë?” Një herë jeni kundër marrëveshjes me BE-në, ua pamundësoni ndërmarrjeve të Republikës së Kosovës të marrin fonde të BE-së, mezi u ka ardhur kjo mundësi, e në anën tjetër, dilni se preokupoheni për nja 4-5 amendamente, diçka votoni, diçka nuk votoni.

Në anën tjetër e ke Vetëvendosjen, ku deputeti Liburn Aliu e arsyeton në emër të komisionit, njeriu që e ka bartur krejt punën e grupit punues për Ligjin për trajtim të ndërtimeve pa leje dhe

thotë që është tepër i rëndësishëm, se duhet të votohet, dhe del tash shefi i grupit të tij, Glauku, thotë nuk i votojmë ligjet që mendojmë që jemi gabim. A është gabim tash Ligji për trajtim të ndërtimeve pa leje, Glauk? Nëse na thotë Liburni që është gabim, të jeni të bindur që edhe ne po votojmë kundër. Po nuk po mund t'ju kuptoj, ju po thoni ne votojmë ato që janë të rëndësishme, edhe i përmende çka ke votuar, e ato që nuk janë të rëndësishme s'i votojmë. Nëse nuk është i rëndësishëm, tregon shefi i grupit punues, zoti Aliu. Po ju thoni që kemi qëndrim politik, të paktën mos u mundoni t'i kamufloni inatet tuaja me diçka tjetër, është legjitim qëndrimi politik. Thoni duam ta bllokojmë Parlamentin, sepse keni pak numra. Ne e dimë që kemi pak numra, po kemi tamam numra sa për t'i kryer disa punë, se e keni parë që i kemi kryer disa punë, kur duam të gjitha punët i kryejmë. Edhe javën e kaluar e keni marrë vesh që të gjitha punët i kryejmë, e merrni vesh edhe këtë javë, edhe javën tjetër.

Po fakti që mund t'i mungojnë shumicës parlamentare 2-3 deputetë në një moment të caktuar, ndoshta para një ore nuk i munguan, tash në këtë moment i mungojnë, juve nuk ju jep kurrfarë vlere në ato konstatimet tuaja pakica a shumicë.

Kush e ka shumicën këtu, nëse s'e kemi ne? A e keni ju? Që qenkeni koordinuar Lëvizja Vetëvendosje me Lidhjen Demokratike të Kosovës, mirë, për hair ju qoftë koalicioni dhe aleanca, ma merr mendja më shumë se krejt po u gëzoja Isa Mustafa, se goxha u ka në qejf juve se i keni ndihmuar shumë në mandatin e tij kur ka qenë kryeministër, ndoshta e paskeni bërë aleancën me 'izën' e tij, mbase ju ecën puna mbarë, është e drejtë juaja, organizohuni si opozitë e bashkuar! Po tregoni drejt cilat janë qëllimet. Ne po i kuptojmë, ju thatë a po na kuptoni, po, po ju kuptojmë. Nuk mund t'ju kontestojmë legjitimitetin e qëndrimit tuaj politik që ta bllokoni Kuvendin e Kosovës kurdo që mundeni.

Dikush prej juve tha se kur nuk votojmë ne, ju merreni votën kështu, tjetri tha jo kur nuk votojmë ne, merreni votën kundër. Ani, në rregull. Po çka po ju pengon të çoni dorën ose ta prekni sustën kundër, cila është arsyeja?

Krejt çka ndodh do të shtyhen për seancën tjetër, në seancën tjetër kalon, këto janë shtyrjet e 5-6 seancave. Kanë mundur të votohen më herët, sot kaluan disa, disa nuk kalojnë.

Në fund, nuk është se po humb mazhoranca, mos e mashtroni veten e as qytetarët e të thoni se po humb Qeveria. Po humbin qytetarët e Kosovës, se nëse nuk kalon shpejt Ligji për trajtim të ndërtimeve pa leje, ju e dini që alternativat janë shumë më të këqija.

Është e vërtetë që një alternativë e mundshme që kjo temë të na shkojë në Bruksel. Çka po doni të bëni, a po doni ta qoni temën në Bruksel? Jam i bindur që s'ma merr kur mendja që ju e keni këtë vullnet. Po bllokoni ndonjë farë teme tjetër, janë disa raporte të agjencive, kot, i keni disa interpellanca, do farë rezolutash, bëni politikë me to!

Por për mendimin tim, njëjtë sa ka qenë i rëndësishëm Projektligji për masat mbrojtëse në importe, që e përmende që e keni votuar, nuk e di sa prej jush e keni votuar, se boll pak vota pati, po e keni votuar ndoshta disa. E ky Projektligji për trajtim të ndërtimeve pa leje mund të jetë edhe më i rëndësishëm, sepse na prek të gjithëve, i prek shumicën dërmuese të qytetarëve të Kosovës.

Po e përfundoj, ju thatë që nuk duam t'i votojmë projektligjet që mendojmë që janë gabim. A është gabim ky projektligj? Nëse është gabim, le të na thotë edhe bartësi i punës të këtij projektligjit që ka qenë shef i grupit punues, zoti Aliu, që e arsyetoi në emër të komisionit. Le të na thonë që është gabim, po ja u jap besën që do të votojmë kundër edhe ne. Po nëse nuk është gabim, cili është arsyeimi të mos votohet një projektligj kaq i rëndësishëm?

Po them, është e drejtë juaja të bëni politikë me çështje të caktuara, bëni politikë, secili këtu jemi duke bërë politikë. Ama politikë me interesat goxha të mëdha, të një numri tepër të madh të qytetarëve të Kosovës s'ma merr mendja që kemi të drejtë të bëjmë asnjë prej deputetëve që kemi ardhur këtu t'i përfaqësojmë këto interesa. Faleminderit!

KRYESUESJA: Replikë, Liburn Aliu.

LIBURN ALIU: Replikë po, kjo është replika, pastaj e kam radhën për fjalë, po ashtu.

Ne këtu i kemi një varg projektligjesh, të cilat sot në shumicën dërmuese prej këtyre nuk do të marrim pjesë në votim dhe kjo është një e drejtë plotësisht legjitime.

Ju kanë kaluar disa ligje më herët dhe thatë sa herë duam, ne i kalojmë. Jo, ju kanë kaluar ligjet të cilat kemi dashur ne t'i votojmë dhe ne i kemi votuar disa ligje, të cilat kemi dashur edhe sot, edhe herëve të tjera e do të kemi edhe radhë të tjera që ne do të votojmë ligje.

Mund të konsiderojmë ndonjë ligj të veçantë që është i rëndësishëm jetike dhe e votojmë, natyrisht nuk e bllokojmë. Ama, detyrë jona është që këtë Qeveri të pakicës ta bëjmë sa më të dukshme dhe ta pengojmë dhe ta ndalim sa më shpejt. Është e nevojshme të shkojmë në zgjedhje sa më shpejt, në mënyrë që të kemi një Qeveri të shumicës. Prandaj, kjo është detyra jonë.

Për sa i përket ligjit në Bruksel, unë nuk e kuptoj pse duhet të shkojë Ligji i ndërtimeve pa leje në Bruksel? Pse po u dashka të trajtohen ndërtimet pa leje tash në Bruksel? Ju a e keni të qartë që edhe ky Ligji i ndërtimeve pa leje, sado që në përmbajtje të vet është i mirë, kryesisht dhe ka ndonjë element që mbase do të ishte i rëndësishëm, më mirë sikur të ishte ndryshe, po nuk mund të jemi kundër realisht këtij ligji, po në anën tjetër do të jetë totalisht jofunksional përderisa Qeveria juaj, qeverisja juaj nuk i ndal ndërtimet pa leje, edhe të vetat, edhe në krejt Kosovën. E sjellim këtë ligj, e tjetrin e tjetrin e çdo ligj nëse ndërtimet pa leje nuk ndalen. Ndalini njëherë ndërtimet

pa leje, mandej ka kuptim ligji. Ne po bimë ligje në vazhdimësi, është ligji i dytë ky dhe pse vijnë ligjet një pas një? Sepse ndërtimet pa leje nuk i ndalni, kush është ndërtuesi më i madh pa leje? Qeveria, jo qytetarët. Qeveria më së shumti sot ndërton pa leje dhe unë ja u tregoj për një, nëse doni.

KRYESUESJA: Replikë, Glauk Konjufca.

GLAUK KONJUFCA: Po shtrohet çështja sikur Kosova ka mbetur ta kalojë këtë ligj dhe do të bëhet parajsë. Po para dy javësh 53 milionë euro i ka humbur kjo Qeveri. Këtu po vidhen paratë me miliona, këtu korrupsioni është në çdo institucion, këtu është bërë praktikë e qeverisjes korrupsioni. Interesi jetik është të ndalet kjo Qeveri, jo t'ia kalojmë njërin prej ligjeve, i cili qenka i rëndësishëm, po u bëka kiameti nëse nuk kalon. More kiameti është duke u bërë që po vidhen milionat në Kosovë, kiameti është duke u bërë që e ke një Qeveri që vendimin më të rëndësishëm të saj e ka rritjen e pagës vetvetes, këto janë problemet e Kosovës, o zotëri, këto janë problemet reale të Kosovës. Problem real i Kosovës është varfëria e qytetarëve, jo pse nuk po kalon një ligj për ndërtime. Sa e ke punësimin në Kosovë, ky është problemi. Po të vdesin pacientët në QKUK, ky është problemi i Kosovës, jo pse paska mbetur Kosova jonë në këtë ligj, i cili nëse nuk po kaluaka, po u bëka shumë keq! Prandaj, gjejini diqysh një farë mënyre e t'ia bëjmë diqysh. Jo, nuk janë këto problemet e Kosovës.

Problemet e Kosovës ne i dimë të gjithë, problemi më i madh është që e ke një Qeveri, e cila nuk e di ku i ka kufijtë, nuk e di ku i ka kufijtë, shkon atje, negocion me Serbinë, të sjellë marrëveshje të dëmshme, e çka të mendoj unë? Të mendoj tash qysh të votohet Ligji për ndërtime! Jo, more vëlla, unë mendoj qysh të rrëzohet kjo Qeveri. Unë mendoj qysh t'i jepet fund punës suaj, e cila është për çdo ditë e keqe, e ju po e tregoni çështjen e Kosovës thujse ka mbetur me një ligj të thjeshtë, mos të lutem!

KRYESUESJA: Replikë, Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryesuese!

E para, desha t'i them Kamishit që logjika jonë nuk është paraja, as nuk është grabitja, as dhuna, as vrasjet, as mashtrimi, as shkatërrimi, e këto çështje të atdhedashurisë do t'i dëshmojë koha, po për dikë do të jetë vonë. Kështu që nuk e kemi problem atë punë, as ballafaqimin, as vlerësimin, sepse vlerësimin më të mirë e jep populli dhe qytetarët e vendit për çdo njërin, apo edhe për gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës.

Kolegu Memli Krasniqi nuk ishte i vëmendshëm, sepse unë çështjen e ngrita në mungesë të kryetares së komisionit, edhe kjo ishte detyrë jona, po e përsëris, edhe juve edhe kolegëve të tjerë deputetë, është diçka që është interes i përgjithshëm joni që të mos biem ndesh me 'acquis communautaire' dhe, edhe tash po e theksojmë. Ju po mundoheni ta përktheni në diçka që nuk

përkon me realitetin, po mundoheni t'i imponoheni opozitës me logjikën e pozitës, po nuk shkon kështu, nuk është as e drejtë, as reale, as nuk është demokratike, të gjithë ne e kemi nga një mandat dhe e përfaqësojmë dikë këtu.

Urdhëroni, hyni në proces të votimit, ju e keni vlerësimin tuaj, ne e kemi tonin, qytetarët po na shohin, ata do ta japin vlerësimin përfundimtar. Por të mundoheni këtu të edukoni opozitën se si duhet të silltet dhe si duhet të votojë, kjo është jodemokratike, është ndërhyrje, është dhunë, është kërcënim, është kanosje dhe çka po i afroni Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe çka po u ofroni qytetarëve të vendit? Kjo gjuhë dhe kjo sjellja juaj e tregon që keni probleme të mëdha, nuk po dua të them probleme individuale, se dikush mund të ketë edhe probleme individuale, edhe me të kaluarën, edhe me krimin, edhe me korrupsionin, me çdo gjë.

Por, ky është qëndrimi ynë dhe këtë qëndrim do ta mbajmë aq sa keni vota.

KRYESUESJA: Kundër-replikë, Memli Krasniqi.

MEMLI KRASNIQI: Mblidhmi minutat, se tre i kam, kështu që mos u habitni, kur kam kundër-replikë që s'ju keni referuar. E vërtetë është që s'ma keni përmendur emrin, përveç Armendit. Është e çuditshme që nuk ma keni përmendur, sepse nuk jeni përgjigjur në asnjë prej çështjeve që i thashë, në asnjë prej çështjeve që i ngrita dhe atyre argumenteve që i dhashë, ju nuk i adresuat. E vërteta është kjo. Qeveria ose shumica nuk është duke ju kërkuar juve të votoni qysh po ju themi ne. Sikur të kishte thënë Qeveria: "Votoni këto ligje pro, ose votoni kundër, ose abstenoni", do të kishte logjikë ajo çka po thua, Armend. Nuk po kërkojmë të votoni si Qeveria, ju votoni si opozitë, votoni kundër, po kryeni obligimin për çka ju kanë votuar njerëzit në këtë Kuvend, kjo është kërkesa.

Me mosvotim, ju po mundoheni thjesht të arrini qëllimin e bllokimit të Kuvendit dhe ndonjëherë po e qëllon.

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESJA: Fjalën e ka Teuta Haxhiu.

Në fakt, e ka kërkuar fjalën për kundër-replikë pas fjalës së Glaukut, por unë prita ta përfundojë edhe Armendi për t'i përmbledhur të dyja.

Regjia, edhe një minutë fjalën Memli Krasniqit.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, kryesuese!

Edhe ajo sa i përket BE-së, prapë, Armend, ty po të referohem. Unë e di që fole në emër të komisionit, po e vërteta është që morët pjesë në votim, këtu është loja me dy kute. Një herë po,

bën, tani jo nuk bën! Mbani qëndrim politik, kur t'i thua qytetarit këtu përmes këtij mikrofoni kam qëndrim politik, mbaje qëndrimin politik.

Dhe, e treta, për ndërtime pa leje tash po më bie në mend. I vetmi qytetet ose komuna që ka më së shumti probleme me ndërtime pa leje është komuna e Prishtinës, tash po më duket i kam rënë në fije pse LDK-ja dhe Vetëvendosja janë kundër këtij ligj. Ndoshta është e vërtetë, po doni të vazhdoni ta bllokoni Komunën e Prishtinës dhe kryetarin Shpend Ahmetin, është e drejtë juaja, bëni çka të doni, ne në atë garë s'kemi qëndrim. Veç nëse duke e bllokuar Komunën e Prishtinës, i bllokoni krejt qytetarët dhe bizneset e Prishtinës, ajo nuk është e drejtë dhe besoni as juve nuk do t'ju kryejë punë.

KRYESUESJA: Fjalën e ka Teuta Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetare!

Kërkoj prej regjisë apo teknikës që ta rregullojnë mikrofonin tim, që dy seanca nuk funksionon, kjo është diçka jo në rregull.

Megjithatë, për ta parë fytyrën e vërtetë të deputetëve që flasin me kamera dhe pa kamera, në komisione ndryshe, në seanca ndryshe, kjo është fytyra jonë e vërtetë, të nderuar qytetarë.

Para një ore e gjysmë u mor një vendim në Kuvendin e Republikës së Kosovës për t'i votuar disa amendamente në mënyrë të hapur, të shihet kush është deputeti që ka emër e mbiemër dhe ne secili e dimë, pas një ore apo pak minutash, ne mund t'i shohim edhe të tjerët, por u mor një vendim, një vendim i seancës, e aq më tepër kur po flasin disa për parime, për transparencë, për dhunë e gjëra të tjera, me të vërtetë po habitem, jo që po habitem unë, po habitem qytetarët!

Fatmirësisht që na njohin bash secilin kush është kush dhe kush nga vjen, secili qytetar na njeh, ama kërkon nuk mund ta mashtrojmë.

Thjesht, unë po flas për një vendim të Kuvendit, i cili mori vendim që amendamentet e Ligjit për trajtimin e ndërtimeve pa leje të votohen me dorë, ky është një vendim i Kuvendit dhe atë që e tha Memli pak më herët, unë po, nga ajo që pashë nga kryetari i Komisionit për gjithë punën që e ka bërë një anëtar i komisionit po shihet publikisht që nuk janë të interesuar ta zhvillojnë Prishtinën, kryeqytetin e Republikës së Kosovës, po janë të interesuar ta bllokojnë kryeqytetin e Republikës së Kosovës, jo Qeverinë, Kuvendin dhe kryeqytetin. Kjo është ajo që po u intereson, por për ta rregulluar kryeqytetin, për të përfutur kryeqyteti fonde, jo vetëm për të rregulluar objektet, po për të vendosur edhe një rend është pikërisht ligji në fjalë, në të cilin kanë punuar anëtarët e komisionit.

Pra, edhe një herë, po të mbyllen seancat për media, besoni secili prej deputetëve krejt ndryshe do të vepronte, po të mos jenë mediat në komisione, secili deputet ka aq muhabet me kolegët tanë që lëvizin andej e këndej sa me mend s'mund ta marrin qytetarët. Po t'i shihni në bufë se çfarë bisedash bëjnë me kolegët e nderuar të Listës serbe, ama bash është shumë për çudi a. Aty i shihni fytyrat e vërteta, por jo në media.

Prandaj, po tentoni të luani, po luani me vetveten, nuk luani me Qeverinë, nuk ka shans, sepse s'mund të luani, po tentoni të luani me kryeqytetin, po s'mund të luani, ju keni marrëveshje me LDK-në e me PDK-në ju VV-ja, po nuk mund ta bllokoni, po tentoni, po s'mundeni. Po flasim për parime e po flasim për diçka që është vendosur në Kuvend. Duhet të respektohet vendimi i Kuvendit për të votuar me dorë, ashtu sikur u dakorduar, e qysh votoni ju është çështje juaja, ama është vendim i Kuvendit.

Nëse flisni nganjëherë kur ju konvenon ta respektoni Rregulloren e Kuvendit, jo kur të doni, nuk është nevoja këtu secili ta interpretojë Rregulloren, se sa kush ka shkollë e sa kush ka dije për të lexuar, krejt qytetarët e dinë, ama për të ditur e aq më tepër të ulesh në një karrige e të mendosh që menjëherë je bërë njëfarë shefi apo kryetar i subjektit, jo, nuk mundesh, jo more ata të kanë votuar për diçka tjetër, nuk do të thotë që ti pse ulesh, ndërrohem unë me Blerim Kuçin aty e të them unë jam Blerimi, jo, jo, unë jam Teuta Haxhiu, për këta më kanë votuar.

Por, ama fytyrën e vërtetë timen qytetarët e donë jo me disa fytyra, një fytyrë në komision, një fytyrë kur s'ka media, një fytyrë tjetër këtu.

(Drejtimitin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.)

KRYETARI: Faleminderit!

Shumë paska diskutues, a të futemi në votim. Janë 10 diskutues, i marrin edhe 100 minuta, a shkojmë në votim, jo, jo, po mendoj a të futemi në votim, shkojmë në votim, ju kisha lutur.

Shkojmë në votim, e votoni, s'e votoni, nuk prish punë. Sasha, të gjithë bashkë jemi, krejt bashkë. Po dëgjo, po shkojmë në votim, Sasha, të lutem, edhe këta deputetë janë 10, po 59 deputetë qenkan. Erdhën deputetët, po shkojmë në votim, ju lutem veç merr kohë, edhe ju pastaj po mërzhiteni, nuk po e them në mënyrë cinike, në mënyrë njerëzore, mërzhiteni dy orë na i merr ky debat dhe në fund pastaj prapë dalim në pikën zero. Unë për ata po mundohem t'ju kërkoj, po ky është Parlament, në fund të fundit.

Po shkojmë në votim, qëndrimi është juaji, po, jo.

Amendamenti 1.

Me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL, Po, Jo, votoni.

Regjia, deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

49 deputetë janë, 49 kanë votuar për, nuk ka abstenime.

E votojmë edhe një herë.

Amendamenti 1.

Në bazë të rregullit po shkojmë, nuk prish punë, edhe një herë po e votojmë.

Përgatitemi për votim, votojmë tash:

50 deputetë, 50 për, ka progres.

Shkojmë në pauzë deri në orën 13:30. Faleminderit!

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës

Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Të nderuara zonja dhe zotërinj!

Po vazhdojmë me seancën, ju lus që t'i zini vendet tuaja, për shkak se duhet të hyjmë drejtpërsëdrejti në votim, në pikën e 12-të, ku kemi ngelur:

12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-024 për trajtimin e ndërtimeve pa leje

Ju lus që t'i zini vendet! Në sallë kemi 68 deputetë. Po fillojmë me votimin e amendamenteve.

Amendamenti 1 i Komisionit FunkSIONAL.

Kundër a ka? S'ka! Abstenim? S'ka! Miratohet.

Amendamenti 2 është propozim i Listës serbe, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL, prandaj votimi duhet të bëhet me elektronikë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash!

Faleminderit! Kanë votuar 40 deputetë. 3 janë për, 35 kundër, 2 abstenime.

As nuk miratohet, as nuk votohet.

Mbesim këtu, meqenëse nuk dëshironi të votoni, e shtyjme për seancën e ardhshme, pra.

13. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij, me amendamentet e propozuara. Ftoj kryetarin e Komisionit FunkSIONAL, zotin Nait Hasani, për shqyrtimin e raportit me rekomandime. Zoti Hasani, e keni fjalën.

NAIT HASANI: Faleminderit, nënkryetar!

Përshëndetje për kolegët deputetë,

Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media e ka shqyrtuar dhe ka hartuar Projektligjin për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës, ka prezantuar edhe amendamentet. Është një projektligj që e rregullon këtë çështje mjaft mirë, kemi amendamente, të cilat janë të Komisionit FunkSIONAL, kërkoj që këto amendamente të votohen. Projektligji është miratuar thua në mënyrë unanime në komision.

Në këtë projektligj rregullohet puna e shërbimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës dhe është, mund të them më i avancuari deri më tash në mbrojtjen e shërbyesve civilë, në mbrojtjen e punëtorëve që konkurrojnë dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre. Prandaj, në komisionin tonë edhe nuk ka vërejtje, përveç disa amendamente që kanë ardhur, që nuk kanë përkrahjen e komisionit, përveç një amendamenti që e ka përkrahjen e komisionit, te çështja e buxhetit, amendamentet të cilat kanë ardhur nga deputeti Armend Zemaj, të cilët nuk kanë përkrahjen e komisionit. Prandaj, kërkoj që deputetët t'i përkrahin dhe t'i mbështesin amendamentet e Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Para se të hyjmë në votim, unë i propozoj Kuvendit edhe Kryesisë që ta rregullojnë çështjen e ajrit në sallën plenare. Ne kemi problem të madh me ajër, besoj që po të matet ndotja e ajrit, është vendit ku është ndotja më e madhe, sepse s'ka ajrosje të mirë. Unë mendoj që është problem për secilin prej nesh që të qëndrojnë në këtë sallë, ose duhet të mërdhijë dikush nga këta kondicionerë ose të tjerët t'i zërë gjumi pa kondicionerë.

Atëherë, po fillojmë votimin e amendamenteve.

Votojmë me elektronikë amendamentin 1, propozim i deputetit Armend Zemaj, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tani.

Edhe ky shqyrtim i ligjit mbetet të shqyrtohet në një seancë tjetër. E respektoj qëndrimin tuaj që nuk doni të votoni, rregulla të tjera s'kemi, këto janë.

9. Votimi i raportit vjetor financiar për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017

Komisioni Funksional ka rekomanduar miratimin e këtij raporti. Diskutimet kanë përfunduar. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tani.

Kanë votuar 44 deputetë. 35 janë për, 9 kanë abstenuar. Nuk kalon, për shkak të kuorumit dhe rregullave që i kemi lidhur me këtë çështje.

10. Votimi i raportit vjetor të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës për vitin 2017

Komisioni Funksional ka rekomanduar miratimin e këtij raporti, votojmë raportin. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tani.

Kanë votuar 45 deputetë, 43 janë për. Kundër asnjë. 2 kanë abstenuar. Të tjerët nuk kanë votuar, prandaj edhe kjo pikë e rendit të ditës shtyhet për seancat e radhës, në qoftë se u mbushet mendja deputetëve që të votojnë.

11. Votimi i raportit vjetor të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturorë për vitin 2017

Komisioni Funksional ka rekomanduar mosmiratimin e këtij raporti. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tani.
Faleminderit!

Kanë votuar 45 deputetë. 24 për, 15 kundër, 6 abstenime. Kuorumi për votim elektronik nuk ekziston, kuorumi fizik është, në sallë janë 74 deputetë.

12. Votimi i raportit vjetor të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2017

Komisioni Funksional ka rekomanduar miratimin e këtij raporti. Votojmë raportin, lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tani.

E njëjta situatë është, kuorumi fizik është, kuorumi me elektronikë nuk prezantohet në ekranin tim, prandaj shtyhet për mbledhjen e radhës, sepse kanë votuar 48 deputetë, 44 janë për, asnjë kundër, 4 abstenime.

* * *

4. Votimi i Propozim-rezolutës nga interpelanca e kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar Lëvizjes Vetëvendosje dhe Grupit Parlamentar të LDK-së, në lidhje me vendimin e Qeverisë Nr.01/50, datë 5. 6. 2018 për pagesën e 53 milionë eurove shtesë për kompaninë “Bechtel&Enka” në kontratën për ndërtimin e Autostradës R6 “Arben Xhaferi” Prishtinë-Hani i Elezit

Propozuesi i interpelancës ka kërkuar që të harmonizohet teksti i propozim-rezolutës me grupet parlamentare para se të hidhet në votim. E ftoj përfaqësuesin e interpelancës, kush e do fjalën që të sqarojë a ka harmonizim a s’ka rezoluta. S’po paraqitet askush. Nuk e keni harmonizuar. Zoti Zemaj e ka kërkuar fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Qëndrimin ka qenë i obliguar ta paraqesë deputeti Liburn Aliu. I ka rekomandimet edhe të Grupit Parlamentar, edhe të Lëvizjes Vetëvendosje.

KRYESUESI: Zoti Glauk Konjufca e ka kërkuar fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Ky tekst i rezolutës, e cila pritet të votohet, është harmonizuar para pak orësh dhe unë mund ta lexoj versionin përfundimtar të harmonizuar të tekstit të rezolutës, nuk është i gjatë, i ka 6 pika.

KRYESUESI: Unë nuk kam kurrjë kundër që ta lexoni, por ajo që do të më interesonte mua dhe opinionit me siguri, a e keni harmonizuar me të gjitha grupet parlamentare apo vetëm ju dy grupet parlamentare që e keni prezantuar?

GLAUK KONJUFCA: Siç duket, grupet parlamentare të mazhorancës nuk po pajtohen me pikën e parë...

(Ndërhyrje nga salla)

...krejt, le të themi, ai diskutimi që ka qenë edhe kur e kemi shtruar problemin gjatë debatit parlamentar e kam fjalën, nëse i rikthehemi javës së kaluar, ka qenë me vendimin për anulimin e atij Vendimi të Qeverisë apo mosanulimin e tij. Ne jemi të pajtimit që gjithçka që shkon jashtë asaj që e ka shpjeguar Liburni, e që është pagesë e pambështetur në ligje, është shumë e rrezikshme për Kosovën dhe Kosova nuk ka kurrfarë obligimi jashtë asaj ndaj Konsorciumit “Bechtel&Enka”.

Kështu që këtë e kemi futur si pikë të parë dhe thotë që Qeveria ta anulojë Vendimin 1/50 të datës 5 qershor të vitit 2018, për aprovimin e kërkesës së Konsorciumit “Bechtel&Enka” lidhur me ndarjen e mjeteve me qëllim të mbulimit të shpenzimeve për vazhdimin e ndërtimit të rrugës nacionale R6 në shumën prej 53,1 milionë euro.

Kjo, sipas mendimit tonë, nëse nuk është pikë e rezolutës, atëherë nuk besoj që kemi bërë diçka esenciale.

KRYESUESI: Në rregull! Unë nuk dua të kontestoj asgjë personalisht, veç një sekondë, se janë paraqitur edhe kryetarët e grupeve të tjera parlamentare. Mendoj që meqenëse ju dëshironi ta fusim në votim, ta lexoni tekstin e miratuar që e keni, ta dëgjojnë deputetët dhe pastaj në votim. Fjalën e ka Glauk Konjufca edhe një herë.

GLAUK KONJUFCA: Pas interpelancës së mbajtur më 5 korrik 2018 lidhur me pagesën e 53 milionë eurove shtesë për kompaninë Bechtel&Enka në kontratën për ndërtimin e Autostradës R-6 Prishtinë – Han i Elezit, Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje dhe në harmonizim të tekstit me Grupin Parlamentar të LDK-së, PSD-së dhe në mbështetje të nenit 65, paragrafi 1 të Kushtetutës së Kosovës dhe nenit 6, paragrafi 1 të Rregullores së Kuvendit, Kuvendi i Republikës së Kosovës nxjerr këtë:

REZOLUTË

1. Qeveria të anulojë vendimin 1/50 të datës 5 qershor 2018 për aprovimin e kërkesës së Konsorciumit “Bechtel&Enka” për ndarjen e mjeteve me qëllim të mbulimit të shpenzimeve për vazhdimin e ndërtimit të rrugës nacional R-6 në shumën prej 53,1 milionë eurosh.
2. Pas anulimit të vendimit Qeveria të fillojë procedurat për përcaktimin e kostos së re, për zgjatjen e afatit të përfundimit të punimeve në përputhje me ligjet në fuqi dhe me kontratën.
3. Brenda dhjetë ditësh, Qeveria, respektivisht Ministria e Infrastrukturës të sjellë në Kuvend për deputetët dosjen e plotë të studimit të fizibilitetit për ndërtimin e Autostradës R-6, kontratën me “Bechtel&Enkën”, pasqyrat e pagesave nga thesari për çdo këst, letërkëmbimin, kërkesat dhe përgjigjet midis Qeverisë dhe Bechtel&Enkës për borxhin e pretenduar.
4. Qeveria të paraqesë me shkrim menjëherë pas miratimit të kësaj rezolute para Kuvendit të Republikës së Kosovës arsyet e pagesës së 53 milionë eurove shtesë për këtë projekt.
5. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm të hartojë raport të auditimit për zbatimin e kësaj kontrate dhe mbikëqyrjen e saj nga Qeveria e Republikës së Kosovës, Ministria e Infrastrukturës dhe Ministria e Financave.
6. Qeveria e Republikës së Kosovës të publikojë në faqet zyrtare pjesët e pasanksionuara të kontratës dhe dokumentet tjera të kësaj autostrade.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka kërkuar zoti Kuçi.

BLERIM KUÇI: Faleminderit, kryesues!

Ne si grup punues për harmonizimin e mundshëm të kësaj rezolute, jo të kësaj po një rezolute paraprake, jemi takuar dhe nuk jemi dakorduar, ose kemi pasur vërejtjet tona që ka pasur mundësi ndoshta me u adaptua. Tash kemi të bëjmë me një rezolutë të re, të cilën asnjëherë nuk e kemi biseduar si grup punues për harmonizim. Kjo është një rezolutë krejtësisht e re, të cilën ne deri sot nuk kemi qenë të njoftuar. Për herë të parë njoftohemi në këtë moment dhe në këtë seancë.

Për këtë çështje, ne si grup parlamentar, nuk do ta përkrahim këtë rezolutë. Pra, kjo është një rezolutë e re. Liburn Aliu, edhe pse tani nuk është këtu, bashkë me grupin punues kemi punuar një kohë të caktuar, kemi ardhur pothuajse para dakordimit, kjo është diçka krejtësisht e re dhe e pakuptueshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, e ka kërkuar fjalën zoti Krasniqi.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Besoj se u sqarua, sepse përfaqësuesit e dy partive opozitare mendoj që nuk ishin krejt të sinqertë kur thanë se është harmonizuar. Ndoshta, është harmonizuar në mes LDK-së dhe Vetëvendosjes. Në tentimin që e kemi pasur për ta harmonizuar, besoj jemi afruar, por nuk kemi arritur pajtueshmëri.

Konsiderojmë që një prej kërkesave për anulim, kjo është e re, kjo as që është diskutuar në asnjë prej takimeve ku kanë qenë përfaqësuesit e grupeve. Kjo është një kontrabandim që e kanë bërë bashkërisht LDK-ja me Vetëvendosjen në këtë draft-rezolutë, asnjëherë s'ka qenë e diskutuar në takimin e përfaqësuesve të grupeve dhe në ato takime ne thash se kemi pasur përafrim, por s'jemi pajtuar, meqenëse konsiderohet që një prej kërkesave mund të jetë në kundërshtim me ligjet e aplikueshme në fuqi. Kemi kërkuar që t'i shtohet një fjali, që cilado kërkesë e kësaj rezolute të jetë në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Meqenëse, përfaqësuesit e opozitës kanë refuzuar që kjo fjali të hyjë, pra që rezoluta të jetë në pajtim me legjislacionin në fuqi, ne nuk besoj që mund të votojmë diçka që mund të jetë në kundërshtim me ligjet. Për këtë arsye edhe ndoshta s'na kanë ftuar më për të biseduar, por janë marrë vesh në mes vete LDK-ja dhe Vetëvendosja, por është e drejtë e tyre. Ne nuk do ta mbështetim në këtë version siç është rezoluta.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Dardan Sejdiu e ka kërkuar fjalën.

DARDAN SEJDIU: Faleminderit, kryesues!

Mua rezoluta më është sjellë sot, e kam lexuar dhe jam plotësisht dakord me përmbajtjen e rezolutës, meqë mendoj se para se të shpenzohen 53 milionë euro është mirë të kuptojmë saktë e drejtë, se për çka janë ato 53 milionë euro. E para se të kuptojmë se për çka po jepen 53 milionë euro, normalisht që duhet ndaluar çfarëdo lloj pagese, për të cilën nuk e kemi idenë se çka është.

E kam thënë edhe në seancë, po e ripërsëris, nuk ka asnjë lloj kuptimi të paguhet as edhe një cent, pa e parë kontratën. Kontrata e Rugës “Bechtel&Enka” duhet të bëhet auditimi i punës apo të themi kështu, procesit të menaxhimit të kontratës që iu bë një kompanie të tretë, e cila paguhet nga Buxheti i Republikës së Kosovës dhe që është “Hill International”. Pa e pa këtë treshe, pa e pasur të qartë kontratën, raportet e “Hill International”, kërkesat e “Bechtel&Enkës” dhe si këto përputhen, nuk mund të flasim për as edhe një cent të parave të Buxhetit të Republikës së Kosovës që të paguhet, e lëre më të flasim për dënime, për të cilat nuk e kemi as idenë e vetme se çka janë.

Eh pra, mendoj që Rezoluta është, edhe korrekte, edhe konkrete, edhe në fakt është një mundësi e jashtëzakonshme për Qeverinë e Republikës së Kosovës njëherë e përgjithmonë të jetë transparente me paranë publike. Çdo mëdyshje rreth votimit të kësaj rezolute, në fakt i bie që nuk po duam të shpalojmë se ku po shpenzohen paratë e kësaj Republike. Autoudha në fjalë e ka një kontratë, ajo kontratë i ka ca nene. Dënimi lidhet me mospërmbushjen e ca neneve nga Qeveria e Republikës së Kosovës e pa e kuptuar ne se cilat nene janë thyer dhe çka s’kemi paguar, nuk mund të flasim për pagesë të dënimeve. Rrjedhimisht, i ftoj të gjithë deputetët që ta përkrahin këtë rezolutë dhe besoj shumë, që kështu ecim përpara në mbrojtjen e interesave të Buxhetit.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Sasha Milosavljeviq e ka kërkuar fjalën.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala, predsedavajući!

Ja bih prvo na početku želeo da kažem da posle današnjeg nekorektnog prepucavanja pojedinih poslanika ove Skupštine sa Srpskom Listom, mislili smo da uopšte ne glasamo za nijednu tačku dnevnog reda danas na ovoj današnjoj sednici.

Međutim, još jednom ćemo pokazati našim građanima na Kosovu da smo odgovorni prema poslu koji radimo i želim da kažem građanima, da građani... vama u stvari, vama dragi kolege, da građani Kosova znaju ko blokira procese u ovoj Skupštini. To sigurno nije Srpska lista. Srpska lista će sada nastaviti da glasa i još jednom ćemo pokazati svima da je odgovorna prema poslu koji radi i obavlja. Hvala!

KRYESUESI: A dëshiron dikush në raport me votimin, a ka dikush vërejtje? Zoti Milaim Zeka e ka kërkuar fjalën dhe pastaj Liburni.

MILAIM ZEKA: Faleminderit, kryetar!
Së pari dëshiroj t'i përgjigjem Listës serbe, që...

KRYESUESI: Jo, jo, s'ke nevojë t'i përgjigjesh. S'të është drejtuar ty hiç. nuk je ti avokat as i yni, as i Listës serbe. Të lutem mos na futni në komplikime. Me Listën serbe s'kemi punë ne.

MILAIM ZEKA: Mos u tut, bre, se unë...

KRYESUESI: Ata e kanë qëndrimin e vet dhe ti s'je këtu avokat i tyre.

MILAIM ZEKA: Nuk ke nevojë, se unë këtu afër i kam. Ani, kaloj te votimi.

KRYESUESI: Ju lutem, jemi në votim.

MILAIM ZEKA: Ani, kaloj te votimi. Në votim, po, te rezoluta po flas.
Kryeministri... veç je bërë diktator, bre Xhavo, diçka.

KRYESUESI: Jo, bre, s'jam bërë, por nuk po dua konflikt.

MILAIM ZEKA: OK, ama unë kam merak për konflikt, jam lindur me konflikte diqysh, edhe më shkojnë përshtati. Këta po duan me luajt, po e din ti çka me luajt, edhe unë po dua me luajt pak me këta.

Ani, kalojmë te Rezoluta. Normal, që është shumë në rregull, ama po dua ta citoj vetëm kryeministri çka ka thënë lidhur me Rezolutën atë ditë. Në qoftë se, ne si deputetë e garantojmë Qeverinë e Kosovës që nuk shkon çështja në arbitrazh dhe nuk humbim ne para në Gjykatën e Arbitrazhit, atëherë kryeministri na premtoi atë ditë, që ai vetë e tërheq pagesën për "Bechtel&Enkën". Prandaj, vetëm në këtë pikë e kam një këshillë, që të jemi të kujdesshëm.

E dyta, unë mendoj që ne mund ta hetojmë procesin si Parlament, mund të krijojmë një grup hetues për ta hetuar krejt procesin, edhe kontratën, edhe shkeljet, edhe të gjitha. Por, mendoj që duhet të jemi të kujdesshëm pavarësisht mbështetjes nga ana e Dardanit që me e mbështet Rezolutën, unë mendoj se nuk duhet sot me e mbështet, të mendojmë edhe pak.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Nitaj e ka fjalën.

MUHARREM NITAJ: Zoti nënkryetar i Kuvendit të Kosovës,
Mendoj që Glauk Konjufca nuk ishte i sinqertë në momentin që e lexoi tekstin e Rezolutës.

Sa për informim, edhe të deputetëve, edhe të qytetarëve të Kosovës, pika e parë e tekstit të rezolutës, të cilën e lexoi Glauku s'ka qenë fare e përfshirë në tekstin fillestar, për të cilin kemi diskutuar, kemi debatuar dhe kemi pasur vërejtjet tona. Mendoj që nuk është formë e mirë e veprimit, aq më tepër të paraqitet si një rezolutë e harmonizuar.

Prandaj, unë ftoj deputetët e Kuvendit të Kosovës që të votojnë kundër, ndër të tjera edhe për shkak të një përpjekje, nuk dua të shprehem ashpër, por është një përpjekje për t'u falsifikuar një marrëveshje, një dakordim, që faktikisht nuk ka ekzistuar fare.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Konjufca e ka fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Unë mendoj që është pafytyrësi me më akuzua për diçka që nuk e kam bërë. Kjo mendoj se është hipokrizia e vërtetë, ose pafytyrësia, ose qysh të duash thoni. Unë nuk thash, unë në hyrje të Rezolutës e lexova, “Ky tekst është harmonizuar me LDK-në, Vetëvendosja, PSD-ja.” Nuk e përmenda kurrkënd prej jush, më falni!

Domethënë, po më mëveshni diçka që është e paqëndrueshme. Unë i përmenda tri grupe parlamentare që janë pajtuar, pse? Sepse, më herët kanë qenë edhe këta, por këta nuk janë pajtuar. E hipokrizi është me të thënë “nuk pajtohem, po pse s'më ke pyetur”. Ti nuk po pajtohesh, pra rri aty ku je dhe voto siç e ke mendjen. Kaq është për ty. Kaq vlen. Domethënë, nëse s'pajtohesh me këtë Rezolutë mund ta shprehësh me votë, por jo duke më mëveshur diçka që nuk qëndron.

Pra, edhe një herë po them, ky tekst është i tri grupeve parlamentare, jo i AAK-së dhe i PDK-së. A po merrni vesh? I tri grupeve është, PSD, Vetëvendosje, LDK. Kthejeni edhe një herë incizimin, mund ta vëreni çfarë kam thënë. Mirëpo, pra nuk i bie që është kontrabandim. Unë po e shpjgoj, pika më e rëndësishme është kjo e para. Ju mund të mos pajtoheni, por ju s'e paskëshit dëgjuar edhe kryeministrin çka ka thënë atë ditë. Pra, përmes argumenteve racionale po mundohem ta shtyj edhe pak këtë rezolutë.

Kryeministri atë ditë në foltore, gjatë debatit kur e kemi bërë, ka thënë kështu, ka thënë – unë krye më vete si Qeveri nuk mund ta anuloj këtë vendim në mënyrë të një anshme, por e anuloj nëse më thotë Kuvendi, nëse më thoni ju me votën e juaj. Nxirreni, e keni në javën e kaluar. Ramush Haradinaj në foltore ka thënë kështu. Kështu që, ai në njëfarë mënyre tha që Kuvendi mund ta marrë përgjegjësinë dhe ta lirojë Qeverinë prej kësaj përgjegjësie. Unë jam që Kuvendi ta marrë këtë përgjegjësi, sepse ashtu qysh i kemi letrat mbi tavolinë, në raport me “Bechtel&Enkën” edhe me Kompaninë “Hill”, unë mendoj që e drejta është në anën tonë dhe ato 53 milionë euro janë të paarsyeshme. Kështu që, nëse ia japim një legjitimitet edhe me votë këtu në Kuvend, me një shumicë, atëherë unë mendoj që ai vendim anulohet. Edhe s'ka çka të bëjë

“Bechtel&Enka”, po të na i kërkojë paratë të cilat nuk i takojnë, as me ligj, as me kurrfarë dokumenti, i cili ekziston në tavolinë. Veç këtë desha ta them.

KRYESUESI: Faleminderit! E shfrytëzove edhe replikën edhe diskutimin. Zoti Nitaj e ka të drejtën për kundër replikë, një minutë e ke Muharrem, veç mos u zgjat.

MUHARREM NITAJ: Shumë i respektuari Glauk, Pse e ke pas një tekst tjetër të Rezolutës në fillim dhe pse mandej e ke ndryshuar komplet tekstin e rezolutës? Domethënë, nëse ti e ke pasur një tekst tjetër, e ke diskutua me ne veç e veç, dhe sot nxjerr një tekst tjetër, kjo është përpjekje për kontrabandim, jo përpjekje për sinqeritet.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka kryetari i Grupit Parlamentar të PDK-së, zoti Krasniqi.

MEMLI KRASNIQI: Zoti kryesues!

Tash ka ardhur koha të hyjmë në votim, por unë ftoj Glaukun, le ta lexojë transkriptin dhe nëse del se i ka përmendur që është harmonizuar veç me LDK-në dhe me PSD-në kur e ka marrë fjalën, atëherë ne i kërkojmë falje, por nëse i del që ka thënë veç jemi harmonizuar dhe s’e ka saktësuar që e ka pasur fjalën për opozitën, atëherë ky duhet të kërkojë falje.

Kur i keni pyetur ju, si kryesues, për ta saktësuar tek herën e dytë me kë jeni harmonizuar, atëherë normalisht s’mundi ta shmangë, e përmendi LDK-në. Por, e vërteta është që, as Armendi, as Glauku, në fjalën e tyre të parë nuk e specifikuan, veç thanë “jemi harmonizuar”. Po tash, kjo është e tejkalueshme. U sqarua!

Harmonizim s’ka. Është rezolutë e LDK-së, Vetëvendosjes dhe mbështetjen e PSD-së. Unë besoj që duhet me e hedh në votim dhe kush të dojë e thotë fjalën e vet nëpërmjet votës.

KRYESUESI: Faleminderit! Dy replika i kemi. Glauk, shtype bre burrë! Po, po, veç shtype kur ta kërkosh fjalën, shtype atë sustën! Replikë kanë Glauku dhe Armend Zemaj.

GLAUK KONJUFCA: Po më pëlqen basti i Memlit, e pranoj bastin e melit. Nëse nuk e kam thënë herën e parë, që është tekst i LDK-së, PSD-së dhe Vetëvendosjes, unë jap dorëheqje këtu, e pranoj bastin e tij.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Zemaj, urdhëro!

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit! Memli, a po dëgjon Memli, se ai na kërkoi përgjegjësi.

Memli Krasniqi, veç një minutë, në ë fjalën time shumë shkurt isha dhe në bazë të asaj të së cilës duke e ditur edhe problemin paraprak që nuk është harmonizuar nga ai grup punues edhe unë e

paraqita shumë qartë, bile e harrova PSD-në, thash LDK dhe Vetëvendosje përmes deputetit Liburn Aliu, i cili ka qenë i obliguar që ta paraqesë rezolutën e plotë. Kështu ishte fjala ime, por është mirë që të jeni të vëmendshëm. Sa herë po e përsërisim këtë dhe dëgjoni, se po krijoni edhe situata të palakmueshme.

KRYESUESI: Zoti Sejdiu e ka fjalën. Dardan Sejdiu.

DARDAN SEJDIU: Faleminderit, kryesues!

Teksti është jashtëzakonisht i shkurtë, është i qartë, mua më është sjellë, e kam lexuar për pesë minuta. Ka të bëjë me transparencë, ka të bëjë me përgjegjësi mbi paranë publike, ka të bëjë me hapje të informacionit për publikun dhe në fund fare, nuk po shoh asnjë problem në asnjërën prej këtyre pikave të kësaj rezolute.

Nëse ka grup parlamentar, i cili nuk ka mbërri ta lexojë, Glauku mund, hiç s'dyshoj, ta lexojë edhe një herë dhe besoj që nëse e gjeni një fjalë aty, që është në kundërshti me ndonjë prej parimeve themeltare të shpenzimeve të parasë publike dhe dijes për paranë publike, atëherë në rregull, por nuk ka. Thjesht, jemi duke bërë debat për diçka, e cila besoj unë thellësisht, duhet më në fund të sqarohet. Sqarohet duke e ndalur pagesën e duke e hapur kontratën. Kaq.

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, të tjerë të paraqitur për diskutim nuk ka. Unë dua ta qes në votim. Zoti Çoçaj, doni të votoni a të flisni? E presim zotin Çoçaj. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Në sallë janë 89 deputetë. Kanë votuar 85 deputetë. 37 vota janë për, 47 vota janë kundër, 1 abstenim. Konstatohet që Kuvendi nuk e miratoi Rezolutën e propozuar nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje dhe i Lidhjes Demokratike të Kosovës.

17. Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me shpenzimet për lobim nga Presidenca dhe Qeverisë së Kosovës, për miratimin e buxhetit, si dhe për zgjatjen e mandatit, afatit të këtij komisioni

Komisioni Hetimor Parlamentar i formuar nga Kuvendi më 1 qershor 2018 në lidhje me shpenzimet për lobim nga Presidenca dhe Qeveria së Republikës së Kosovës ka kërkuar miratimin e buxhetit të këtij Komisioni për realizimin e mandatit të tij, si dhe për zgjatjen e mandatit afatit të këtij komisioni nga një muaj në gjashtë muaj.

Kryesia e Kuvendit të Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 22 qershor 2018 e ka ngarkuar Komisionin për Buxhet dhe Financa, që ta shqyrtojë kërkesën e Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me miratimin e Buxhetit të këtij komisioni.

Komisioni për Buxhet dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më 4 korrik 2018 ka vlerësuar se buxheti për Komisionin Hetimor do të shqyrtohet nëse Kuvendi vendos për zgjatje të mandatit. E ftoj kryesuesin e Komisionit Parlamentar, zotin Dardan Sejdiu, që ta paraqesë dhe arsyetojë kërkesën. Zoti Dardan, e ke fjalën.

DARDAN SEJDIU: Faleminderit shumë, kryesues!

Këtë kërkesë në emër të propozuesit për komision hetimor duhet ta bëjë zoti Abdixhiku, i cili fatkeqësisht nuk është këtu, por ndoshta mund ta bëjë dikush nga LDK-ja, e cila ka qenë propozuese e këtij komisioni hetimor, pra i takon propozuesit që të bëjë arsyetimin për kërkesën në fjalë, nëse dikush nga kolegët e LDK-së mund të vazhdojë me arsyetimin, nëse jo, atëherë mund ta bëj edhe unë. A po? Faleminderit!

Atëherë, i nderuar kryetar, komisioni në fjalë është mbledhur tashmë dy herë, është formalizuar, por duke e pasur parasysh mandatin që na është dhënë që të trajtohet tema që ndërlidhet me lobim prej vitit 2010 - 2018, na duhet edhe më shumë kohë për të trajtuar temën, por gjithashtu edhe në aspektin e buxhetit, në mënyrë që të sigurohemi që ta bëjmë punën në mënyrë të duhur. Këtë kërkesë e kemi paraqitur në afat kohor në Kryesi të Kuvendit, jemi në kuadër të procedurave dhe rregullave ligjore dhe do të isha mirënjohës, si kryetar i këtij komisioni, nëse seanca plenare na përkrah në kërkesën në fjalë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, grupet parlamentare kanë të drejtë të deklarohen. Zoti Armend Zemaj, pasi u paraqite tash me vonesë, zoti Armend Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryesues! Po, pajtohem me zgjatjen e afateve. I theksoi arsyeshmëritë të cilat janë dhe cilat duhen që të përfundojnë me këto procedura. Kështu që, do të ishte në rregull që të jetë konform Ligjit për hetim parlamentar dhe të mos jetë mandati i kufizuar, por të jetë mandati i kërkuar, ashtu siç e parasheh edhe ligji, prej gjashtë muajsh. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Memli Krasniqi e ka fjalën.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Ne edhe në mbledhje të Kryesisë parimisht s'kemi pasur kundërshtime për këtë çështje, por besoj se është shumë e nevojshme që deputetët ta dinë për çka po votojnë, sepse as propozuesi i Komisionit Hetimor, e besa as në dokumentet që i kanë shkuar Kryesisë e që na kanë ardhur këtu në seancë, ne nuk e dimë sa mjete, sa buxhet, sa para po i lypin, sa kohë dhe sa para po i kërkojnë për këtë komision hetimor. Ma merr mendja, që është minimumi i korrektësisë që deputetët ta dinë a po flasim për 10 000 euro, a për 100 000 euro, apo 1 milion euro, apo sa mjete po i kërkon ky komision hetimor. Dhe, janë mjete të Kuvendit të Kosovës, duhet ditur, të

planifikuara s'janë. Unë besoj që duhet me e ditë ku i marrim, por mbi të gjitha para se të votojmë, kërkoj që të sqarohet për sa saktësisht, për çfarë shume po bëhet fjalë dhe saktësisht për sa javë, ose muaj, po bëhet fjalë që të zgjatet mandati. S'kemi asgjë kundër, por jo para se të saktësohen këto dy çështje, që janë thelbi i kërkesës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Konjufca e ka fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Grupi Parlamentar i Vetëvendosjes pajtohet me këtë propozim, të cilin e shpjegoi zoti Sejdiu, i cili ka të bëjë me Komisionin Hetimor Parlamentar në lidhje me shpenzimin e parave publike nga Presidenca e Republikës së Kosovës.

Kështu që ne mendojmë se është kërkesë e drejtë, është e nevojshme, kurse sa u përket këtyre specifikimeve teknike se cilat do të jenë shumtë, e kështu me radhë, unë mendoj që mund të përcaktohet gjatë diskutimeve të mëtutjeshme më të hollësishme, por me rëndësi është ky vendimi i parë, të kalojë kjo kërkesë.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Nitaj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, e ka fjalën.

MUHARREM NITAJ: Mendoj që kërkesa për zgjatje është e saktësuar, kërkohet që komisionit t'i zgjatet afati i punës në gjashtë muaj.

Për pjesën tjetër që e përmendi kolegu Krasniqi për detajet, për shumën, ndoshta propozuesi është mirë që të na japë një ide.

Po në parim Grupi Parlamentar i AAK-së është dakord që të mbështetet një iniciativë e tillë. Natyrisht me sqarimet, me shpjegimet e kërkuara për shumën e mjeteve që do të duhej të konsideroheshin për punën e këtij komisioni.

KRYESUESI: Replikë ka zoti Krasniqi.

MEMLI KRASNIQI: Po e shfrytëzoj të drejtën e replikës, meqenëse m'u përmend emri. Çështja është shumë e thjeshtë. Nëse pika e rendit të ditës është: Kërkesa e komisionit për miratimin e buxhetit, ne s'mund të miratojmë buxhet pa e ditur sa. Kjo i bie sikur të sillet buxheti i Republikës së Kosovës e të thuhet pika e miratimit të buxhetit për vitin 2019, po e miratojmë në parim, e le të vendosë Ministria e Financave edhe Qeveria sa para u duhen dhe qysh donë t'i ndajnë. Domethënë, s'ka logjikë të dalë në votim pa e ditur saktësisht sa mjete të parasë publike po kërkohen për t'u shpenzuar për këtë aktivitet. S'kemi asgjë kundër, por jo pa e saktësuar decidivisht për çfarë shume po bëhet fjalë.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Zafir Berisha, në emër të Grupit Parlamentar Nisma e ka fjalën.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, kryesues!

Si anëtar i këtij komisioni nga Nisma, për sa unë e di, ka pasur një unitet të të gjitha subjekteve politike në këto kërkesa.

Tash zoti Krasniqi nga PDK-ja nuk është anëtar në atë komision dhe, me gjasë ka një shkarje nga ajo që ka qenë unitet yni. Por, sido që të jetë, mendoj se nuk flitet për ndonjë shumë të madhe që këtu po tentohet të tronditet opinioni se sa paratë i harxhojmë.

Unë mund të them se fjala është për shuma simbolike, jo për funksionimin e vetë komisionit, sa për ndonjë lëvizjes të caktuar edhe të ndonjë dëshmitari që mund të vijë në Kosovë ose dikush nga ne të shkojë për t'i vërtetuar disa nga të dhënat. Tashmë komisioni i ka drejtuar dy kërkesa në adresë të Presidencës dhe të Ministrisë së Punëve të Jashtme.

Unë mendoj që shuma nuk ka nevojë të përcaktohet, përpos që mund të thuhet se mund të jetë pjesë nga shpenzimet dhe mallrat në kuadër të buxhetit që ka Kuvendi.

Edhe kolegët le të ndihmojnë, nuk besoj se flitet për ndonjë shumë marramendëse që ne tash thjesht duhet të ndërhyjmë përmes ministrisë apo të ndryshojnë linja buxhetore. Faleminderit!

KRYESUESI: Ne po diskutojmë dhe mund të diskutojmë shumë gjatë, duhet votuar një herë t'i zgjatet mandati komisionit dhe në qoftë se ne votojmë për këtë, atëherë komisioni ka të drejtë të bëjë kërkesë për financim në mënyrë të detajuar, pastaj të shqyrtohet në Komisionin për Buxhet dhe ne votojmë ose jo, po duam t' i votojmë dy çështje përnjëherë.

Replikë, zoti Memli Krasniqi.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit! Por meqenëse më përmendi zoti Berisha, unë nuk jam anëtar i komisionit, po i kam dy anëtarë të grupit tim parlamentar në atë komision dhe i kam pyetur, tre në fakt, dhe i kam pyetur decidivisht për çfarë shume bëhet fjalë, domethënë as ju në komision nuk keni vendosur për çfarë shume bëhet fjalë.

Nëse është shumë modeste, unë po pyes sa: a janë 100 euro, a janë 100 mijë euro, a janë 5 mijë euro? Ju e keni të drejtën meqenëse keni kërkuar si komision, seanca t' jua miratojë buxhetin. Kërkesa shkruan decidivisht për miratimin e buxhetit. Nëse doni miratimin e buxhetit, nuk mund të miratohet në mend, duhet thënë 50 mijë euro, 5 000 euro, 20 mijë euro, sa euro po doni t'i harxhoni sipas planifikimit tuaj dhe, tek e fundit, kërkonte një shumë të caktuar dhe nëse nuk shpenzohen, ju nuk keni nevojë t'i shpenzoni, i ktheni prapë në buxhetin e Kuvendit. Ose mund

ta votojmë vetëm zgjatjen e mandatit dhe pastaj komisioni, konform rregullave të brendshme të Kuvendit, sipas nevojës, bën kërkesa në Administratën e Kuvendit për t'i shpenzuar mjetet, edhe për ato biletat e udhëtimit që po i përmendni që mund të shkoni jashtë dikush ose që mund t'ju vijë dikush nga jashtë, edhe për gjëra të tjera.

Të mos e devijojë askush këtë çështje. Nuk është kontestimi i mjeteve, pyetja është sa, sepse logjikisht s'mundet, unë po habitem nëse dikush kërkon të votohet miratimi i buxhetit pa e ditur sa është buxheti. Hajde po e votojmë veç zgjatjen e mandatit, pa e përmendur buxhetin dhe ju shfrytëzoni procedurat ligjore për buxhet përmes Kuvendit. Po nëse doni ta miratojë seanca buxhetin, përcaktojeni një shumë, e votojmë, nëse s'i harxhoni, i ktheni, nëse ju duhen para më shumë, vini prapë në seancë, jua miratojmë prapë. Me rëndësi është ta kryeni punën mirë, t'i bëni hetimet ashtu qysh duhet dhe të nxirrni rezultate që i ndihmojnë këtij vendi dhe qytetarëve të Republikës së Kosovës.

KRYESUESI: Kundër-replikë ka Zafiri.

ZAFIR BERISHA: Zoti Krasniqi, po kuptoj që je duke lypur qime në vezë, se ju jo që s'i keni pyetur anëtarët e komisionit, po ju s'e dini as sa anëtarë ka PDK-ja në atë komision. Kështu që çështja e zgjatjes së mandatit ka qenë më me rëndësi, sa e kuptoj unë, janë një pjesë e anëtarëve të komisionin, sepse për shumën, për pozicione buxhetore nuk është diskutuar, sepse thjesht mendojmë se mund të shpenzohen sa një ekskursion që e bën ekipi i kryetarit të Kuvendit për lobim në Bruksel apo në Paris. Nuk është ndonjë shumë e madhe që ne tash thjesht të humbim kohë për këtë çështje.

Bërthama është e kërkesës së Komisionit Hetimor që të shtyhet mandati, të ketë kohë për ta trajtuar një lëndë bukur voluminoze për të cilën dyshohet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Dardan Sejdiu e ka kërkuar fjalën. Ia përmendën emrin 10 herë, e nuk ia dhashë fjalën.

DARDAN SEJDIU: Faleminderit, kryesues!

Një komision në Kuvend e ka një buxhet të përcaktuar me Rregullore dhe ky komision i Kuvendit në Rregullore e ka të përcaktuar një buxhet vjetor prej 5 000 eurosh.

Nëse mandati nga Kuvendi zgjatet për një vit, është e qartë sa duhet të jetë buxheti. Nëse mandati zgjatet për gjashtë muaj, siç ka kërkuar ky komision, është e qartë sa duhet të jetë buxheti.

Po Memli, nëse i pjesëton një vit, i ke 5 000 euro. Memli, mendoj që matematikën e di, nuk ke nevojë të na tregosh, besoj që di ta pjesëtosh pesëshin me dy, aq je i mençur, bile.

Po, në anën tjetër, është tepër me rëndësi që të mos përdorin kësi situata për të krijuar një farë diskutimi të paqenë. Ka qenë kërkesë jashtëzakonisht e sinqertë, jashtëzakonisht konsensuale për një mandat gjashtëmuajor shtesë, në mënyrë që të bëjmë një punë.

Për një mandat gjashtëmuajor shtesë buxheti të parafinohet nga një Rregullore e Kuvendit, e cila thotë komisioni ka buxhet për një vit 5 000, për gjashtë muaj 2 500. Pra ne mund të bëjmë diskutime, por realiteti është ky.

Nëse Kuvendin e shndërrojmë në kësi lloj diskutimesh, për besë, atëherë kjo veçse na shti në situatë ku llafi llafin e bën, e nuk merremi me punë, me procedura e rregulla të parapërcaktuara.

Po mendoj që është edhe korrekte, edhe e sinqertë që të gjithë anëtarët e komisionit kemi qenë të qartë, gjashtë muaj mandat shtesë dhe buxhet për këtë gjashtë muaj. Kaq.

KRYESUESI: Faleminderit! Replikë ka Memli.

MEMLI KRASNIQI: Dardan, faleminderit që ma përmende emrin.

Edhe nuk jam duke lypur “qime në vo”, po ndoshta “kime jam tu lyp në vo”. Po edhe ju jeni duke lypur goxha shumë “kime në vo”, a po ju vjen marre të thuhet 2 500 euro a, edhe pse matematikën e dimë, edhe me numra më të mëdhenj. Çka është problemi, pse nuk thoni po i duam 2 500 euro, nuk janë shumë. Unë mendova që edhe më shumë që duhet t’u jepet. Unë mendoj që duhet dhënë krejt buxhetin e një viti, 5 000, se nëse ju bie të udhëtoni jashtë vendit, nuk ju dalin, se jeni një komision shumë i madh. Edhe nëse sillni mysafirë nga jashtë, dëshmitarë, prapë ju duhen mjete, nuk ju dalin 2 500. Po deri më tash i vetmi je, Dardan, që the me formula matematikore i bie kaq. Nuk është asgjë të thuhet i ndahen 2500 euro, i vazhdohet mandati gjashtë muaj dhe të lypen më shumë, prapë nuk është problem.

Krejt çka kërkuam ne nuk është të zgjatet kaq shumë debati, sepse ka mundur të jepej kjo përgjigje menjëherë, të thuhet 2 500 euro janë kërkesë për këtë komision, gjashtë muaj afati dhe po e votojmë. Votat i kemi, po pse hy hezitim të thuhet 2 500 euro. Kurrjë nuk është, e përmende, më vjen mirë, nëse ka konsensus për 2 500 euro për këtë komision, atëherë jemi në rregull. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër-replikë ka Dardani.

DARDAN SEJDIU: Faleminderit, kryesues!

Memli, në fakt nuk po i jep rend askujt prej replikave në çdo fjalë në Kuvend, e për atë prite pak më shumë. Ta kishe lexuar Rregulloren, e kishe kuptuar që kur kërkohet për gjashtë muaj është 2 500, kur kërkohet për një vit, është 5 000 në Rregullore është.

Është për keqardhje që një deputet, një ministër e ka këtë farë lloj diskutimi. Unë po e them thjesht, kemi konsensus në komision, zgjatnani mandatin edhe për gjashtë muaj, kjo parafinohet dhe ecim tutje. Kaq.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Naser Osmani.

NASER OSMANI: Faleminderit!

Mirë që më erdhi dikur fjala për t'u sqaruar, po si po duket këta dhanë disa alternativa.

Unë po flas sipas Rregullores.

Rregulla thotë kështu: “Kryesia e Kuvendit i drejtohet Komisionit për Buxhet dhe Financa për nevojat e shpenzimit të komisionit, i cili është ngritur në Kuvend për çështje hetimore. Komisioni për Buxhet dhe Financa për çështjet e Komisionit Hetues ndan në nivelin e katër komisioneve të përhershme që kanë një buxhet deri në 10 mijë euro. Komisioni ndan deri në 10 000 euro mbi këtë shumë. Komisioni për herë të dytë sipas kërkesës së Kuvendit ndan mjete sipas nevojës. Përndryshe, ky është limiti, të cilin mund ta ketë në disponim Komisioni Hetues.

KRYESUESI: Faleminderit! Është e saktë ajo që e tha Naseri.

Radha është e zotit Hajdar Beqa.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar ministra,

Deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Flas si anëtar i komisionit, si përfaqësues i Partisë Demokratike në atë komision.

Ne i kemi mbajtur gjithsej dy mbledhje, mbledhja e parë ka qenë një mbledhje formale konstituive, në mbledhjen e dytë e kemi aprovuar planin e veprimit, por atë ditë, të nesërmen përfundonte mandati i komisionit tonë, sepse ishte 30 ditë mandati.

Është e vërtetë që në komision, edhe pse kemi pasur debate të ndryshme, pse ne jemi Komision Hetimor të këqyrim si kanë shkuar shpenzimet për lobim. Kemi pasur një konsensus, po është dashur të ceket shuma, e atë e ka marrë përgjegjësi kryetari dhe nënkryetari i komisionit ta caktojë shumën, sepse duhet të ceket shuma. Mendoj është dashur të jenë dy pika. Pika e parë e rendit të ditës zgjatja e mandatit dhe pika e dytë buxheti.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Nitaj e ka fjalën.

MUHARREM NITAJ: Zoti kryesues,

Kam një propozim konkret, le të votojmë për zgjatjen e mandatit të komisionit, sepse komisioni edhe ashtu nuk ka mandat të punojë më dhe në seancën tjetër propozuesi ta sjellë specifikimin e mjeteve buxhetore dhe ta votojmë në seancën tjetër, të votojmë sot për zgjatjen e mandatit, ndërkaq pjesën financiare herën tjetër.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Milaim Zeka e ka fjalën.

MILAIM ZEKA: Faleminderit, kryesues!

Veç Memlit desha t'i them që edhe Zafa me "q", edhe ti me "k", mirë e patët. Kështu që nuk ishte kërkesa e Zafës e keqe, Memli.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Lushtaku e ka fjalën.

MERGIM LUSHTAKU: Faleminderit!

Edhe unë si anëtar i Komisionit Hetimor, ne e kemi aprovuar kërkesën për shtyrje të afatit dhe jam i pajtimit që kjo çështje të diskutohet në Komision për Buxhet dhe Financa.

Ndërsa, nëse teprojnë, qysh u tha nga të tjerët, paratë nga buxheti për këtë çështje, atëherë besoj që propozimi më adekuat ishte që këto para t'i shpenzojmë për lobim për Kosovën. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Berisha,

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, kryesues!

Unë edhe një herë kërkoj falje për këtë ndërhyrje, por meqë këtu po ka të interesuar të zgjatet këtë çështje, unë po mendoj se kërkesa për gjashtë muaj dhe shpjegimi që e bëri deputeti Naser Osmani, tashmë çdo gjë është e qartë se çka ne duhet të votojmë.

Prandaj, duhet të nisemi nga kërkesa jonë për ta zgjatur mandatin dhe shpjegimin që e bëri Naseri në përputhje me rregullat e funksionimit për komisionet dhe për komisionet hetimore. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Atëherë ne po e hedhim në votim çështjen e afatit që me ligj është gjashtë muaj, duke llogaritur nga dita që është themeluar komisioni.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Faleminderit! Kanë votuar 72 deputetë, 69 janë për, 1 kundër dhe 2 abstenime. Kërkoj nga komisioni, respektivisht kryetari i komisionit që ta bëjë shkresën, kërkesën për nevojat që i ka Kryesisë së Kuvendit. Faleminderit!

Konstatohet që Kuvendi e miratoi zgjatjen e mandatit për gjashtë muaj të Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me shpenzimet për lobim nga ana e Presidencës dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës nga dita e themelimit të tij, respektivisht çështja e shpenzimeve nuk është miratuar dhe nuk ka nevojë të miratohet në Kuvend, shpenzimet i miraton Kryesia sipas kërkesës së komisionit.

19. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës

Radiotelevizioni i Kosovës ka informuar Kuvendin për nominimin e kandidatëve për tre anëtarë nga komuniteti shqiptar në Bordin e RTK-së.

Kuvendi duhet ta themelojë një Komision ad hoc për shqyrtimin e aplikacioneve dhe intervistimin e kandidatëve të nominuar.

Grupet parlamentare i propozojnë deputetët për kryetar, zëvendëskryetar dhe anëtarë të Komisionit ad hoc.

Ftoj kryetarët ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare që t'i propozojnë deputetët për formimin e këtij komisioni.

Ftoj kryetarin e Grupit Parlamentar të LDK-së që të propozojë dy deputetë për anëtarë të komisionit.

Fjalën e ka zoti Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: I propozoj Valentina Bunjaku-Rexhepin dhe Armend Zemajn.

KRYETARI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i PDK-së ka propozuar Xhevahire Izmakun dhe Luljeta Veselaj Gutaj, Izmakun kryetare, zonja Gutaj anëtare.

Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje i ka dy të propozuar, në qoftë se s'ka ndryshim, se po më duket Glauku ka një ndryshim. Zoti Konjufca, e keni fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Jo, në fakt, të lajmërova që kam diçka procedurale, u desh përpara se të flasim grupet parlamentare. E kam vetëm t'ju informoj se e kam një konflikt të interesit me këtë pikë, desha ta lajmëroj seancën që në çdo fazë të këtij procesi, duke filluar prej propozimeve, as në diskutime as në votim nuk do të duhej të merrja pjesë në këtë seancë, prandaj më duhet ta lëshoj edhe fizikisht. Faleminderit!

KRYESUESI: Çfarë konflikti interesi ke, o burrë?

Atëherë Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje ka propozuar Valon Ramadanin, zëvendëskryetar i parë dhe Adem Mikullovcin, anëtar.

Ftoj kryetarin e Grupit Parlamentar të PSD-së që të propozojë një deputet për anëtar të komisionit. Zoti Sejdiu e keni fjalën.

DARDAN SEJDIU: Faleminderit, kryesues!

Nga Grupi Parlamentar i Partisë Socialdemokrate, Frashër Krasniqi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ftoj Grupin Parlamentar të AAK-së që të propozojë një deputet për anëtar të komisionit, zoti Isufi.

AHMET ISUFI: Rasim Selmanajn.

KRYESUESI: Faleminderit! Ftoj kryetarin e Grupit Parlamentar të Listës serbe që ta propozojë një deputet për zëvendëskryetar të dytë, zoti Sasha Milosavljeviq e keni fjalën.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala predsedavajući!

Poslanička grupa Srpska Lista za ovakvu Komisiju predlaže kao člana Jelenu Bontić.

KRYESUESI: Faleminderit!

Ftoj Grupin Parlamentar Nisma që të propozojë një deputet për anëtar të komisionit, zoti Shala e ka fjalën.

HAXHI SHALA: Nisma Socialdemokrate propozon Milaim Zekën të jetë anëtar.

KRYESUESI: Faleminderit! Ftoj Grupin Parlamentar 6+ që ta propozojë një deputet për anëtar të komisionit, zoti Fikrim Damka e ka fjalën.

FIKRIM DAMKA: Teşekkür ederim sayın başkan.

Altı artı Parlamenter Grubu adına Albert Kinoliyi önermekteyiz.

KRYESUESI: Faleminderit!

Atëherë, po futemi në votim, a ka dikush jashtë salle që duhet të votojë.

Kemi 73 deputetë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash:

Faleminderit!

Kanë votuar 67 deputetë, për janë 65, kundër 2.

Konstatohet që Kuvendi i emëroi anëtarët e Komisionit ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për tre anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga komuniteti shqiptar.

Ngarkohet Komisioni ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për tre anëtarë të Bordit të Televizionit të Kosovës nga komuniteti shqiptar që të veprojnë në përputhje me nenin 26 të Ligjit për Radiotelevizionin e Kosovës dhe Kuvednit t'i paraqesin raportin me rekomandime.

20. Propozimi i Grupit Parlamentar të AAK-së për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare

Atëherë, kemi një propozim të Grupit Parlamentar të AAK-së për zëvendësimin e anëtarëve të komisioneve parlamentare.

Grupi Parlamentar i AAK-së ka propozuar zëvendësimin e anëtarëve të komisionit parlamentar si në vijim:

Deputeti Muharrem Nitaj propozohet kryetar në Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor në vend të deputetit Daut Haradinaj.

Deputeti Daut Haradinaj propozohet anëtar i Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës, në vend të deputetit Muharrem Nitaj.

Deputeti Muharrem Nitaj propozohet anëtar i Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, në vend të deputetit Gani Dreshaj.

Të nderuar kolegë dhe zonja deputete, kërkoj nga ju që me ngritje dore formale ta miratojmë këtë. Është qëndrim i tyre, kanë të drejtë. Konstatohet që u miratua ndërrimi i deputetëve.

18. Zgjedhja e një anëtari të Komisionit të Pavarur për Medie

Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një anëtar të Komisionit të Pavarur të Medieve i ka shqyrtuar nominimet e kandidatëve dhe Kuvendit ia ka rekomanduar emërimin e një anëtari të Komisionit të Pavarur të Medieve nga dy kandidatët e propozuar.

E ftoj Komisionin ad hoc, zotin Imet Rrahmani, që ta paraqesë dhe arsyetojë raportin. Imeti s'është këtu. Atëherë, fjalën e ka zoti Rasim Selmanaj. Zoti Selmanaj, e keni fjalën.

RASIM SELMANAJ: Faleminderit!

Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e anëtarit të Komisionit të Pavarur për Medie, në bazë të neneve 67 dhe 71 të Rregullores së Kuvendit, nenit 10.1, 10.5 dhe 11 të ligjit, në mbledhjen e

mbajtur më 25 qershor 2018, pas shqyrtimit të biografive dhe intervistimit të kandidatëve të nominuar për anëtarë të Komisionit të Pavarur për Media vendosi që Kuvendit t’ia paraqesë këtë:

R e k o m a n d i m

1. I rekomandohet Kuvendit të Republikës së Kosovës të bëjë emërimin e një anëtari të Komisionit të Pavarur për Media me votim të fshehur.

2. Për një anëtar të Komisionit të Pavarur për Media nga radhët e komuniteteve tjera propozohen kandidatët, si në vijim: Azra Desiq dhe Fatih Basha. Kuvendi bën përzgjedhjen e një anëtari të Komisionit të Pavarur për Media nga dy të propozuar. Anëtari i Komisionit të Pavarur për Media emërohet me mandat 3-vjeçar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ju e dini që Kuvendi duhet t’i zgjedhë me votim të fshehtë. Për votimin e fshehtë krijohet Komisioni votues, me përbërje nga një deputet prej secilit grup parlamentar. Grupi Parlamentar i LDK-së, kë e ka për anëtarë të komisionit? Zoti Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Ne e propozojmë deputetin Fidan Rekaliu.

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i PDK-së, zoti Reçica?

ELMI REÇICA: Grupi Parlamentar i PDK-së e propozon zotin Hajdar Beqa për kryetar të këtij komisioni.

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje? Zoti Liburn Aliu e ka fjalën.

LIBURN ALIU: Fitore Pacolli.

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i PSD-së, zoti Topalli?

FATON TOPALLI: Unë e propozoj Faton Topallin.

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i AAK-së, Zoti Isufi?

AHMET ISUFI: Zoti Rasim Selmanaj.

KRYESUESI: Faleminderit! Lista serbe, Sasha?

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala, predsedavajući!
Mi predlažimo za člana ove Komisija Adema Hođžu.

KRYSUESI: Grupi Parlamentar Nisma? Zoti Berisha, e keni fjalën!

ZAFIR BERISHA: Në emër të Nismës e propozojmë Veton Berishën.

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar 6+?, zoti Danush Ademi?

DANUSH ADEMI: Grupi Parlamentar 6+ e propozon Albert Kinollin.

KRYESUESI: Faleminderit! E miratojmë edhe këtë komision. Konstatoj që Kuvendi i emëroi anëtarët e Komisionit votues për zgjedhjen e një anëtari të Komisionit të Pavarur të Medieve. Kërkoj nga Komisioni votues që të fillojë me procedimin e votimit, ndërsa deputetët të ftohen të votojnë sipas listës. I lus anëtarët e Komisionit t'i zënë vendet e tyre me qëllim që të fillojmë votimin.

I lus anëtarët e komisionit që t'i zënë vendet e tyre që të fillojmë me votimin. Atëherë, po fillojmë:

Abdyl Salihu, Adem Hoxha, Adem Mikullovc, Ahmet Isufi, Aida Dërguti, Albin Kurti, Albulena Balaj-Halimaj, Albulena Haxhiu, Ali Lajçi, Allbert Kinolli, Andin Hoti, Anton Quni, Arban Abrashi, Arben Gashi, Arbër Rexhaj, Arbërie Nagavci, Armend Zemaj, Avdullah Hoti, Bahrim Shabani, Bekë Berisha, Bekim Haxhiu, Besa Baftiu, Besa Gaxherri, Bilall Sherifi, Blerim Kuçi, Blerta Deliu-Kodra, Danush Ademi, Dardan Molliqaj, Dardan Sejdiu, Daut Haradinaj....,

Siç e dini që menjëherë pas kësaj fillojmë me seancën e re të Kuvendit të Kosovës, prandaj ju kisha lut që ta keni parasysh.

...Donika Kadaj-Bujupi, Doruntinë Maloku-Kastrati, Drita Millaku, Driton Çausi, Driton Selmanaj, Duda Balje, Dukagjin Gorani, Elmi Reçica, Emilija Rexhepi, Enver Hoti, Etem Arifi, Evgjëni Thaçi-Drăgusha, Fadil Beka, Fatmir Xhelili, Fatmire Kollçaku, Faton Topalli, Fidan Rekalio, Fikrim Damka, Fisnik Ismaili, Fitore Pacolli-Dalipi, Flora Brovina, Frashër Krasniqi, Gani Dreshaj, Ganimete Musliu, Glauk Konjufca, Hajdar Beqa, Haxhi Shala, Haxhi Avdyli, Hykmete Bajrami, Igor Simiq, Ilir Deda, Imet Rrahmani, Islam Pacolli, Ismajl Kurteshi, Ismet Beqiri, Jasmina Zhivkoviç, Jelena Bontiq, Kadri Veseli, Korab Sejdiu, Kujtim Shala, Labinot Tahiri, Liburn Aliu, Lirije Kajtazi, Luljeta Veselaj-Gutaj, Lumir Abdixhiku, Lutfi Zharku, Memli Krasniqi, Mërgim Lushtaku, Mexhide Mjaku-Topalli, Milaim Zeka, Miljana Nikoliç, Mimoza Kusari-Lila, Mirjeta Kalludra, Mufera Srbica-Shinik, Muharrem Nitaj, Nait Hasani,

Naser Rugova, Naser Osmani, Nezir Çoçaj, Ramiz Kelmendi, Rasim Selmanaj, Rexhep Selimi, Safete Hadërgjonaj, Sala Berisha-Shala, Salih Salihu, Sali Zyba, Sami Kurteshi, Saranda Bogujevci, Sasha Milosavljeviq, Shemsi Syla, Shkumbin Demaliaj, Shqipe Pantina, Slavko Simiq, Slobodan Petroviq, Sërgjan Mitroviq, Teuta Haxhiu, Teuta Rugova, Time Kadrijaj, Valentina Bunjaku-Rexhepi, Valon Ramadani, Verica Qeraniq, Veton Berisha, Visar Ymeri, Vjosa Osmani-Sadriu, Xhavit Haliti, Xhelal Sveçla, Xhevahire Izmaku, Zafir Berisha, Zenun Pajaziti, Zoran Mojsiloviq.

* * *

RASIM SELMANAJ: Po fillojmë me numërimin e fletëvotimeve për zgjedhjen e një anëtari të Komisionit të Pavarur të Medieve nga radhët e komuniteteve:

Azra Desiq,
Azra Desiq,
Fatih Basha,
Fatih Basha,
E pavlefshme,
E pavlefshme,
Azra Desiq,
E pavlefshme,
E pavlefshme,
E pavlefshme,
Fatih Basha,
Azra Desiq,
E pavlefshme,
Azra Desiq,
E pavlefshme,
E pavlefshme,
Azra Desiq,
Azra Desiq,
Fatih Basha,
Fatih Basha,
E pavlefshme,
E pavlefshme,
Fatih Basha,
Fatih Basha,
Fatih Basha,
E pavlefshme,
Azra Desiq,
Fatih Basha,

Azra Desiq,
E pavlefshme,
E pavlefshme,
E pavlefshme,
E pavlefshme,
E pavlefshme,
Fatih Basha,
E pavlefshme,
Azra Desiq,
Azra Desiq,
E pavlefshme,
E pavlefshme,
E pavlefshme,
E pavlefshme,
Azra Desiq,
E pavlefshme,
E pavlefshme,
E pavlefshme,
Azra Desiq,
Azra Desiq,
Fatih Basha,
Azra Desiq,
E pavlefshme,
E pavlefshme,
E pavlefshme,
E pavlefshme,
Azra Desiq,
E pavlefshme,
E pavlefshme,
Fatih Basha,
E pavlefshme,
E pavlefshme,
E pavlefshme,
Fatih Basha,
Azra Desiq,
Fatih Basha,
E pavlefshme,
Azra Desiq,
Fatih Basha,
E pavlefshme,

Fatih Basha,
E pavlefshme,
Azra Desiq,
E pavlefshme,
E pavlefshme,
E pavlefshme,
E pavlefshme,
E pavlefshme,
E pavlefshme.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Komisioni Votues për zgjedhjen e një anëtari të Komisionit të Pavarur të Medieve në radhët e komuniteteve tjera paraqet këtë raport para Kuvendit.

Për rezultatet e votimit për zgjedhjen e një anëtari të Komisionit të Pavarur të Medieve nga radhët e komuniteteve tjera. Komisioni votues në përbërje nga një anëtar nga të gjitha subjektet politike, pas procedurës së votimit të fshehtë dhe numrit të votave të deputetëve të Kuvendit për zgjedhjen e një anëtari të Komisionit të Pavarur të Medieve në seancën plenare të mbajtur më 12 korrik 2018, konstatoi:

- në votim kanë marrë pjesë 75 deputetë,
- të pavlefshme janë 40 fletëvotime,

Votat e fituara për kandidatët e propozuar për një anëtar të Komisionit të Pavarur të Medieve nga radhët e komuniteteve tjera janë, si në vijim:

1. Azra Desiq i ka fituar 19 vota, kurse
2. Fatih Basha i ka fituar 16 vota.

Në bazë të këtij rezultati asnjëri nga kandidatët nuk i ka marrë votat e mjaftueshme për të qenë anëtar i Komisionit të Pavarur për Medie dhe procedura përsëritet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit edhe juve si komision!

Atëherë, në bazë të konstatimit të kryetarit të komisionit, konkursi duhet të përsëritet. Faleminderit!

* * *

E enjte, 19 korrik

Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 5 korrik 2018

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Para se të futemi në pikat e rendit të ditës, më lejoni t'ju uroj për lajmin e djeshëm për marrjen e rekomandimit pozitiv për heqjen e vizave për qytetarët tanë.

Ju falënderoj si deputetë, edhe ata të legjislaturave të kaluara që kanë kontribuar për miratimin e shumë ligjeve të rëndësishme që ka ndikuar në këtë proces. Kemi pasur të gjithë bashkërisht sfida, besoj shumë se bashkërisht do të arrijmë me sukses të realizojmë edhe atë që është qëllim parësor i qytetarëve tanë, përmirësimi i jetës së tyre, në mënyrë që të qëndrojnë në Kosovë, të mos lëvizin jashtë dhe në të njëjtën kohë të kemi liberalizim të vizave.

Urime të gjithëve!

Po fillojmë me pikat e rendit të ditës si në vijim:

Pikat e papërfunduara nga seancat plenare të mbajtura më 8, 14, 19, 28 qershor 2018, si dhe më 5, 6 dhe 9 korrik 2018.

Aktualisht në sallë janë 69 deputetë.

Të nderuar deputetë,

Diskutimet për të gjitha pikat e rendit të ditës nga seancat e lartpërmendura kanë përfunduar, por nuk ka pasur kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje.

Andaj, në këtë seancë procedojmë me votimin e tyre.

Visar Ymeri e ka kërkuar fjalën, sigurisht ka diçka.

VISAR YMERI: Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

I nderuar kryeministër,

Kryetar i Kuvendit të Republikës,

Ne tash e një kohë jemi duke diskutuar për një çështje jashtëzakonisht të rëndësishme, e cila fatkeqësisht po vazhdon në Republikën e Kosovës, e në ndërkohë që po shpërfilllet nga Kuvendi i

Republikës së Kosovës. Të gjithë besoj e dini që e kam fjalën për dialogun me Serbinë, në të cilën Kosova prapë po nxitet pa kurrfarë përgatitje diskutimi, thua se deri tash asgjë nuk ka ndodhur e keqe nga ky dialog.

Deri tash, pra prej se ka filluar në vitin 2012 dialogu na e ka ndryshuar edhe emrin politik nga Republika në fusnotë...

KRYETARI: Zoti Ymeri, s'po ta ndal fjalën, se pastaj devijon seanca, po mundësisht për një minutë përmbyle e të futemi në votim.

Nuk prish punë, për një minutë përmbyle, jepe mesazhin, të mos e ndal, se nuk po dua ta ndal.

VISAR YMERI: Vetëm pak ju kisha lutur të dëgjoni, meqenëse po e trajtojmë si çështje urgjente, kjo ka nevojë për arsyetim dhe arsyetimi është ky...

KRYETARI: Zoti Ymeri vazhdo, një minutë e ke, koncentrohu, të lutem, nuk kemi nevojë të krijojmë skena, adresojë si shqetësim çështjen që e ke dhe vazhdojmë seancën.

VISAR YMERI: Çështja urgjente duhet të arsyetohet, sepse diçka që unë mendoj që është urgjente, ju mund të mendoni që nuk është urgjente, prandaj duhet dëgjuar arsyetimin e pastaj të vendoset, jo në fillim, në fund do të kisha thënë.

Pra, siç isha duke thënë, dialogu përveç se ndryshimit të emrit, na e ka fuqizuar edhe zyrtarizuar praninë politike të Serbisë në Kuvend e në Qeveri përmes Listës serbe dhe së fundit rrezikoi të na e kthejë me kokë poshtë rendin kushtetues përmes Bashkësisë së komunave me shumicë serbe, për ta formalizuar kështu ndarjen e thelluar identifikimin etnik në politikë në dëm të barazisë së drejtësisë qytetare, në dëm të integritetit të njerëzve të territorit, në dëm të përbashkimit e funksionalizimit të resurseve të tregut.

Dhe, në vend se ta vemi gishtin në kokë dhe ta marrim seriozisht këtë situatë ku gjendemi, në vend se ta diskutojmë e ta ridizajnojmë dialogun, vendimmarrjen në të, vijat e kuqe për të, e temat që i flasim e ato që nuk i flasim, krerët institucionalë e quajnë...

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Ymeri, janë dy mundësi, nuk desha ta ndal fjalën, se më vjen keq. Është mocioni procedural, si e tha zonja deputete, e të njëjtën kohë e keni edhe një mundësi po sot, e kemi seancën e re, vetëm të shkojmë në votime dhe nuk e besoj se zgjat më shumë se një orë. Të gjithë kanë çka të flasin, të gjithë do të flasin edhe për çështjen e dialogut. Në qoftë se nuk inicion mocion procedural, të futemi në pika të rendit të ditës ose të shkojmë, mos më keqkupto, nuk po dua t'ia ndërpres fjalën as tënden as të askujt.

Shkojmë te pikat e rendit të ditës, Visar, ti e di, edhe kryeministri është këtu, edhe gjithë grupi parlamentar kanë dëshirë të flasin për dialog, po të shkojmë.

Unë nuk ta ndal fjalën për hir të respektit, edhe për hir të lajmit të djeshëm pozitiv, unë nuk po ik nga tema, as nuk po dua të vë në pozitë të vështirë. Po ka procedura, mocioni procedural e fut menjëherë, në qoftë se dëshiron, vetëm inicioje, e fus në votim, e ke edhe të dytën mundësi, menjëherë pas një ore shkojmë në seancën e re dhe pastaj ngrite si çështje, mos më keqkupto.

Ju kisha lutur, nuk është qëndrim politik me të cilën po dua të mbaj qëndrim autoritar, ndoshta do të duhej ndonjëherë, nuk po dëshiroj.

Visar, të lutem! Regjia, 30 sekonda, në qoftë se do të iniciosh mocion procedural.

VISAR YMERI: Kryetar,

Si shkojnë procedurat në Kuvend, nëse ka një çështje urgjente që deputeti ose grupi parlamentar do ta ngre, atëherë ai e merr fjalën menjëherë për ta ngritur këtë çështje urgjente.

Dhe, së dyti, çështja urgjente duhet të arsyetohet, në mënyrë që të tentoj t'i bind deputetët e tjerë që kjo është çështje urgjente dhe të pranojnë atë, pastaj vjen mocioni, ky nuk është diskutim për dialogun.

Unë po dua ta ngre një çështje urgjente që ta kemi pikë në rendin e ditës dialogun ku do të flasin të gjithë dhe pastaj natyrisht secili grup parlamentar do ta ketë të drejtën...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Zoti Ymeri, ne po bisedojmë, për hir të publikut.

Kjo çështja e Rregullores është më e thjeshtë, vetëm se kur të duam e komplikojmë dhe filozofojmë, është shumë e thjeshtë, po, e ke çështjen urgjente, paraprakisht bisedohet, bile e ke, neni 49 në Rregulloren e Kuvendit, e shikoni, në qoftë se unë jam gabim, si grup parlamentar e shtroni si çështje. Sido që të jetë, po shkojmë me këto pika të rendit të ditës, edhe ne do të futemi, jemi në seancë të re, nuk po e bëj, Visar, pse mundem, bile po mundohem të të ruaj për shkak të respektit si deputet, po tash ndoshta edhe kjo butësia ime po krijon mundësi, por Rregullorja është kjo. Qe, Arbeni është i opozitës, mund të bëjë interpretimin nga opozita. Visar, a e vazhdojmë seancën, veç je duke e keqpërdorur butësinë time.

E vazhdojmë seancën...

I ka 30 sekonda, po kërkon të bëjë kërkesë për mocion procedural, kryetar i Grupit Parlamentar të PDK-së, pak më qetë, se dje ka qenë një ditë e mirë, të mos e prishim sot, do të bëjë propozim mocion procedural. Urdhëro, zoti Ymeri, bëje propozimin.

VISAR YMERI: Mirë, atëherë meqenëse nuk po doni ta dëgjoni arsyetimin, unë kërkoj që në mbështetje të nenit 65 të Rregullores, paragrafi 1, pika 1 ta diskutojmë sot si çështje urgjente dhe pastaj edhe ta miratojmë një rezolutë, të cilën do ta propozojmë ne, e të cilën edhe do ta modifikojmë, për të diskutuar për çështjen e dialogut dhe veçanërisht vendimmarrjes në këtë proces të dialogut, në të cilin ne kërkojmë që vendimmarrja t'i bartet Kuvendit, e jo aktualisht siç është një proces edhe jolegjitim, edhe jotransparent, e që është duke vazhduar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Të mos ia prishim hijeshinë të djeshmes, do të bëhet edhe më mirë në të ardhmen, besoni!

5. Votimi i Projektligjit numër 06/L-080 për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi pjesëmarrjen e Kosovës në Programin e Unionit “Konkurrenca e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, COSME 2014-2020”

Të gjitha i kemi kryer, edhe debatin e kemi konsumuar, për votim duhen 80 vota, ne jemi 69, nuk po e vej në votim, 85, në fakt, qenkemi, kërkoj falje se në ndërkohë...

E futim mocionin procedural në votim, ka një mocion procedural.

Zoti Visar Ymeri, edhe një herë nga vendi, të lutem, thirri deputetët, a donë a nuk donë të votojnë, unë e vë në votim propozimin e deputetit Visar Ymerit, në qoftë se votoni për, kalon mocioni procedural, në qoftë se votoni kundër, vazhdojmë me pikat e rendit të ditës, në mënyrë që të mos e komplikojmë, vendimmarrja është juaja.

Zoti Ymer, thirri deputetët!

VISAR YMERI: Pra, edhe një herë, kryetar,

Kërkoj që urgjentisht të diskutohet në këtë seancë, sot pa filluar me të tjerat, çështja e dialogut me Serbinë, e cila po vazhdon nga Zyra e presidentit dhe me të cilën Kuvendi është absolutisht i anashkaluar e i përjashtuar nga vendimmarrja.

Kërkoj nga deputetë që të votojnë që ta pranojnë këtë kërkesë timen për debat në Kuvend.

KRYETARI: Faleminderit!

Shumë i qartë ke deputeti.

Tash shkojmë në votim, në qoftë se votoni për, shkojmë në votim.

Po e komplikoni pa nevojë, se votat i tregojnë grupet.

Kryetarët e grupeve parlamentare, zoti Avdullah Hoti. Qëndrimi i LDK-së.

AVDULLAH HOTI: Ne kërkojmë që kjo çështje të hedhet menjëherë në votim, Grupi ynë Parlamentar e përkrah këtë mocion. Faleminderit!

KRYETARI: Memli Krasniqi, nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës.

MEMLI KRASNIQI: Thënë të drejtën, kur doli zoti Ymeri e foli për çështje urgjente, unë u frikova mos na ka shpallur luftë ndokush, ose thashë ka ndodhur ndonjë tragjedi, për të cilën ende nuk jemi njoftuar.

Nuk është urgjente çështja e dialogut, se kemi biseduar për dialog këta muajt e fundit, nja dhjetë tryeza të ndryshme, ka pasur mundësi të mblidhen 40 nënshkrime, të kërkohet seancë e jashtëzakonshme, mund të kërkojnë debat, interpelancë a çka do, po të mundohesh ta kidnaposh seancën, duke u thirrur në çështje urgjente, kur asgjë urgjente e as e jashtëzakonshme s'ka ndodhur, për ne është e paarsyeshme. Ne kuptojmë nevojën për protagonizëm dhe për të marrë rol politik, është krejtësisht legjitime edhe e mirëseardhur edhe kush mundet, le të vazhdojë.

Por ne mendojmë që nuk ka urgjencë për ta hedhur sot në rend të ditës, si pikë të parë, po mundemi nesër, pasnesër, një ditë tjetër.

KRYETARI: Faleminderit! Glauk Konjufca, fjala për ju.

GLAUK KONJUFCA: Natyrisht që kjo është një çështje urgjente, pajtohemi të gjithë, një debat, një diskutim parlamentar lidhur me dialogun me Serbinë ka munguar, është dashur të ndodhë shumë më herët.

Mirëpo, po ashtu e kam një kritikë për PSD-në, të cilën nuk mund të mos e them. Ndonëse votat do t'jua japim, kjo është hera e fundit që do t'jua japim votat pasi e shajnë opozitën, kështu nuk mblidhen votat duke e sharë opozitën. Domethënë, një ditë më parë të shajnë, e pastaj në Kuvend kërkojnë ndihmë, se është një çështje shumë e rëndësishme.

Pra, po them, votat do t'jua japim, po kjo është hera e fundit që ja u japim votat pasi flasin pa lidhje.

KRYETARI: Ndërkohë do të vazhdojmë me rendin e kryetarëve të grupeve parlamentare. Kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, e ka kërkuar fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Përshëndetje, kryetar i Kuvendit,
Nënkryetar,

Deputetë,
Kolegë të Kabinetit,

Ne kemi furnizuar Parlamentin me raport për të arriturat dhe sfidat në zbatimin e marrëveshjeve nga 2013-ta, një raport konkret, hera e parë është një transparencë e një raporti, ne kemi filluar një përgatitje për një seancë, ku do të mundnim të diskutonim përmbajtjesisht edhe për ata që ka ndodhur deri më tani, ashtu si ka kërkuar një subjekt politik, për një analizë të asaj që ka ndodhur, edhe si duhet të ndodhë më tutje.

Mirëpo, mua më duket që aktivizimi i seancës së sotme për debat është një lloj nxitimi dhe nuk do t'i shërbejë po e them mjaftueshëm temës për shkak se është në nxitim.

Nëse dëshirojmë të mbajmë një seancë për një temë kaq të rëndësishme, që është më me peshë që e kemi në vend, ju kisha sugjeruar që ta merrni kohën e duhur, t'i bëni përgatitjet e duhura dhe të kemi një seancë të përgatitur për të temë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, kryeministër!

Tash PSD-ja e ka thënë çështjen e vet, kalojmë te Aleanca.

A dëshironi prapë zoti Ymeri, Visar Ymeri, në emër të PSD-së, ka të drejtë në emër të grupit.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Vetëm disa sqarime, nuk është kjo çështje as protagonizmi dhe është çështje urgjente. Prandaj edhe e kërkoja që në fillim ta lexoj arsyetimin, në mënyrë që ta kuptojë edhe zoti Krasniqi nga PDK-ja, edhe deputetët e tjerë pse është urgjente, po sido qoftë, këta nuk duan ta dëgjojnë dhe nuk deshën ta dëgjojnë.

Ndërkohë që, për sa i përket qëndrimit të Lëvizjes Vetëvendosjes, konsideroj që është jopolitik në atë se po mundohen ta transmetojnë këtë votë sikur votë ndihmese për PSD-në. Në fakt, ne po flasim për dialogun që unë mendoj se është e dobishme për Kosovën që ta trajtojmë këtë dialog dhe ta marrim vendimmarrjen në Kuvend, jo për PSD-në. Nëse nuk e shihni dialogun si çështje të Kosovës, atëherë po mbase edhe nuk duhet ta votoni.

KRYETARI: Nga pak ka garë, ka! AAK-ja, Ahmet Isufi e ka kërkuar moti fjalën.

AHMET ISUFI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë e shoh se në dy elemente po tentohet të thirret një debat i tillë, një është për ta relativizuar ose për ta zbehur aktin e djeshëm që ka ndodhur në Bruksel për liberalizimin e vizave për

qytetarët e Republikës së Kosovës dhe, njëkohësisht një orë nuk po mund të pritët që të kryhen pikat, të cilat janë vazhdim i seancave të kaluara dhe të kalohet në rendin e ri të ditës.

Unë për një orë nuk e di pse po ju ngutet kaq shumë, nuk është shumë e arsyeshme. Besoj që më shumë është për ta zbehur aktin e djeshëm. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Bilall Sherifi, Nisma Socialdemokrate. Kërkoj falje, Bilall! Lista serbe. Kërkoj falje, zoti Sasha Milosavljeviq.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala, predsedniče!

Poslanička Grupa Srpske liste smatra da već duže vreme odugovlačimo sa nezavršenim tačkama dnevnog reda od prethodnih sednica i da ovo nije toliku hitno da bi bilo na današnjem dnevnom redu pre nego što završimo sa nedovršeno tačkama od prethodnih sednica. Tako da ovaj mi smatramo prvo treba da završimo ono što već duže vreme razvlačimo po skupštini, da izglasamo ovih tačka za koje nismo glasali, pa tek onda ćemo razmotriti zahtev gospodine Ymeri. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Sherifi, në emër të Nismës Socialdemokrate.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, zoti kryetar!

Përshëndetje kolegë,

Të nderuar qytetarë,

Urgjencat kanë natyra të ndryshme, janë urgjenca të sekondave, të minutave, orëve, të ditës dhe urgjenca të javës. Unë këtë e shoh si urgjencë ditore, por nuk e shoh si urgjencë të orës, e shoh si nevojë që të debatojmë sot, por nuk e shoh si nevojë që të debatojmë tash, menjëherë, për faktin se i kemi disa ligje, ku jemi një numër i konsiderueshëm i deputetëve dhe mund t'i kalojmë dhe të vazhdojmë pastaj në seancën e radhës dhe ne deputetët e Nismës do ta mbështesim këtë çështje të hyjë si pikë e rendit të ditës në seancën e re, por jo në këtë seancë.

Pra, ne mendojmë që duhet të vazhdojmë t'i votojmë, t'i heqim nga rendi i ditës këto pika, për të cilat të gjithë jemi të vetëdijshëm se kanë po aq urgjencë, për faktin se janë pika të grumbulluara nga...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: 6+, ju lutem! Zoti Albert Kinolli!

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Mendoj se nuk ka asgjë të keqe për debat parlamentar për një çështje kaq të ndjeshme. Aty ku debatohet, nga debati mund të dalë diçka pozitive, mirëpo duke pasur parasysh agjendën shumë të ngarkuar dhe pikat e rendit të ditës që kemi për votim dhe besoj numri i mjaftueshëm të deputetëve që këto pika, të cilat veç tani janë mbledhur që sa kohë, e nuk po mund t'i votojmë, mendoj që së pari duhet t'i votojmë, me këtë rend të ditës që e kemi përpara dhe pastaj, pse jo, mund të debatojmë. Faleminderit!

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë, para se të shkoj në votim, po e shoh qëndrimin, a ka mundësi të takohemi këtu me kryetarët e grupeve parlamentare, e kam një propozim, para se të shkojmë në votim. Në minutë, takohemi këtu përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Ka të bëjë për këtë çështje, një minutë, në qoftë se dëshironi.

(Ndërprerje incizimi)

Të nderuar kolegë deputetë, kemi probleme teknike. Pesë minuta s'po lëvizim nga salla, ristartohet sistemi. Të dëgjoni me vëmendje administratën, pjesën e IT-së, se kanë probleme teknike. Lëvizini kartelat të gjithë, largohuni një herë të gjithë, pastaj i vendosni prapë. Largoni kartelat, kur thotë regjia, unë ju tregoj e i vendosni prapë, se nuk po mund të identifikojnë prezencën, pastaj edhe votimin nuk mundemi. Largoni pak kartelat të gjithë!

Koleg i IT-së, shkoni në pjesën tuaj, pastaj si të më thoni ju, unë vepro, sipas të gjitha gjasave kemi një marrëveshje të përbashkët me kryetarët e grupeve parlamentare edhe për çështjen e ngritur. Ka të bëjë me mirëkuptimin dhe në të njëjtën kohë mbarëvajtjen e seancës.

(Ndërprerje incizimi)

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë, futni kartelat. Sipas të gjitha gjasave, mund të vazhdojmë seancën. Ta marrim vetëm një konfirmim nga sektori i IT-së.

Ju lus, kolegët deputetë të kthehen në sallë. Aktualisht jemi 81 deputetë, kemi mundësi që pikën e parë të rendit të ditës, votimi i projektligjit... Më fal!

Para se të futemi në vazhdimin e seancës, kemi një marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare. Posa të përfundojmë këto pikat e papërfunduara të vazhdimin të seancës, Grupi Parlamentar i Partisë Socialdemokrate në seancën e re do të propozojë menjëherë mocionin procedural për dialogun dhe kemi pajtueshmëri të grupeve parlamentare që të jetë në seancën e radhës. Menjëherë do të vihet, në bazë të propozimit të Grupit Parlamentar të Partisë Socialdemokrate.

5. Votimi i Projektligjit nr. 06/L-080 për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi pjesëmarrjen e Kosovës në programin e Unionit “Konkurrenca e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme COSME, 2014/2020”

81 deputetë janë në sallë. Ka mundësi për votim. A ka dikush pa kartelë? Një deputet është pa kartelë, do ta marrim votën në mënyrë teknike. Në këtë projektligj është propozuar një amendament nga Komisioni Funkcional. Për miratimin e tij kërkohen së paku 80 vota për. A shkojmë në votim në mënyrë elektronike apo vetëm në mënyrë formale?

87 deputetë. A ka dikush kundër? 87 deputetë janë në sallë, ama për amendamentin jam duke folur, pastaj projektligjin do ta votojmë në mënyrë elektronike, për amendament vetëm me dorë do të votojmë.

A ka dikush kundër? A ka abstenim? Amendamenti i propozuar me 87 vota miratohet, 86.

Tani shkojmë në votimin e projektligjit në tërësi. Regjia dhe deputetët të përgatiten për votimin e Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian 2014/2020, konkurrenca e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Votojmë tash!

Janë 70 deputetë që kanë votuar. 61 për, 9 abstenime, gjersa i kemi 86 deputetë në sallë, edhe një me dorë, por megjithatë nuk është arritur cilësia e kualifikuar për ta trajtuar të votuar. 86 deputetë janë në sallë. Unë edhe një herë do ta vë në votim në bazë të rregullit që e kemi. Po e përsërisim.

I kisha lutur deputetët që ta votojmë. Kur të përgatiten deputetët votojmë edhe një herë. 86 deputetë janë në sallë. Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

71 deputetë kanë votuar, 62 për, asnjë kundër, 9 abstenime. Nuk ka kuorum. Unë do ta provoj nga fundi i rendit të ditës edhe një herë. Nuk konsiderohet i votuar.

12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-024 për trajtimin e ndërtimeve pa leje

Në këtë projektligj janë propozuar gjithsej 28 amendamente. Amendamenti nr. 1 është miratuar në seancë plenare të mbajtur më 12 korrik 2018. Do të vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara sipas radhitjes së paraqitur në raport nga Komisioni Funkcional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor.

Unë do të shkoj pothuajse një nga një, për arsye se ka ndërhyrje në secilin amendament, propozim të një grupi parlamentar, Komisioni Funkcional ka qëndrim. Vetëm çështja është se a

mund ta konstatoj prezencën dhe e pyes vetëm kush është kundër më tepër. Atëherë e marr të cilësuar për të gjithë. A ka konsensus në këtë pjesë? Atëherë, shkojmë në mënyrë elektronike.

Amendamenti 1, propozim i Grupit Parlamentar Lista serbe, pa përkrahje të Komisionit FunkSIONAL. Votojmë tash!

53 deputetë kanë votuar. 11 për, 37 kundër, 5 abstenime. Nuk ka 85 deputetë në sallë, nuk ka votim.

Shkojmë edhe një herë. Çka u politizua ky ligj nuk e di, po nuk po votohet.

Amendamenti 2, propozim i Grupit Parlamentar Lista serbe, pa përkrahje të Komisionit FunkSIONAL. Votojmë me elektronikë. Votojmë tash!

61 deputetë kanë votuar. 9 për, 44 kundër, 8 abstenime. Nuk kalon ky amendament.

Amendamenti 3, propozim i Grupit Parlamentar Lista serbe, pa përkrahje të Komisionit FunkSIONAL. Votojmë tash!

59 deputetë kanë votuar. 9 për, 44 kundër, 8 abstenime. Votojmë edhe një herë.

Amendamenti 3, propozim i Grupit Parlamentar Lista serbe, pa përkrahje të Komisionit FunkSIONAL. Kemi prezencë në sallë, 85 deputetë janë. Votojmë tash! 87 deputetë janë në sallë.

60 deputetë, 9 për, 43 kundër, 8 abstenime. Ju kemi afruar... 87 deputetë janë në sallë. Me emra të përveçëm, secili e ka në mënyrë elektronike një mundësi për të votuar. Edhe një herë po e vë, pasi qenë 60 deputetë.

Amendamenti 3, propozim i Grupit Parlamentar Lista serbe, pa përkrahje të Komisionit FunkSIONAL. Votojmë me elektronikë. Votojmë tash!

61 deputetë kanë votuar. 11 për, 44 kundër, 8 abstenime. Nuk kalon amendamenti 3.

Amendamenti 4, me përkrahje të Komisionit FunkSIONAL.

Votojmë tash! 50 deputetë. 42 për, 7 kundër, 1 abstenim. Nuk ka pasur kuorum të mjaftueshëm. 87 deputetë janë në sallë.

Edhe një herë do të votojmë amendamentin 4, me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Votojmë tash!

Në dukje, ky ligj nuk është shumë i politizuar, por nuk e di çka është duke ndodhur. Janë 87 deputetë në sallë.

Kryetarë të grupeve parlamentare, a dëshironi ta votojmë apo po e lëmë për ndonjëherë tjetër krejt, a çka më? Po de, veç varen shumë familje nga ky ligj. Unë dua ta mbaj një konsultim. Të shkojmë në pauzë, për arsye se jemi brenda ligjit. Po shoh një entuziazëm nga Lidhja Demokratike e Kosovës. Nuk e di a është... që s'po votohet. A e provojmë edhe një herë, pastaj po shkojmë në pauzë pak. S'është problem, kjo është demokracia. Nganjëherë po dalin 61, nganjëherë 59... kjo është demokracia.

Edhe një herë amendamenti 4, me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Kush është kryetar i komisionit? A kanë qenë të gjitha partitë për? A, qëndrim politik!?

Hajde po e votojmë edhe një herë, me përkrahje të Komisionit FunkSIONAL, amendamenti 4. Votojmë tash!

Shkojmë në pauzë 10 minuta.

Shikoni, shefat e grupeve parlamentare, në qoftë se ka mundësi një minutë, prapë po takohemi këtu, të mos të dalim jashtë salle.

(Ndërprerje e incizimit)

Administrata, në qoftë se ka mundësi, zilen. Kthehemi në sallë. Po vazhdojmë seancën.

(Ndërprerje e incizimit)

I kisha lutur deputetët të kthehen në sallë.

(Ndërprerje e incizimit)

Administrata mundësisht, sa deputetë janë në sallë?

75 deputetë janë në sallë. Jemi tek amendamenti 4, me përkrahje të Komisionit FunkSIONAL, projektligj tepër me rëndësi, konsensus i paparë brenda komisionit, por në seancë diçka s'po na ecën. Shkojmë në votim. Tash dalim edhe te ajo pjesë.

Votojmë amendamentin 4 me përkrahje të Komisionit FunkSIONAL. Kush është për, kundër, abstenim, apo çfarëdo? Votojmë tash!

Kjo është situata. 51 deputetë. 41 për, 10 kundër, 0 abstenim.

Për hir të publikut dhe për hir të kolegëve deputetë, për afërsisht situata është pak a shumë e qartë. Një pjesë e opozitës nuk voton, zyrtarisht s'është thënë, nuk do të votojnë për të bërë 61 deputetë, është një lloj gjysmëbojkoti i pashpallur. Në raste të tilla, ne nuk mund të vazhdojmë seancën, për arsye se s'ka votim.

Atëherë, Memli Krasniqi, urdhëro. E ka kërkuar fjalën, se duhet të kemi një vendimmarrje. Fundi i fundit, është legjitime kjo.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Është evidente që jo vetëm në këtë seancë, por që disa seanca radhazi, veçanërisht javëve të fundit, një pjesë e opozitës nuk merr pjesë në votim, nuk e përmbush detyrën e vet, mandatin që e ka, qoftë të votojë pro, kundër. Me siguri mund të themi se është e drejtë legjitime e tyre, por në një situatë të tillë nuk ka kuptim as vazhdimi i kësaj seance e asnjë seance tjetër. Neve na vjen keq, sepse ne u dakorduam me iniciativën tuaj edhe për seancën e radhës, edhe për mocionin që e propozoi Grupi i PSD-së, që pasi të kryhen votime dhe këto votime nuk po kryhen, por pasi që të kryhen këto votime, ne të shkojmë në seancën e radhës, ta votojmë mocionin dhe të fillojmë të diskutojmë për temën që u ngrit.

Por, në një situatë të tillë ne nuk mund të marrim pjesë as në atë seancë, sepse nuk jemi ne këtu..., nëse opozita s'është t'ia bëjë kuorumin pozitës, as pozita nuk është për t'ia plotësuar dëshirat opozitës.

Nuk besoj se ka kuptim që të vazhdojë kjo seancë, se po shihet, pozita nuk i ka 61 deputetë sot në sallë dhe nëse nuk marrin pjesë as për ligjet tepër të rëndësishme për qytetarët e Kosovës, si Ligji i trajtimit të ndërtimeve pa leje, ose të shkojmë edhe një hap tutje. Nëse një pjesë, në këtë rast konkretisht grupi i LDK-së, nuk i voton as Marrëveshjen e Kosovës me Bashkimin Evropian që u ndihmon ndërmarrjeve të Kosovës pas shumë vjetëve që kemi tentuar të gjithë bashkërisht të marrim pjesë në programet e BE-së dhe, edhe këtë e refuzojnë, kjo për mua, thënë të drejtën, personalisht po flas, kjo as politikë nuk është. Kësaj unë nuk di të vë emër, por është çështje e tyre.

Sidoqoftë, unë ju flas në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, nëse siç u pa edhe në këtë votim, nuk do të ketë sukses, ne mendojmë që ta përfundojmë këtë seancë. Do të shkojmë, nëse javën e ardhshme e caktojmë apo kurdo që të vendosë Kryesia, në një seancë. Do të konsolidohemi, vijmë dhe i votojmë pa pasur nevojë për opozitën fare. Faleminderit!

KRYETARI: Shkojmë në pauzë deri në orën 14:00.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës
Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

Të nderuar kolegë deputetë,
E kemi një situatë reale, në të cilën ka deputetë në sallë, deri në 87, por të njëjtën kohë ka një qëndrim të padeklaruar, që një pjesë e opozitës nuk do të votojë.

Në rrethana të tilla, unë do ta vë në votim edhe një herë.

(Ndërprerje e incizimit)

Jemi në vazhdim të seancës, amendamentin 4. Në qoftë se nuk kalon, ne duhet ta ndërpresim seancën. Kjo është ajo dhe të njëjtën kohë pastaj e thërrasim me Kryesinë mbledhjen e radhës për këtë çështje.

Atëherë, unë edhe një herë po e vë në votim, pastaj ua jap fjalën kryetarëve të grupeve parlamentare, për korrektësi, pasi që është situatë e re pas votimit edhe pastaj e bëjmë vendimmarrjen.

Amendamenti 4, Komisioni Funkcional, shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-024 për trajtimin e ndërtimeve pa leje. Votojmë tash!

46 deputetë kanë votuar. 75 janë në sallë. 40 kanë votuar për, 6 janë kundër. A jua jap fjalën nga pak dhe relaksoheni, apo dëshironi ta ndërpresim. Reagimet janë se pastaj sot nuk do të ketë seancë. Pak më herët kur i pata grupet parlamentare përfundon me kaq. Do të thotë, po ikni edhe prej dialogut, debatit për dialog, po largoheni?

Ndërpritet seanca.

Kryesia mblidhet. E thërrasim seancën e radhës. Duhet përfunduar një herë një seancë për të dalë në tjetrën.

* * *

E hënë, më 23 korrik 2018

Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 5 korrik 2018

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas rendit të ditës të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit në mbledhjen e mbajtur më 19 korrik 2018.

Fillojmë me rendin e ditës, jemi te pikat e papërfunduara nga seancat e mbajtura më 8,14,19, 28 qershor dhe 5,6,9,12,19 korrik 2018, shumica janë projektligje, të cilat për mungesë të deputetëve kanë mbetur të pavotuara.

Diskutimet për të gjitha pikat e lartpërmendura kanë përfunduar, por nuk ka pasur kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje. Andaj, në këtë seancë do të procedojmë vetëm me votimin e tyre.

E kemi një projektligj, i cili kërkon 2/3 e kolegëve deputetë. 71 deputetë janë aktualisht në sallë. Po e kaloj këtë, në momentin kur të bëhemi 81 futemi në votim, deputetët janë duke ardhur.

12. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit nr. 06/L-024 për trajtimin e ndërtimeve pa leje

Në këtë projektligj janë propozuar gjithsej 28 amendamente. Amendamenti numër 1 është miratuar në seancën plenare të mbajtur, më 12 korrik 2018. Ndërsa, dy amendamentet e tjera, 2 dhe 3, nuk janë miratuar në seancën plenare të mbajtur më 19 korrik 2018. Vazhdojmë me votimin e amendamenteve të tjera sipas radhitjes së paraqitur në raport nga Komisioni FunkSIONAL për Bujqësi.

Amendamenti 4. Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim! Amendamenti 4, me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL, votojmë tash!

Po e shihni edhe vetë, nuk ka kuorum. Edhe një herë e nxjerr në votim, kemi kohë gjithë verën, mos u ngutni hiç. 79 deputetë, kur bëhen 81, kthehem pastaj te ai 80-shi prapë. Kemi kohë, mos u ngutni, edhe vera me shi po merr.

Amendamenti 4, me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Regjia dhe deputetët, 81 deputetë janë në sallë, shkojmë për votim, votojmë tash!

Është situatë e njëjtë, 10 minuta pauzë, pastaj vazhdojmë prapë.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës
Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Atëherë edhe një herë jemi te amendamenti 4. Deputetë, mundësisht çka e kanë ndërmend të votojnë, bjerini ziles, le të vijnë!

Faleminderit! 84 deputetë janë në sallë. Po i kthehemi edhe një herë pikës me 2/3.

5. Votimi i Projektligjit nr. 06/L-080 për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi pjesëmarrjen e Kosovës në Programin e Unionit "Konkurrenca e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme COSME) 2014-2020"

Amendamenti i propozuar në këtë projektligj është miratuar në seancën plenare të mbajtur më 19 korrik 2018. Pjesëmarrja ndërkombëtare e Kosovës është shumë me rëndësi, e bashkon pozitën dhe opozitën. Shkojmë për votim, votojmë tash!

92 deputetë janë aktualisht në sallë. S'paska qenë shumë e rëndësishme, se s'po e votojnë, 72 deputetë kanë votuar, 63 për, 9 abstenime.

Shkojmë prapë te pika:

12. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit nr. 06/L-024 për trajtimin e ndërtimeve pa leje

Jemi te amendamenti 4. I pari ka kaluar, i dyti dhe i treti nuk kanë marrë miratimin e këtij Kuvendi. Jemi te amendamenti 4, me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL, votojmë tash.

67 deputetë kanë votuar. 57 për, 10 kundër, asnjë abstenim. Kalon amendamenti 4.

Shkojmë te amendamenti 5. Propozim i Grupit Parlamentar Lista serbe, kisha kërkuar nga Lista serbe amendamentet e tyre t'i vë të gjitha apo një nga një, varet nga Lista serbe? A dëshironi një nga një apo të gjitha bashkë? Sasha Milosavljeviq po thotë menjëherë të futen të gjitha bashkë. Urdhëro, zoti Sasha Milosavljeviq, unë do t'i ndaj, pastaj do t'i lexoj saktësisht një nga një cilat janë kur futen bashkë në qoftë se pranon Grupi Parlamentar Lista serbe. Urdhëro, zoti Milosavljeviq!

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala, predsedniče!

Poslanička Grupa Srpska lista se slaže da staviti sve amandmane da glasamo od jednom.

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë, kisha dëshiruar vëmendjen e grupeve të tjera parlamentare po ashtu. Unë do t'i lexoj vetëm ato të cilat janë të Listës serbe, pastaj do të kthehem te amendamentet që janë në radhitje, si për shembull 7 e tjera.

Amendamenti 5. Propozim i Grupit Parlamentar Lista serbe, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Amendamenti 6 po ashtu. Amendamenti 8, amendamenti 9, gjithmonë propozim i Grupit Parlamentar Lista serbe pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL, amendamenti 10, amendamenti 11, amendamenti 12, amendamenti 13, amendamenti 15, amendamenti 17, amendamenti 19, amendamenti 20, amendamenti 22, amendamenti 23, amendamenti 24, amendamenti 25, amendamenti 26, të gjitha janë propozim i Grupit Parlamentar Lista serbe, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL me kërkesën e Grupit Parlamentar Listës serbe votohen të gjitha përnjëherë, në mënyrë elektronike.

Ftoj deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash!

72 deputetë kanë votuar. 12 për, 52 kundër, 8 abstenime. Të gjitha këto amendamente, të cilat i lexova, nuk kalojnë.

Amendamenti 7, me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash.

65 deputetë kanë votuar. 55 për, 9 kundër, 1 abstenim.

Do të shkoj të gjitha përnjëherë të tjerat çka janë me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Administrata më përcjell.

Amendamentet 14, 16, 18, 21, 27 dhe 28, të gjitha bashkarish, vëmendje kolegëve deputetë, shkojmë të gjitha me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL, i votojmë në tërësi. Regjia dhe deputetët përgatiten për votim. Votojmë tash!

67 deputetë kanë votuar. 56 për, 9 kundër, 2 abstenime. Kalojnë të gjitha amendamentet e propozuara.

Tani jemi te votimi i tekstit të projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash.

94 deputetë janë në sallë. 66 deputetë kanë votuar. 56 për, 10 kundër, 0 abstenime.

Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 06/L-024 për trajtimin e ndërtimeve pa leje. Urojmë qytetarët e Republikës sonë për këtë ligj.

Shkojmë edhe një herë, 94 deputetë janë në sallë. Votimi i Projektligjit nr. 06/L-080 për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian, duhen 2/3 të votave. Votojmë tash!

Ndërpritet procesi i votimit, kërkoj falje, edhe një herë do ta vë në votim. Regjia, na bëj me shenjë kur jeni gati, në rregull. Përgatitemi për votim, e votojmë tash marrëveshjen ndërkombëtare.

Është duke u shkrirë bojkoti i një pjese të opozitës, avash-avash. Kemi kohë.

15. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

Në këtë projektligj janë propozuar gjithsej 8 amendamente, vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara sipas radhitjes së paraqitur në raport nga Komisioni FunkSIONAL për Administratë Publike.

Amendamentet 1, 2, 3 janë nga deputeti Armend Zemaj. Nuk është prezent deputeti. A shkojmë të tria përnjëherë, pa përkrahje të Komisionit FunkSIONAL, janë propozime të deputetit Armend Zemaj. Po shkojmë, tri amendamentet janë propozime të deputetit Armend Zemaj pa përkrahje të Komisionit FunkSIONAL. I votojmë të tria amendamentet menjëherë në mënyrë elektronike, i votojmë tash!

71 deputetë kanë votuar. 8 janë për, 56 kundër, 7 abstenime. Nuk kalojnë këto tri amendamente.

Jemi te amendamentet 4, 5, 7 dhe 8. I votojmë bashkë, me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL, e amendamentin 6 e votojmë ndaras, për arsye se ka reagim. Amendamentet 4, 5, 7 dhe 8 votohen bashkërisht, regjia dhe deputetët të përgatiten për votim, me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL, votojmë tash.

69 deputetë kanë votuar. 58 për, 5 kundër, 6 abstenime. Kalojnë amendamentet 4, 5, 7 dhe 8.

Amendamenti 6. Komisioni për Buxhet dhe Financa, me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL qenka edhe ky, votojmë tash!

69 deputetë kanë votuar. 58 për, 8 kundër, 3 abstenime. Miratohet amendamenti 6. Votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara, votojmë tash!

68 deputetë kanë votuar. 58 për, 1 kundër, 9 abstenime.

Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

* * *

15. Votimi i raportit vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për vitin 2017

Komisioni FunkSIONAL ka rekomanduar miratimin e këtij raporti, votojmë tash.

65 deputetë kanë votuar. 52 për, 8 kundër, 5 abstenime.

Kuvendi e miratoi raportin vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për vitin 2017.

16. Votimi i raportit vjetor të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2017

Komisioni FunkSIONAL ka rekomanduar miratimin e këtij raporti. Votojmë tash!

Nuk ka kuorum të mjaftueshëm për votim, votojmë edhe një herë. Kush është me dorë? Atëherë, 60 deputetë kanë votuar në mënyrë elektronike. 50 për, 1 kundër, 9 abstenime, 1 me dorë. Cila është vota juaj, deputet? Për! 61.

Administrata, se po ka konfuzion te deputetët, mos keqkuptoni, se po e vërej, le të vërtetohet a t'i shikojmë a është votë apo jo. Administrata, të lutem! A e përsëris edhe një herë? Për shkak se nganjëherë po ka probleme, po ka keqkuptime.

Shkojmë edhe një herë në votimin e raportit vjetor të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2017. Votojmë tash! Me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

61 deputetë kanë votuar. 51 për. 10 abstenime. Po shihet, vota e Gani Dreshajt po ashtu, si deputet. Faleminderit! Kalon raporti.

Kthehemi edhe një herë te:

5. Votimi i Projektligjit nr. 06/L-080 për ratifikimin e Marrëveshjes ndërkombëtare në mes Kosovës dhe Bashkimit Evropian për pjesëmarrjen e Kosovës në programin e Unionit të konkurrencave të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, 2014/2020

Votojmë tash! 80 vota duhen.

79 vetë... Ka shkrirje të pjesërishme. A e ke edhe një votë, a? S'po punon.

79 kanë votuar. Pavarësisht, edhe po qe se janë 80 deputetë, 9 janë abstenime. Duhet 80 për, kine parasysh. Kështu që po e lëmë për... kemi kohë gjatë pushimeve verore edhe një herë...

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*